

SAFIR KROMI . RASTËSIA, SI U BËRA MATEMATIKAN!

Safiri nuk ishte i përzënë nga fati njerëzor për t'u bërë matematikan, dymbëdhjetë herë kur:

- (1) Në gjimnaz u erdhi për herë të parë, mësuesi i matematikës me diplomë fakulteti;
- (2) Nxënësi i dalluar nuk e dinte matematikën; ai mbeti për t'u riprovuar në vjeshtë;
- (3) Miku i shpisi ia zgjidhi saktësisht të gjitha detyrat e librit (310) sish; nga Trigonometria; Gjeometria analitike; Planimetria dhe Stereometria; pjesa më e madhe e së cilave ishin të zgjidhura gabimisht;
- (4) Nuk u aftësua dot ta flas lirshëm gjuhën serbokroate;
- (5) Kuvendarët e vendlindjes morën vendim për hapje të SHLP-Dega e Matematikës;
- (6) Kryefamiljari mezi e bindi vëllain për ta regjistruar SHLP; fillimisht pa e caktuar Degën;
- (7) Kuvendi i Komunës shpallë Konkurs për matematikanë të diplomuar; 'me pagë marramendëse';
- (8) Kundërshtarët e Kushtetutës së ('74), një vit më pas e krijuan 'përbindëshin' e shkollimit të mesëm QAMO, së cilës nuk i dihej as 'koka e as bishti!' Maskaradën e saj e zbuluan 'politikanët e pa shkollë'-si një 'rrenim i heshtur i shkollës shqipe!' Po këta, tamam në vigjilje të Epokës së Informatikës, matematikanin me vështrim e mendim kritik; me qëndrime e analiza kritike e veçuan nga mësimdhënësit tjerë që e rrethonin, për ta emëruar "*Ministër komunal për shërbime shoqërore*" (Arsim; Kulturë; Kulturë Fizike; Punë Sociale; Shëndetësi).Kjo ishte 'lotaria jetësore' më e madhe e ndodhur shumë rrallë;
- (9) Konkurroi dhe u pranua ligjërues i SHLP-Dega e Matematikës; për lëndën mësimore MMM;
- (10) MMM ishte një 'oazë e pashkelur' nga matematikanët shqiptarë, të cilët haptazi pranonin që 'atësia' e saj i përkiste Pedagogjisë, thënë ndryshe ajo konsiderohej disiplinë shkencore 'kopile';
- (11) E 'zbuloi' që MMM ishte pa zot shpie! Puna që do bëhej aty do jetë 'pa ortakëri';
- (12) Përfunduar MMM('87); tek të tjerët, Recensent libri për MMM ishte matematikani altruist, anëtar i ASHAK të cilit i përket merita madhore që nuk lejoi të 'tjerët me grada', Safirin ta shndërronin në një hiç!

Radhitje tejet specifike *shkaqesh* dhe *rrethanash* të cilat asnjëra nuk ndodhej në dorën e Safirit përveç *pasojave* të cilat e kërkonin me ngulm shërbimin që do duhej ta bënte me punë intelektuale. Ishte një shtjellim ngjarjesh dhe ndodhish të rrokullisura tepër shumë rastësisht në jetën e tij të cilat edhe po të ishin të 'programuara' dhe rezultative, 'mendja e shëndoshë' do thoshte që diku përgjatë këtij shtegtimi 'do ngelë sharra në gozhdë' dhe sukseset do ndërpriteshin! Athua ku ndodhej sekreti i një rasti të tillë, me gjasë i papërsëritshëm?!

Për të arritur sukses në jetë personin duhet ta përcjellin gërshetim rrethanash e lidhje ngjarjesh të ndodhura rastësisht, të 'vulosura' nga **fati**, do të thotë paraqitje e një rasti të volitshëm, i cili mund të ndodhë rrallë dhe *mençuria*, do të thotë rastin në fjalë ta shfrytëzojë në mënyrën më të mirë t' mundshme. Asgjë nuk ndodhë rastësisht! Rastësia është pjesë e rëndësishme e fatit.Po qe se udhëheqësh nëpërmjet iluzioneve fati të tradhëton! Libërthi është shkruar si kujtesë për fëmijët tuaj dhe fëmijët e fëmijëve tuaj!

PASQYRA E LËNDËS
RASTËSIA, SI U BËRA MATEMATIKAN

I. Fëmija i tetë në familje	3
II. Kultivues duhani në moshën tetë vjeçare	6
III. Nxënës i dalluar i gjeneratës	8
IV. “Kartoni i gjelbër” i “shkollës pa zanat”	13
V. Nga Lubjana kryengulthi-mësues në Çermian	22
VI. “Dëshira” për të jetuar mes tymit e hirit vdekjeprurës	26
VII. “Fundi i tunelit”- “ndjenja miqësie” me “matematikën e frikshme”!	29
VIII. Motivi material e flak matematikëfobin	32
IX. Ndërrim vendesh punësh si kollare!	35
X. Botimi i librit të parë, METODIKA E MËSIMIT TË MATEMATIKËS (’87)	39
XI. Botimi i librit të dytë, METODIKA E MËSIMIT ELEMENTAR TË MATEMATIKËS (’93)	44
XII. Botimi i librit të tretë, METODIKA E MËSIMDHËNIES SË MATEMATIKËS (’98)	50
XIII. Botimi i librit të katërt, METODIKA E MËSIMIT ELEMENTAR TË MATEMATIKËS (’03)	54
XIV. Botimi i librit të pestë, METODOLOGJI E MËSIMDHËNIES SË MATEMATIKËS (’08)	72
XV. Botimi i librit të gjashtë, LOJËRAT MATEMATIKE ME METODIKË (’13)	76
XVI. Turpi i Akademikut të rinj, Anëtar Redaksie Enciklopedie!	79
XVII. Tregimi për librat dhe botimi i librit të shtatë, MMM (2020)	83
XVIII. Kopertinat e librave	103
XIX. Matematika nuk mund të jetë gogoli i vetvetës!	108
XX. Në vend të përfundimit	111

I. FËMIJA I TETË NË FAMILJE

Popullësia shqiptare gjithandej ku shtrihej e dyndur por dhe e asimiluar, përgjatë kohërave të tejshkuara krahasuar me shumë popuj të tjerë, edhe pse veçohej me shkallë të lartë lindshmërie, megjithatë nuk rritej e shtoej! Tek shqiptarët gjithnjë kishte një numër të madh jetësh të humbura. Një pjesë e konsiderueshme e tyre fironin në prag martesë! Rrjedhjet e jetëve të humbura vinin nga konfliktet e luftërat e vazhdueshme për mbijetesë dhe pavarësi, së bashku me shërbimet e detyrueshme ushtarake disa vjeçare në shërbim të huajve (kur pjesë e madhe e të rinjëve nuk ktheheshin gjallë), pastaj nga doket e zakonet e mbrapshta ndërshqiptare, vdekshmëria foshnjore, lëngatat dhe sëmundjet vdekjeprurëse etj. Brezi i stërgjyshërve, gjyshërve por edhe i prindërve tanë, e ‘përsëritnin gojarisht’ por edhe e ‘zbatonin praktikisht’, që çdo zot shtëpie ‘me fëmijë nuk ngopet kurrë’ sepse jetës nuk i dihet! Martesat ishin të hershme sepse edhe mosha mesatare e popullësisë sillej rreth të gjashtëdhjetave!

Në kohën kur gjithçka mungonte (ushqimi, veshmbathja e shkollimi) dhe kur lypësia filloi të ushtrohej si një profesion, erdhi ta shoh dritën e kësaj bote përplot me halle dhe telashe, vëllai i katërt, më i vogli i familjes Kromi, por edhe në fund të Luftës së Dytë Botërore atëherë kur çdo artikull jetësor të thuash mungonte! Kësaj i shtoej që isha i lindur për t’iu bërë naze ushqimeve! Dhe që në nismë kisha një ‘rritë të kushtëzuar’ paksa më të ngadalshme, me disa ecejake jetësore të rastësishme, të paplanifikuara bile shumë të pazakonshme si çudibërëse, të cilat kishte për t’i lakmuar gjithsecili!

Safiri rrjedhë nga një familje zejtare: nga babai zhgun-qepës dhe e ëma prodhuese në avlëmend (vegël e madhe druri për të endur pëlhurë). Ndodhi të isha fëmija i tetë në familje, i lindur në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur çdo familje çonte jetë me shtrëngime! Në fëmijërinë e hershme familja jonë përdorte bukë misri si shumica e popullit shqiptar. Atë e dërgonim herët në mëngjes për ta pjekur në furrën me drurë të mëhallës, ku burim jetese ishte lopa të cilën për fat të keq nuk e kishin të gjitha familjet! Ushqimi i mëngjesit zakonisht ishte me bukë misri, qumësht të nxehtë, djathë, vezë, reçel, suxhuk e të ngjashme. Kalimi nga të ushqyerit me ‘bukë misri’ në atë me ‘bukë gruri’ ndodhi kur unë i kisha mbushur pesë vjeç. Buka e grurit gatuhej në magje të shtëpisë dhe çohej në furrë të mëhallës për ta pjekur, në orët e vona të paradites. Atëbotë ka ndodhur edhe këmbimi i *një copë bukë misri me një copë bukë gruri* ndërmjet fqinjëve e familjarëve. Në cilësinë e artikullit ushqimor, mishi është blerë shumë rrallë dhe me pakicë (një gjysmë, një deri në tre kilogramë), teprica e të cilit si i papërdorur (i mbështjellë) është futur për t’u ruajtur në fund të pusit të thellë (7-10 metra) nëpërmjet një çengeli të lidhur me litar (por pa e prekur ujin e pijës) në cilësinë e frigoriferit! Mish pule është përdorur më shpesh dhe kultivimi i pularive në oborre ka qenë aktivitet i zakonshëm, duke siguruar mishin dhe vezët! Piteja (byreku) e gatuar me petë të holla e grunjte, ndërmjet petëve të së cilës futej kosi i kulluar, djathi, vezët, gjalpë, lakrat, kungulli... numrohej ndër ushqimet e parapëlqyera. Paraja nuk gjëndej gjithnjë në duar të njerëzve; një pjesë zejtarësh kryenin punë pa para në dorë (veresije)!

Të rritesh në një familje si fëmija më i vogël kishte edhe përparësi! Ushqimet dhe veshmbathjet e munguara por edhe dhuratat nga vizitat e rralla i përkithnin më të voglit. Qumështi vloej në prush në një kusi bakri e kallajsur, në sasi gjashtë litrash dhe pas valimit të tij kusia gërryhej nga më i vogli duke ngrënë një masë yndyrore të rreshkur, me shije të ‘çokolatës’! Nga ato pak para që i kisha nëpër xhepa, për çdo ditë vizitoja ëmbëltoret ndërsa përgjatë stinës së verës harxhimit i kisha për pemë.

Babai i Safirit - Ozoni që në moshën shtatë vjeçare bashkë me të motrën - Florën tre vjet më e vogël mbeten jetimë. Për rritën e tyre ishte përkujdesur nëna e tyre Xhemi, atëherë njëzetë e pesë vjeçare! Axha Jodi i shkolluar në Shqipëri, djal axhe me Ozonin kishte bërë përpjekje ta merrte me vete për shkollim në Shqipëri mirëpo nëna e tij Xhemi nuk kishte lejuar, me arsyetimin që Jodi e ka një vëlla (Bromin) ndërsa Ozoni është pa vëlla bonjak dhe nëse largohet nga shtëpia mund t'i mbyllet sofa!

Nënë e Safirit, hanmin Drita Neone njerëzit e mbanin në mend për grua punëtore të shkathët me punëdore, të respektuar dhe bujare. Nga ato pak para që kishte nëpër duar ditëve të caktuara u jepte të varfërve një rrësk lëmoshe. Ajo ishte e pashkollë por inteligjente dhe shumë e vyeshme. U japi fëmijëve të saj edukatën e punës dhe të mirësjelljes! Përmendej si mbesë shehu ndër më të diturit e kohës i cili kishte kryer Shkollën e Lartë të Ndërtimeve në Kajro.

Personazhi i tregimit tonë kishte gjenetikë të trashëguar më shumë nga mamaja dhe më pak nga babai. Sa më shumë që rritej filloi të shndërrohej në 'fotokopje besnike' të dajës së tij të madh Diamantit, i cili që në moshën gjashtë vjeçare kishte vijuar shkollimin ilegal në gjuhën shqipe (1910), për ta kryer Shkollën e Ulët Qytetare (1914). Njëri ndër mësuesit e tij kishte qenë babai i tre djemve të njohur për vendin ku më i vogli prej tyre njihej si aktori i madh shqiptar me famë botërore, Bekimi!

Dita e Hënë mbahej në mend si 'sjellja e tërë pazarit' në shpinë tonë! Nuk dinte fëmija se çfarë të hante më parë? 'Ditën e pazarit' të hënave, me fshataret që vinin në qytet, nëna Drita Neone bënte shit-blerje në shpi (ndërrim malli-me mallin); u jepte sasi të caktuar peri (në kalema) në këmbim të një peshe të caktuar pemësh (mollë; mushmollë; manaferra; thana; arra; gështenja; kumbulla; lajthia; dardha). Për sasi dhe vlerë më të madhe pemësh jepej disa decimetra pëlhurë, prodhim shpie! Me pemë dhe ajron herë-herë ushqeheshin dhe të tjerët nga farefisi! Nga prindërit Safiri trashëgoi shprehinë shumë të madhe punuese, urtësinë e pa ngacmuar, intelektin, drejtësinë, sinqeritetin dhe bamirësinë! Gjithnjë e fliste të vërtetën dhe vetëm të vërtetën e ndaj gënjeshtarëve dhe atyre që shpifnin nuk shfaqej aspak tolerant, bile tek ai krijohej hatërmbetje!

Në moshën shtatë vjeçare Safiri doli para mësuesit Antimon i pa shoqëruar nga askush, i cili e refuzoi regjistrimin e tij në klasën e parë fillore (1952) me arsyetimin: Pusho edhe një vit, ushqehu më shumë, kështu si je nuk mund ta bartësh as çantën! Vërtetë zhvillimi fizik i tij nuk ishte i duhuri, i hollë nga trupi e nga fytyra por i shkathët dhe i zhdërvjellët, i hajthëm, shkurt intelektin e tij ishte premtues! **Mosha mendore** e tij nuk u përfill nga mësuesi, ajo ishte tamam për shkollë! Mësuesi e përfilli **moshën Kalendarike** e cila kishte prapambetje në zhvillimin fizik! Atëbotë në fëmijërinë e hershme të tij, ushqeheshin të pavarur do thotë edhe të uritur apo shumë të uritur janë larguar nga sofa! Brezi i të rriturve ka qenë i zënë me punë të tjera ekzistenciale, më 'dobiprurëse' krahasuar me të ushqyerit e fëmijëve! E tillë ishte sjellja dhe mentaliteti i njerëzve tek ne në gjysmën e parë të shekullit njëzetë!

I zhgënjyer u kthye nga shtëpia e mësuesit duke qarë sepse *disa nga shokët vijonin klasën e parë edhe për herë të dytë* (si përsëritës) ndërsa *Safirit nuk iu dha mundësia ta vijonte atë as për herë të parë!* Disa të tjerë në këtë moshë vijonin edhe klasën e tretë! Mbeti i zhgënjyer pa abetare, pa shkollë dhe pa shoqëri! Si fëmijë vogëlak ai nuk dinte përse nuk u regjistrua në shkollë? Nuk besonte që nuk mund ta bartë çantën! Njëherë u tha prindërve: 'Çfarë gabimi kam bërë unë?' Pse askush nuk më përcolli për tek

mësuesi? A mund të ishte fajtor im vëlla dhjetë vite më i madh i cili e kishte humbur vitin duke u ndarë edhe nga shkolla?! Ishin shumë pyetje pa asnjë përgjigje!

Sorollatja njëvjeçare e vogëlakut nëpër rrugët e pluhurosura duke lozur me argjilën e përroit në cilësinë e rrugaçit, pa shkollë dhe pa shoqërinë fëmijërore me zvogëlim dhe mungesë përkujdesjeje por edhe i braktisur paksa! Në oborrin e madh ku kishte vend edhe për ‘mullarë sane’ e kositur nga livadhet që familja i kishte në pronësi, filloi të merrej me ‘ndërtimin e një shitoreje’ në të cilën kishte edhe ‘shitblerje’. Për pak kohë filloi t’iu ofrohej punëtorive të automekanikëve të cilët hidhnin në mbeturina pjesë të ndryshme metalike, i gjurmonte ato dhe filloi mbledhjen e tyre në një qoshe të oborrit! Shpreshherë e shoqëronte Piritin (i cili ishte për disa vite më i madh) për në Mejtepin e qytetit dhe aty afër ‘furnizohej’ me argjilën e përroit Krena. I ka ndodhur të shkojnë dhe të kthehen bashkë nga shkolla! Ai filloi të bredh vetëm apo në shoqëri rrugëve të qytetit; Natën vështronte detyrat e shtëpisë së vëllait më të madh i cili shkruante me bishtpenë të zhytur në ngjyrë jeshile, vjollcë ose të kuqe e më rrallë në ngjyrë të kaltër apo të zezë!

Viti shkollor 1953/1954 erdhi i përcjellur me shumë gëzime në jetën fëmijërore të tij! Ishte blerë Abetarja, fletoret me vija të ngushta për t’i shkruar shkronjat dhe me katrorë për Aritmetikë, çanta nga pëlhura, lapsi, goma, e më vonë Libër Leximi për klasën e I të shkollave fillore. Godinat shkollore ku mbahej mësimi ishin të vogla. Mësimet zhvilloheshin në sarajet e bejlerëve të cilat ishin konfiskuar pas Luftës së Dytë Botërore.

Në gjysmë-vjetorin e dytë të klasës së parë fillore, Safiri tetë vjeç, ‘për të mos e dëmtuar apo prishur harmoninë familjare’ u bashkua iniciativës së vëllait dhjetë vite më i madh për ta mbjell duhanin duke ‘lënduar’ fëmijërinë e dëshiruar! Vëllai e kishte humbur vitin shkollor dhe ishte ndarë nga shkolla! Rezultati i asaj initiative ishte shkatërruese nuk u fitua asgjë! Tokë pa ujitje, e pa plehëruar asnjëherë dhe pa përvojën e duhur të tre fëmijëve të parritur! Në fotografinë e nxënësve të klasës parë për çudi Safiri nuk ndodhej! Ai ishte fotografuar herën e parë por fotoja kishte dështuar. Kur u kërkua të ri-fotografohen një ditë tjetër ai mungoi sepse kishte shkuar në duhanishte për të punuar!

Atëbotë qyteti i Safirit, Jakova ngjasonte në një katund mesjetar me: Vija uji për vaditje, rrjedha të cilat lëshoheshin nëpër rrugë sipas orarit të caktuar për vaditje. Oborret e shtëpive ishin shndërruar në ‘ara’ ku mbjellej: Qepa; hudhëra; lakra; magdanozi; purrini; kobëza; kungulli; pacërka; luledielli; misri; domatja; kastravec... Të thuash, tek çdo e dyta familje kultivohej pularia! Pas viteve pesëdhjetë të shekullit kaluar (1950) kur filloi mbjellja dhe kultivimi i duhanit, në muret e oborreve të ngritura nga qerpiqët përreth shpisë, nëpërmjet kunjave prej druri vendoseshin vargjet e duhanit për tharje (fermentim).

Bariu i lopëve dhe ai i buallicave në orët e para të mëngjesit, me të lindur Dielli trokiste me thirrje nëpër dyerë shtëpish, për ta pranuar dhe ruajtur lopën apo buallicën përgjatë kullotjes në fushë a shesh të madh me bar por dhe livadhe; lendinë shkurresh apo kaçubash përreth lokalitetit, me rreze ecjeje deri në dy kilometra. Rrugët e qytetit ishin të mbushura plot me bajga të ‘thata’ e të ‘njoma’ derisa t’i merrte i ‘interesuari’ për bahçe (kopsht).

II. KULTIVUES DUHANI NË MOSHËN 8-të VJEÇARE

Kultivimi i bimës së duhanit tek ne në Kosovë zuri fill aty kah vitet e 50^{-ta} të shekullit kaluar, për të vazhduar nëpër fshatra deri në vitet e 80^{-ta}. Për çështje ekzistenciale mbjelljen e duhanit me ngulm e kishte kërkuar vetë populli shqiptarë, ‘e drejtë’ e fituar më 1951. Nga qyteti i tij i lindjes, askush nuk mbanë në mend që përveç shqiptarëve të ishte së paku edhe një familje sllave që merrej me kultivimin e duhanit! Ishte koha kur turistët nga vende te ndryshme të botës, të gjithë me makina luksoze shkelnin në tokën e shqipeve, rrugët kryesore të së cilës ishin të shtruara me zhavorr (përplot me gropa), kur edhe nga automjeti më i vogël ngrihej ‘rë e dendur pluhuri’. Turistët me kamera dhe fotoaparate regjistronin ‘peizazhe të ngjashme me ato të vendeve afrikane’! Djalëria dhe rinia nëpër qytete e tëra ishte e paangazhuar por edhe e pashkolluar dhe e papunësuar, thjeshtë ishte e djerruar: Disa kohën e kalonin duke i përparë gjelat në tokë dhe rosat në ujë ose bënin gara me pëllumba duke matur inteligjencën e tyre ndërsa të tjerët evidentonin me durim parakalimin ditor të turistëve: a kishte më shumë italianë apo gjermanë?!

Papunësia e skajshme dhe niveli i ulët i jetesës nëpër qytete në njërin anë si dhe reklamimi masiv shtetëror për ta kultivuar bimën e duhanit si bimë shumë fitimprurëse në anën tjetër, bëri që edhe në mjediset qytetare të zinte fill mbjellja vullnetare e duhanit! ‘Pushteti popullor’ e kishte analizuar mirë që kultura bujqësore-industriale e bimës së duhanit u ‘përshtatet shqiptarëve’: nataliteti i lartë, analfabetizmi i ngjeshur dhe mendësia jashtë rrjedhave të kohës.

Në vitin e largët 1954 në duhanishten e Safirit në cilësinë e argatit kishin punuar shumë të rinj; nxënës apo studentë (për të fituar dy bileta për kinema), të cilët më vonë ishin bërë emra të njohur sporti, kulture, arti, arsimit, e shkence. Safiri si *nikoqir* i furnizonte me ujë burimi të pijshëm e të ftohtë!

Punët lidhur me kultivimin e bimës së duhanit dhe prodhimin që jepte ai zgjasin 12 muaj të vitit, thënë ndryshe përveç që janë të lodhshme, jofitimprurëse, të dëmshme për shëndetin, ato nuk kanë të sosur asnjëherë! Nga pranvera e vitit 1954, gjashtë vite rresht Safiri ynë u rrit me bimën dhe për bimën e duhanit. Në bisedat e rastësishme, kur bëhej fjalë për kultivimin e bimës industriale të duhanit në vend ai në shaka e sipër e kishte bindur bashkëbiseduesin që e kishte kryer ‘Shkollën e Ulët praktike gjashtë vjeçare’ të duhanit!

Zgjimi nga gjumi në agun e çdo mëngjesi pranveror dhe veror ishte tamam si një ‘tërmet’ në trupin e njomë, të brishtë, të parritur por dhe të pangopur me gjumë fëmijëror të Safirit vogëlak. Lindja e Diellit por edhe Perëndimi i tij ‘do duhej të shihej drejtpërdrejt në duhanishte’! Gëzimi më i madh fëmijëror i ditës ishte kur binte rrebesh shiu apo kur vranësira e ditës së re - mëngjesin e kishte shndërruar në muzg, duke e pamundësuar kështu shkuarjen e familjarëve në duhanishte.

Ndër punët e fundit, por shumë të zorshme dhe shumë të dëmshme për shëndetin ishte **Palosja e duhanit**. Kjo për faktin që puna kryhej dimrit në dhoma të mbyllura, aty ku ishin magazinuar sasi të mëdha duhani të ‘papërpunuar’ (tuba) dhe ‘të përpunuar’ (të bërë palë-palë si çorapet). Atëbotë, matja e ndotjes së ajrit me nikotinë nuk është bërë por në mëngjes punës ia ke filluar ‘si i shëndoshë’, ndërsa në mbrëmje punën e ke mbaruar ‘si i sëmurë’, me dhembje koke, marramendje e vjellje! Të gjithë ishin për

ndihmë mjekësore por ‘njerëzit e duhanit’ nuk gëzonin sigurime shëndetësore! Ftoni dhe limoni ishin dy frytet të cilat ‘ndreqnin’ punë!

Palosja e duhanit nënkupton klasifikimin e fletëve sipas cilësisë, duke krijuar më pas stoqe duhani, në trajtë ‘paralelopipedi kënddrejtë’. Zakonisht palosja është bërë pas Vitit të Ri. Fillimisht tubat e duhanit janë ‘zbutur’ duke i futur në ambiente ku kishte avuj uji në mënyrë që gjatë klasifikimit të duhanit sipas cilësisë (ngjyrës dhe madhësisë; ari; i verdh; i kuq; jeshil i mbyllur; ngjyrë kafe; i përzier; i mykur; i madh; i vogël)të mos shpie në thyerje e copëtim fletësh! Disa prodhues duhani duke qenë mospërfillës tubat i ‘zbutnin’ duke i spërkatur me ujë, mirëpo pas dy-tre ditësh fitonin ‘duhan të mykur’, çmimi i të cilit ishte i papërfillshëm, thënë ndryshe çmim lëmoshe! Komisioni tre anëtarësh, i dalë nga këshilltarët komunal, vlerësonin cilësinë e duhanit dhe ofronin çmimin: Klasa I-A; Klasa I-B; Kasa I-C; Klasa II-A; Klasa II-B; Klasa II-C; Klasa III-A; Klasa III-B; Klasa III-C; nga duhani ngjyrë ari (më i shtrenjti) deri tek ai i mykuri apo pjesërisht i mykur (çmimi i të cilit ishte përbuzës).Çdo prodhues duhani kishte të drejtë ankese, përfitimi eventual ishte simbolik dhe zhgënjyes!

Nga kultivimi njëvjeçar i duhanit duke i mbjellë 25000 fije fidane, familja përfitonte aq para sa mjaftonin për të siguruar ‘bukën e gojës’, pak veshmbathje, për ta paguar qiranë e duhanishtes, për shpenzime materiale shkollore dhe pak para për argatë por pa mundësi reale për ta blerë një biçikletë apo një radio apo edhe një orë dore! Duhani në Qendrën Grumbulluese ‘dorëzohej’ në dimër ndërsa pagesa kryhej në pranverë atëherë kur merreshin farëzat për bimën e re!

‘Pushteti popullor’ e kishte vlerësuar mirë që kultura bujqësore - industriale e bimës së duhanit u përshtatet shqiptarëve: ‘Lindshmëria e lartë’; ‘Analfabetizmi i ngjeshur’ dhe ‘Mendësia jashtë rrjedhave të kohës’. Por krahas punës rraskapitëse dhe helmuese që kërkon bima e duhanit, me gjasë tek prodhuesit e familjarët e tyre do ekzistojë prirja për të qenë duhanpirës potencial, me këtë edhe bartës sëmundjesh kronike kanceroze; sëmundjesh zemre; enësh gjaku; insulti truri...

Ishte koha kur mbrohej teza: Edhe pse kultivimi i duhanit nuk po sjellë përfitime materiale ia vlen të mbjellët, meqë tek të rinjtë ka zhvilluar shprehinë e punës dhe janë larguar nga rruga. Megjithatë punët e përditshme rreth bimës së duhanit me shumë gjasë pengonin rritjen dhe zhvillimin normal fizik dhe psikik të tyre.Ditët e gjata të verës ishin përvëluese dhe shkatërruese për qeniet e njoma të fëmijëve ende të parritur të cilët në vend që të lexonin libra apo të shkonin në verime mali, deti a bjeshke ose së paku të luanin me top ishin të detyruar të punonin pa ndonjë dobi materiale ngjashëm me të rriturit! Fatbardhë dhe me shumë fat i quanim fëmijët të cilët punonin ‘nën hije’, të zëmë shegert tek ndonjë zejtarë. Ja këtu fshihej ‘lumturia fëmijërore’ e kohës! Ata që janë gjallë e shëndosh dhe kanë përjetuar kultivimin e duhanit, së paku një vit kalendarik, u mbetet t’i kujtojnë si vite të humbura e të braktisura, të një jete skëterrë dhe të hidhur aq sa ishte dhe është i hidhur edhe vetë duhani i mallkuar si bimë por dhe si cigare! Çdo dite të re e asaj periudhe kohore shpirtërisht helmuese, i mjaftonte hidhërimi dhe pikëllimi i vetë i papërmbajtur dhe i pafundmë! Kultivimi vullnetar i bimës së duhanit ishte një ‘dënim i programuar kolektiv’ i popullatës së pa arsimuar shqiptare në Kosovë e cila ishte tradhtuar dhe ndarë pabesisht nga Trungu amë. E gjymtuar dhe e shtypur; e përbuzur dhe e lëçitur ; e shfrytëzuar dhe e përndjekur; Kosova ishte akoma duke qarë dhe dënesur bile shumë! ‘Lindi Muri-qani’ i dytë ndër shqiptarë akoma më i egër! Kjo nuk ishte ëndërr!

III. NXËNËS I DALLUAR I GJENERATËS

Si çdo fëmijë tjetër Abetaren e desha shumë thotë Safiri por nuk isha i udhëzuar ta ruaj! Fotot e saja shumë joshëse i kisha prerë me gërshërë për të sajuar album! Nga të rriturit nuk isha këshilluar që ABC-në si libër i veçantë duhet ruajtur si 'sytë e ballit'! Vjershën për Abetaren e mban në mend dhe sot:

Abetaren e mbarova,	O e bukura Abetare,
Të gjitha shkronjat i mësova,	Kur të bleva s' dijë-sha fare,
Shumë i lumtur jam sot,	Sot shkruaj e lexoj,
Bashkë me shokët e mi plot.	Prindërit e mi i gëzoj!

Në fund të klasës parë fillore e mora dhuratën e parë, librin Dimka si nxënës i shkëlqyeshëm; në klasën e dytë Këngë popullore shqiptare; të tretën: Libër Leximi për klasën e IV fillore; më pas; Pupla e gjelit; Ndodhitë e Nikoletin Bursaqit; Vija e vrugë; Hajdi; Rrushi ka nisë me u pjekë; e në gjysmëvjetorin e parë të klasës parë gjimnaz dhuratë mora këto libra: Tregime të zgjedhura dhe Era dhe Kolona. Ndër vite disa nga dhuratat shkollore të shpërndara në qershor nuk i kisha marrë me dorën time. Duke mos qenë prezent ditën kur komunikohet suksesi sepse 'nuk bënte të humbej puna në duhanishte' shokët e klasës ma sillnin dhuratën në shtëpi kur të shpërblyer ishin pak veta. Dhe sot zhgënjimin e kam të freskët.

Shënimin e datave nëpër fletore e kisha filluar që në *klasën e tretë fillore*. Më pas fletoret për shikim i merrte mësuesi për t'i përcjellë datat në Ditarin e klasës! Mësuesi im nuk kishte përgatitje të madhe shkollore megjithatë veçohej për faktin se ai e 'praktikojë ndarjen e paraleles' në grupe nxënësish; fillimisht në dy, ku në 'cilësinë e mësuesit' udhëhiqnin të dalluarit Boksiti dhe Safiri të cilët do t'i mësonin nxënësit tjerë së paku dy herë në javë nga dy orë mësimore, në dhoma ose në kopshte shtëpie. Që atëherë mësuesi i tij e kishte 'zbuluar' që *nxënësi mund ta pranojë rolin e mësuesit* prej nga pas pesëdhjetë viteve do lindi **Mësim-nxënia aktuale** dhe përfitimi prej saj: "**Kush mëson të tjerët, mëson më shumë kundrejt atij që mësohet**"! Safiri shpjegonte leksione nga historia, gjeografia dhe dituri natyre (matematikën e punonte mësuesi vetëm një orë në javë!) Përgjatë sezonit të nxehtë e të thatë, pas shpjegimit të leksioneve Safiri ngjitej ngadalë në mollën e Albitit dhe nga atje i 'vlerësonte' shokët e vet me notë dhe ato ndonjëherë i dërgonte tek mësuesi po qe se ai i kërkonte! Kjo mund të ishte një parandjenjë për profesionin e tij të ardhshëm jetësor! Ndër kujtimet mbresëlënëse nga shkolla fillore Safiri veçon:

Pushimet tri javore nën pishat e Deçanit atëherë kur kishte mbaruar klasën e pestë fillore. Kryqi i Kuq i kohës i kishte shpërblyer nxënësit më të mirë të shkollave të Komunës; nga një ose dy nxënës prej çdo shkolle. Nxënësit e shpërblyer ishin të klasave të shtata dhe të gjashta. Ndodhi që Safiri si i vetmi, të jetë i klasës pestë! Ishin të vendosur në shatorre për vajza dhe për djem. Aty çonin jetë të organizuar si në 'ushtri' me ngritje flamuri të Kryqit Kuq për çdo ditë, gjimnastikë mëngjesi, ligjërata të përditshme për Trupin dhe Shëndetin e të ngjashme. Pranonin ushqime pesë herë në ditë dhe për çudi shëndetligu kishte shtuar peshë afër dy kilogram! Që atëherë Iliri i Ponosheci ishte pushuesi i veçantë i kl.VI^{të} i cili dallohej nga Zeoliti, Fosforiti dhe Tirkizi për analiza lidhur me shumë debate historie dhe gjeografie.

Kujtimi i dytë akoma më mbresëlënës dhe me shumë vlerë ishte **shpërblimi i gazetës Rilindja e datës 15 fror 1960 me rastin e pesëmbëdhjetë vjetorit të daljes së saj!** Atëbotë ai ishte nxënës i klasës së shtatë dhe tek gazeta e kohës ishte parapaguar një familjar i punësuar në Fabrikën e Tekstileve. Në fillim të shkurtit ai e vëren një *Pyetësor* lidhur me: *Sa ishte e lexueshme gazeta Rilindja, me rastin e 15 vjetorit të botimit?* E kishte prerë me gërshërë pjesën e gazetës, ‘format i pamjaftueshëm’ për të dhënë përgjigje. Sa i kujtohet djalosht kishte prerë nga letra e pashkruar një ‘drejtkëndësh aneks’ të cilin e kishte bashkangjitur me atë të gazetës për dhënie përgjigjesh më të plota. Në mesin e pyetjeve kishte qenë edhe: **A e lexoni Programin e Radio Prishtinës?** Në pjesën e drejtkëndëshit, Safiri kishte shkruar: **Jo, sepse nuk kam radio!** Kjo i kujtohet! Dhe në pyetjet tjera ngjashëm ishte përgjigjur me sqarime shtesë! Me gjasë, përgjigjja e dhënë në pyetjen e ofruar ka bërë të reflektoj në Anëtarët e Komisionit të Shpërblimit dhe Safirit t’i jepej Shpërblimi i dytë në shumën prej njëzetë mijë dinarëve të kohës, i baras-vlerëshëm me tri paga mujore të një nëpunësi! Shpërblimi i parë ishte tridhjetë mijë ndërsa i treti dhjetë mijë! Një familjar nëpunës i shoqëruar me filloristin bënë tërheqjen e të hollave në Postën e qytetit dhe vërtetë me ato të holla ishte blerë një radio duke mbetur edhe pak kusur! Kryetar i komisionit vlerësues (me fotografi e tekst) kishte qenë njëri ndër gazetarët udhëpërshkrues dhe shkrimtarët më të mirë dhe më të frytshëm që kishte vendi asokohe!

Njohja e gjuhës së huaj së bashku me **drejtshkrimin** dhe **dorëshkrimin** (bukurshkrimin) janë **tri kartela identiteti** për çdo person. Shkollarët e viteve të gjashtëdhjeta, ku bënte pjesë edhe Safiri, pushtet mbajtësit racistë e nacionalistë; së fundi edhe shfarosës, me qëllim i penguan shqiptarët për ta mësuar gjuhën e huaj tetë vite radhazi! Nga klasa e pestë fillore deri në të tetën kishin vijuar mësimet nga Gjuha Frënge dhe falë mësuesit altruist të shkolluar në Normalen e Elbasanit me shpjegime dhe praktikë gjuhësore cilësore, mbështetur në ‘*Pushtetin e Notës*’ bëri që pas katër viteve mësimesh; Safiri, Boksiti dhe mësuesi të komunikonin në Frëngjishte!

Bukurshkrimi dhe drejtshkrimi i Safirit ishin për t’u lakmuar! Nga klasa e dytë fillore deri klasën e katërt fillore ushtronin bukurshkrimin me bishtpenë në fletore me vija të ngushta. Me kalimin e viteve bukurshkrimin e kishte *përsosur* sepse leksionet e shkruara në shkollë i plotësonte duke i rishkruar në të pastër. Edhe me drejtshkrim ka qenë i dalluar, me përmirësime të dukshme posa filloi ta lexojë Rilindjen e viteve të gjashtëdhjeta; më pas duke shkruar *Tema të Konkurseve shkollore* nga lënda Morali socialist e më vonë nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe.

Në ciklin e ulët të shkollës fillore (I-IV) ai kishte tre mësues, me gjasë vetëm njëri me shkollë të mesme të kryer! I kanë mbetur të ruajtura librat ARITHMETIKA për klasën II- të fillore; ARITHMETIKA për klasën III-të fillore dhe ARITHMETIKË e GJOMETRI për klasën IV-të të fillore.

Në faqosjen e kuqe të librit për klasën e dytë fillore, vërejmë një çun me tesha të bardha kombëtare; qeleshe në kokë, jelek dhe tirq zhguni të bardhë (me gajtan të kuq, sipas historianëve i përdorur në kohën e kryeheroit kombëtar, Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe para tij, simbol luftërash të vazhdueshme ekzistenciale dhe simbol gjaku, i cili pas vdekjes së Skënderbeut është zëvendësuar me gajtan të zi, simbol i përmotshëm i zisë kombëtare). Çuni (i vizatuar shumë bukur) në të bardha, para një tabele në formë trapezi ngjyrë të zezë me vija paralele të kuqe ka shkruar $8 \times 8 = 64$ duke treguar

thelbësoren matematike në klasën e dytë filllore e cila shpiente tek njohja e detyrueshme e Tabelës së shumëzimit së cilës i pa ndihmuar nga askush Safiri 'ia kishte marrë dorën'!

Libri kishte përmbajtje me vlerë, autorët e të cilit nuk ishin shqip-folës. Shenja e shumëzimit atëbotë shënohej me X e cila më vonë ishte zëvendësuar me pikë. Nxënësit e asaj kohe është dashur të dinin shumë më tepër por nuk kanë pasur mësues të zotë. Ja çfarë ndodhej në libër: Njohja me numrat 20-100; Njohja me gjatësi, gjerësi dhe lartësi; Masat dhe matja e lëngjeve; Masat e peshës; Tabela e shumëzimit dhe e pjesëtimit me 2; 4; 8; ndarë në shtatë pjesë (2, 4, 8, 3, 6, 9, 7); Gjysma; E katërta; E teta; E treta; E gjashta; Vija e drejtë dhe e lakuar; Masa për kohën...Ajo çfarë më bën përshtypje tregon Safiri libri ka mbetur si të ishte i papërdorur; në atë nuk ka asnjë shenjë; numër; shkronjë; simbol të shkruar edhe pse zgjidhjet e shumë detyrave që ndodheshin në libër e kërkonin! Mësuesen e klasës së Dytë filllore asnjëherë tjetër nuk e kam parë si mësuese! Me gjasë ajo ishte larguar nga mësuesia sepse nuk kishte shpjeguar asgjë nga mësimi i matematikës!

Në klasën III^{të} dhe IV^{të} Filllore Safiri e kishte po atë mësues. Mësimdhënia e tij ka dalluar shumë pak nga para-rendësi. Përgjatë mësimëve të Historisë, Gjeografisë apo Dituri natyre, Safiri ishte 'dora e djathtë' e mësuesit! Në kohën kur gjashtë dekada më parë '**nxënësi e pranoi rolin e mësuesit**', Safiri këtë akt pedagogjik e vlerëson '**zbulim' mësim-nxënieje!**

Mësuesin e matematikës (V-VIII) e konsideronim njohës të lëndës mësimore. Tek **mësuesi Kallaj**, asnjëherë nuk ishte hetuar ndonjë gabim material. I heshtur, i mbyllur dhe me autoritet. Dy vite ishte dhe kujdestar klase. Në këtë cikël mësimor nga matematika, Safiri ishte i vlerësuar me notën pesë (5). Meqenëse shkoja shumë herët në shkollë tregon ai, sa herë kishim orë të matematikës (tri herë në javë), mësuesi më priste para hyrjes për të më huazuar stilografin me ngjyrë, i nevojshëm për shënimin e orëve në Ditarin e Punës dhe kur kthehej në klasë ma jepte! Si fëmijë më dhimbsej mësuesi Kallaj, si ka mundësi të jetë pa stilograf kur ndoshta paguhej për punën që kryente!?

Në vazhdim të shkollimit nga klasa parë Gjimnaz - mësimi i gjuhës frënge mori *tatëpjetën!* Ajo u katandis si mos më keq duke u 'zëvendësuar' me gjuhën ruse! Një plejadë e tërë nxënësish-intelektualë të ardhshëm kishin 'vdekur në të gjallë'! Ata tanimë ishin dënuar mos ta dinë asnjë gjuhë të huaj, asnjëherë! Mosnjohja e mirëfilltë e një gjuhe të huaj të shpie në 'analfabetizëm modern'.

Safiri kur filloi ndjekjen e leksioneve në gjimnaz e hetoi që nxënësit nga shkollat tjera filllore e dinin matematikën më mirë se ai! Sa ora e ndërroi vlerësimin për mësuesin edhe pse ai nuk gjykohej por vlerësohej. Analizat e tija ishin si vijon: Fletorja e matematikës në cilësinë e 'Provës materiale' mbetet dëshmitarja e (mos)punës së mësuesit së bashku me tabelën shkollore. Ora mësimore do të përfundojë por gjurmët e saja ngelnin të freskëta, e kjo ishte **Tabela shkollore**, shkrimet e së cilës përcjellën në fletoret e nxënësit. **Fletorja e nxënësit të mirë mbetet 'fotokopje besnike' e punës së mësuesit me nxënësi.** Në fund të analizës që iu është bërë na doli që **mësuesi Kallaj** ishte shumë dinak në (mos)veprime dhe sjellje, me gjasë ish student i dështuar i ndonjë Shkolle të Lartë!

Vrojtuesit të vëmendshëm nuk i duhen prova të tjera besueshmërie për të nxjerrë një përfundim lidhur me punën e tejshkuar dekada më parë. Fletoret e shkruara përgjatë viteve shkollore, sa faqe përdornin?; Çfarë ishte cilësia dhe vëllimi i shpjegimit, (konstruktionit në gjeometri), ushtrimeve; numri i

detyrave rutinë njëjavore; Çfarë ishte shpjeguar dhe interpretuar; kur, dhe si; sa detyra kishin mbetur të 'zgjdhura për gjysmë'; sa hetohej zhargitja në kohë e orës mësimore kur shumë datave të një ore mësimore u përkisnin edhe më pak se gjysma e një faqeje fletoreje; nëse orët e matematikës mbanin rregullisht datat, çfarë hetohej në vëllimin e 'shpjegimeve' në përqindje nëpër gjysmë-vjetore; në cilët muaj vërehej ndonjë organizim testimi apo detyra ndërmjet lojës dhe matematikës; garë diturish matematike ndërmjet paralelesh të klasës së njejtë; ose shpallja e nxënësit më të mirë në matematikë, në nivel klase; shkolle; qyteti e të ngjashme.

Safiri nga klasa e tretë fillore ishte shkruar i rregulltë i datave të përditshme në fletoret e tija të matematikës dhe ai asnjëherë nuk ka munguar në shkollë! Përbajtjet mësimore të shpjeguara dhe të ushtruara, në fletoret e tija të mirëmbajtura nuk i japin mësuesit notë kaluese! Lidhur me inteligjencën ishte i 'duhuri' por me gjasë shumë dinak duke i mashtruar gjenerata të tëra nxënësish me ***një shterpësi të paparë matematike; të pafrytshme, të pa dobishme dhe të pa aplikueshme!*** Meqenëse bëhet fjalë për mësimdhënie matematike përgjatë katër viteve (V-VIII); që ***në Perëndimin e Përparuar quhen vite Gjinnazi dhe çdo nxënës nuk gëzon të drejtën t'i ndjekë***, atëherë (mos)puna e këtij mësuesi nuk amnistohet, përgjegjësia e tij sa vjen e rritet, mbetet i vetmi më shumë mëkate por edhe i mallkuar, veçmas nga nxënësit e ditur kur ata do rriten! Inteligjenca e mësuesit e udhëhequr bukur në rolin e të paditurit dhe të hipokritit, provohet kur i 'vonshmi' mbaroi shkollën fillore dhe u regjistrua në gjimnaz; atëherë mësuesi i matematikës kaloi me punë në një shkollë të mesme profesionale, ku për ligjërime matematike kërkohej ballafaqimi në nivel më të lartë dijesh!

Në fund ai plot vrer theksonte: *Nuk gaboi asnjëherë të na thoshte: Si mësohet e 'vështira matematikë'?* Nuk e dëgjuam kurrë ndonjë këshillë që: Mësimi i matematikës kërkon punë sistematike të palodhshme ('zbuluese-hulumtuese'); ajo është si një lloj treningu në sport; nuk e pranon të mësuarit mekanik dhe me *ecuri fushate!* Ajo mund të krahasohet si *atletika në sport*, lojtari që nuk ka kondicion nuk mund të luaj, do të thotë: Matematikën nëse nuk e di mjaftueshëm nëpërmjet 'gjuhës' me të cilën ajo flet, nuk mund ta aplikosh. Përfundimisht nuk u kishte thënë: ***Matematika mësohet prej librave***, shkrimet e fletoreve janë dytësore, plotësuese që do të thotë më parë duhet ta dish teorinë e leksionit të caktuar dhe më pas ajo të aplikohet nëpërmjet detyrave. Po qe se është e mundur, e mira e së mirës është: Një detyrë të zgjidhet edhe në tri mënyra të ndryshme; krahasuar me zgjidhjen e tri detyrave në mënyrë të njëjtë të cilat i ngjajnë si veja-vesë. Mësimi i matematikës udhëhiqet me punë hulumtuese-zbuluese, dallon diametralisht nga mësimet e kimisë, fizikës, biologjisë, gjuhëve të huaja!

Krejt në fund Safiri e pranon zbulimin e vonshëm të fshehtësisë matematike të cilin mësuesi nuk e kishte thënë: Në matematikë duhet të futesh! Hyrja në të nuk ndodhë me sqarime të të tjerëve! Kurset dhe organizimi i tyre nga mësuesit e matematikës me nxënësit e tyre (me pagesë) është dukuri e shëmtuar dhe ilegale por edhe kontraproduktive prej të cilëve nuk ka përfituar askush! Kjo dukuri është e përhapur para shumë dekadave gjithandej në Ballkan e cila gjithnjë ka qenë jashtë rrjedhave të kohës! Këto kurse u krijuan si 'zëvendësim' i Mësimit Plotësues obligativ dhe kjo pas viteve ('90) të shekullit XX. Duhet bërë përpjekje zgjidhjeje detyrash të ndodhura në librin shkollor me punë të pavarur, pa e kapërcyer asnjë sosh të cilat kërkojnë përfundim dhe këto të jenë 'të kontrolluara nga i dituri' për përpikëri zgjidhjeje! Puna dhe vetëm puna personale e vijueshme paraqet një rën ndërr parakushtet e suksesit në mësimin e matematikës!

Ky mësues matematike (V-VIII), matrapaz, demagog ishte gogoli i mësimit të saj; ai nuk e meritoi të jetë asnjë ditë mësues i shkencës së madhësive! Ish-nxënësit e tij nga të cilët nuk është dëgjuar kurrë asnjë ankesë cilësie dhe të cilët nuk e kanë studiuar matematikën, as që iu ka shkuar mendja ndonjëherë dhe as që e kanë hetuar mësimdhënien mashtruese të këtij mësuesi hipokrit!

Rrëfimet e tij lidhur me jetën shkollore nuk kanë të sosur! Atij i ndodhen ecuri e rrjedha të pazakonshme. Nëse zihen në gojë *librat shkollorë* ai bie në nostalgji. Tani në pleqëri mallëngjehet më shumë se përpara, sepse kishte humbur përgjithmonë si të ishte i dehur dyzetë libra të bibliotekës së ardhshme personale për një 'kafshatë goje'! Vuan nga malli për librat e gjuhës frënge të cilën e mësoi me shumë zell gjatë katër viteve shkollore (V-VIII) duke e harruar më pas si të ishte 'gjuhë e vdekur'! Malli më i madh i përket humbjes së librave të matematikës për klasat nga e pesta në të tetën. 'Librat e mjera ishin të paditura' meqenëse në vitet që do pasojnë (dhe jetës nuk i dihet!) ai mund të jetë matematikan me emër! Meqenëse 'librat e kanë gjuhën e tyre me të cilën flasin, faji për ikje u mbetet atyre'! Megjithatë, Safiri ishte nxënës i shkëlqyeshëm me dhurata librash ndër më të mirët në paralele, ka pasur mundësi të kundërshtojë familjarët dhe mos të ndodhë humbje librash me dorën e vet!

Vëllai i nënës me plakje të parakohshme kishte disa fëmijë dhe më shumë se gjysma prej tyre ishin nxënës të shkollës fillore dhe njëri sish qëlloi të jetë për një vit shkollor më i rinj se Safiri të cilin e kishte 'shënjuar' për mirëmbajtje të librave dhe prej atij do duhej blerë! Familjarët e porositnin djalin me këto fjalë: 'Tani vjen daja për t'i marrë librat tuaja, ti mos kundërshto sepse është turp për ne, e ke kaluar klasën, këto libra nuk të nevojiten më, duhet me i shitë me gjysmë çmimi, dmth. dhjetë libra nga pesëdhjetë dinarë bëjnë pesëqind dinarë (të kohës) kuptohet pa vullnetin e tij! Kësaj shume u shton të tjerat t'i japim ne dhe i blen librat e reja. Safirit i dridheshin duart së bashku me zërin kur ofronte dorëzimin e librave dhe zemra e tij qante thellë me dënësje përbrenda! Kjo shitje e 'plagosur' ishte realizuar në katër fillim vite shkollore duke trazuar një shpirt djalërie! Për vete i gjente paratë për t'i blerë librat e reja në librari; shumës së fituar të parave duke i shtuar më shumë se aq! Kush ishte shumë i gabuar dhe fëmija i vocërr mund ta dijë! Nga kompleksi i librave të shitura çuditërisht pa qëllim (thuj se ka ditur libri të flas, mos më prekni meqenëse Safirin do ta bëjmë matematikan!) ka ngelur një libër gjeometrie nga Dr.Nikolla Çepinac : GJEOMETRIJA PËR KLASËN E VIII TË SHKOLLËS FILLORE, (pa asnjë detyrë të zgjidhur, i paprekur fare)!- Ishte për tu vlerësuar 'dija praktike' e ish mësuesve nga vitet e 55-ta të cilët kishin njohuri për 'të mësuarit në garë' i cili gjithnjë ka qenë rezultativ! Pas vitesh vlerësohej që ish 'mësuesit pa shkollë' tandem Safir-Boksit 'nuk e ndanë'përgjatë 12-të viteve, edhe pse asnjëherë nuk ishin ulur në një bangë! Ata 'përfaqësonin vëllezër binjakë'.

Safiri krahasuar me Boksitin përgjatë arsimit fillor përfaqësohej paksa më i ditur për dy arsye: E para; ishte për një vit kalendarik më i moshuar dhe e dyta; një familjar i tij ishte parapagues i gazetës Rilindja.Referatet e tij me shkrim (nga lënda mësimore Morali socialist në kohë Pavarësie shtetesh afrikane nga kolonializmi; 1960/61) ishin të cilësuar lartë në nivel shkolle të cilat sillnin dhe dhurata.

IV. “KARTONI I GJELBËR” I “SHKOLLËS PA ZANAT”

Ringjallja e përfytyrimit për shkollimin e mesëm në fillim të viteve të gjashtëdhjeta të shekullit të kaluar (kur një grup i vogël nxënësish ndër më të mirët e shkollave fillore të komunës me qejfe regjistrinon **gjimnazin** në shenjë krenarie që ‘dhe unë jam i zoti’), brezit të rinj pak i intereson, atëbotë një pjesë e konsiderueshme nxënësish gjimnazin nuk mund ta kryenin për katër vite! Disave u duhej viti i pestë, por dhe i gjashti si përsëritës të klasave! Këta të fundit ish nxënës të gjimnazit, me kalimin e viteve ‘çuditërisht’ u bënë shkrimtarë, akademikë, piktorë, poetë, regjisorë, dramaturgë, gazetarë, artistë ndër më të mëdhenjtë që kishte vendi!

Deri në vitin njëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një Safiri ishte tetë herë radhazi nxënës i dalluar, i shkëlqyer, i shpërblyer me dhurata librash rregullisht. Pa u konsultuar me askënd në familje dhe farefis me të cilët kishte mundësi dhe rrethana ta bëjë, vetëvendosi ta regjistrojë shkollën e mesme ‘pa zanat’-gjimnazin kur pas diplomimit në provimin e Maturës nxënësit detyrimisht duhet të ndiqnin arsimin superior; fakultetin e zgjedhur katërvjeçar ose ish-shkollën e lartë dyvjeçare, varësisht nga dëshirat: ‘dashuria në shikim të parë’, aspiratat, motivi material, mundësitë materiale, bursa e fituar, të njohurit e gjuhës sllave, krenaria djaloshare, ëndërra jetësore, ndikimi shoqëror etj., por anashkalohej thelbi i orientimit profesional: Mbështetja tek dhuntia personale lidhur me degën e studimit!

Fillimviti në klasën e parë gjimnaz për Safirin me shokë ishte në të vërtetë paksa i frikshëm. I kujtohet edhe sot momenti i pranisë në lokalin e shkollës, i grupimeve të drejtpërdrejta të nxënësve në tri paralele të klasave të para, tamam si të ishin ‘dele për t’u shitur’, pa u pyetur asnjë nxënës për kërkesat dhe dëshirat eventuale të tyre! Nëpër shkolla ishte traditë që përzgjedhja dhe klasifikimi i nxënësve nëpër paralele të fillonte gjithnjë nga më të mirët, ndërsa grupimet e para në paralele fillonin me indeksin 1; pastaj 2 etj.

Në formimin e paraleleve ai ‘nuk kishte pasur fat’ edhe pse një familjar i tij, mësues i gjuhës latine ishte bashkëpjesëmarrës në rigrupime nxënësish shkollash të ndryshme. Kjo për faktin që mësuesi tjetër i matematikës (më vonë emër i njohur profesori universitar) do jetë mësues në klasën e parë një! Dhe tani pas gjashtëdhjetë viteve kur bëhet kjo analizë, del që familjari ka qenë i denjë për të jetuar larg nga çfarëdo konflikt interesi. Ai e paska ditur në cilën paralele të klasave para do punojë mësuesi i dalluar për matematikë dhe është dashur që nipi i tij ‘si i shkëlqyeshëm’ nga shkolla fillore të sistemohet në paralelen e para një, por kjo nuk kishte ndodhur! Sikur familjari të kishte vepruar ndryshe për nipin e sofrës me gjasë do t’iu kishte mbushur mendja të bëhej matematikan që nga mosha e djalërisë apo rinisë së hershme! Nga tri paralelet e para kishte dal vetëm një Doktor i shkencave të ndërtimitarisë dhe ky nga e para një ku mësues matematike i shkollës fillore kishte qenë mësuesi egoist e dinak Kallaji!

Paralelja e para tre me tridhjetë e dy nxënës do jetë ajo ku Safiri do vijojë mësimet me kujdestar klase, tek një ‘i shitur’ për mësues matematike, me padije të shumta dhe i cektë, *njëri prej mësuesve* ‘karikaturë’ të matematikës i cili do dalë *sharlatan* i vërtetë në kuptimin e plotë dhe objektiv të fjalës. Vlerësimet e fundit nëpër gjysmë-vjetore i kreu në mbështetje të mirëmbajtjes së fletoreve! Vetëm për këtë ‘lloj vlerësimi shekujsh mesjetarë’ ai është dashur të pushohet nga puna në Gjimnaz! Matematika nuk mësohet pa libër shkollor! Edhe pse libri i matematikës për klasën e parë gjimnaz në gjuhën amtare

mungonte, do duhej të përdorej libri përkatës nga ndonjë gjuhë tjetër! Matematikanët e të gjitha meridianëve të planetit tonë pa e ditur gjuhën e njëri-tjetrit por nëpërmjet gjuhës së shenjave dhe simboleve, me ligjëtori ecurish matematike e kuptojnë njëri-tjetrin pa vështirësi!

I ulur në bankën e dytë të rreshtit të skajshëm afër dritareve së bashku me një djalosh mëhalle, kishte një 'prapavijë trimërie' që do atakohej me pyetje të shpeshta të mësuesve! Ishte ndër të parët e paraleles i vlerësuar me notat e para shumë të mira, duke u diferencuar nga të tjerët. Kështu ndodhi dhe me notat e dyta me pak përparime, duke kryer gjysmë-vjetorin e parë me shumë sukses, si *njëri ndër tre nxënësit më të mirë të paraleles*, të cilët nga drejtorja e gjimnazit u shpërblyen me nga dy libra; njërin në shqipe dhe tjetrin të përkthyer në shqipe. Ishin dhuratat e fundit përgjatë shkollimit që Safiri mori. Klasën e parë gjimnaz e kreu me sukses shumë të mirë, ndërsa nga matematika u vlerësua si i mirë, por realiteti fliste ndryshe pa mësuar dhe pa ditur të thuash asgjë nga profesioni i ardhshëm jetësor!

Mësimi i matematikës në klasën e parë gjimnaz s'kishte ku të shkonte më keq e më dobët, tregonte ai! Bile shumë më mirë do kishte qenë që Matematika në atë vit shkollor 'të ishte fshirë plotësisht nga orari', mëqenëse mësimet e ligjëruara nga mësuesi ngjanin me ato të një batali! Tani për tani *matematika i mbetet lëndë mësimore e 'padëshiruar' (non grata)* për shkak të mësuesit egoist por dhe injorantë (V-VIII) dhe mësuesit të papërgjegjshëm gjimnazi, ku notat e tyre në librezat nuk ishin reale.

Nga tri paralelet e para në gjimnaz (e para një; e para dy dhe e para tre ku ishte Safiri) njëra ishte 'shkrirë' në përsëritës të vitit parë dhe me vetëvendosje të nxënësve (në konsultim edhe me prindërit) u formuan dy paralele: grupi i shkencave shoqërore dhe grupi i shkencave natyrore. Për grupin e parë zakonisht përcaktoheshin nxënësit me sukses të mirë dhe ata shumë të mirë ndërsa për grupin e dytë përcaktoheshin nxënësit e dalluar në mësimet por të pa testuar asnjëherë nga askush!

Ishte i vetëdijshëm për udhëkryqin jetësor në të cilin ndodhej aty ku synonte e dëshironte të përcaktohej; në grupin e Shkencave Natyrore ndodhej edhe '*Matematika e frikshme*' dhe momentalisht për atë lëndë mësimore ishte batallitur! Ende nuk kishte dijeni përse matematikën nuk e dinte si lëndët tjera mësimore! Me bindje vlerësonte që *Matematika është gogoli!* Megjithatë nuk mendoi gjatë dhe u përcaktua për grupin e 'më të mirëve'!

Gjithnjë, nëpër gjimnaze nga klasa e dytë e tij ka ekzistuar përcaktimi i nxënësve për në Grupin e Shkencave Natyrore dhe Grupin e Shkencave Shoqërore por zbulimi i dhuntisë personale të trashëguar tek çdo nxënës veç e veç gjithnjë ka munguar! Si orientohen, ndihmohen, udhëzohen dhe kontrollohen nxënësit aktualisht për ta zgjedhur dhe kapur tamam profesionin e jetës, askush nuk di ta shpjegojë! Gjimnazisti i diplomuar për ta regjistruar cilindo fakultet ka në pronësi 'kartonin e gjelbër', megjithatë rrugëtimi nëpër gjimnaz dhe sot nuk ishte asnjëherë i sigurt bile për shumicën e nxënësve paraqet një lloj *humnerë jetësore!* Personat të cilët nuk përfillin 'dhuntinë e trashëguar' për atë degë studimi, deri në diplomimin eventual ballafaqoheshin me tej-zgjatje të kohës së studimeve; ndërprerje të studimeve pas disa viteve ose ikje prej studimeve të dështuara pas një viti akademik! Në këtë labirint jetësor ish gjimnazisti është inkuadruar të bëjë edhe aso lloj punësh të pa imagjinueshme më parë: punën e shoferit; taksistit; inkasantit; zejtarit; rojës së natës; gastronomit; blegtorit; bujkut; qebaptorit; furnizuesit; librarit; mësuesit; tregtarit; artistit; farmacistit; politikanit; ndërtimtarit; mërgimtarit; e të ngjashme. 'Sfondi

i errët' i gjimnazeve aktuale, përfundon me të dhënë realiste në udhëheqje: Sot gjimnazi mund të drejtohet dhe udhëheqet nga mësuesi i Edukatës fizike i cili do duhej ta kryej 'gjinastikën e trupit të nxënësit' por nuk është kompetent për ta drejtuar, udhëzuar dhe kontrolluar 'gjinastikën e trurit të tij'! Këtu fillon politizimi i njëmend i Arsimit kosovar! Gjimnazet do duhej të udhëhiqen nga profesionistët e Shkencave matematike-natyrore të ndihmuar nga ata të Shkencave shoqërore-humanitare ndërsa t'i ndjekin vetëm nxënësit e shkëlqyeshëm nëpërmjet Provimeve pranuese-kualifikuese! Përse pas më shumë se 70-të viteve përvojë negative, nuk pranojmë ta zbatojmë **modelin gjerman të gjimnazeve**?

Në vitin e dytë gjimnaz për fatin e madh të mëvonshëm të Safirit, erdhi një tjetër mësues matematike, **Graniti** i pari me diplomë fakulteti. Profesor i lindur, i rritur, i edukuar dhe i shkolluar në kohë trazirash dhe luftërash (atëherë kur mungonin buka, mësuesi, libri dhe fletorja ndërsa *lapsi për të bërë më shumë lapsa ndahej në dysh*), aty pari ku ecën 'toka dridhej'! Ditën kishte punuar si argat krahu për të fituar para të cilat do t'ia lehtësonin shkollimin. Detyrat e shtëpisë i gjenin zgjidhje natën vonë nën dritën e qiriut e në rastin më të mirë nën dritën e fenerit! Boja e shkrimit me bishtpenë ishte jeshile apo e kuqe për t'u verbuar më kollaj!

Në kohën e fëmijërisë dhe të rinisë së tij *analfabetizmi rrezatoi me tërë forcën e tij shkatërruese*. Njerëzit mezi dinin të shkruanin emrin e tyre dhe zakonisht letra e ushtarit lexohej tek komshiu. Për çudinë e njerëzve të kohës, që atëherë mësuesi Granit paska ditur të reflektojë në zgjedhjen e profesionit jetësor, *'gjuhën me të cilën flasin të gjitha shkencat e natyrës'* dhe jo vetëm. Mësuesi kishte ardhur për t'i mësuar nxënësit me 'dajak në krah'! Emërtimi por edhe lënda e studimit, matematikën e sistemon në lëndë mësimore të trishtuar. Kur kësaj i shtoheshin dhe kërcënimi i mësuesit: *'shpinë ta fali e notën s'ta fali'*; atëherë tek të gjithë nxënësit *hidhërimi kishte filluar të shndërrohet në pikëllim, duke i katandisur edhe familjarët e tyre*. Mësimi i matematikës Safirit dhe shokëve të tij ngadalë filloi t'iu shndërrohet në ankth dhe makth!

Profesori i matematikës me diplomë fakulteti ishte matematikani i parë, i cili në vitin e largët 1962 kishte vendosur të punojë në qytetin e tij të lindjes, 'potencial kadrovik i arritur' nëntë vite pas 'Qytetit të Urave' (1953). Si kuadër shumë deficitar më gjasë i dukej vetja superior ndaj mësuesve tjerë, Përgjatë shkrimeve në tabelë përpiquej të spikat unazën e tij me peshë mesatare në formë katrore. Nëpër klasë sillej si të ishte një xhandar! E pranoi mësimdhënien e matematikës në tëra paralelet ekzistuese të gjimnazit. Kuptohet ishte një barrë e madhe për të realizuar shtatë plan-programe të ndryshme. Në këtë kuptim, me gjasë puna cilësore e një tridhjetëvjeçari do mungojë e cila do bëhet e qartë vitin e tretë gjimnaz!

Përmbajtja programore e Matematikës për vitin e dytë Gjimnaz, nuk ishte e vëllimshme (Algjebër dhe Gjeometri) por Safiri as këtë vit shkollor nuk përfitoi njohuri me të cilat do ishte i kënaqur! Profesori thënie: **'Matematika nuk lexohet por ushtrohet'** e përsëriste shpeshë pa sqarime të mëtejshme! Asnjëherë nuk e kishte përmendur që *fillimisht mësohet Teoria e leksionit e më pas zgjidhen detyrat*; si ushtrohet kur detyrat gjysmë të zgjidhura mungonin; nuk kishte sqarime për zgjidhje detyrash; si të vërtetohej saktësia e zgjidhjes kur asnjëherë në tabelë nuk kishte bërë provë për zgjidhjen e saktë të një detyre!

Në mesin tonë ishte një **nxënës i veçantë, Egjra** e quanin, në matematikë shumë më i ditur se në të tjerët - tregonte Safiri, të cilit iu dha '*rol i mësuesit*' për një ditë, para provimeve me shkrim dhe kjo vetëm një orë mësimore pasdite; gjithsej katër herë përgjatë vitit shkollor! Me gjasë, mësuesi bënte përpjekje për ta përmirësuar 'bilancin e kalueshmërisë me pak investime'! Herën e parë, bëhej fjalë për *Ndërtimin dhe hulumtimin e Funksioneve katrore*! Pas dy viteve Safiri i bëri analizat e 'fenomenit Egjra' meqenëse si ai, inteligjentë ishin së paku më shumë se dhjetë të tjerë të cilët shfaqnin prapambetje në mësimin e matematikës. Athua përse ku ndodhej sekreti?

Nxënësi në fjalë kishte ardhur nga një shkollë tjetër fillore ku ndodhej një mësues matematike i pa diplomuar por me veti altruiste - nga duart e të të cilit kishte dalë edhe një matematikan! Ish nxënësi i dalluar por me gjasë egoist në ndërtim, asnjëherë nuk e tregoi sekretin e dijës së tij por as fletoret e tija të matematikës nuk i kishte parë asnjë shok klase! Ai e kishte familjarin e tij të moshës së mësuesit Granit të shkolluar me arsim superior por dhe me mundësi blerjeje librash matematike, të zëmë, Përmbledhje detyrash në vendin ku kishte studiuar! Botërisht dihet: **Matematika nuk mësohet pa libra!** Libri i ushtrimeve matematike edhe po qe se është i shkruar në 'gjuhën që e kupton shumë pak', ai nëpërmjet skicave, diagrameve, numrave, shenjave, tabelave, simboleve, relacioneve, operacioneve, sistemeve, figurave, funksioneve, rezultateve të zgjidhjeve apo të gjysmë-zgjidhjeve, e bënë të mundur që '*detyrat e dhëna të lexohen, formulohen, kuptohen dhe zgjidhen deri në fund*'. Ish shoku i klasës – Egjra nuk kishte mundësi që vetëm ai t'i dinte saktësisht zgjidhjen e detyrëve matematike të klasës dytë gjimnaz dhe tjerët të ishin injorantë, mbase në fizikë, biologji, kimi, gjeometri përshkruese, ishim tamam njësoj të ditur në rrethin e ,nxënësve të dalluar'!

Edhe përgjatë klasës së dytë gjimnaz i udhëhequr me shpresa të mëdha për nxënie matematike, Safiri nuk e përmirësoi atë mësim-nxënie siç dëshironte!. Me një mungesë të qëllimshme në një provim me shkrim (për të mos marrë notë të dobët), në fund ia doli të vlerësohej me notën mjaftueshëm (dysh). Klasën e dytë gjimnaz e kaloi me sukses shumë të mirë por me mësim matematike mbeti i zhgënjyer dhe i pakënaqur absolutisht!

Ishim në klasën e dytë gjimnaz, tamam para më shumë se gjashtëdhjetë viteve, atëbotë lindi 'dyshi famëkeq', nota e parë kaluese - formale, e cila realisht ishte padituri, notë e cila ta siguronte kalueshmërinë ('nxënësi nuk dinte aq shumë, por bënte përpjekje për të ditur'). Dyshi ishte dhe mbeti vlerësim identifikues thujse i pavlerë, i cili nuk të shpiente askund!

Klasa e tretë gjimnaz mbeti viti i kthesave, thyerjeve dhe i ndryshimeve të mëdha pozitive në jetën djaloshare të Safirit të cilat në fund të fundit do reflektohen dhe në profesionin e jetës! Edhe këtë vit shkollor në gjimnaz do punojë mësuesi me diplomë fakulteti, nga i cili në fund do përfitojë vlerësimin më maksimal të arritur ndonjëherë në historikun e gjimnazeve - i cili përmban 'premissa të një përralle', gjithsesi të besueshme! Në këtë rrjedhë ngjarjesh të 'papërsëritshme' janë disa rrugë e udhëkryqe, të përcjella me shumë fat, të pabesueshme. E para ndër ecejaket më vendimtare që **Safiri** në të ardhmen **do bëhej matematikan** ishte - **Pushteti Absolut i Notës së mësuesit Granit** nga i cili do futet në mundime nxënieje prej zori dhe frike ngeljeje në klasë!

Libri i klasës së tretë gjimnaz - Grupi i shkencave natyrore ishte i përkthyer në gegërishte të moçme, përmbajtja e të cilit ishte e ngjeshur, me informacione të shtangëta dhe të vështira për t'u kuptuar. Nuk përmbante hapësirë të duhur për qasje krijuese për vetëkontroll; mungonin udhëzimet për t'i zgjidhur detyrat ose thjeshtë mungonin detyrat e zgjidhura. Në anën tjetër mentori shtëpiak për matematikë nuk ekzistonte askund! Atëbotë, Safiri i fajësonte mësuesit e parë të matematikës të cilët ishin dështak dhe të paditur; egoist dhe matrapaz; sharlatan dhe batakçi ! Në lëndët mësimore simotra: biologji, kimi, fizikë, gjeometri përshkruese,... ishte i dalluar. Tashmë po largohej përfundimisht nga Matematika! Në pritje ishte të largohej përnjëmend edhe nga shkolla si vëllai dhe motra e tij më herët!

Mësimi i matematikës u ndërlikua më shumë kur filluan leksionet në veçanti nga *Trigonometria*, *Gjeometria analitike*, *Planimetria dhe Stereometria*. Atë vit shkollor mësuesi me diplomë fakulteti asnjë detyrë të thuash nuk e zgjidhi deri në fund! I papërgatitur për orë mësimore në emër të gabimeve të shtypit, fajësonte autorin sllav të librit por edhe përkthyesin. Përpjekjet e Safirit për t'u futur në disiplinën atraktive Trigonometri ishin shterpe dhe të pasuksesshme.

Mësuesi egoist (i identifikuar më vonë edhe si i dembelosur për mësimdhënie si i papërgatitur), nuk interpretonte rrugëzgjidhjen e detyrave! Me asnjë fjalë nuk e shpjegonte metodologjinë e nxënies së Trigonometrisë, tamam si një lojë shahu ku deri në zgjidhje detyrash shpjen shumë rrugë; rrugica por edhe 'rrugë qorre'. Normalisht shumë formula (algoritme) duhet mësuar pa gabime dhe po të njëjtat duhet aplikuar vetëtimthi sipas ligjësorive të caktuara matematike! Dhe po qe se punohet me saktësi të gjitha 'rrugët mbretërore' shpjen tek rezultati i zgjidhjes së përpiktë e cila kërkohet!

Edhe pse në gjysmëvjetorin e parë nuk kisha nxënie të suksesshme, Këshilli i mësimdhënësve në cilësinë e nxënësit të dalluar, 'ia fali notën' duke fituar një *dysh jetëshkurtër* - deri në fillim të gjysmëvjetorit të dytë atëherë kur filloi tatëpjeta e madhe në mësim-nxënien e matematikës! Abstenimi për t'u fotografuar me shokë para fundit të vitit shkollor shprehte qëndrimin dhe mbylljen në vetvete përplot pezëm dhe mosbesim në kalueshmërinë eventuale nga matematika në klasën e tretë gjimnaz!

Suksesi i nxënësve në mësim ndërlidhet ndonjëherë edhe me standardin jetësor të kohës: të ushqyerit dhe veshmbathja nuk ishin të kënaqshme; nxënësit i ndiqnin leksionet në shkollë pa ngrënë mëngjes; për shumë familje lopa ishte burim jetese; harxhimet ushqimore bëheshin një herë në javë, ditën e pazarit; një numër i vogël nxënësish kishin orë dore dhe veshje dimri; nxënësi që nuk kishte sigurime sociale dhe shëndetësore, mungesën e tij si i sëmure e arsyetonte nëpërmjet familjarit fizikisht!

Vitet e tyre të rinisë ka gjysmë shekulli e më shumë që kanë kaluar, në pa kthim së bashku me ato si gjimnazist! Ata që ende janë gjallë e shëndosh pa përjashtim i kujtojnë si vite të egra, jo humane, dhe të sërta rinore, të një jete të hidhur pelin, e përcjellë në çdo hap me kërcnim note të dobët dhe ankth! Mësuesit dhe nxënësit nuk jetonin, punonin e mësonin si partnerë, por si kundërshtarë, ku nga ana e mësuesve kishte paragjykime me premisa hakmarrëse! Ishte koha kur *nxënësi konsiderohej objekt* i cili nuk do duhej të shihej në rrugë por vetëm në relacionin *shtëpi-shkollë* dhe anasjelltas përndryshe pritja për t'u vlerësuar me 'notë subjektive' të nesërmen ishte e zakonshme!

Thënia tejet e mbrapshtë e mësuesit Granit: '**Detyrat e shtëpisë duhet zgjidhur qoftë edhe gabimisht**', për Safirin u kategorizua si një **këshillë prej budallai** e cila i solli çoroditje në të mësuar,

njëherit dhe shumë dëme afatshkurtra veçmas në klasën e tretë gjimnaz, për të cilën Safiri do rrefehet në vazhdim të tregimit. Përgjatë tërë vitit shkollor, bëri përpjekje të vazhduara, për ta fituar 'dyshin e kalueshmërisë'! Në bankën përballë tij ndodhej nxënësi **Selen** i cili ishte i ulur me të dalluarin **Egjrën**. Për Selenin ishte e 'rezervuar' nota në Matematikë: shumë e mirë(4) ose e shkëlqyeshme(5). I vlerësuar me këto dy nota, të gjithë mendonim që ai ndodhej në 'rrugë të mbarë në nxënie matematike' dhe nga kjo rrethanë mund të përfitojë dhe ndonjë 'shok' i tij! ('Notat fiktive' të Selenit në matematikë dolën të ishin falso!)

Safiri mori leje nga **Seleni** për t'i kopjuar nga ai detyrat e zgjidhura të matematikës (përgjatë 'pushimeve')! Askush tjetër nuk e bëri atë 'punë'! Si përfundim Safiri nuk mësoi asgjë për më tepër iu 'katandis nxënia'! Përgjatë përgatitjes për Provimin e Vjeshtës Mentori i tij i kishte thënë: 'Në fletore, të gjitha detyrat i keni të zgjidhura gabimisht'! Është për t' u habitur edhe sot, se sa vetjak ka qenë **Egjra** me qëndrime, aspirata, interesa e qëllime egoiste ndaj shokëve, në veçanti ndaj dyshe **Selen** dhe **Safir!**

Seleni e mbante mbiemrin e një familjeje të madhe fisnike, me ndikim ekonomik-politik në vend dhe duke mos dalë asnjëherë në tabelë për të ushtruar, notat në mësimin e matematikës i kishte të përfunduara në mbështetje të suksesit nga Provimet me shkrim! Matematika ishte bërë e 'kollajshme' për të, sepse përgjatë Provimit detyrat e tija ishin të zgjidhura saktë, pasi ndodhej i ulur me Egjrën në një bankë! Atij i mbetej vetëm t'i kopjonte detyrat të cilat do t'ia zgjidhte Egjra! Si rezultat i kësaj Seleni mbeti vetëm me shkollë të mesme të kryer dhe as që u orvat ta studiojë matematikën për dallim nga shoku i tij i bankës i cili arriti në maje të saj! Kjo mjaftonte për të thënë se mësimdhënia e mësuesit Granit ishte amatoreske, e paplanifikuar, e papërgatitur ndërsa *vlerësimi i diturive nga ai kategorizohej: subjektiv, naiv, i pamatur, i turpshëm, skandaloz dhe i pa ekuilibruar! Megjithatë, falë 'Pushtetit të notës' që ai mbante edhe pse subjektive, nga paralelja në fjalë diplomuan katër matematikanë!*

Në lëndët tjera mësimore simotra, Safiri kishte rezultate shumë të mira; me gjasë ky ishte shkas, për ta rivlerësuar atë në vjeshtë edhe njëherë! Kësaj radhe në cilësinë e kryeneçit mësuesi Granit nuk bëri lëshime dhe qëndrimi i tij dashamirës ishte **fat i parë i madh njerëzor!** Po të kishte ndodhur ndryshe, njëqind për qind, ai nuk do ishte bërë matematikan kurrën e kurrës!

'Rebelimi' i grupit ndodhi, por kurrë ndonjëherë më parë nxënësit e dalluar s'ishin mbetur për vjeshtë! Mësuesin nuk e vriste ndërgegjja, as nuk e brente pendimi! Për momentin *u dorëzuan duke e humbur një 'betejë' por jo edhe 'luftën'*. Kërkuan një *armëpushim* dymujor (korrik-gusht). Fillimisht ishte i brengosur që nga ata asnjëri nuk e njihte 'gjuhën' nëpërmjet së cilës fliste matematika por e dinin ta parashtronin pyetjen retorike: 'Kur personi me intelekt mesatar mund ta mësojë *gjuhën e gjarprit*, atëherë përse nuk mund të mësohet gjuha me të cilën do flisnin të gjitha shkencat e natyrës'!

Mësuesi 'kishte lidhur lojë' me një student të matematikës të vitit të parë që ky i fundit t'i mësojë nxënësit që kishin mbetur për t'u riprovuar në matematikë, kuptohet me pagesë. (Atë vit shkollor në mësimin e matematikës kishin mbetur për t'u riprovuar një numër rekord nxënësish). Situata kishte qenë e mbarsur me një shkallë rrezikshmërie shumë të lartë, kujton Safiri. Po që se nxënësi nuk arrin sukses në riprovim dhe po ai nuk ka bërë pagesë për kursin tek studenti, apriori do ta humbas vitin! Kjo u dëshmuua si e vërtetë pasi përfunduan provimet e vjeshtës!

Safiri u përcaktua për një strategji tjetër (me gjasë shumë të rrezikshme por pa e ditur fare se çfarë skenari po përgatitej nga mësuesi Granit për ta vlerësuar matematikanin e ardhshëm me shokë)! Në një qendër tjetër urbane, një mik shpie *Mentori* student i dalluar i vitit tretë të FSHMN –Dega e Matematikës kishte paraqitur gatishmëri për të punuar me Safirin tri javë nga dy orë në ditë. Pjesa tjetër e ditës shfrytëzohej për t'i rishkruar dhe risistemuar detyrat e zgjidhura. Puna e tij ishte e normuar tetë deri në dymbëdhjetë orë në ditë!

Dhoma në të cilën Safiri ishte akomoduar për kohën ishte mrekullia vet! Dritarja e saj ishte me shikim kah Perëndimi dhe jo më shumë se tre kilometra vijë ajrore larg majave të bjeshkës. Për këtë arsye edhe pse muaji korrik ishte me vapë të madhe freskia në dhomën ku punonte ishte ideale.

Përndryshe miku ishte njohës i shkëlqyeshëm i përmbajtjeve të librit 300 faqesh për klasën e tretë gjimnaz. Nuk kishte detyrë në libër të cilin nuk dinte ta zgjidhë duke ofruar interpretim zgjidhjeje të saktë së bashku me provën e saj analitike dhe grafike! Kishin zgjidhur numër rekord detyrash për të arritur në fund të shtatëmbëdhjetë ditëve numrin prej 310 sish. Detyrat e zgjidhura pa gabime ishin bazament i fuqishëm matematik i cili më parë vetëm mund të ëndërrohej! Mikut të shtëpisë të cilit Safiri i mbetet borxhli përjetë bashkë me aftësinë dhe gatishmërinë e tij ishte *fati i dytë i madh njerëzor*, duke e shndërruar matematikanin e ardhshëm në një fatmirë të madh dhe të rrallë, për faktin që:- Derisa mësuesi Granit kishte trumbetuar që të thuash afër gjysma e detyrave të librit shkollor, janë të përcjella me gabime shtypi dhe për atë ishin të pazgjidhura, e vërteta doli krejtësisht ndryshe!

Çfarë mund të mësonte nxënësi i deridjeshëm *rebel* në mësimet nga Trigonometria, Gjeometria analitike, Planimetria dhe Stereometria në vetëm tri javë mbetet për t'u dëshiruar tamam si në përrallë, e pa besueshme, e pa zakonshme, e dyshimtë, si e sajuar për lexuesin!

Pas vikendit 17 ditë rikthehet në shpinë e tij për të vazhduar punën përgatitore të riprovimit me gojë dhe me shkrim. Ditët kalonin njëra pas tjetrës, me punë (15-16) orë në ditë; ditën ushtronte përmbajtjet teorike ndërsa natën shokëve të mëhallës të cilët kishin mbetur për t'u riprovuar *u mbante ligjëratat teorikë nga Trigonometria dhe Gjeometria analitike por edhe nga Planimetria dhe Stereometria*.

Koha e armëpushimit dy mujor (20 Qershor- 20 gusht) kaloi dhe erdhi dita e tij e shumë prituri! Detyrat e provimit me shkrim djaloshi i tregimit tonë i zgjidhi shpejt dhe saktë pa asnjë gabim dhe ishte i bindur në kalueshmëri! Pa i dhënë vetes pushim filloi përgatitjet e provimit më gojë i cili do mbahej pas tri ditëve. Në pjesën me gojë posa i mori pyetjet mësuesi në prani të Komisionit prej tri vetash i tha: Kromi, meqenëse me shkrim i ke zgjidhur të tri detyrat pa gabime nuk do dalësh në tabelë! Përpiqu këtyre pyetjeve 'gojore' t'u japësh përgjigje në vend!

Ishte i ngazëlluar dhe pyetjeve me gojë vetëtimthi në disa fletë të bardha u dha përgjigje të saktë, shpejtë! Mësuesit nuk i mbeti gjë tjetër vetëm ta përgëzoj! Në provimin me shkrim dhe tash me gojë je përgjigjur shkëlqyeshëm por *nota nga një(1) nuk mund të ngritët në pesë(5) por vetëm në shumë mirë(4)!* Ti je i vetmi që ke arritur këtë sukses!

Rasti i Safirit dëshmoi dhe ia vlen ta mbani në mend: *Nëse ekziston 'Pushteti i notës', edhe pa transmetim cilësor diturish, nxënësi me vet-arsimim mund të bëhet i lumtur!* Deri këtu Safirin e ndoqën

dhe e ndihmuan dy fate njerëzore: **Pushteti i notës**, i palëkundur dhe **treqinddhjetë detyrat e zgjidhura saktësisht pa gabime**, nga miku i shtëpisë. Sikur njëra nga këto dy parakushte të kishte munguar rrjedha e ngjarjeve jetësore tek Safiri do ishte ndryshe!

Mësuesit Granit i përkiste 'merita' vetëm për mos-falje të notës - një nxënësi të dalluar! Po, përse ia mohoi suksesin e rrallë të shkëlqyeshëm në mësimin e matematikës gjatë Provimit të vjeshtës? Meqenëse Safiri çdo detyrë e zgjidhi saktësisht dhe çdo pyetjeje teorike iu përgjigj me përpikëri, burrëri do kishte treguar po të thoshte: "*Djali i mirë, kush ta paska mësuar Matematikën kaq mirë përgjatë këtyre dy muajve? Të uroja suksesin ty dhe atë person që nuk e njoh! Pas kryerjes së klasës katër gjimnaz, të këshilloj e të dëshiroj ta studiosh Matematikën dhe të bëhemi kolegë pune!*"

Në afatin e provimeve të vjeshtës (gusht-shtator) nuk kishin arritur sukses të gjithë nxënësit, një pjesë e konsiderueshme e tyre e patën humbur vitin! (Në paralelen e Safirit në klasën e katër gjimnaz kishin 'ateruar' shtatë shokë të rinj, të gjithë këta me humbje viti nga mësimi i matematikës)! Mësuesi i matematikës iku nga qyteti i tij i lindjes dhe shkoi për të punuar në një qendër më të madhe urbane.

'Mësuesi i sertë' kohës sate mjaft i ke dhënë, hiç më pak se gjashtë matematikanë! Keni mbetur në kujtesën historike të brezave për 'Pushtetin e Notës'. Atëbotë të gjithë njerëzit nuk të patën kuptuar njëlloj, në mesin e tyre edhe unë! Ishe ndër partizanët e fundit të shtrëngimit të notës e mbështjellë me velin e frikës dhe të ankthit!

Në klasën e katër gjimnaz për mësues matematike u erdhi një i moshuar, për të cilin askush nuk kishte njohuri lidhur me përgatitjen e tij shkollorë. Nga shokët ai u informua që Safiri fletoret e matematikës i ka më të mirat në paralele! Ia kërkoi për huazim dhjetëditorë - ato të klasës tretë të cilat ia ktheu përsëri. Ai mbetet i veçantë për freskinë e shfaqur për të qenë i muhabetshëm gjatë pjesës hyrëse të çdo ore mësimore deri në pesëmbëdhjetë minutat e para, duke e fituar epitelin - **Grafit muhabeti!** Më vonë u kuptua; 'mësuesi *shtegtar*' kishte ndërruar hiç më pak se njëzetë vende pune!

Në fillim të klasës së IV^{të} dy paralele gjimnazi dhe një paralele e Shkollës së Mesme të Tekstilit organizuan ekskursionin dhjetëditor të maturantëve nëpër ish-Jugosllavi deri në Bled të Sllovenisë ku shumica e nxënësve me tren udhëtonin për herë të parë! Tre mësuesit përcjellës, të ngathët, nxënësit i kishin drejtuar gabimisht të hipnim në një '*tren të shpejt*' i cili shpinte për në Austri, me mendimin se po udhëtonim për në Bled! Pas disa kilometrash treni ndalet për një minutë; rrëmujë e '*njerëzve të gjakut tonë*' për të zbritur nga treni! Por një grup prej nja pesëmbëdhjetë vetash kësaj here mbetëm në tren i cili qarkullonte me shpejtësi të madhe për '*të pritur rastin tjetër*' pas dhjetë minutash! Kësaj radhe ndalesa ishte akoma më e vogël me ç' rast kërcimi në Tokë nga treni ishte përgjatë një '*lëvizje të vogël*'! Fatbardhësisht patëm shpëtuar pa thyer dorë apo këmbë për t'iu bashkuar shokëve në një hotel të Bledit pas nja katër orëve diku në mesnatë!

Safiri maturant në matematikë doli nxënës i mirë, ndërsa në kimi, fizikë, biologji ... shumë i mirë, për të mos thënë i dalluar! Për **Temë mature** zgjodhi **Kërpudhat** nga lënda e Biologjisë, për faktin që një familjar i tij ishte Agronom dhe 'mundësia në letër' për të siguruar literaturë 'ishte e madhe'! Megjithatë, literatura u sigurua në një qendër tjetër urbane! Atëbotë njerëzit me diplomë fakulteti ende ishin të rrallë! Temën e maturës e mbrojti me sukses shumë të mirë por *orientimi profesional* i tij nuk kishte 'busull'! Kjo

ishite *'dhurata e shkollës pa zanat'*, ku transmetimi i diturive bëhej nëpërmjet injorantëve dhe *mësimdhënia ishte vend pune por nuk ishte mision jetësor*. Atëbotë, **Safiri nuk mendonte për studim të matematikës** kurrsesi, meqë tek ai ekzistonte *'frika e brendshme prej saj'*, *tamam si nata në det!*

Dy gjetje të analizuara lidhur me personelin udhëheqës të ish-Gjimnazit në një 'kohë pa kohë' mbase deformimet shoqërore-politike ishin të mëdha e tronditëse meritojnë vëmendje!

Safiri dallohej për një dhunti të rrallë, thënë shkurt në mesin e shokëve dhe shoqeve ishte stenograf i lindur(mënyrë për të shkruar me shpejtësi ligjërimin e dikujt duke përdorur shkurtesa dhe shenja për fjalët e thjeshtuara; simbole të posaçme e të veçanta të lexueshme edhe me një shkronjë!)

Amoniaku, profesor psikologjie e logjike (në klasën e tretë) dhe sociologjie (në klasën e katër gjimnaz për të cilën ekzistonte libri) ishte personalitet i ditur shkencor por përveçse autokrat i thekur ishte dhe shpirtgëz. Tekstet për dy lëndët e para mësimore të zëna në gojë nuk ekzistonin ndërsa ai i njëjtte leksionet shkëlqyeshëm dhe si vjershë i ligjëronte! Vlerësimi me notë kërkohet dhe përveç Safirit i cili ishte 'specializuar', askush tjetër nga shokët nuk mund t'i merrte shënimet e një të folme si të ishte 'konferencë për shtyp' apo 'transmetim ndeshjesh sportive'?!)

Turravrap pas mësimit, puna e parë që e bënte (pas orëve të Psikologjisë dhe Logjikës pa hëngër drekë, por edhe pa mëngjes!) ishte deshifrimi i asaj çfarë kishte shkruar me dorën e vet përkatësisht t'i bënte ato të lexueshme. Me fletoret e Safirit u shërbyen të gjithë nxënësit e interesuar, asnjëri nuk ishte refuzuar, të cilët të gjithë e dinin shpinë ku ai jetonte. Edhe sot shokët e mbetur gjallë i falënderon për besën e dhënë, për t'ia kthyer fletoret pas kopjimit! Dhe shpirtligu me gjasë e kishte 'zbuluar' nxënësin i cili i mbronte nga nota e dobët apriori! Dënimi për atë ishte nota e mjaftueshme (2), duke ia lejuar që përgjatë vlerësimit të tij ta thoshte vetëm një fjali! Në raste të tilla apo të ngjashme askush nuk guxonte ta kundërshtonte apo të ankohej mbase ai ishte vet pushteti dhe shteti.

Damka tjetër e tij ishte mbetja për ta 'riprovuar' për vjeshtë në matematikë, Kryetarin e rinisë së gjimnazit, çun i Veteranit të Arsimit nga Normalja e Elbasanit! Dhe kjo në klasën e katërt gjimnaz, mbase nxënësit i nënshtrohen mbrojtjes nga Tema e Maturës! Rasti ishte i kurdisur; mësuesi i Sociologjisë (Amoniaku) dhe ai i Matematikës (Grafiti) i kishin ndërruar rolet për realizim skenari duke e prishur mundësinë e organizimit të mbrëmjes së maturës por edhe për ta penguar ish-Kryetarin e Rinisë, Regjistrimin e Fakultetit të dëshiruar, në tetorin e atij viti!

Gjimnazi i vendlindjes për kohën që po flasim (1964/65) e kishte dhënë gjeneratën e tetë të gjimnazistëve e cila përfundoi shkollimin e mesëm me një ekskursion dhjetëditorë deri në Bledin ilirian por pa 'kujtimin e detyrueshëm' që do duhej të ofrojë Gjimnazi lidhur me **Mbrëmjen e Maturës**, e cila mbahet edhe në kohë lufte! Ajo nuk u organizua si shenjë pakënaqësie ndaj sjelljeve banditeske të **Amoniakut** dhe disa mësuesve të tjerë, me vlerësime hakmarrëse ndaj disa nxënësve, të cilët megjithatë në cilësinë e të diturve arritën arsimim superior, në mesin e tyre edhe ish-Kryetari i Rinisë me karrierën e një gjyqtari dhe avokati të dalluar!

V. NGA LUBJANA KRYENGULTHI-MËSUES NË ÇERMJAN

Vetëm tre-katër veta ishin me orientim të mirëfilltë profesional mbështetur në dhunti ekzistuese dhe inteligjencën e trashëguar. Disa ishin të penguar nga mosdhënia e Provimit Pranues, disa të dytë nga mosnjohja cilësore e gjuhës sllave, disa i pengoi mosnjohja e matematikës, disa i pengoi mungesa e bursës apo kredisë, kushtet sociale -ekonomike në familje, etj. Më të kënaqur se të tjerët ishin ata që do qëndronin në Kosovë për t'u shkolluar! Zgjedhja e tyre ishte Arsimi, Ekonomia dhe Drejtësia, ndërsa për Farmaci, Mjekësi, Veterinë apo Makineri, Elektroteknikë, Artet e Bukura... do duhej ikur jashtë Kosovës!

Ish Fabrika e Tekstilit jepte bursa për të studiuar në Fakultetin Teknologjik të Tekstilit, në Lubjanë të Sllovenisë! Pa e njohur gjuhën sllovene dhe pa pasur standard të mirëfilltë jetese, sa ora u krijua ideja dhe përcaktimi i pesë shokëve; Urani, Bariti, Piriti, Rutili dhe Safiri, për t'u shkolluar në ish skajin e trojeve të Ilirisë antike! Të fundit, vëllai ia kishte dhënë mantelin e trupit! Shokët ishin vërtetë të dehur me emërtimin e ekspertit të fushës Teknolog, por çfarë lidhje ka Gjimnazi me Degën e Tekstilit?

Një ditë tetori pesë shokët u nisën për në Lubjanë të pa përgatitur në çdo pikëpamje dhe aspak optimist për këtë iniciativë! Me të arritur atje mbetën qyqe në rrugë, nuk i pranuan në konviktin e studentëve! Si parakusht do duhej të ishin pjesëtarë familjesh luftëtarësh të LNÇL. Pas kritikave të ndërsjella që ia bënin njëri-tjetrit për këtë 'ekskursion të dytë' u detyruan që gjumin e natës ta bënin në Stacionin e trenit! Atje qëndruan dhjetë ditë. Ishte një lajmërim i thënë në gjuhën sllovene për orët mësimore të së nesërme (të cilin 'dështakët' nuk e kishin kuptuar fare), bëri që ata të gjenden aty gabimisht dhe të merrnin qëndrim për ikje nga atje menjëherë të nesërmen!

Kthimi nga Lubjana ishte i dhimbshëm, i barasvlershëm me një fatkeqësi të madhe të vetë sajuar! Çfarë do t'iu përgjigjeni të interesuarve përse jeni kthyer, a menduat që atje bëhej ndarje e diplomave! Më pas a keni dëgjuar fare që disa bashkë-vendas të qytetit atje kanë 'zënë rrënjë' dhjetë, dymbëdhjetë, pesëmbëdhjetë vite dhe ende nuk kanë diplomuar! Përse iu ka munguar komunikimi me familjarët e tyre për të fituar një përvojë parapërgatitore?

Me tren deri në Fushë Kosovë u kthyen një pasdite tetori për të ndaluar më pas në Prishtinë. Safiri atëbotë nuk kishte të afërm me banim aty dhe kishte mendim të çuditshëm; donte që gjumin e natës ta bënte në Parkun e qytetit! Shokët e hetuan një familjar farefisnie, me dredhi e dërguan deri tek hyrja e tij ku banonte dhe u ballafaqua me të papriturën! Plaka e shtëpisë e drejtoi tek një adresë tjetër duke mos paraqitur gatishmëri strehimi për atë natë! Skena ishte tamam si natë varri për të mbetur pa frymë! Zëvendësimi i bujtinës ishte i rehatshëm dhe dashamirës për mos me e harruar kurrë, për mirë dhe rastisi si e porositur që kryefamiljari dhjetë vite më vonë, të nderohej për shkuesi nusërie!

Të nesërmen doli i vetmuar dhe shkoi tek Dekanati i Shkollës së Lartë Teknike për të hetuar mundësinë e regjistrimit por tashmë kishte kaluar dhjetëditëshi i parë i tetorit dhe ishte vonë. Më pas u takua me Rutilin, i cili kishte plane qëndrimi aty për ta studiuar drejtësinë ndërsa ai e donte kthimin në shpi dhe punësimin eventual në ndonjë shkollë fshati.

Atje qëndroi vetëm një shok me Shkollë të Mesme Tekstili dhe me mirëqenie të konsoliduar i cili në kohën e qëndrimit të tyre në Lubjanë mori banesë me qira! I kreu studimet me gjasë përgjatë një

dekade por me karrierën e tij njëzetë vjeçare, personalisht nuk do duhej të ishte i kënaqur për investimin studimor, për faktin që në vitet e nëntëdhjeta të shekullit 20-të, Sistemi Ekonomiko-Shoqëror i Shtetit ('sallatë' e qanin Shqiptarët e Turqisë) u rrëzua dhe Industria e Tekstileve në Kosovë falimentoi me shkatërrim! Ish-shokët e kthyer nga vendi i të parëve tanë (Ilirisë antike) disa dekada më parë kishin arritur këto kualifikime jetësore: kimist; gjuhë dhe letërsi angleze; fizikan dhe matematikan.

Ekskursioni i dytë dhjetëditor në Slloveni në Fakultetin Teknologjik –Dega e Tekstilit në Lubjanë i katër shokëve gjimnazistë ishte një dështim madhor djaloshar, përcaktim studimor fare i papjekur, por edhe një turp personal i secilit veç e veç! Si e kishin konsideruar gjuhën sllovene në mendjet e tyre, kur të folurit gjatë përditshmërisë ishte 99.5% shqip dhe as gjuhën tjetër sllave nuk e dinin me përjashtim të Mëhallës së Re e cila kishte shkollë filllore dhe popullsi të përzier! Atje katërshja takoi disa arabë të cilët rrëfyn se vijonin kursin e vrullshëm gjashtëmujor të gjuhës sllovene. 'Dështakët' çfarë kishin mësuar deri atëherë sllovenisht që shpejt do ktheheshin! Më pas, si bën që për shkak të një burse të siguruar me shkollën e mesme të Gjimnazit të vijohet një fakultet tekstili! Kuadrot e profilit të tillë përveç përgjegjësisë në punë për vete dhe të tjerët, në çfarë shkalle ndodhej rrezikshmëria e shëndetit të tyre; avujt, ngjyrosja e tekstileve, ...,puna në ndërrimin e natës, përgjegjësia për cilësinë e prodhimit,...

Gjeneratat e gjimnazistëve para gjashtëdhjetë viteve ishin shkolluar, edukuar e arsimuar tamam si 'dele'.Nuk kishin njohuri të duhura dhe të thella për botën që i rrethonte. U mungonte kthjelltësi mendimi dhe vlerësimi; gjykimi dhe veprimi, lidhur me orientimin dhe kualifikimin profesional-jetësor të tyre, cektësia të thuash në gjithçka përreth tyre ishte evidente!

Sjelljet sunduese të mësuesve ndaj nxënësve me gjasë u kishin topitur e shtangur mendimet dhe vlerësimet e pjekura e të bazuara! Me gjasë aty-këtu ndonjë familjar i shokut, vijues i shkollimit superior të ka ofruar ndonjë detaj sjelljeje dhe orientimi dhe kjo ishte e tëra; me vetëvendosje kandidati gjëndeje para sportelit të referentit të studentëve për regjistrim, pa e çarë kokën shumë për hiçgjë,+ 'mos vallë e kishte humbur adresën'; me gjasë vepronte si të ishte një lotari 'le të dal, ku të dal'! Ishte si një lloj dehjeje *krenarie*. Të humbet së paku një vit shkollimi për hiçgjë ishte shumë më shumë se budallallëk, me pasoja eventuale humbjeje dëshire a vullneti për studime në të ardhshmen. Kandidatët të cilët ishin regjistruar në fakultet aty ku nuk e meritonin dhe ku nuk e kishin vendin, mirëqenia e tyre familjare ishte e begatë, për ata bezdia nuk ekzistonte; dy-tre vitet e para mësohej gjuha sllave dhe+ më pas për çdo dy-tre vjet kalonin me sukses provimet e një viti dhe përfundimisht pas dhjetë apo dymbëdhjetë vitesh diplomahej!Përjashtim bënin një numër i vogël kandidatësh, nxënësish të dalluar, të përcaktuar saktë për Degën e paramenduar dhe të planifikuar qëmoti, të cilët ishin rritur dhe shkolluar në ambiente me popullsi të përzier, nuk kishin probleme gjuhe dhe studimet i kryenin me sukses dhe në afate optimale.

Ideja për përcaktimin e profesionit jetësor të gjimnazistit (në veçanti) do duhej ndodhë pas *debateve dhe analizave katërvjeçare për dhe kundër profesionit jetësor* nën udhëheqjen, mbikëqyrjen dhe sugjerimin edhe të *mësuesve të gjimnazit* të cilët do duhej me qenë me *kompetenca të plota*, ta zëmë: Kompetenca e të mësuarit në gjuhën amtare dhe në një gjuhë tjetër jo amtare; Kompetenca e njohjes së një apo dy gjuhëve të huaja; Kompetenca e aplikimit të diturive matematike; Kompetenca e kultivimit të oratorisë në gjuhën (jo)amtare; Kompetenca digjitale; Kompetenca e të mësuarit për të jetuar së bashku me të tjerët,në rrethe të tjera shoqërore të ndryshme nga origjina e të tjera!

Nga përvoja jetësore e dëgjuar (1972), njëri ndër matematikanët shqiptarë më në zë të kohës (P.P.) thoshte: Detyra ime profesionale përveç ligjërimit në Fakultet është *'shëtija'* nga rrethi në rreth për të veçuar, identifikuar dhe zbuluar talentet matematikanë të cilët do regjistrohen në FSHMN. Safirit i piknin edhe lotët nga katrahura e tij jetësore! Ah sikur...! Kjo i bie sikurse Trajnerët dhe Përzgjedhësit e Top-këmbës në cilësinë e spektatorit shëtisin nga ndeshja-në ndeshje; nga lokaliteti në lokalitet; nga qyteti-në qytet; nga kampionati-në kampionat; nga shteti-në shtet; për zbulimin dhe identifikimin e lojtarëve për të cilët do ketë shit-blerje, për ta kompletuar ekipin e një skuadre prej njëzet e dy lojtarësh, për sezonin e ardhshëm të Kampionatit shtetëror nga Top-këmba!

Hidhërimi të cilin e solli kthimi nga Lubjana nuk i zgjati më shumë se dy-tre ditë dhe Safiri djali axhami filloi t'i kthehej jetës dhe optimizmit se mirë do bëhet! E mori për shfrytëzim një biçikletë tek fqinji për ta kërkuar dhe gjetur një vend pune në ndonjë fshat. E dinte që shkollat e afërta fshatare në gjysmën e dytë të tetorit nuk mund të kenë vende të lira pune dhe ia mësyu fshatit Çermian ku ndodhej shkolla fillore dhe si me dorë doli vendi bosh i punës, mësues i klasës së tretë dhe sa ora iu zbukurua vendi i punës, edhe pse doli të jetë fshat gati i braktisur, pa elektrifikim dhe larg nga qyteti trembëdhjetë kilometra me një rrugë dhish, askund rrugë rrafshi, me panumër shumë kodra dhe kodrina dhe përgjatë shirave duhej të ecej në këmbë gjysma e rrugës, pa biçikletë, 'ajo duhej të pushonte' në Bec, sepse toka ishte argjilore dhe rrota e biçikletës bëhej si t' ishte rrota e mullirit, atëherë ajo ose të bartej në krah ose të lihej në rrugë! Vërtetë ishte si një lloj punësimi ndëshkues! Megjithatë jeta dhe puna njëvjeçare në cilësinë e mësuesit pranë Sukës së Dushkajës, paksa të braktisur pa rrugë, pa ushqime të mjaftueshme, pa rrymë elektrike ('65) nuk ishte e kollajshme por në moshë djalërie te të njëzetave, vlerësohen si më të bukurat në jetën e gjithsecilit!

Aty tashmë kishin filluar punën shokët e rinj, disa prej tyre të njohur edhe më parë: Metali, Bariti, Berili dhe Boraksi. Metali ishte kthyer nga Zagrebi pas një viti qëndrimi atje, me gjasë duke përjetuar shumëçka nga jeta studentore ndërsa Safiri në cilësinë e të 'dehurit' ishte kthyer nga një 'ekskursion' i dytë dhjetëditorë deri në Lubjanë të Sllovenisë sepse ia deshë hunda të nuhasë atje tipin e shkollës! Tani fati i ngjashëm jetësor i bashkojë, të punojnë si mësues në një shkollë dhe për ta bërë gjumin e natës në një dhomë në të cilën ishte i vendosur edhe Bariti. Me të parin njiheshin që në vegjëli dhe ai ishte lajmëtari për shpërblimin prej njëzetë mijë dinarësh nga Rilindja kur ishte në klasën e shtatë fillore. Safirin e sistemuan si Metalin, mësues të klasave të treta. Në gjysmë-vjetorin e dytë ia dhanë pa dashje edhe orët e biologjisë sepse Temë mature i kishte *Kërpudhat*. Paga mujore e mësuesit ishte tamam për ta blerë një biçikletë, tridhjetë e shtatë mijë dinarë. Ishte koha një vit para Plenumit të Brioneve kur çdo shqiptar mund ta kishte 'kokën në thes'. Zakonisht kthimi në qytet lejohej çdo të shtune sepse me udhëtime të përditshme vlerësohej që dëmtohet mësimdhënia! Biçikletat ndodheshin në paradhomë.

Meny e ditës ishte pitja me kos, e sjellë nga shtëpia të hënën, vezët, supa, suxhuku, konserva, fasulja e Kooperativës Bujqësore. Safiri e Metali ish nxënës të dalluar gjimnazi përgjatë një viti asnjëherë nuk kishin folur lidhur me ecejaket e tyre 'studentore', prej së cilave biseda do përfitonte i pari, ndërsa i dyti me gjasë ishte përshëndetur me studime universitare së paku me ato jashtë Kosovës! Ai ziente në gojë premtimet për punësim në gazetën Rilindja që ia kishte bërë xhaxhi Argjendi nga Prizreni. Si i rinj kishte prirje të theksuara për biseda përplot me analiza ngjarjesh shoqërore-politike të kohës, dhunti kuvendesh odash familjare e trashëguar nga të parët!

Puna intelektuale e një mësuesi fshati krahasuar me punën studimore të një studenti atë e kishte shndërruar në një person të hiçit para të cilit paraqitej një djerrinë intelektuale tek e cila shuhej çdo iniciativë studimi! Blerje librash asnjë; me lexuar asgjë; me mësuar diçka, asgjë; me shkruar hiçgjë! Kohë për meditime nën dritën e fenerit apo gazit kishte me bollëk, sa të duash! Ishte shndërruar në një ëndërrimtar syçelur, të përgjumur dhe të pashpresë, por këto halle nuk i fliste zëshëm dhe askujt nuk ia tregonte. Përgjatë vitit ende ishte i përhumbur në kujtimet e ‘aventurës sllovene’! Në Kosovë nuk i pëlqente asnjë Degë studimi, kishte mjaft për të zgjedhur por për çudi nuk tërhiqej nga asnjëra shkencë. Mendonte që shkollimi jashtë Kosovës ishte i vlerës më të lartë. Kjo ishte e vërtetë, universitetet e tyre ishin themeluar para njëqindpesëdhjetë vitesh por edhe para treqind vitesh. Atje ekzistonte një kulturë studimi paksa më ndryshe, një civilizim më i lartë vlerësimi, arritje e një specializimi më të përkryer e kështu me radhë. Për dalje jashtë Kosovës gjendej ndonjë Degë me gjasë aty ku ka matematikë por *për studim të Matematikës si disiplinë shkencore në këtë kohë nuk i qe mbushur mendja asnjëherë! Ajo për kohën ishte një dashuri e fjetur dhe për djaloshin nuk kishte gojë të flasë!*

Por kudo që të shkosh duhet ditur mirë gjuhën sllave, serbokroate, nuk mjafton ta kuptosh por të jesh folës i shpejtë, i lirshëm, i rrjedhshëm e i pagabuar! Po këtu Safiri e kishte mangësinë, ndodhej në pamundësi për t’i shfrytëzuar prirjet e tija intelektuale, shprehinë punuese, e kuptonte gjuhën jo-amtare por e fliste ngadalë, vrazhdë dhe përplot me gabime gramatikore. Me gjasë fajin e kishte matematika!

Gjatë shkollimit fillor e të mesëm, mësuesit e gjuhës serbe në qytetin e nëntëdhjetë e nëntë për qindindshit shqiptarë ‘thuaja ishin të porositur’ për paaftësinë e fëmijëve shqiptarë për ta mësuar gjuhën sllave! Përndryshe kur ishte i aftë ta mësojë Gjuhën Frënge për katër vite shkollim si është e mundur mos ta mësojë mirë të folmen e gjuhës sllave në kohën kur as fëmijët dhe as të rriturit nuk kanë qenë të ngarkuar me ndasi kombëtare?!

Në Qendër të qytetit ishte Mëhalla e Re e strukturuar me popullsi të përzier. Në përgjithësi, banorët e kësaj lagjeje e zotëronin të folmen e gjuhës serbokroate rrjedhshëm dhe pa gabime, sepse ia kishin mësuar gjuhën e njëri-tjetrit që në fëmijëri. Shumë kuadro të këtij rrethi të shkolluar jashtë Kosovës tregonin rezultate shumë të mira si të ishin shkolluar në gjuhën amtare! Tek Safiri por edhe tek shumë të tjerë si ai e kuptonin gjuhën sllave por ishin belbër në të folmen e saj. Ishte një hendek i tij madhor ku në fushën trunore të gjuhëve, padiktueshëm kishte zënë fill zgjerimi i fushës lidhur me Matematikën por për këtë ndërrim rolesh i ‘zoti’ i tij akoma nuk dinte gjë!

Në fshat kishte kohë për të menduar çfarë të duash por hallakatja në planifikimin e ardhmërisë ishte sfiduese dhe e pashpresë, aspak optimiste. Ndodhej në një gjendje hipnoze, kishte humbur vullnetin dhe dëshirën për studime, i shtangur pa ndonjë iniciativë alternative dhe gjykonte me papjekuri prej fëmije. Ishte shumë e vështirë të dalë ai nga hipnoza! Më shumë i thoshte mendja, përshëndetjet nga shkolla dhe shkollimi duke e ndarë mendjen si të pa zot dhe të paaftë për studime universitare kur pas shërbimit ushtarak tetëmbëdhjetë mujor ia vlen të emigrojë në Perëndimin e përparuar për të punuar dhe jetuar si punëtor krahu; në bujqësi apo blegtori!

Përgjatë vitit shkollor kishte pranuar për kontroll Inspektorët arsimorë komunal të cilët vlerësuan lartë punën e mësuesit dhe nga Drejtoria e shkollës pasoi oferta për të qëndruar edhe një vit aty të cilën ai e refuzoi.

VI. "DËSHIRA" PËR TË JETUAR MES TYMIT E HIRIT VDEKJEPRURËS!

Dhe në vazhdim si të ishte në ëndërr e kishte futur në kokë idenë fikse, atë të vitit të kaluar, u kuptua për ta studiuar Teknologjinë! Kishte dëgjuar por edhe e kishte njohur mirë inxhinierin teknolog, banor në Mëhallën e Re të qytetit i cili gjuhën sllave e zotëronte sikur atë amtare! Ishte magjeps me emërtimin Ing.Teknolog. Fillimisht nuk ishte përcaktuar për llojin e Teknologjisë: Ushqimore apo atë Inorganike. E rëndësishme ishte si Degë e rrallë studimi dhe përgjatë njëzetë viteve pas Luftës së Dytë Botërore, në qytetin e shkollarëve ishte vetëm një teknolog dhe i dyti nuk dukej në horizont! Ishte tamam si një 'Dashuri në shikim të parë'! Dihej që shkollimi universitar do jetë në gjuhën sllave dhe bursa me gjasë do jetë e siguruar (kuadër deficitar) por edhe përvoja e Lubjanës ishte ende e freskët!

Përgjatë verës së vitit ('66) vitit të 'Plenumit të Brionëve', Safiri zhvillojë korrespondencë me (tre-katër) Dekanate të Fakulteteve Teknologjike, në disa ish Republika ku ofroheshin kushtet e pranimit (regjistrimit); disa prej të cilave kishin edhe Provim Pranues. E veçanta e përcaktimit eventual që do pasojë ishte si ndodhi që ai mos të komunikojë me asnjë nga shokët e gjimnazit? Me gjasë të gjithë ata të mbeturit të cilët e humbën vitin kot së koti ishin përcaktuar për Fakultete apo Shkolla të Larta në Kosovë në Gjuhën Shqipe, ndërsa ky 'burri i burrave' donte të studionte në gjuhën sllave për të cilën ende nuk bindej që nuk do ta mësojë kurrë si duhet! I zgjuar prej natyre por jo dhe me mendje të hollë.

Në fund qershori të atij 'viti të mbrapshtë' u përcaktua për Fakultetin Teknologjik në Tuz Ila të Bosnjës tek i cili pas javësh dorëzoi dokumentacionin ku përgjatë shtatorit do duhej nënshtruar Provimit Pranues në lëndët: Kimi ;Fizikë dhe Matematikë. Në ndërkohë Kombinati Xehetarë-Metallurgjik 'Kosova' në Obiliq kishte shpallur Konkurs për dhënie burse për Fakultet Teknologjik. Pas dy udhëtimeve për në Tuz Ila dhe dy të tjera për Obiliq u realizua dëshira për ta regjistrua Fakultetin në fjalë (Pa Provim Pranues, numër më i vogël kandidatësh të paraqitur). Një pjesë e pagave të mësuesisë ishin në Librezën e Kursimeve dhe tani bursa e fituar ishin të mjaftuara për jetën studentore.

Asnjëherë nuk i shkoi mendja që për sa i përket komunikimit në gjuhën serbokroate do mbetej belbër! E pabesueshme e kuptonte të thuash çdo fjalë por të komunikonte pa gabime ishte e pamundur. Që në nismë e kishte mendjen e fjetur! Tani problemi i gjuhës në Tuz Ila ishte paksa më i thellë! Një pjesë mësimdhënësish ligjëronin serbisht; disa të tjerë kroatisht (Për këtë edhe gjuha e studimit ishte në serbokroate!). Kjo do thoshte që do duhej ditur mirë të dy gjuhët sllave! Aty ndodheshin edhe shumë studentë arabë; sirianë, jordanezë, palestinezë (në qershor ('67) nisi Lufta arabe-izraelite) por tek ata nuk kishte ankesa! Para se të vinin këtu kishin vijuar kursin gjashtëmuor për mësimin e gjuhës sllave, ndërsa Safiri kishte mësuar në shkollë tetë vite këtë gjuhë dhe nuk ishte i aftë të komunikonte lirshëm! Fajin e kishin mësuesit e kësaj gjuhe të cilët ishin nacionalistë të thekur, nuk donin t'i aftësonin 'pakicat kombëtare' të flisnin me gramatikë gjuhën zyrtare (shtetërore)! Dyshi (2) si nota e parë kaluese (nuk di aq mirë por po bën përpjekje për të ditur) ishte pjellë e hegjemonizmit shtetëror të kohës (1963) për ta rrënuar Arsimin Kombëtar Kosovar dhe 'pakica kombëtare' të mbetet gjysmë analfabete!

Në janarin ('67), provimin e parë semestral *Mineralogji* e kaloi me shumë sukses e mori shtatë(7) dhe kjo i dha shpresë të madhe që kalueshmëria e provimeve të tjera do ecën mbarë! Lëndët studimore kryesore të vitit të parë: Kimi; Fizikë dhe Matematikë i ndoqi me rregull por të jesh belbër në gjuhën jo

amtare ishte pengesë e pa përballueshme, 'këngën e dinte, por zëri nuk po i shkonte'! Në vitin e parë të studimeve në Teknologji nuk ndodhej asnjë student shqiptar për dallim nga Metalurgjia që vitin e parë e parë të studimeve i ndiqnin dy bashkëvendas me të cilët takoheshin rrallë!

Provimet nga Kimia dhe Fizika (të dyja me shkrim e me gojë) në gjuhën serbokroate nuk mundi t'i përballojë, ndërsa përgjatë qëndrimit njëvjeçar në Tuz Ila, nuk ishte bërë as përpjekja më e vogël për ta përgatitur provimin nga Matematika dhe as që iu nënshtrua këtij provimi! Me atë farë 'lloj gjuhe që fliste' (që disa dhe qeshnin me të drejtë!) arriti kalueshmëri edhe në Sociologji: shtatë(7); Gjuhë ruse: gjashtë(6) dhe Paraushtarak: për herë të dytë, gjashtë(6)! I kujtohet provimi Sociologji kur Profesori e lavdëroi kandidatin njëherazi me qortim drejtuar një grupi vajzash: 'Shikoni çfarë pengesa ka në të shprehur, megjithatë përmbajtjen e saj e di shumë mirë, ndërsa ju në gjuhën amnore...'

Edhe pse përgjatë muajve korrik-gusht kishte qëndruar në Tuz-Ila për përgatitje provimesh, ai nuk ia doli të arrijë kalueshmëri në Kimi dhe Fizikë dhe vendosi të kthehet në familje, e të përshëndetet me studime universitare! Referentja e studentëve, një grua fisnike e bukur dhe e mençur, e kishte lënë të pres për pesë orë rresht për t'u ç' regjistruar nga Fakulteti me lutje dhembshurie: I ke katër provime të dhëna, thirri mendjes! Ndal! Mos ik! Por ai kishte vendosur! Fytyra e tij ishte bërë dyllë i verdhë si i ndonjë të vdekuri, ndjeu të therura në zemër! Meqenëse gjuha me të cilën komunikonte ai nuk kishte përmirësime, shpirti i tij fliste që studimet e tij nuk kishin të ardhme! Për momentin nuk kishte më as paqe as prehje! E keqja më e vogël ishte ç' regjistrimi nga Fakulteti Teknologjik dhe ai u realizua po atë ditë! Me lot ndër sy, i pikëlluar e ndiente vetën më fatkeq se kurrë ndonjëherë dhe iku i gjallë apo thënë besnikërisht si një 'kufomë e gjallë' në relacionin Tuz-Ila – Bijelina - Brčko- Beograd-Pejë. Dhe sot loton!

Atëbotë të dy prindërit ishin gjallë dhe jetonin me pleqërinë e tyre, të cilët u përqaftuan me djalin duke shprehur ankthin e zemrës së tyre me fjalët: " O i hidhëruar mos u hidhëro shumë; Në mes të mossuksesit dhe humbjes kur askush nuk e pret dhe mendon, papritur dhe pa kujtuar mund të lind suksesi dhe fitorja; librat nuk i ke heq nga dora; pasi je kthyer shëndosh e mirë të gjitha i ke me vete. Për ne do ishte më keq sikur atje të mbetesh nja dhjetë apo më shumë vite në studime dhe me vete të sjellësh grua e fëmijë"! Djali e ndiente në ndërgjegjen e vet që për këtë trazim shpirtëror u mbetej borxhli pleqërisë së prindërve të cilët derdhën edhe pika loti. Me atë rast përfunduan bisedën me shpresën që mirë do bëhet dhe asnjëherë tjetër nuk diskutuan lidhur me studimet në Bosnjë! Djali muaj më parë e kishte filluar edhe duhan-pirjen!

Në vjeshtën e atij viti para se të planifikonte të shkonte ushtarë 18 muaj (personat me shkollë të mesme të kryer) brengosej për pagesat eventuale në këste mujore që do vinin më pas për bursën e shfrytëzuar. Fatbardhësisht kjo nuk ndodhi duke u falënderuar bujarisë së Kombinatit 'Kosova' në Obiliq, të cilit i mbetet borxhlinj për dhënien njëvjeçare të një burse të kohës, e shfrytëzuar me parapagimin një vjeçar edhe të gazetës 'Rilindja' e cila ia freskonte jetën dhe shpirtin! Me gjasë kalueshmëria në katër provime kishte bërë të anashkalohej rasti pa llogaridhënie!

Pas kësaj që ndodhi atë e priste jeta me turp e përcjell me thashethëne edhe nga të afërmit dhe të njohurit! Ato u vërtetuan pas shtatë viteve kur fëmijët e tyre i morën rrugët e studimeve në Sarajevë

dhe Zagreb dhe duke u kthyer nga atje pas një përkatësisht dy viteve! Fjalët e tyre gojë më gojë ishin përcjell: ‘Kemi folur dikur për të tjerët ndërsa sot na ndodhi në sofrën tonë’!

Safiri nuk dinte t’i përgjigjej pyetjeve të cilat vërdallë ende silleshin në kokën e tij:

- *Përse profesioni i teknologut ishte fiksuar në kokën e tij?*
- *Përse vendosi të shkojë në studime në vendin ku flitej edhe serbisht edhe kroatisht?*
- *Përse shkoi si një shqipfolës i vetmuar kur studimet në tandem janë dobiprurëse?*
- *Përse nuk ishte përcaktuar për studime në Kosovë në gjuhën amtare?*
- *Përse studimi aktual i matematikës ishte jashtë çdo kombinimi?*

Katër pyetjet e para ishin pa përgjigje! Pyetjes së fundit vetëm pjesërisht dinte t’i përgjigjej! Ai atëbotë kështu mendonte :

* Dhuntia për ta studiuar Matematikën është e trashëguar e cila më mungon, prindërit e mi nuk shfaqnin as aftësi elementare tregtie!

* Matematikën rrallë kush e di dhe rrallëherë mund ta mësojë por akoma më rrallë mund ta studiojë!

* Studimi i Matematikës është i përshtatshëm vetëm për personat shumë inteligjent; me IQ afër 130!

* Çdo provim matematike përbëhet nga Provimi me shkrim (eliminues) dhe Provimi me gojë; domethënë të diplomosh në Matematikë është një lloj si të diplomosh në dy apo tri fakultete të tjera!

* Si të merrej qëndrim për studim Matematike kur studentët e Degëve tjera ankohen vetëm për një provim të Matematikës; ‘Po qe se përgjatë vitit të parë të studimeve do kaloja Matematikën me sukses, atëherë diplomimi në Fakultetin e regjistruar përmbanë gjasa reale’!

* Puna e mësuesit të matematikës krahasuar me sakrificat e studimit të saj, nuk sjellë të mira materiale të veçanta! Me atë mund të fitohet vetëm prestigji i personit (nderim i fituar me punë intelektuale e vepra studimore) por është e sigurtë mungesa e mirëqenies materiale e ngjashme sikurse e mjekut! Personat me prirje të rralla për nxënie matematike me vetëdije orientohen në studimin e shkencave teknike – kompjuterike ose atyre ekonomike-financiare, aty ku qarkullon paraja duke i ikur studimit të shkencës së matematikës!

Gjimnazi Kosovar për Fakultetin Teknologjik nuk doli të jetë shkolla e duhur. Studentët të cilët e kishin kryer Shkollën e Mesme Teknike - Teknologjike lidhur me ushtrimet laboratorike-eksperimentale nga Kimia dhe Fizika ishin bërë ‘mësuesit’ e gjimnazistëve! Çfarë mund të përfitonte ‘Safiri i vetmuar’ po të qëndronte edhe mëtutje në Tuzlla? Ai aty do duhej të planifikonte sëpaku edhe tetë vite të tjera studimi sepse ‘dita e mirë vërehej në mëngjes’. Përveç të folmes ‘belbër’ atij i mungonin aftësitë teknike-punuese; laboratorike-eksperimentale! Megjithatë dhe poqese një ditë do fitonte një diplomë teknologu me atë do t’i “shkurtohej jeta mes timit dhe hirit vdekjeprurës”!

VII. “FUNDI I TUNELIT” – “NDJENJA MIQËSIE” ME MATEMATIKËN E FRIKSHME!

Me hapjen e SHLP - së në vendlindje (1967) (Shkollë e parë e Lartë në ish-Jugosllavi ku studimet zhvilloheshin vetëm në Gjuhën shqipe), kryefamiljari i propozoi dhe mezi e bindi Safirin për ta regjistruar njëriën prej Degëve (Gjuhë e letërsi shqipe; Histori-Gjeografi ose Matematikë)! Do të gabosh shumë i tha po qe se vendos të shkosh ushtar 18 muaj! Zgjedhe cilën Degë studimi e dëshiron dhe regjistroje! Mendo disa ditë dhe vetëvendosi për ta regjistruar Matematikën si kandidati i fundit në regjistër me numrin rendor 65 duke pranuar një pyetje shtesë nga ana e referentit: ‘Shok ku ishit deri tani, regjistrimet kanë përfunduar para disa muajsh’!? *Hapja e Shkollës së Lartë në vendlindje dhe këmbëngulësia vëllait altruist për ta penguar të shkuarit ushtarë duke ia ‘zbukuruar’ njëriën nga Degët e sapo hapura; të dyja bashkë ishin fati i tretë i madh njerëzor*, i cili ka mundur mos të ndodhë dhe jetë i fikur një matematikan!

Për njerëzit e pa sistemuar në jetën profesionale por dhe studimore, *Dega e Matematikës* gjithnjë ka qenë joshëse dhe atraktive për ta studiuar, meqenëse zakonisht të ka siguruar gjithnjë punësim, ndërrim vendesh pune por edhe të mira materiale krahasuar me Degët tjera arsimore! Ishte gjenerata e parë e Shkollës Lartë Pedagogjike-Dega e Matematikës dhe për regjistrim nuk ishte refuzuar askush; kandidatë të ardhur nga të gjitha trojet shqiptare-folëse në ish-Jugosllavi me të gjitha shkollat e mesme të kryera: Gjimnazi-Drejtimi Gjuhësor-Shoqëror dhe Shkencor-Natyror; Shkolla e mesme: Teknike (Elektroteknikë; Makineri; e Tekstilit); Ekonomike; e Mjekësisë; e Mësuesisë..Të rinj por dhe ata paksa më të vjetër donin ta provonin mençurinë njerëzore! Realisht aty e kishin vendin gjimnazistët-Drejtimi i Shkencave të Natyrës e ndonjë nxënës i dalluar i shkollave të mesme Teknike; të tjerët ishin për të zënë vend, për t’u bërë më shumë dhe disa sish në veçanti bota femërore ishte prezent paksa me tepri për të krijuar lidhje eventuale dashurie dhe për t’u martuar!

Gjatë semestrit të parë dimëror një numër i konsiderueshëm studentësh firuan, me ndërrim grupesh; me kalim në grupin Histori- Gjeografi dhe në grupin Gjuhë dhe Letërsi Shqipe ndërsa shumë të tjerë të moshuar dhe me shkollë të mesme ekonomike e ngjashëm u larguan, kështu nga gjashtëdhjetë e pesë kandidatët e fillimit mbetën pesëmbëdhjetë deri njëzetë sish ndërsa në tabelë për të ushtruar dilnin tre-katër veta, jo më shumë!

Mësimdhënësit e disiplinave matematike (Analizë matematike I, Algjebër dhe Gjeometri elementare) vinin nga qytetet fqinjë,të një largësie prej tridhjetë e gjashtë kilometrash. Gjeometria ishte bërë e frikshme krahasuar me të tjerat më e ndërlikuar për disa arsye të ndryshme: Para se gjithash për mungesë literature; e shtjelluar më cektë përgjatë shkollimit fillor dhe të mesëm; për shkaqe abstraktimi që ngërthen pëmbajtja e studimit të saj por edhe për shkaqe subjektive të mësimdhënësit.’*Gjeometria është disiplinë shkencore paksa më abstrakte krahasuar me disiplinat tjera matematike por nuk është e drejtë ta urrejmë atë përse është abstrakte,më e arsyeshme është ta urrejmë mësuesin i cili nuk e shoqëron nxënësin nëpër rrugë abstrakte.*’(A. Revuz) Mësimdhënësi i Gjeometrisë Elementare (Euklidit), mësues gjithëpërfshirës i Safirit, njohës i shkëlqyeshëm i gjeometrisë kishte kërkesa diturie paksa të stërholluara por në anën tjetër nuk kishte bërë as përpjekjen më të vogël për të siguruar literaturën aq shumë të nevojshme për të shkruar dhe botuar sëpaku një dispensë gjeometrie, as përgjatë tërë karrierës së tij dyzetëvjeçare (1967-2005)!

Para se të përfundojë semestri i parë, *'fatmiri'* i cili orvatej të futet në 'djepin e matematikës' nga vëllai i rrallë altruist bëri porosi për të blerë kompletin e librave të autorëve sllavë; *Apsen, Kurepa, Demidoviq, Ushçumljiq-Miljiqiq* dhe *Lopandiq*, të cilat sollën një frymë të re studimi; më sistematik, më të ngjeshur, më të thellë dhe më frymëzues. Ai nuk vështronte të tjerët si dhe çfarë bënin. Kur nuk kishin ligjërata, puna ditore e tij ishte më shumë se dymbëdhjetë orë. Harrohej në zgjidhjen e detyrave të njëpasnjëshme pa e kapërcyer asnjë! Duke u larguar sqarimeve të tjerëve, ai tashmë ishte futur në matematikë, duke u mishëruar përditë e më shumë me natyrën e studimit të saj e cila kërkonte punë të palodhshme dhe kohë të pallogaritshme. Krahasohej me Rubinin i cili ishte katër vite më i rinj. Në Degën e Matematikës tashmë ishte sajuar grupi prej pesë vetash (Safir, Rubin, Bronzit, Topaz dhe Dolomit) të cilët garonin padiktueshëm në nxënie deri në diplomim pas njëzetë e katër muajsh.

Për momentin nuk i interesonte as shoqëria, as sporti por as politika! Ishte fatlum që për kohën, nuk ishte lëshuar në ndonjë aventurë dashurie sepse ofertat ishin të mëdha! Studimi i matematikës është i veçantë dhe nuk duron angazhime jetësore shtesë; familja; shoqëria; pasioni; pushimi; dëfrimi; zbavitja; argëtimi; rekreacioni u përkasin intervaleve të shkurtra kohore! Përcaktimi i Safirit për të bashkëjetuar me Matematikën mund të krahasohej me martesat e vonshme, por cilësore. Fillimisht ndaj saj kishte urrejtje të madhe të cilën me kohë e shndërroi në dashuri nga dita në ditë duke e rritur!

Që nga ditët e para të sistemimit në një ambient të pa imagjinuar dhe të pa ëndërruar disa muaj më parë, filloi të tregojë zell për Analizën matematike dhe Algjebërën duke u dallua nga të tjerët. Doajeni i Degës, gjithnjë e vlerësoi Safirin më shumë se të tjerët. Përgjatë ushtrimeve dhe ligjëratave dëgjohej t'i ketë thënë: *"Me një lule, nuk vjen pranvera"*! Atëbotë Rubini, më vonë shoku më i mirë i tij fliste nën zë: 'Po na del më i miri ndër ne por 'veterani' e ka mësuar Matematikën në Fakultet një vit para nesh'!. Ai tashmë kishte blerë disa libra të Algjebërës, të Analizës matematike dhe të Gjeometrisë analitike në gjuhën serbokroate por *nuk i mungonin as Dispensat e Profesorit të Algjebërës*, blerje të realizuara në heshtje për t'i ikur konkurrencës në dituri *për të cilat Rubini katër vite më i ri nuk dinte asgjë!* Blerja e librave por dhe e Dispensave të profesorit për të cilat kishte udhëtuar enkas 72 kilometra, jepnin shenja të mjaftuara që ai dëshironte njëmend të kurorëzohej me shkencën e matematikës e cila nuk mësohej por as nuk harrohej për një ditë!

Paksa e çuditshme, përgjatë viteve akademike (1967-1969) në cilësinë e studentit shumë të mirë në Degën e Matematikës pa mësuar e studiuar asnjë minutë Matematikë në Tuz-lla, diplomoi i pari dhe me notë mesatare paksa më të lartë se shokët duke marrë titullin profesional: *Arsimtar i matematikës*, kualifikim me të cilin mund të punësohej në shkollë fillore por edhe shkollë të mesme.

Shokët matematikanë u punësuan në shkolla të mesme ndërsa vetëm ai u punësua në shkollën fillore në njërën ndër më të mirat e vendit e cila në vitet e 70-ta kaloi e para në javën pesëditore të punës. Ajo ishte dhe mbeti për shumë dekada, krenaria e 'Qytetit të katër lumenjëve' dhe e Kosovës. Në muret e Drejtorisë së Shkollës nuk kishte hapsirë vendosjeje për Shpërblime; Dekorata; Mirënjohje; apo Vlerësime në rang Kombëtarë por dhe Ndërkombëtarë lidhur me punën e admirueshme edukative dhe arsimore të mësuesve lidhur me sukseset e nxënësve! Aty për dallim nga mjediset tjera shkollore përzgjedhej kuadri mësimor si më i miri i qytetit! Po që se ishte një mësues i mirë; zëvendësohej me një tjetër po aq të mirë bile edhe më të mirë! Po aty studentët e SHLP-së mbanin orët praktike. E veçanta e

kësaj shkolle ishte *ekzistenca e 'Pushtetit të notës'!* 'Për fat të keq' kishte nxënës që edhe përsëritnin vitin, me tri e më shumë nota të dobëta, por një përqindje e madhe e tyre ishin të shkëlqyeshëm dhe po këta me shumë gjasë diplomonin në njërin e Fakulteteve të Universitetit të vendit! Pushteti i notës, i pa stolisur me intervenime për ta ndryshuar atë, nuk varet nga personat e vetmuar të këtij akti pro perëndimor por nga 'politika udhëheqëse e stafit të shkollës' dhe më lartë!

Punësimi në shkollën eksperimentale të vendit ishte i admirueshëm për kohën! Djaloshi i ditur, i formuar por edhe i pashëm ndodhej në prag të fejesës! Së paku dy goça të lagjes së shkollës ia kishin 'vu syrin' duke bërë garë mes tyre; cila do jetë më e zonja për ta përvetësuar për të mos thënë edhe shumë prindër nxënësish 'jepnin sinjale' për vajzat e tyre më të mëdha! Qartazi vërehej, familjarë të rrethit gjërë shoqëror njohës ofronin oferta të cilat lexoheshin për ta përvetësuar si dhëndër shpie! Po të vepronte si dëshironin të tjerët mbetej enigmë suksesi përfundimtar i matematikanit, me gjasë do ishte tretur si vesa e mëngjesit!

Shumë i kënaqur me vendin e punës, me rregullin shtëpiak të shkollës që nuk e kishe parë si askurrë, me personelin arsimor e udhëheqës, me nxënësit dhe prindërit e tyre, të gjithë zonja e zotëri të mëdhenj qyteti, por dhe me pagën mujore njëqind dinarë, së cilës i shtohej '*shtesa*' për mësuesit e matematikës për një të gjashtën e pagës, ai për momentin nuk kishte asnjë aspiratë tjetër, as atë për t'u punësuar diku gjetkë mbase ndodheshin edhe shokët e tij në shkollat e mesme të qytetit ku mund të krijonte më shpejtë familje! Thënë troç, puna në këtë shkollë i ngjasonte një vendpunimi të përkryer sikur "*dashuria e parë që nuk harrohet, dëgjoje këtë fjalë që trondit...*"

Përcaktimi për ta regjistrua Degën e Matematikës pranë Shkollës së Lartë nuk ishte bërë nga qejfi, dashuria apo zotësia për atë, por ishte kërkesë e momentit dhe rrethanave të sapokrijuara jetësore; e ngutshme, e menjëhershme; e doemosdoshme; nga zori e nga halli ose- ose të mbetej pa shkollim të lartë thotë Safiri; dhe kjo në stilin 'merre' ose 'lëre'!

Por të studiosh në **FSHMN-Degën e Matematikës** 'duhej kënduar nga qejfi'. Ajo pas dy vitesh studimi ishte 'dashuri e fjetur'! Hamendësimi para se gjithash kërkon **përgatitje psikologjike** (teorike-praktike) me tërë përfundimin logjik '**do t'ia dalë**'! Kandidati do duhej të jetë i udhëhequr me **motiv** (përse do ta studiojë; për cilat shkaqe dhe arsye); **moral** (a jam i përgatitur të sakrifikojë jetën e rehatshme) dhe **durim** njerëzor (cili është modeli kur unë shfaq durim të ngjashëm?); çfarë mund të përfitojë por dhe çfarë eventualisht mund të humbasë! *Në fillim mund të përjetoj edhe mossukses nga i cili nuk bën të trembem! Si ta flak matematikëfobinë kur ajo është ende e fuqishme në vehtën time?!* Nuk bën të krahasohem me të tjerët! **Koeficienti i një inteligjence**, eventuale më të ultë, nëpërmjet **shprehisë punuese** duhet kompenzuar me **orar të punës shtesë**! Përfundimi psikologjik nxitës: '**Do t'ia dalë**' do duhej të jetë **moto e studimit të matematikës**!

Ka shembuj të panumërt ndeshjesh futballi mes ekipesh rangjesh të ndryshme kur fiton ekipi i rangut më të ultë; mbështetur në **përgatitjen psikologjike të lojtarëve** dhe **angazhimin maksimal** të tyre si rrallë ndonjëherë tjetër duke sjellur befasi për ta mbajtur në mend për një kohë të gjatë!

VIII. MOTIVI MATERIAL E FLAK MATEMATIKËFOBINË!

Megjithatë ndodhi 'e papritura', e cila me shumë gjasë ka mundur mos të ndodhë kurrë!!! Në një mëngjes të bukur dhjetori, rehatia shpirtërore e mësuesit të matematikës u trondit. Në shkollën ku punonte me një gazetë në dorë vjen Rubini shoku i studimeve i diplomuar në të njëjtën ditë në Degën e Matematikës pranë SHLP i cili punonte në një shkollë të mesme. Pas përshëndetjes, me frymëmarrje të rënduar pyeti:

-A e ke blerë sot Rilindjen?

-Jo, u përgjigja! Pse po pyet i thash?

Mori dhe shfletoi tek faqja e katërt e saj konkursin e rrallë por gjithsesi 'kumbues nga fjalët' që dëgjohej gjithandej, lëshuar nga Kuvendi Komunal ku shprehej:

Kuvendi i qytetit të bukur dhe arsimdashës shpallë Konkurs për profesorë matematike, me diplomë fakulteti, paga mujore e të cilit do jetë gjysmë milioni dinarë! [shumë e cila baras vlerësohej me katër paga mujore të mësuesit, punësuar në shkollën fillore] ***Ky ishte fati i katërt i madh njerëzor*** që e motivoi Safirin 'deri në palcë' për t'u bërë matematikanë i diplomuar!

-Çfarë mendoni lidhur me këtë shpallje? -Po pyet Rubini.

-Jam i befasuar ia ktheu Safiri dhe vazhdon, disi e pabesueshme! Mund të jetë një kurth për të mashtruar me qëllim dikë! (Pas diplomimit në FSHMN, vlerësimi i fundit doli i vërtetë, paga mujore ishte si e të tjerëve)! Po mendojmë dhe vlerësojmë paksa 'me mend në kokë dhe me këmbë në tokë'! Është një hap i një ndërmarrjeje serioze por edhe komprometim eventual i personalitetit tonë në rast dështimi të studimeve!

Çfarë mendon, a mund t'ia dalim po pyet Rubini.

Sikur të kishim qenë të zotët e kësaj pune, atëherë përse e regjistruam Shkollën e Lartë në vend të FSHMN- Degën e Matematikës? A ka mundësi të turpërohem dhe më pas të futemi në gojën e botës, të na nxihet faqja dhe në fund të ikim nga vendlindja të turpëruar përfundoi Safiri!?

Duke mbetur pa gjumë atë natë, të nesërmen në mëngjes Safiri e telefonoi Rubinin duke i thënë:

- Vendosa për t'i vazhduar studimet edhe pse jam më i moçëm se ti për katër vite!

-Unë i këtij mendimi isha që me ardhjen t'ime tek ti – u gjegj Rubini.

-Të falënderojë shumë për lajmërimin ia ktheu Safiri. Me fat të mirë dhe me mbarësi jetese për ditët që do vijnë në udhëtimin e gjatë dhe të vështirë për dituri të thella matematike, të cilat mbetën çështje të pakuptueshme e misterioze edhe për shumë gjenerata para nesh, të mbuluara me velin e shumë të panjohurave objektive dhe subjektive, me lloj-lloj 'thera' 'driza' e 'murriza'! Mirë u pafshim!

Në mëngjesin e së hënës shokët morën autobusin e orës pesë e tridhjetë për në 'Qytetin pa lum', për të mbërri atje në ora tetë ku autobusi ndaloi përballë FSHMN, dyqind metra më larg.

Shqetësimet e para të mëdha i solli Referenti i studentëve, një mes burrë i njohur për ata.

Duke i sqaruar pritjet e tyre tha:

Me fat për këtë ndërmarrje shumë të guximshme! Shikoni, për ta regjistruar vitin e tretë të studimeve-Dega e Matematikës, fillimisht duhet me iu nënshtruar *shtatë deri tetë provimeve plotësuese: (Gjeometri analitike; Gjeometri elementare; Algjebër; Fizikë; Gjeometri përshkruese; Analizë matematike II dhe Gjuhë e huaj)*. Nga SHLP u pranohet vetëm Analizë matematike I.

Pas sqarimeve të dhëna paksa iu ndrydhen zemrat por megjithatë nuk u bënë pishman aspak! Njëzëri vendosën për t' i dorëzuar dokumentet për regjistrim në FSHMN-Dega e Matematikës!

Pas regjistrimit në fakultet në vjeshtën e vitit 1970, Safiri shkoi ushtar në Banja Lluca të Bosnjës, për t'u kthyer gjallë pas njëmbëdhjetë muajve! Tani në shkollë për mësimdhënie të matematikës e pritnin nxënësit e katër klasave të teta për të cilët mbanë kujtimet më të mira si nxënës të ditur dhe të rreskur me një edukatë të lartë qytetarie! Ishte kënaqësi dhe privilegj të punosh me këta nxënës, ku në çdo paralele kishte më shumë të shkëlqyeshëm se të tjerë! Edhe sot i kujtohen emrat e ish-nxënësve: Fatosi, Qemali, Vjollca, Di ana, Valbona, Violete, Gazmendi, Rudolfi, Luljeta, Atifete, Afrimi, Alberti, Kadrushi, Ngadhënjimi, Selajdini, Arsimi, Fëllanza, Shqipja, Arbëresha, Valoni, Luani, Rajmonda dhe shumë dhjetëshe të tjera nxënësish, të cilët u bënë emra të njohur publik. Fatosin e kujton si yll, ish -nxënësin shumë të ditur, më i miri në matematikë përgjatë karrierës së tij para universitare; së bashku me Qemalin në atë kohë në garat e matematikanëve të rinj kishin zënë dy vendet e para në nivel vendi!

Me nxënësit e katër paraleleve të teta me 20 maj para më shumë se pesëdhjetë vitesh, ishte organizuar "Nata festive" e përfundimit të Shkollës fillore nën kujdesin dhe mbikëqyrjen e arsimtarëve kujdestarë. Me urimet për sukseset në shkollimin e mëtejshëm kishte përfunduar ahengu me këta nxënës të rrallë mbase më shumë se 80% e të cilëve patën arritur arsim superior! Tashmë kanë filluar të pensionohen por e veçanta e këtyre ish-nxënësve mbetet më shumë se dhjetë veta bënë emër në nivel vendi, veçmas në lëmin e mjekësisë! Në gjimnaz nuk patën kush t'i mësojë në matematikë!

Vitin shkollor 1971/72, e mbanë në mend si ndër vitet e vështira në jetën e tij djaloshare por vit shumë produktiv! Krahas detyrimeve të punës në shkollë, karantinës në vendlindje, për shkak të Variola Vera-s; në Nëntor ('71); Janar ('72); Prill ('72); Qershor ('72); Shtator ('72); Tetor ('72) dhe Nëntor ('72), për çdo afat të provimeve me shumë sukses i kaloi Provimet plotësuese për ta regjistruar vitin e III-të të studimeve në gjendje të pastër. Kjo ishte një parashenjë premtuese, motivuese dhe domethënëse!

Safiri ishte i moshës 27 vjeçare kohë kur duhej të krijonte familje, tani ai po vendosej për banim në një dhomë me një derë në rrugë të një shpije private, larg konviktit të studentëve meqë e dinte që atje nuk punohej shumë! Problem i radhës ishte fitimi i bursës! 'Si t' i besohej dhënie burse personit të moshës 27 vjeçare i cili në vend që të krijonte familje, kishte vendosur ta studiojë Matematikën në pleqëri'!

Objektivisht shumë pak e besueshme në suksesin përfundimtar të tij! Rast i ngjashëm nuk kishte ndodhur kurrë, në asnjë Degë tjetër studimi! Si mund të ndodhë kjo në matematikën e frikshme!?

Sikur në udhëkryqet e tjera të jetës së tij edhe kësaj radhe doli 'shpëtimtari'! Ishte drejtori i shkollës ku punoi, një personalitet i shquar me autoritet dhe me shumë ndikim në komunë! Bursa për Safirin lidhet me emrin e tij. Ai intervenoi dhe e lajmëroi personalisht për fitim burse por edhe garantoj që 'plaku beqar' do jetë i suksesshëm në matematikë! Kishte të drejtë! Personi që shpalli konkursin për profesor të diplomuar të matematikës dhe personi tjetër që intervenojë dhe lajmërojë për fitim burse, ishin të dy shokë të ngushtë mes veti, i përkitin 'shoqërisë BB' të cilët 'sajuan rastin' motivues të dy arsimtarëve të posa diplomuar në SHLP për t'i vazhduar studimet në FSHMN. Atyre u përket merita!

Nga gjysma e shtatorit të vitit "Variola Vera" (Lija e Ujit), 'matematikani i ardhshëm me të cilin mund të krenohet vendi' u vendos në 'Qytetin pa lum' duke e braktisur edhe një gjysmë page mujore e cila i përkiste. Shkaku i përgatitjes më të sigurt të një Provimi plotësues në fund të muajit i cili numëronte më shumë se gjashtëmijë detyra e lëshoi punën më herët! Ky provim në mesin e të tjerëve për disa arsye ishte problematik por fatmirë dhe ai e kaloi për herë të parë! Safiri ishte ushtar në Banja Lluka kur Rubini katër vite më i rinj e kishte vazhduar vitin e tretë të studimeve, por ato deri në fund i kishte marrë me sevda! Ndiha reciproke midis tyre ishte e rrallë, veç tjerash Rubini banonte në Konvikt studentësh!

'Plaku' ligjëratat dhe ushtrimet i ndoqi pa mungesa dhe puna ditore e pakta e tij numëronte 12orë pa u marr me lexim gazetash apo përcjellje të emisioneve televizive të kohës! Disiplinat shkencore të vitit të tretë (III) të studimeve të cilat ishin vetëm tri por jashtëzakonisht abstrakte e përcaktonin fatin e studimeve të fatmirit! Në këto tri disiplina shkencore abstraksioni shfaqej *i lulëzuar*, në shkallën më të lartë të mundur! Shënimet e këtyre tre provimeve dy bashkëndasë të tij ('të lidhur ngushtë me matematikën') i morën për huazim njëjavorë për t'i vëzhguar; krahasuar dhe studiuar kapacitetet e tyre intelektuale me ato të 'plakut', në stilin: 'Ai ishte i suksesshëm, a mund t'ia dalim edhe ne'? Shënimet u kthyen, por edhe ata hoqën dorë nga 'iniciativa studiuuese abstrakte'!

Me ndihmën e abstraktimit me anë të të menduarit, **lirohemi nga tiparet konkrete** të objekteve, të dukurive dhe i **përfytyrojmë** ato në mënyrë abstrakte. *Vetë nocioni abstrakt përkufizon konceptin e një gjëje që nuk kapet dot me anë të shqisave dhe që rrjedh nga përgjithësimi mendor, diçka që është shkëputë nga realiteti, si tepër teorike, e papërcaktuar dhe e vështirë për ta kuptuar!*

Atëbotë kriteri në vlerësimin e studentëve në Degën e Matematikës ishte i ngjashëm apo identik, sikur në vendet e Perëndimit të përparuar! Në provimet e vitit të tretë, në mbështetje të një pune sistematike, të palodhshme dhe të pallogaritshme, Safiri u vlerësua me tri teta! Atëherë, ai e kuptoi që diplomimi në FSHMN ishte çështje kohe! Përgjatë përgatitjes së tyre (kur nënvizimi i tekstit të leksioneve bëhej nëpërmjet shumë ngjyrave, për të lënë gjurmë në kujtesë), mysafirët e rastit me pasiguri e shumë dyshim vështronin shëndetin mental të frekuentuesit! Ishte Shefi i Katedrës së Matematikës, profesori i Funkcioneve Komplekse i cili përgjatë vlerësimit në provimin e tij (të vitit të IV-të të studimeve), i pari ia kishte komunikuar që: "Do jesh mësimdhënës në ndonjërin e Shkollave të Larta në vend", edhe pse intimisht pak i besohej atij premtimi!

IX. NDËRRIM VENDESH PUNE, SI KOLLARE!

Në vitin e Kushtetutës së 74' për të cilën atëbotë, 'fatmiri' tashmë absolvent 'nuk dinte asgjë, nga politika' duke qenë i 'përgjumur' nga ankthi i super angazhimit intelektual lidhur me një super provim, tek profesori super cinik i cili për pesë vite vajtje- kthim nga një vend fqinj kishte dhënë vetëm dy nota kaluese; e 'kishte harruar' që duhet të punësohej, ku tjetër pos në gjimnazin e vendlindjes në të cilin para dhjetë viteve('64-'74) kishte mbetur për t'u riprovuar në matematikë!! Ishte gjysma e shtatorit dhe atëherë Safirit i doli 'gjumi' i rëndë dhe i thellë!

-Po ku ishe deri tani or burrë?! E kërkuam një të tillë me 'qiri dhe me pishë' dhe nuk e gjetëm! Kemi nevojë për mësues matematike por nuk guxojmë me të pranuar! Është mbyllur konkursi para një muaji! Shkoni në Kuvendin Komunal dhe ata do duhej ta lejojnë punësimin pas mbylljes zyrtare të Konkursit plotësues!

-Unë mendoja që thirrem nga Ju në shpi ia ktheu Safiri! Drejtori plak buzëqeshi!

Rasti i punësimit u zgjidhë pas disa ditëve! Për punësimin e tij në Gjimnaz kishte marrë vesh tërë qyteti! Kaherë i vlerësuar, prindërit e nxënësve të klasave të para ishin njohur me kohë që nga nëntë klasat e para të interesuarit për mësim matematike mund t'i risistemojnë fëmijët e tyre në paralelet me numrat një deri katër por edhe mund të ikin prej tyre!

Që në javën e parë të punës, Safiri hetoi intelektin e lartë dhe homogjen të nxënësve që i mori, për t'i arsimuar në matematikë! Për zellin dhe dijen që tregonin kishte planifikuar që 'ata, mos t'i lëshoj nga dora' dhe t'i përcjell vit pas viti deri në maturë, me gjasë që shumica prej më të mirëve, nesër, pasnesër të bëhen matematikanë dhe ta rrisin esnafin e tyre! Mësimi në klasat e para gjimnaz zhvillohej pasdite termin kohor jashtëzakonisht i përshtatshëm në mënyrë që paraditen e çdo dite të ushtrohej përkujdesje për Nënëloken Neone e cila nuk ishte aq e moçme por shëndetligë dhe jetonte me beqarin!

Në qershorin e atij viti shkollor çdo gjë u përmbys! *Dashamiri i madh i arsimit dhe i dijës provoi ta jetësoj Pushtetin e notës, hallkën më e rëndësishme të shkollimit para universitar* por nuk ia doli me sukses, sepse shkolla udhëhiqej nga 'mësues përrallash' historie dhe gjeografie! Udhëheqja e gjimnazit ishte paralajmëruar në qoftë se ndodhë *Falja e notave në mësimin e matematikës nxënësve me tre nota të pamjaftueshme në tri lëndë mësimore, ai do ik me siguri nga 'shkolla e mesme pa zanat', vlera e vetme e së cilës ka qenë dhe mbetet Pushteti i notës!* Ta mësosh matematikën pa Pushtetin e notës është njëlloj si me mbushë ujë me shoshë të shpuar shumë! Mësuesit e gjimnazit njëzëri nuk e aprovuan qëndrimin e guximshëm të riut risimtar që për mësimin e matematikës të bëhej përjashtim! Dhe vërtetë u largua shumë i zhgënjyer!

Ai tashmë veteran arsimit, sot mendon dhe vlerëson ndryshe nga qëndrimi për ikje që kishte marrë dikur! Kuptohet vetiu as atëherë as më vonë, 'Pushteti i notës' nuk është çështje personash apo lëndësh mësimore me kritere vlerësimesh ndër më të ndryshme. 'Nota kaluese' në asnjë rrethanë në emër të kësaj apo asaj situate nuk do duhej të jepej si 'biletë autobusi'! 'Pushteti i notës' do duhej përligjur, aprovuar dhe sanksionuar me rregullore nga Ministria e Arsimit me llogaridhënie të caktuara.

Ikja e tij e 'gabuar' nga Gjumnazi ishte e papëlqyeshme edhe për mësuesin. Para se gjithash në mbarë botën gjumnazet gjithnjë i mbledhin nxënësit e dalluar dhe për çdo mësues të mirëfilltë është privilegj e nderim të punosh në mjedise të tilla. Tani nxënësit mbetën pa mësuesin e 'dëshiruar'! Kjo u hetua pas tri viteve kur asnjëri nga tetëdhjetë të dalluarit nuk e mori rrugën e studimeve të shkencës matematike! Nga ajo ish-gjeneratë nxënësish të katër paraleleve dolën më shumë se njëzetë mjekë, specialistë, të cilët sot kanë bërë emër dhe jashtë vendit! Fatmirësisht ata janë të vet-kënaqur!

Nga vjeshta e themelimit të QAMO-ve përgjatë katër viteve të ardhshme, Safirin dinamik e gjejmë në Shkollën e Mesme Teknike: (Elektroteknikë, Makineri, Gjeodezi dhe Ekonomi), me nxënës të mirë por edhe shumë të mirë! Të shkëlqyeshëm nuk kishte ose vetëm një nxënës në paralele, sa për 'farë'! Në pranverën e hershme të vitit pasues ai diplomoi në FSHMN-Dega e Matematikës dhe mori titullin profesional të ëndërruar, *profesor i matematikës por me pagë 'normale' pa asnjë shtesë!* Sjellja e shtirur me 'Konkurs dredharak' ishte 'kurdisur' dhe qëllimorë për t'i joshur dy të rinj drejt diplomimit në FSHMN-Dega e Matematikës! 'Skenaristët' ka kohë që kanë ikur me këtë bamirësi të madhe e të rrallë!

Në Qendrën Teknike punoi dy ditë në javë (paradite dhe pasdite, nga nëntë orë në ditë!), duke fituar të ardhura mujore paksa më të mëdha! Kishte shumë kandidatë të cilët e kryenin Shkollën e mesme pa shikëputje nga puna (me korrespondencë). Ishte hapur Punkti i një shkolle të mesme në një qytezë jashtë vendlindjes ku shkonin një herë në javë për të dhënë mësim. Çdo amvisë dhe çdo shitës qyteti, që 'ecte në dy këmbë' dhe që ishte me 'frymëmarrje', e kishte regjistruar Shkollën e Mesme Ekonomike! Kjo ndodhi kur në vend ishin krijuar QAMO-t (Qendra e Arsimit të Mesëm të Orientuar), mbase përgatitja profesionale e nxënësve gati ishte shembur! Dy vitet e para shkollore ishte arsimitim i përgjithshëm ndërsa vitet e fundit i përkisnin arsimit profesional të Degës. (Absurdi i kohës: Daktilografia mësohej në klasën e III-të). Shkrimja e shkollave të mesme në një të vetme (QAMO), si 'konglomerat arsimor' së cilës nuk i dihej as koka, as trupi dhe as bishti ku nxënësit mësonin pak ishte diletantizmi më i theksuar në lëmin e Arsimit në vend i cili zgjati katër vite të plota! Ky rrënim parauniversitarë i Shkollës Shqipe kishte kaluar në heshtje pa llogaridhënie! **Kjo ndodhi e programuar pas një viti, nga Kushtetuta e 1974.** Krijimi i QAMO-ve nuk ka qenë ide shqiptare, por bartës e realizues të saj ishin 'shqiptarët injorantë' nga ish -Enti Pedagogjik Krahinor, të udhëhequr nga Pedagogët e shekullit 19-të të 'cilët nuk kanë shikuar më larg se hunda'! Para shkatërrimit të QAMO-ve, në vend që të dënohej dhe ndëshkohej produkti dhe njerëzit që sajuan produktin, bartësit e 'Udhëheqjeve të përbindshme' u bënë 'koka turku' duke e bërë me dije Safirin, që pas katër viteve duhej ikur prej andej një orë e më parë!

U largua nga QAMO e 'plagosur për shuarje' për të kërkuar vendin e pestë të punës, ku tjetër, pos në Entin Pedagogjik, institucion arsimor ndërkomunal, këshillëdhënës pa kompetenca ekzekutive dhe pa llogaridhënie, ngjashëm si Qendrat Didaktike të mëvonshme mbase personeli për punën që kryente nuk ishte 'perfekt' dhe asnjëherë i trajnuar! Në Entin Pedagogjik së bashku me shokë kishte bërë disa vizita shkollash ku ishte evidentuar një parregullsi e madhe në punën e mësuesve por pa ndonjë pasojë për ata! Puna e tyre ishte pa llogaridhënie! Aty kishte kohë të mjaftueshme të merrej me përzgjedhje dhe lexim librash por edhe me shkrime nismëtare nga Metodika e Matematikës! Vizitën e parë bashkë me shokë në Panairin Ndërkombëtar të Librit jashtë vendit e realizoi në tetorin e atij viti për ta vazhdua traditën edhe shtatë herë të tjera me shokët e vend-punimit të rinj të shtatë që do vjen!

Atëbotë fundi i vitit '79 ish-udhëheqësit komunalë edhe pse me 'shkollë pak' e kishin ndie ardhjen e *'Epokës së Informatikës'*. Kishte filluar prodhimi, blerja dhe përdorimi i kompjuterëve të parë. Flitej që nuk do të kalojë shumë kohë dhe Shtëpia e Mallrave; Vetëshërbimi dhe shërbimet e tjera administrative do pajisen me kompjuterë të cilët do t'ia lehtësojnë punën arkëtarit; mjekut; inxhinierit; arkitektit; teknikut; politikanit; agronomit; profesorit; matematikanit; gazetarit; piktorit; skulptorit... dhe çdo intelektual tjetër por dhe zejtarëve! Ata mendonin dhe vlerësonin që matematikanët me diplomë fakulteti dinë shumëçka lidhur me kompjuterët dhe programimin e tyre! Atëbotë, Informatika studiohej dhe mësohej vetëm në Fakultetin Teknik ndërsa FSHMN-Dega e Matematikës nuk ishte vend as për një konsultë apo një vëzhgim thjeshtë ishte një 'spektatore rasti', ajo nuk kishte ecur në hap me kohën!

Vërtetë tek ne, jo në kohën kur mbrohej teza që 'matematikani u duhej', por njëzetë vite më vonë (në fillim shekullin e rinj) ta zëmë, shit-blerja e mallit nëpër vetëshërbime dhe shtëpi mallrash ishte digjitalizuar! Programimi i digjitalizuar shtrihet në dy 'objekte' regjistrimi dhe llogaritjeje; para së parës vendoseshin 'vetëtimthi' gjësendet e ndodhura në shportë që do shit-blerën, një nga një dhe me automatizëm shënohen emërtimet e gjëseneve të përcjella me çmimet përkatëse dhe krejt në fund shkruhej pagesa totale (gjithsej) e mallit që po blihej në euro; kartëmonedha e dorëzuar dhe kusuri që do t'i kthehej blerësit dhe nga 'objekti i dytë' jepej kuponi fiskal së bashku me kusur!

Në lëvizjet e kuadrove që bënin atëherë për arsyen e lartcekur *strukturat komunale të kohës*, Safirin e kishin përzgjedhur për një Funkcion shumë të lartë të Pushtetit vendor; **Sekretar Sekretariati për Shërbime Shoqërore** (arsim; shëndetësi; kulturë; sport; rini, mbrojtje sociale), të përfaqësuara nëpërmjet **BVI** (Bashkësi Vetëqeverisëse të Interesit; Arsime, Shëndetësi, Kulturë), përkatësisht, **anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit Komunal**, ndryshe 'ministër komunal' për veprimtari shoqërore! Posti shoqëror ishte prestigj i lakmuar për gjithkënd; kabineti 'ministror'; 'krenaria e të qenit në pushtet' (si i rinj 35 vjeçar); mbledhjet e mëngjesit të Këshillit Ekzekutiv; një orë punë në zyre dhe dy orë punë në terren; shoferi personal; udhëtimet zyrtare; mëditjet; reprezentacionet; mysafirët; shoqëria elitare...Deri në prill të vitit ('80) tek 'matematikani epror' nuk ndjehej mungesë e 'Patent shoferit'! Ndodhën rastet e para kur për disa orë nuk mund të bashkoheshin 'shoferi i autorizuar dhe makina zyrtare'! Gjatë gjashtë mujorit në vazhdim vendosi t'i nënshtrohet Provimit për shofer të cilin e kaloi me sukses!

Në ndërkohë, 'matematikani i gjashtë vendeve të punës,' kishte filluar të mendoj shumë më ndryshe! Çdo pushtet çfarëdo që të jetë i ka 'ditët e numëruara'! Për çudi të njerëzve që e rrethonin, mandati i tij katërvjeçar së shpejti do shndërrohet në 'mandat të vocërr' sa 'grima', i cili do zgjasë vetëm njëmbëdhjetë muaj! (Para se të punësohej në Entin Pedagogjik, një vit më parë kishte konkurruar në Shkollën e Lartë Pedagogjike- Dega e Matematikës për lëndët mësimore: Analizë matematike II dhe Metodikë e Mësimit të Matematikës, të dyja provime me të cilat diplomonin studentët)!

Tani një quadro politike joshqiptare kishte mbetur pa vend të denjë pune për atë! Në anën tjetër eprori i Safirit kundërshtar i emërimit të tij në këtë post kishte përgatitur 'skënarin' me gjasë për ta sistemuar diku gjetkë, aty ku 'joshja intelektuale' do duhej të jetë më e madhe pikërisht në Arsimin e Lartë pranë SHLP - Dega e Matematikës në vendlindje në cilësinë e ligjëruesit aty ku 'prodhohej' dhe 'plasohej' dituria, aty ku kandidatët edhe me 'grada shkencore' refuzoheshin! Duke qenë konkurrues edhe një vit

më parë, me vetë-dëshirë nga **bota politike** e kohës 'rrëshqiti' në **botën akademike** duke 'regjistruar' kështu vendin e shtatë të punës!

Koha vlerësoi që hapi i ndërmarrë ishte në 'kohën e duhur' dhe për 'vendin e duhur'! Gjashtë muaj më pas, sikur të ishin 'të porositura' ndodhën Demonstratat e përgjakshme të (Mars-Prillit) të vitit 1981. Dhe po të qëndronte në atë 'post', shkarkimi i tij si ish-'ministër komunal' edhe për arsim me gjasë do ishte i pashmangshëm dhe i ndëshkuar keqas!

Ashtu si në kulturën e një populli edhe në jetën e njeriut pavarësisht se çfarë zhvillimi të mëtejshëm do të shfaqet, mbetet shumë e rëndësishme e çmuar dhe domethënëse *shkëputja* e parë me të cilën ai përpiket të ecën me këmbët e veta! Meqenëse në moshën tridhjetë e dy vjeçare, Safiri tashmë ishte bërë matematikanë, kuptohet i vonshëm, nuk vonoi shumë si zakonisht e ndoqi edhe **fati për t'u punësuar në Shkollën e Lartë Pedagogjike-Dega e Matematikës**, aty ku i kishte bërë hapat e parë për 'aritmetikë' siç e quanin komshinjatë e nënës Drita Neone, pra aty ku prodhohej dhe plasohesh dituria. Dhe moshë, edukimi, motivi, morali, vullneti, karakteri e rrethanat tjera shkonin në favorin e tij!

Vendi i rinj i punës ishte një fat i madh i pa imagjinuar dikur meqenëse në Degët tjera të Shkollës së Lartë Recensionet shkencore për zgjedhje kuadrosh të lëshuara nga mësimdhënësit eminentë të lëmit përkatës, 'lënin jashtë dyerve' të UP shumë 'shkencëtarë' goxha 'të leshur', meqenëse nga vëzhgimet që bënin rezultonin që u mungonin 'tiparet profesionale dhe morale' ose 'kishin pengesa në të folur' (ishin belbër) ose 'nuk dinin të flisnin dhe të komunikonin' ose 'ishin në dimrin e jetës së tyre' ose 'nuk dinin të lexonin para se të kishin lindur' ose 'nuk mbanin kollare' ose 'nuk e kishin të botuar asnjë punim profesional' e tjera. Ngritja me tituj shkencorë dhe profesional ishte thuaja e admirueshme! *Fati tij ishte një rast i volitshëm* të cilin do duhej ta shfrytëzojë me mençuri! Lënda mësimore-shkencore, *MMM Metodikë e Mësimit të Matematikës* (disi e bekuar me të cilën me statut shkolle do duhej të diplomonin studentët) ishte tamam si t'ishte porositur; e 'paprekur'; me dinjitet; e 'virgjër' e cila e kishte humbur të dyja bashkë 'atësinë' dhe 'amësinë'; nuk njihej as nga vetë matematikanët si bijë e tyre! Me kohë ajo nuk ushqehet nga matematikanët por as nuk mbrohet nga ata, të cilët me zemër deklarorin nuk është bijë e jona! Arsyeja ishte që matematikanët, mësuesit e Safirit dhe mësuesit e mësuesve të tij nuk dinin të flisnin, e pashpjeguar! Për ta mjaftonte një fletore njëzetë faqesh dhe ndanin mendim dhe vlerësim të njëjtë: *'Matematika është shterpë, ajo s'pjell metodikë.'* Kjo e fundit është e juaja! Të qoftë për hair MMM, zotëri Pedagog! I pafsh hairin!

Matematika për shumicën e nxënësve në tërë Botën e qytetëruar mbetet lëndë mësimore e 'pa-dëshiruar'; më e vështira dhe më e urrejtura! Në këtë drejtim ajo konsiderohet **'autoritare'** ndaj të gjitha lëndëve të tjera mësimore! Ajo të shpie drejt *faktorit lidhje* me botën e globalizuar, me njerëzit të cilët nuk janë si ti; me norma kulturore dhe arsimore krejtësisht të ndryshme nga ti. Ajo ta siguron biletën hyrëse për *punësim; afirmim;*; ajo të sjellë *nderim, respekt dhe vlerësim* të lartë intelektual; ta zgjeron 'ranglistën' e përzgjedhjes së vendeve të punës sipas ofertës. Matematika të ushtron për të udhëhequr me paranë publike dhe private; kapitalin; kursimin dhe fitimin por edhe falimentimin. Të mëson me persiatë me mënyrën tënde të gjykimit nëpërmjet Mendimit Kritik; të jep dije dhe forcë; ndikim dhe nderim por në fund të fundit të jep dhe Pushtet sikurse Safirit i cili zgjati njëmbëdhjetë muaj.

X. BOTIMI I LIBRIT TË PARË, METODIKË E MËSIMIT TË MATEMATIKËS ('87)

Vetiniativa për ta krijuar dorëshkrimin MMM ('87) ishte rrjedhojë e një 'kalaveshi' shkaqesh dhe rrethanash kuptimplote:

1. Krijimi i opinionit strategjik universitar nëpërmjet 'fjalisë lapidare', dhënë nga Rektori i UP-së i viteve ('80): "Në UP nuk ka vend për asnjë mësimdhënës i cili nuk shkruan një libër ose një dispencë për studentët e tij".

2. Botimi i dhjetëra punimeve nga MMM në revistën arsimore-pedagogjike e shoqërore 'Shkëndija' në mesin e së cilave kishte edhe asosh të shpërblyera nga Redaksia trembëdhjetë anëtarëshe e Revistës;

3. Elita shkurtpamëse e matematikanëve kosovarë të cilët 'donin ta preknin qiellin me dorë' e hapën Shkallën e Tretë të Studimeve Post-diplomike në Gjuhën serbokroate (mentorët e frekuentuesit të gjithë ishin shqiptarë) në këto disiplina matematike: Algjebër; Analizë matematike; Ekuacione diferenciale por jo edhe për *Metodologji matematike* (nuk donin të linin trashëgimtarë në stilin: "Unë mirë jetova, pas meje u bëftë kiameti")! Dekada me rradhë punohej e 'arsimohej' me një paçavure 20-të fletësh' duke vlerësuar që MMM nuk është disiplinë matematike! Tashmë vendi ishte me një Doktor Metodologjie të Matematikës i cili e kishte edhe 'aneksin jetësor të mjaftuar' ('79-'93) për ta formuar ndonjë metodikanë! Por kjo nuk ndodhi;

4. 'Mos-Gradimi i matematikanit të vonuar' u 'kompenzua' me shkrime librash në seri;

5. Pas Demonstratave të përgjakshme të vitit ('81) ekzistenca e funksionimit të SHLP në përgjithësi dhe grupeve të njëjta studimore në veçanti (Matematikë; Gjuhë dhe Letërsi Shqipe; Mësim klasor), të ndodhura në një largësi hapësinore më të vogël se 40^{-të} kilometra ishte e diskutueshme; me synim mbylljeje;

6. Mësimdhënësit e Arsimit të Lartë e kanë kohën e nevojshme dhe të mjaftueshme për 'studime shtesë' (qofshin ata 'me grada' apo 'pa grada'); për ta 'rizbuluar' vetvetën; cilët dhe ç'farë janë!

Matematikanët tanë 'i madh dhe i vogël' ishin shumë të ditur por me shumë faj. Kishin gabuar në hapa, ishin të orientuar pas titujve shkencorë dhe pas honorarit ku mbulonin tre-katër vende pune dhe as që u shkonte mendja ndonjërit prej tyre që ekziston MMM dhe për atë disiplinë shkencore shkruhej e botohej edhe në shtetet fqinje me Kosovën! Ishin të paprekshëm; punë udhëheqësish institucionesh; autorë librash universitarë, e bënë punën e autorëve, recensentëve dhe koautorëve të librave shkollorë para universitarë të një tirazhi tridhjetëmijë deri pesëdhjetëmijë kopje!

Që në nismë Safirit iu kujtuan aforizmat e njërit ndër tre matematikanët më të mirë që kishte shteti amë: "Askush nuk arrin sukses më të shpejtë se ai që i shfrytëzon gabimet e të tjerëve!" Dhe "Kush e ka lëvruar shkencën e matematikës i udhëhequr vetëm nga dobia materiale dhe levërdia e çastit; ose ka dështuar ose nuk ka arritur diçka për të qenë!"

Në memoaret e Safirit lexojmë: 'Bota akademike' është e admirueshme për shumicën e intelektualëve për të mos thënë nga të gjithë! E dija që punësimi im në Arsimin e Lartë në cilësinë e kuadrit deficitar edhe pse i 'kurdisur' ishte një rastësi! Fillimisht kisha parë një 'ëndërr' të bukur dhe paksa të rrallë! Isha bërë i njohur jo vetëm në qytetin e lindjes por edhe në tërë vendin duke 'shitur dije dhe dritë' dhe kjo disa herë rresht, për çdo pesë vjet! I doli gjumi i rëndë dhe i thellë, i tëri i djersitur shumë deri në bërryla, duke nxjerrë nga thellësia e qenies së tij një ofshamë të madhe!

Ne njerëzit e një gjaku ëndrrat i interpretojmë ndryshe nga të tjerët. Ëndrrave shumë të bukura u frikësohemi, me gjasë mund të na përcjellë ndonjë 'fat i keq'! Paragjykimet ishin të huaja për Safirin! Ai lidhur me ëndrrën kishte vlerësuar paksa ndryshe! I edukuar; ndërtuar; rritur dhe i kalitur me tipare të një vullneti të paepur dhe karakteri shumë të fortë, ishte zotuar që ëndrrën ta shndërrojë në realitet!

Ëndrra e matematikanit ishte të shkruaj libra lidhur me pyetjen boshtore: Si dhe në ç' mënyrë të mësohet gjuha me të cilën flasin të gjitha shkencat e natyrës?! Numri i librave të 'ëndrës' së tij ishte sa gishta ka një dorë, ide dehëse, e pa mbështetur në arsye të shëndoshë dhe po aq tallëse e përqeshjeje! Në realitet kjo 'ngjarje' ishte e 'pamundur', hamendje a pandehje me gjasë realizimi zero! Më thuaj ti si mund të shkruash libër Metodologjie edhe po qe se di me e përpiluar; kur as mësuesi i jot, Doktor Metodologjie, mësuesi i parë i matematikës në vend nuk e kishte shkruar atë përgjatë pesëdhjetë viteve, të punës akademike, për ta plotësuar mungesën e madhe të paarsyeshme që ndihej tek ne, për këtë lloj literature metodike në shqipe!? Mëdyshja që i valëvitej në mendjen e Safirit ishte: Kjo 'ëndërr' ka gjasë reale mos të realizohet as sot, as nesër, asnjëherë!! Po Doktor vetë ose shokët e tij do jenë recensentë të librit? A është e mundur që ata të japin *Pëlqimin për botim*? Shumë pak e besueshme! As magjistarët nuk e dinin ku do ta shpjen matematikanin ëndërrimtar kjo punë e pamenduar mirë dhe e papeshuar sa duhet karshi bajraktarizmit vendor përgjatë rrethanave, kurtheve dhe mundësive reale që do krijoheshin.

Fillimisht në artin e mësimdhënies Safiri ishte një 'lypsar', ku tjetër pos tek paraardhësit e tij. Nga ata mori vetëm zhgënjim. 'Nuk kemi asnjë rresht të shkruar i cili mund të ndreq punë, është një oazë pak e shkelur nga matematikanët shqiptarë'-thoshin ata. Tarafi i profesionit ndodhej në agoni, lidhur me Metodologji e mësimdhënies së matematikës (tani edhe të mësim-nxënies) duke vlerësuar që nuk iu përket atyre dhe atë me shumë qejf iu 'është dorëzuar pedagogëve, edhe pse ata nuk kanë qasje tek njohuritë elementare matematike! *Vetëm kjo mjaftoi që ai të bëhet i vetëdijshëm për ta kuptuar që vërtetë Metodika e Matematikës qenka disiplinë shkencore 'pa zot shtëpie'; 'pa atësi' e 'pa amësi' (kopile)!*

Safiri i deridjeshëm i moshës tridhjetë e pesëvjeçare ishte në padijeni të plotë për të shkruar. Vendosi të mësojë për t'u bërë shkruar nga hiçi! Dhe fillojë të shkruaj. Përgjatë tre viteve të para në SHLP, për kursin e Metodikës së Matematikës i krijoi *tri dorëshkrime të ndryshme*, përmbajtja e së cilave shtohesh dhe rritej sikurse buka; shtojë miellin, shtojë ujin, por 'çmimi' i saj nuk rritej!

Fillimisht mori mundimin dhe guxim të shfaqë belbëzimet e para metodike që në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar në gazetën 'Flaka e Vëllazërimit' të Shkupit dhe në revistën arsimore-pedagogjike dhe shoqërore 'Shkëndija' të Prishtinës, së cilës i mbetet borxhi i madh! Në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm, 'Shkëndija' punimin e tij '*Si të zhvillohet dhe përparohet Mësimi Elementar i Matematikës*' i botuar në vitin 1983 e shpërbleu si punimin profesional më të mirë vjetor. Është për t'u përmendur

“Problemi i aftësisë dhe paaftësisë në matematikë”, botuar në “Flaka e Vëllazërimit” në vitin 1981 dhe po këtë punim në vitin 1982 e botoi edhe Revista “Matematika-Fizika” pranë FSHMN në Prishtinë. Më pas “Problemi i mosuksesit në mësimin e matematikës”, botuar nga Buletini shkencor i SHLP-Gjakovë; “Çfarë metodash të përdorim në mësimin e matematikës”(në vazhdime), botuar në “Shkëndija” në vitin 1984; “Përkufizimi në matematikë” në “Përmbledhje punimesh” nga SHLP-Prizren në vitin 1997 dhe “Mësimi elementar i matematikës dhe refleksionet e saj me rrezatim moral” nga SHLP- Prizren në vitin 2001; ku punoi katërbëdhjetë vite (1989-2003) si bashkëpunëtor i jashtëm me fond të plotë orësh!

Me botimin e gjashtëmbëdhjetë punimeve profesionale nga MMM në faqet e ‘Shkëndijës’, përgjatë viteve (1982-1990), ato i dhanë Safirit kurajë dhe vetëbesim që duke shkruar nga dy-tre rreshta për çdo ditë, ka mundësi ta shpalojë ‘dhuntinë e fshehtë’ për të shkruar nesër-pasnesër edhe libër! Për Safirin revista ‘Shkëndija’ u shndërrua në një ‘poligon stërvitjeje’ për të shkruar, shkruar dhe shkruar! *Euklidi (330-275 p. e. s)* ky mësues i mbarë matematikanëve antikë dhe modern që erdhën pas tij, para 23 shekujsh e kishte lënë amanet (porosi) këtë thënie filozofike: *“Matematika ua shpërblen mundin vetëm atyre që interesohen për të”!*

Praktika e mësimdhënies paraqet punë intelektuale, kërkimore, hulumtuese, zbuluese dhe artistike. Vilet fshehurazi, për çdo ditë nga pak dhe askush-askujt nuk ia dhuron të gatshme! Përvoja paraqet tërësinë e ecurive të ndodhura më parë të përjetuara, atë që e kemi provuar ose e kemi jetuar dhe prej së cilës kemi nxjerrë mësim! Përvojës së suksesshme të thuash i paraprinë ajo e hidhura!

Vizitat disa ditore (të metodikanit-ëndërrimtar) në Panairë librash nëpër disa vende të Ballkanit ndjehej si domosdoshmëri personale dhe kjo ishte realizuar tetë herë radhazi (1979-1986)! Me pajisje literature aktuale të kohës ishte e mundur për të vëzhguar e soditur edhe të tjerët përreth tij. Kështu të përfituarit e një përvoje të përparuar mësimdhënieje, ishte e dukshme nga dita në ditë!

Pas dhjetëra punimesh profesionale të botuara në ‘Shkëndija’ kishte krijuar dorëshkrimin e librit të parë **MMM (1987)** pas tre vitesh punë në Arsimin e Lartë. Lajmërimi ishte bërë publik në gazetës Rilindja, katër ditë para stinës së verës së vitit 1983! Për momentin kur po flasim, Safiri ishte ligjërues. Si mund t’i botohej libri universitar kur i mungonte koautori, titulli shkencor, shoqëria akademike?! Recensentët, vlerësimin e tyre mund t’ia bënin edhe ‘me porosi’! Atëherë për realizim ëndrre i duhej të shpikë ‘leva’ dhe këta gati u zbuluan! Po qe se në dorëshkrim do futej pak ‘ideologji e kohës’ (në cilësinë e *piperit në gjellë*), Recensentët në vlerësimin e tyre me gjasë do jenë paksa më ‘tolerantë’, më të matur dhe të përshpejtuar!

Recensionin e parë të librit MMM (1987) ishte shkruar relativisht shpejtë por shumë tendencioz dhe i ‘minuar’, dhënie Recensionin ‘me dy kuptime’ i cili kushtëzoi dhe bëri të stërgjatët botimi i librit deri në katër vite pritjeje! Në dorëshkrim Safiri kishte atakuar autorë librash shkollorë me përmbajtje të stërholluar ku e kishte të përfshirë edhe Recensentin, duke e heq veten më trim dhe më të fortë se ç’ ishte! Reagimi i Recensentit me përvojë, i përpiluar me shumë mjeshtëri ishte i ‘natyrshëm’ por megjithatë hakmarrës! Shembulli i ‘huazuar’ nga libri i Recensentit bënte fjalë për *Përkufizimet* të cilat ishin të kompozuar nga tridhjetë, përkatësisht dyzetënjë fjalë, raste ‘emblematiske’, edhe këto në librin e klasës së pestë të Shkollës Filllore’ për nxënësit e moshës 10 vjeçare! Nga kjo ‘kritikë’ ku kolegët e Degës mbronin

‘tezën’ në libër nuk bën të kritikohej libri, ‘dëmshpërblimi’ ishte i barasvlershëm me shumën e honorarit të librit që po botohej e shpenzuar për bileta autobusi! Për t’i dalë zot librit nga ‘Shkolla tek bunari’ deri në ‘Qytetin pa lum’ Safiri kishte udhëtuar më shumë se gjashtëdhjetë herë! Njerëzit e njohur e pyesnin në autobus mos vallë e kishte ndërruar vendin e punës edhe njëherë!

Lidhur me librin ishte formuar ‘**Kori i burrave**’ në fakt një ‘oktet’ me dirigjent Talkun. Aty bënin pjesë edhe Sulfuri, Nikeli, Jodi, Dolomiti, Mangani, Karboni dhe Fosfori të cilët për katër vite dorëshkrimin e përcjellën me disa ‘epigrafe’ dhe donin ta bënin shkumb e hi, tamam si Zhiva e ditëve tona ‘kampion mujshari’ në vend, i cili librin e botuar si ‘emblemë kombëtare’ e llojit vet për hatër të një biçim Bismuti gjithandej ku iu dha mundësia e shpalli ‘të pa dëshiruar’ duke e ‘përlyer emrin e tij, tepsinë e familjes dhe letrat e diplomave’! Që nga data 18 qershor ‘83, kur ‘Rilindja’ botoi artikullin (një faqesh) ‘Gjithnjë e më shumë tekste origjinale’ dhe në një kryerresht të tij; ‘Nga shtatë Shkollat e Larta, tash për tash parashihen të botohen vetëm dy tekste universitare: ‘Metodika e Mësimin të Matematikës’ e Safir Kromit dhe ‘Kimia e Përgjithshme dhe Inorganike’(Sh. G.), ‘të gjithë ishin kundër metodik anit në formim’ dhe për të mbetur ‘gjallë në zall’ ai ‘ishte bërë kundër të gjithëve’!

Si në përrallë pas disa propozimeve dhe (ri)emërimeve të reja recensentësh të cilët do ‘shkruanin aq sa kishin dituri’ pas katër vitesh u fitua e drejta, për ta botuar librin në ‘Qytetin e urave’, i cili pas dy viteve i ofroi perspektivë për të punuar në Shkollën e Lartë atje, diku afër Urës së Moçme të Gurit për katërmbëdhjetë vite në cilësinë e bashkëpunëtorit, me fond të plotë orësh. Këtu ai ndjeu kënaqësi dhe ç’lodhje të rrallë intelektuale në një ambient pishash tridhjetë vjeçare sikur të kishte shkuar për mësimdhënie në ndonjë vendverim mali apo bjeshke, diku jashtë vendit! Periudha kohore e punës në këtë ambient përrallor i përket pesë viteve akademike; dy vite para se të ‘burgosej shkolla shqipe’ dhe tri të tjera, pas Çlirimit të vendit. Dhe për të mos ndodhë si Arsimi në Çeçeni, nëntë vite të tjera të *mesit* i përkasin punës nëpër oda xhamish, ku udhëtimi me autobus ndër urban ishte falas! Nuk e kishte të ditur, të dëgjuar apo të lexuar, fjalë apo shprehje falënderimi e mirënjohjeje publike lëshuar nga Rektorati i UP në adresë të BIK lokalet e së cilës ishin strehë e sigurt (pa pagesë) për Mësimdhënie Universitare! Ngjashëm për Atdheun sakrifikojë edhe Shoqata e shoferëve të autobusëve! Pak gjasa ka që autori të jetë i gabuar meqenëse atëbotë synohej një orë e më parë të funksionon ‘kthesa’ në UP dhe të fillojë së funksionuari ‘Fabrika e Diplomave Universitare’ edhe pa shkollë të mesme të kryer!

Safiri gjithnjë e kishte vlerësuar lartë rregullin shtëpiak të kësaj shkolle e cila dallohej dukshëm nga ‘Shkolla tek Bunari’! Atje atij iu mundësua *ekspozimi i librave të botuara* përbrenda një vitrine, në korridorin më frekuentues të shkollës! Për këtë gjest të tyre ai u ishte mirënjohës! Ata nuk vuanin nga kompleksi i xhelozisë; përse një person i vetëm ka shkruar disa libra ndërsa shumica prej tyre asnjë?!

Pak kohë pasi që libri kishte dalë nga shtypi ‘i *gjashti në bronz*’, në një mbledhje rasti kishte thënë: **“Kemi gabuar që kemi lejuar botimin e librit!** Si do të paraqitemi para opinionit jugosllav me ‘autor anonim’, kur *mësuesi i parë i matematikës ndër ne (1952), ende nuk ka shkruar Metodikë të Matematikës!!* (Fatkeqësisht, mësuesi i parë gjatë rrugës e kishte humbur bishtpenën)!

Matematikani i ynë përgjatë karrierës së tij të bujshme dyzetë vjeçare punësuar në tetë vende pune ‘të cilat i ndërronte si kollaret’ nga njëra tek tjetra gjithnjë avancuese megjithatë asnjë vend-punim i tij nuk i kishte dhënë mirënjohje simbolike (formale) për punën e tij të palodhshme arsimore!

Ishte nëntori **1987**. Godina e SHLP tek ‘Bunari’- Krye-pazari ishte bërë vendi i dy kretimeve paksa të rralla; Dyzetë vjetori i themelimit të Normales së Gjakovës, ish nxënës të së cilës fituan titujt më të lartë shkencorë duke u bërë edhe anëtarë të ASHAK dhe Njëzetë vjetori i themelimit të Shkollës së Lartë Pedagogjike nga bangat e së cilës si student i gjeneratës së parë doli Metodikani ynë! Po këtu u punësua 11 vite më vonë tani si mësimdhënës në Degën e Matematikës. Atëbotë ishte i ngazëllyer dhe me faktin që një javë më parë nga shtypi i doli edhe libri i parë i tij, Metodika e Mësimi të Matematikës (1987) ku Botues ishte Universiteti i Kosovës në Prishtinë (atëbotë, ashtu quhej).Atij tashmë i përkisnin tri gëzime; kretime përvjetorësh dhe promovim libri.

Për punëtorët e SHLP-së ishin organizuar biçim mbledhje; njëra në objektin e shkollës ku në mes tjerash *Palaçoja zyrtar, karikaturë prej mësimdhënësi*, fjalitë e të cilit në gjuhën amnore gjithnjë i kishte të papërfunduara, me gjysmë zëri të mekur pyeti: Si t’ia bëjmë në këtë përvjetorë jubilarë a duhet të propozojmë ndonjë ish-student të dalluar për t’i dhënë Mirënjohje?***(Në kohën kur një pjesë e madhe shqiptarësh ‘shkrihen’ për të pasur një dekoratë,ka edhe nga ata që i kthejnë mbrapshtë ato!)***

‘Dora e djathtë’ e tij Bori i Sharit nga rrethina e Përzërenit foli: ‘Jo, nëse ka qenë i mirë ka qenë për vete!’ Nuk reagojë askush tjetër edhe pse raportet ndër njerëzore ishin të mira me të gjithë! Kolegët e punës i zuri turpi, bile i madh! U turpëruan për asgjë! Fajin e kishin: xhelozia , smira, dembelosja dhe padituria e të zemërplaturve! *Në një kohë kur shoqëria kosovare e politizuar gjithandej sundohet nga antivlerat me dekorata; diploma e tituj akademikë, ti je më i nderuar nëse nuk e ke marrë një vlerësim të tillë!* Bori i Sharit tashmë ka ikur por ish-kolegëve të tij mund t’iu kujtohet ***thënia e famshme e Cezarit: ‘Veni, vidi, vici!’ (erdha, pashë, fitova)***! Safiri në mesin akademik ‘*erdhi*’ ndër të fundit e Plejadës së tij; ‘*e pa*’ çfarë dhe si punohej e vlerësohej studenti deri në diplomim; e preku ‘paçavuren’ 20-fletëshe (‘67-’80) të MMM dhe së fundi *fitoi* përgjatë 30-të viteve në vazhdim (‘80-’10) ; *botoi 7-të libra universitarë!*

Në mbledhjen e dytë atë në Pallatin e Kulturës u shpërndanë shumë vetave ‘Mirënjohje për të rritur’(30 sosh); ish- Drejtorë shkollash; fillore, të mesme e të larta; ish-Kryetarë komunash, ish-Rektorë; ish-Ministra; ‘shqip’ e ‘serbisht’ por *asnjë për ish-studentë, kuptohet* së paku një tjetri ose disa të tjerë pa Safirin!***Përgjatë periudhës kohore njëzetë vjeçare (1967-1987)*** në Shkollën e Lartë Pedagogjike tek ‘Bunari’ Krye Pazari me 5 (pesë) Degë mësimore (Gjuhë dhe Letërsi shqipe; Matematikë; Biologji-Kimi; Histori-Gjeografi dhe Mësim Klasor) ***diplomuan 2682 studentë***, në mesin e të cilëve është dashur të dekorohen edhe disa ish-studentë të dalluar meqenëse ata ishin ‘produkti’ i jubileut!

Libri ishte botuar nga ETMM në 2000 kopje për nevojat mësimore të tri Shkollave të Larta Pedagogjike- Dega e Matematikës. Shitja kishte vijuar nëpër librari përgjatë pak më shumë se tre vite, meqë ETMM ishte mbyllur dhunshëm në kohën kur ‘*Shkolla shqipe ishte burgosur!*’ Me gjasë kopjet e mbetura të librit në depo ishin shndërruar në letër! Honorari i librit MMM (1987) ishte 10% e vlerës së 2000 kopjeve e kjo ishte afërsisht 400 DM të kohës, *para të papërfillshme* të cilat nuk kanë mjaftuar për të paguar as ‘biletat katërvjeçare të udhëtimit’ për t’i dalë zot dorëshkrimit në ETMM!

XI. BOTIMI I LIBRIT TË DYTË, METODIKA E MËSIMIT ELEMENTAR TË MATEMATIKËS

Ideja e planifikuar për ta krijuar dorëshkrimin M M E M ('93) nëpërmjet dorëshkrimit **provokues** dhe atij **përfundimtar** u tregua e suksesshme!-‘Varianti provokues’ iu ofrua dy çifteve Recensentësh; ku çifti i parë me përçmim të thellë, ‘nuk e preku’ as me dorë as me sy’, ndërsa vetëm njëri Recensent nga çifti i dytë ofroi ndihmën e nevojshme me pesëmbëdhjetë faqe të shkruara; por pas përmirësimeve dyveçare nuk pranojë ta marrë ‘dorëshkrimin përfundimtarë’, tashmë!

Në vazhdim ‘varianti përfundimtarë’, për Recension i ofrohet mësimdhënësit ndër ‘më të zotët dhe më objektiv’ të Katedrës, Recension i të cilit doli të jetë: i përshpejtuar; arbitrar; mospërfillës; i cektë; i kundërthënëshëm; nënvlerësues me shenja të dukshëm përçmimi!

Në fund të tunelit, Recension i për MEM ('93) i mbeti për vlerësim doajenit të Katedrës së Matematikës, më vonë anëtar Akademie pranë ASHAK i cili dorëshkrimin e vlerësoi pozitivisht, si kontribut të çmuar, me porosinë: **‘Të botohet sa më parë!’**

Botimi i MEM ('93) për Safirin ishte sfidues për këto shkaqe dhe rrethana:

1. ‘Burgosja e Shkollës Shqipe’ në Kosovë; 2. Mbyllja ETMM; Rilindja; RTK; Sistemi librarë nën dry; 3. Luftohej në disa ish Republika sllave; 4. Numër i madh kopjesh libri 1000= 500+500 kopje i një ‘malli kaçak’ i cili mund edhe të konfiskohej; 5. Financues i botimit të librit autori Safir Kromi, 3000 DM të kohës; 6. Bartja e librave dhe magazinimi i tyre në ‘Qytetin pa lum’; 7. Shitja e librave aty ku punonin mësueset dhe kjo nëpërmjet autorit (sikur Rilindasit); 8. Kohëzgjatja e shitjes së librave zgjati pesë vite!

Meqenëse tek ne në Kosovë në periudhën (1983-1987) MEM (Metodika e Mësimit Elementar të Matematikës) ishte një ‘xhungël e pashkelur’, atëherë matematikani kishte gjykuar me Mendim kritik (njëmbëdhjetë vite para se të artikulohej për herë të parë tek ne)! Me gjasë për të shkruar një dispensë e ndoshta edhe libër duhej krijuar ‘mekanizma sigurie’! Fillimisht duhet shkruar ‘**Variantin provokues**’ dhe më pas ‘me çdo kusht’ e ‘me çdo çmim’ duhej caktuar Recensentët më në zë nga kjo fushë! Safiri kishte bërë përpjekje për ta ‘imituar’ *gjuhëtarin Konstantin Kristoforidhi* i cili në kohën e tij me zgjuars, qëllimisht ka thyer shumë vezë një fshatareje, të vendosura në një shportë! Me rënkimet, zërin e përvajshëm, dënesët, ofendimet e rënda, mallkimet me gjithë shpirt që do dalin nga goja shumë e pistë e fshatares, gjuhëtarit donte ta pasurojë Fjalorin e Gjuhës Shqipe! Kuptohet vetiu, dëmin e shkaktuar, studiuesi rilindës e pagoi!

Derisa u botua libri i parë, ai kishte krijuar ‘**Dorëshkrimin provokues**’ MEM ('93), i cili u ofrua ‘dy vetave të një koke’, të cilët ‘donin ta preknin qiellin me dorë’, por e refuzuan me shumë përbuzje dhe smirë, duke mos e prekur as me sy dhe as me dorë! Njëri prej tyre ishte *shok klase* gjimnazi përgjatë katër viteve me të cilin në klasën e parë të dy kokë më kokë përsëritnin leksionin e fundit të historisë së frikshme gjatë tre minutave! Ajo përkthehej që ‘fatmiri i ardhshëm’ e kishte humbur adresën fare!

Në vjeshtën e vitit ('86) Dorëshkrimin për Recension e pranuan pa lutje, mësimdhënësit më të mirë që kishte vendi nga kjo fushë (të cilët ishin futur në lajthime) ku në fund të atij viti i dhanë *vlerësimet*

negative të pritshme por me mospërfillje e nënvlerësim të skajshëm, me fjalë dhe shprehje përçmuese me përfundimin: Mos të merret parasysh për botim!

I pari kishte shkruar: “Vërejtjet e bëra flasin për punën akoma shumë të madhe e të gjatë që duhet bërë me dorëshkrimin. Për shkak të nevojës që ndihet për tekste të këtij lloji, autorit Safir Kromi i rekomandojmë që të vazhdojë me ripunimin e dorëshkrimit të dorëzuar në mos të gjithat, pjesën më të madhe të përmbajtjeve programore”!

I dyti kishte shkruar: “Jam i bindur se veproj edhe në interesin e autorit, kur të rekomandoj që tërë këtë materie dhe këtë **brumë** të paraqitur në dorëshkrim, edhe njëherë vetë autori **ta ripërtpë mirë e mirë**, me plotë **përgjegjësi** dhe **seriozitet** dhe pastaj atë ta prezantojë qartë e drejtë në mënyrë koncize, në tekstin i cili gjithsesi duhet ta ketë **vulën e origjinalitetit** dhe nivelin e një teksti universitar. **Nëse kam kuptuar mirë detyrën time atëherë me keqardhje të thellë** më duhet të konstatoj qartë dhe pa dilema se ky dorëshkrim një barrë të tillë (për të qenë Tekst Bazë të lëndës MMEM) nuk mund ta mbajë. *Pra propozoj që ETMM dorëshkrimin MMEM për studentët e SHLP- Grupi i Mësimi Klasor të autorit Safir Kromi në gjendjen e tanishme mos ta merr parasysh për botim.*

Safiri i vlerësoi si dobiprurëse vetëm vërejtjet e Recensentit të parë të cilit i mbetet shumë herë mirënjohës. Recensionin tjetër nga babai i Matematikës kosovare, kishte dhimbje të tjera, shfryu tërë mllef! Të mirat që i sollën këto recensione negative ishin mbi të gjitha *flakja e duhan-pirjes pas njëzetë e dy vitesh ‘helmimi me nikotinë’*, së cilës i ‘frikësohej shumë që nuk do dijë të ligjërojë’ meqenëse pas orëve dyshe 90-minutëshe do duhej tymosur dy cigare por realiteti do fliste ndryshe! Mbi të gjitha, shkrimet e njërit Recensent ishin përfitim i një përvoje të re modeste në të shkruarit e librit origjinal të fshehtat e të cilit me kalimin e kohës do të duhej t’i zbulojë autori vetë, askush nuk t’i jep të gatshme!

Pas njëzetekatër muaj pune intensive hulumtuese-zbuluese në fund të vitit (’88) Safiri i kishte dhënë fund **‘Dorëshkrimi përfundimtar’** të MMEM (’93). Në janar të (’89) libri në dorëshkrim u dorëzua për Recension një personaliteti shkencor ndër më të mirët që kishte vendi i pangarkuar me sherre, me bindjen që ai do jetë objektiv dhe pa hile! Megjithatë po ai doli ndër Recensentët më betër!

Në memoaret e mia, shkruante: “Nuk duhet dhënë fjalëve lak! Për qasje ndër më të ndryshme si zakonisht pa fije droje dhe turpi por me fakte kisha atakuar librat absurd të matematikës si të isha ‘babai i mësuesve të mi’ tek të cilët nuk ishte përfillur Parimi i Maturisë! Meqenëse Recensenti ishte autor dhe koautor i disa librave shkollor (V-VIII) vërejtjet e mia të preکشme tek ai me gjasë kishin shpalosur inate e shqetësime ndër më të ndryshme dhe padyshim Recensionin negativ por kundërthënës me vehtën i tij ishte refleksion dhe *rrjedhje e qëndrimit paragjykses ekstrem dhe vlerësimin subjektiv të skajshëm!*

Për ta zbardhur Recensionin e lëshuar nga ‘Personi më i ditur i Katedres’ në shkurt të vitit (’89) me cilësi *‘prove materiale’* si vlerësim i **përshpejtuar** (dy javorë); i **cekët** (një faqe e dhjetë rreshta); **nënçmues e arbitrar** (askund, në asnjë rresht nuk përmendej emri i autorit të dorëshkrimit!), pas dy jave pasoi Reagimi kumbues i Autorit drejtuar ETMM. Disa kolegë shkollorë kishin rastin ta lexojnë dhe më sugjeruan ta ndryshojë tekstin; ishte shkruar paksa ‘ashpër’ por Safiri nuk trembej, as lëkundej. Dromcat objektive të dala nga goja e Recensentit ishin: Lënda, materiali i marrë nga matematika, kryesisht është përpunuar e shfrytëzuar drejtë. Dorëshkrimi është përpiluar me kujdes dhe përkushtim edhe teknikisht e

gjuhësisht është mjaft mirë i përgatitur. Nga ata pak rreshta të Recensionit vlerësohej *tri herë: Gjërat përsëriten* dhe *4 herë: Pjesë të parëndësi, kjo aq më parë kur ekziston libri Metodika e Mësimit të Matematikës, që do të thotë:* "Një libër tashmë e ke botuar, si guxon të bësh fjalë për një libër tjetër të dytë"?! Ja, kjo ishte 'filozofia' e mësueseve tanë matematikanë përgjatë pesëdhjetë viteve!

Atëbotë subjektet përgjegjëse të ETMM pas marrjes së këtij reagimi vlerësuan: "**Libri do të botohet**"! Më vonë siç dimë 'ngjarjet u zhvilluan si në film' dhe ETMM u vu nën dry për të mbetur në kujtesën historike, të brezave; 'Ishte koha kur...' Për çudi 'pjellë' kazani i Nasradinit, *njerëzit e librave në Entin e Teksteve e 'kishin pëlqye shumë dorëshkrimin e librit' dhe 'donin ta shpallnin të humbur'*! Për fat të mirë familjari im me punësim përballë tyre në Shërbimin e Kontabilitetit Shoqëror pas katër-pesë 'tentimeve të befasishme' arriti ta nxjerrë 'Librin në dorëshkrim' si të shpëtuar!

Pas tri viteve të përgjumura ('92) po këtë dorëshkrim pa përmirësime të mëtejshme në asnjë rresht, në cilësinë e Recensentit e mori për vlerësim doajeni i Matematikës ndër ne më vonë **anëtar i ASHAK** duke dhënë mendim dhe vlerësim pozitiv për dorëshkrimin si "Kontribut të çmuar", me porosinë, "**Të botohet sa më parë**"! Me shumë rëndësi ishte kush fliste dhe çfarë fliste?! Nga një autor anonim, siç thoshte ish Ministri për librin e parë ('*nuk e ka emrin e atij që e ka shkruar*'), Recensentit zulmëmadh dhe vetëm atij i përket merita arsimore, shkencore, humane dhe kombëtare që e zbuloi, e nxiti në të zhvilluar, e përkrahu, e mbrojti dhe i dha shtytje matematikanit paksa të vonuar i cili do botoj në vazhdim edhe pesë vëllime të tjera nga MMM, për çdo pesëvjeçar nga një libër të rinj duke i mbetur borxhlinj për jetë të jetëve mëqenëse ka pasur mundësi e rrethana tjera edhe familjare të veprojnë dhe ndryshe! Ai e pengoi sorollatjen shtesë të metodikanit që po lind karshi Recensentëve të tjerë, bile edhe ziliçarë e demagogë të cilët donin ta 'hanin' në të gjallë dhe ta bënin një hiç!

Kishin kaluar tre vite (1990-1993) nga mbyllja e shkollës shqipe. Shpërngulja masive e të rinjve tanë nëpër Evropë ishte i dhimbshëm dhe pikëllues në atë kohë. Bashkë me ata atëherë u larguan edhe shumë kuadro mësimdhënësish nga UP, ndërsa **Safiri** i tjetërsuar vërtetë, **planifikonte të botonte libër universitar me vetëfinancim, ndër të parët e kësaj natyre, në vlerën prej tremijë markash të kohës!** Ishte ndërmarrje e rrallë autoriale me vlerë kaq të madhe paraqe të cilën nuk e kishte bërë askush para tij por as pas tij! Para se gjithash ishte kohë lufte a vdekjeje në disa ish-vende fqinjë! Botimi i këtij libri ishte refleks mbrojtës i Arsimit kombëtar dhe rrjedhojë e shqetësimit shumë madh të autorit për fatin e shkollës shqipe, në Kosovë.

Për ta botuar librin MEM ('93) nuk e hapën 'kuletën' as ata që e shisnin vetën për 'patriot' dhe 'kishin para nëpër duar' dhe ndihmonin shkollat me lëndë djegëse! Ai kishte trokitur nëpër shumë dyer ndërmarrjesh shoqërore por edhe private që ende punonin, në cilësinë e 'lypësit', ashtu siç vepronin në Maqedoninë fqinje e më pas për t'i falënderuar me shkrim, tek një faqeje libri! Mendonin, që botimin e librit e kishte për biznes. Për çudi autori nuk e kishte idenë, sa do kushtojë botimi i librit! Ai u kishte thënë shumë njerëzve: 'Do ta shes, me gjasë dhe një pjesë oborri të shtëpisë trashëguar nga babai dhe librin do ta botojë!' Vendosi të jetë financues dhe botues!

Në kohën kur po flasim (nëntor, '92), Rektorati i UP ishte strehuar në një godinë të vjetër në **Rrugën e Avokatit**, diku afër tij në të djathtë të rrugës. Pas Recensioneve pozitive autori duhet kryer disa

formalitete.Rektorati i UP gati ishte zhbërë dhe shturë, i ndodhur me probleme ekzistenciale. Edhe pse me Recensione pozitive të librit MEMEM ('93), *UP nuk ishte i gatshëm të ofrojë Vendim për ta botuar!* Ishte koha kur 'qeni nuk e njihje të zotin e shtëpisë'! Ishte i arsyetuar ta kryej 'falsifikimin e parë dhe të fundit në jetën e tij' thoshte Safiri! Në analogji me Metodikën e Gjuhës Shqipe në përfundim kishte shkruar lidhur me Vendimin 04 nr. 413-235/80, libri është i liruar nga tatimi në qarkullim! Në qoftë se sot krenohemi me demokracinë të ndodhur më shumë se njëzetë vite pas çlirimit, askujt nuk i bie ndër mend ta aktualizojë që Libri Universitar por dhe librat tjerë shkollor do duhej liruar nga Tatimi në qarkullim! Shembull: Libri universitar i shitur në librari me një çmim prej 15 eurosh; me 20% të këtij çmimi paguhet librari; me 10% të çmimit paguhet Tatimi në qarkullim; autori paguhet 10,5 euro! Realisht pa mëkate, autori do duhej paguar 13 euro, dy euro t'i ndalet për librarin(është e mjaftueshme) dhe lirim nga Tatimi në qarkullim!

Botimi i MEMEM ('93) ishte ndër botimet e para universitare të vetëfinancuara, për të mos thënë i pari! Kjo vërehet për faktin që në mbështjellësin e librit mungonte Stema e UP-(mars '93), ndërsa në botimet e mëvonshme Stema ishte domosdoshmëri për autorin! Për ta shndërruar dorëshkrimin në libër ishte njëloj si ta rritësh një fëmijë, i cili nuk ndodhë përgjatë një muaji(Recensionet e dorëshkrimit; Reagimi eventual i autorit; Lektura e dorëshkrimit; Radhitja kompjuterike; Korrektura e parë; Korrektura e dytë; Të punuarit e figurave; Realizimi kompjuterik së bashku me 'thyerje teknike'; Fotokopje e librit në paus (dikur), tani në kompjuter; Faqosje (mbështjellësi) e librit dhe të dorëzuarit në shtyp).Kjo punë në largësi tetëdhjetë kilometra e ndodhur në vitin ('92) dhe fillim vitin('93) ishte e lodhshme. Ishte kohë e ngjashme me vitet e gjashtëdhjeta kur u njohëm me televizorët e parë! Personat që dinin të punonin me kompjuter ishin të rrallë dhe fare të pakët!

Libri doli nga shtypi *Ditën e Mësuesit* të atij viti. Gazeta Bujku edhe në ato kushte e rrethana që ekzistonin e gjeti guximin nëpërmjet gazetarit B.V. ta informojë lexuesin, për daljen nga shtypi të librit MEMEM në kohën kur dëmi eventual për autorin të jetë më i vogël. Numri real i kopjeve të librit ishte njëmijë (autori i shënoi pesëqind meqenëse e kishte vlerësuar që libri si 'mall kaçak', edhe mund të konfiskohej në pesëqind kopje, për t'i mbetur autorit gjysma e tyre! Për fatin e mirë të lexuesit kjo nuk ndodhi.Nga tirazhi i MEMEM më shumë se njëqindpesëdhjetë kopje (me regjistër) kanë qenë të dhuruara; shokëve, kolegëve, mësuesve, drejtorëve të shkollave, bibliotekave, Universitetit të Prishtinës - disa dhjetëshe, disa institucioneve në shtetin amë(Bibliotekë kombëtare, Institut Pedagogjik, FSHMN.)

Safiri e kishte nderimin të qëndrojë në Kabinetin e Rektorit 'kundër-tankist' në Velaninë e trazirave, vepra jetësore e të cilit mbetet një peng nderimi i përmotshëm, për të gjithë njerëzit e shkrim-leximit! Shkencëtari model, atdhetar, i ditur, vizionar në cilësinë e autorit me përvojë, e dha porosinë: Çdo autor libri përballlet me tri beteja: E para, *për ta krijuar dorëshkrimin*; E dyta, *për ta botuar librin*; E treta, *për ta plasuar librin tek lexuesi*. Rrëfimi i Rektorit kishte gjetur aplikim në vazhdimësi në veçanti *shitja, libri si mall mund të 'plaket'* shumë shpejt, bile edhe para se të botohet!

Atëbotë, meqenëse '*shkolla shqipe ishte e burgosur*' dhe '*sistemi librar nën dry*', MEMEM ishte shitur si 'mall kaçak', në tërë vendin e shqipeve aty ku ishin mësuesit, në shkollë apo xhami; në klasa apo korridore; banesa apo shtëpia; në katunde apo qytete. Ishte koha kur *mësuesi e kishte pagën dyzetë DM* të kohës (mjete të mbledhura me shumë vështirësi nga kontributi qytetar) ndërsa libri kushtonte pesë

DM (e barasvlershme me çmimin e tridhjetë vezëve).Librin e blinin më shumë se të tjerët studentët e SHLP- Dega e Mësimit klasor dhe mësuesit pa shikëputje nga puna. Shitja zgjati pesë vite.

Për ta plasuar librin tek lexuesi, Safiri i hapi punë vetes. Ishte beteja më e vështirë që do zhvillohej deri atëherë. Ishte bërë pishman për numrin e madh të kopjeve (njëmijë), në kohën kur luftohej në disa ish republika sllave ndërsa në çdo skutë të vendit ndihej *‘erë lufte’*! Ishte koha kur këndohej kënga “Oj Kosovë, oj nëna ime”!

- Me një rast Safiri iu ankua kunatit të tij me fjalët: -‘Ky do jetë libri im i fundit’!

- Kunat ia priti: ‘Ky është vetëm i dyti, ti nuk ke të ndalur, shpejtë ke për t’ia nisur librit të tretë, e më pas besa edhe të katërtin...’

Për kohën kur po flasim, ai kishte numëruar katër vite punë, pranë SHLP në ‘Qytetin e Urave’, me fond të plotë orësh në cilësinë e bashkëpunëtorit në Degën e Matematikës. Ishte me shumë fat që atje u plasuan një numër i konsiderueshëm librash. Atëbotë kishin ardhur të tjera kohë veçmas për ata si puna e ligjëruesit, dy herë në javë udhëtim për në ‘Qytetin e urave’.Në çdo skutë kishte patrulla policie prej të cilave kërkohesh ‘prodhimi’! Nxënësit e një shkolle fillore tek e cila ushtrohej Praktika shkollore me studentë,Safirin e kishin ‘shndërruar’ në kopje të liderit historik të shqiptarisë kuptohet nga fizionomia:

fytyra; flokët e gjatë; syzat; rrudhat e ballit; të ecurit; shalli; kollarja; posa ta shihnin në oborrin e shkollës së tyre shqiptonin zëshëm emrin e tij (si në kor)! Me gjasë, nxënësit kishin të drejtë por frika ishte e evidente.Për këtë arsye shkollat ku ushtrohej pjesa praktike herë pas here ndërroheshin!

Një ditë në Drejtorinë e një shkolle fillore në Qendër të qytetit, me studentet debatonin lidhur me Praktikën e një ore mësimore të mbajtur dhe papritmas ia behu një oficer policie!

–*Zotëri më jep Kartën e Identitetit (në gjuhën serbe)!*

– Urdhëroni i përgjigjem

– *A jeni duke punuar legalisht apo ilegalisht?*

– *Unë jam autor i disa librave universitare dhe Matematika nuk është ideologji!*

–Oficeri: *“Kush të ka mësuar ty të flas kështu”! “Për pesë minuta lëshoje shkollën dhe ik”!*

-Vërtetë *ika shpejtë për të mos shkuar në mbajtje*. Me të arritur në vendlindje nëpërmjet radios “Kosova e lirë”, njerëzit ishin njohur për *Bisedën informative* të Safirit, me ç’ rast ma dhuronin nga një buzëqeshje të lehtë!

Në fillimtetori (’96) pas tre vitesh nga botimi i librit të dytë Safiri i pajisur me pasaportë mori guximin për të vizituar Shqipërinë duke marrë me vete më shumë se pesë kopje libri MEM (’93) për t’i dhuruar FSHMN-Dega e Matematikës dhe Institutit Pedagogjik.Në vendkalimin kufitar tek Hani i Hotit (Mali i Zi-Shqipëri) kishte filluar të frikësohet! Doganierët dhe Policia Malaziasë, nën zë por edhe mbi zë filluan të pëshpëritnin (me emër e mbiemër disa herë, në gjuhën sllave): ‘Ja na erdhi Presidenti i Kosovës’

Asnjë zë dhe përgjigje nga askush, heshtje! Druajtja nuk ishte e vogël, me vehte kisha libra plus Serbia e Mali i Zi ende sajnin një shtet! Megjithatë, përveç frikës ndalesa individuale nuk kishte! Poashtu në kthim 'rasti' nuk u përsëritë! Me atë rast Safiri u bind që nxënësit e 'Qytetit të Urave' vërtetë paskan të drejtë! Shkoi në kryeqytetin shqiptar për të qëndruar sëpaku pesë ditë, por u kthye për 34 orë(dy ditë e një natë)! I nisur në ora 7 të mëngjesit për t'u kthye nga Kryeqyteti të nesërmen me autobusin e parë të orës 17-të! Arsyeja: Pas muzgut të natës së parë u përhapë lajmi që shumë shpejtë do shpërthejë bomba! Menjëherë fillojë të mbyllej çarshia(dyqanet dhe korzoja) njerëzit filluan të iknin dhe atë natë u mbyllë në bujtinën e rezervuar dhjetëmarkash! Të nesërmen e preu biletën dhe iku nga kryeqyteti! Pas gjashtë muajve, (mars '97) shpërtheu 'lufta qytetare' me disa mija jetë të humbura për shkaqe ngritjeje të 'Ekonomisë piramidale' krijuar nga socialistët e rrëzuar nga Pushteti!

Është interesant, përgjatë viteve (90-94) pamja fizike e Safirit kishte ngjashmëri të theksuar me liderin e rinj socialist të asaj kohe (F. N.): Gjatësia e trupit; pesha(kur ende nuk kishte rënë në burg nga Demokratët); flokët; kollarja; të ecurit; syzet me xhama të ngjyrosura; koka e ngjajshme por paksa më e madhe! Sëpaku ashtu dukej dhe nga pamjet në ekranet televizive të kohës! Kishte raste që ndonjë i panjohur (pa fije turpi) e pyeste rrugës: 'A të ka thënë kush që je i ngjashëm me F.N.'? Kuptohet vetiu, kureshtarët mbeteshin pa përgjigje! Por kishte rastisë që dhe shitës dyqanesh kur hetonin që aty pari do kalonte matematikani, dilnin para shitoreve në distancë më shumë se dhjetë metra dhe përcjellnin ecjen e tij drejt tyre, duke 'regjistruar me sy' ngjashmëritë në veshje, lëvizje dhe pamje së jashtmi.

Derisa në dy rastet e para personalitetet me të cilët 'identifikohej' matematikani ishin prototip i tyre përafërsisht moshe të njejtë, tani pas pensionimit të tij (2010) 'zbuluesit' filluan ta krahasonin me një personalitet akoma më të lartë, me shkrimtarin më të madh shqiptar, gjeniun e letrave shqipe por 10 vite më të moçëm! Sipas tyre pika të përbashkëta ishin flokët (më të gjatë se 3 cm); rudhat e ballit dhe të fytyrës; kapela; syzat me korniza të trasha kauçuku; me dioptri më të madhe. Kjo homonimi krahasuar me dy të parat me gjasë pak mund të qëndronte, meqenëse Safiri në sytë e të panjohurëve vlerësohej në pamje 10 vite më i rinj plus shkrimtari i madh është 10 vite më i moçëm, do thoshte dallimi në moshë do dalë 20 vite! Ja kështu *merrej nëpër gojë* personi i Safirit përgjatë 30 viteve si t'ishte 'kameleon'!

XII. BOTIMI I LIBRIT TË TRETË, METODIKA E MËSIMDHËNIES SË MATEMATIKËS ('98)

Në memoaret e tij shkruan: 'Për arsye nga më të ndryshme disa përmbajtje programore të librit MMM ('87) nuk ishin shkruar drejtë dhe me cilësi. Ishte evidente mungesa e kontributeve të pedagogut, në cilësinë e Recensentit. Pa dyshim në mungesë përvoja në hartimin e librave edhe autori e kishte pjesën e vet të konsiderueshme të fajit dhe për faktin që 'kori i burrave' e kishin topitur për katër vite por dhe për mungesë koautori! Nga dashamirët e tij kishte dëgjuar se njëzetë për qind e përmbajtjes programore duhet hequr. Kështu ribotimi eventual i plotësuar dhe i përmirësuar ishte bërë detyrim!

Ende pa u shitur njëmijë kopjet e MEM, nga koha e Masakrës në Srebrnicë të Bosnjës, Safiri filloi dorëshkrimin MMM ('98), atëherë kur nisi të merret edhe me bletari, fillimisht me dy koshere të blera në *Krushkamadh* me çmimin e dy deleve në pazar! Një vit më parë ishte përgatitë për Teori të Bletarisë nëpërmjet disa librave të cilat e aftësuan për dimërimin e sigurt të tyre! Bletari e ka 'provimin' e dhënë po qe se dinë t'i dimërojë bletët! Kultivimi dhe rrita e tyre deri në gjashtë koshere të ndodhura në oborrin e shtëpisë zgjatën tetë vite (1995- 2003), atëherë kur bëra gabimin e pafalshëm thot Safiri! Përgjatë një meremetimi njëjavor në objektin e shtëpisë ishte krijuar zhurmë e pluhur, ambient të cilin bletët nuk e durojnë dhe të gjitha në ikje e sipër shkojnë në vet-flijim! Aty afër nuk kishte mentor bletarie dhe me paditurinë t'ime foshnjore, bëra asgjësimin e *Parkut të bletëve* me gjashtë koshere, situatë të cilën e kisha lexuar dikur që moti por angazhimet e shumta ditore bënë që ta kisha harruar tërësisht! Kështu pasioni i tij shumë i dashur por i vonshëm, tashmë i moshës pesëdhjetetë vjeçare mori fund para kohe me shumë hidhërim!

Lidhur me librin MMM ('98) aspiratat e tija sa vijnë e shtohen. Përveç emërimit të rinj për librin ***Metodikë e Mësimdhënies së Matematikës*** i lindi dhe një objektiv i rëndësishëm së veçantë! Në kërkim të fjalës së bukur lidhur me dituritë më të reja të kohës, libri MMM ('98) të synojë e të merr *interes më të madh përdorimi* dhe për tri institucione të Arsimit të Lartë; *për studentët e SHLP-Dega e Matematikës; për studentët e Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore-Dega e Matematikës (ide e përzier me ëndërr!)* dhe *ata të Fakultetit Filozofik-Dega e Pedagogjisë!*

'Shtylla ndërtimi' për realizimin e këtij objektiv i duhet kërkuar tek:

- Puna e ndejshme (ngadalë e pa u nxituar) gjashtëmbëdhjetë mujore;
- Përdorimi i ngjeshur i Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe;
- Përzgjedhje edhe të një Recensenti-pedagog, altruist me përvojë të përparuar;
- Përzgjedhje e Lektorit të dorëshkrimit për të qenë gjuhëtari më i mirë që ka vendi!

Pas një pune të përkushtuar (16-17)-të mujore, në dhjetorin e vitit ('96) u krijua dorëshkrimi i rinj MMM ('98) i plotësuar thellësisht dhe i përmirësuar dukshëm i cili në shkurt të vitit ('97) u dorëzua tek Recensentët më në zë që kishte shkenca jonë në këtë fushë. Në qershorin e atij viti ***u dha Recensionin pozitiv*** për ribotim me vlerë njohëse dhe vlerësime shumë afirmative, bile më shumë se ç'pritej ku ishte përfshirë 'realizimi i ëndrrës së autorit': ***Tekst universitar edhe për FSHMN-Dega e Matematikës!***

Ishte koha kur 'A-demikët' e Mixhës Ramë e kishin tërë 'Pushtetin e vetëvendosjes'(jo si Parti Politike)! Autori kërkoi me shkrim dhe me gojë nga matematikanët dhe pedagogët vendorë: 'Ja ku jam, thoshte ai për t'u futur në rresht aty ku e kam vendin! Kishte pikëpamje dhe debate denigruese lidhur me personin e tij! Safirit i vjen keq që personat të cilët e patën shansën e riafirmimit (mëqenëse fundi i karrierës së tyre mbetet i vyshkur) 'nuk dinin të lexonin' që mosgatishmëria e tyre për angazhime shtesë, në vlerësimin e gjetjeve më të reja në fushën e 'rizbuluar' MMM nga ana e matematikanit të vonshëm, e ka dëmtuar shumë prestigjin e ish-potencialeve intelektuale nga 'dy veta të një koke'! MMM ishte dhe mbeti 'minierë' intelektuale arsimore e pashfrytëzuar për të cilën do duhej të punojnë gjeneratat pas nesh! *Ajo konsiderohej disiplinë shkencore kopile pa prindër biologjikë dhe padashur 'kopili' edhe pse i rritur mbeti tek dera e matematikanit të vonuar, i cili e mori rolin e 'gjyqtarit' i autorizuar nga aftësia dhe instiktet e tija për t'i dhënë zgjidhje çështjes së moçme 70-të vjeçare! Nga kjo rrethanë 'rizbulimi', 'dy vetat të një koke' për mosveprim me dashje, do ngarkohen me shumë faj prej mësuesve shqiptarë! Por pa pasur thumbime në sy; gulçitje në fyt dhe vrer në qenie sepse kemi llojllojshmëri përvojash e dijesh ndër më të ndryshme, shuarja edhe të asaj pak dëshire e *bërjes së një matematikani me letra* me të cilin do të krenohej vendi i tij, iku në pakthim sepse i përkisnim botës së bajraktarëve shqiptarë. Askush nga të diturit nuk e mori guximin ta shqiptonte me plot gojën: *'Burra katundi që duket kallauz s'do'*; ky është pionieri i MMM në botën shqiptare, 'me letra ose pa letra'!!!*

Mundësia për të konstruktuar '*raketa*' nuk ekzistonte por ekzistonin premiset për t'ia vënë 'bazat' e mirëfillta artistike, njëres ndër pesëdhjetë disiplinat matematike, Metodologji e mësimdhënies dhe mësim-nxënies bashkëkohëse të Matematikës nga vetë matematikanët e cila deri dje konsiderohej 'disiplinë pedagogjike'! Megjithatë kjo nuk ndodhi sepse përreth kishte ziliqarë dhe smirëzi, pa dituri, të frymëzuar dhe të edukuar nga psikologjia e inatit, egoizmit e përçmimit për gjithçka dhe për gjithkënd!

Akademiku i rinj, autor i një libri të Doktorant urës, i cili bartë epitetin Full profesor vlerësonte dhe gjykonte: 'Në botimin MEMEM ('93) keni bërë gabim në dhënien e Recensionit pozitiv ndërsa tani në botimin tjetër MMM ('98) keni gabuar akoma më shumë me dhënien e Recensionit pozitiv'!(Çfarë motivi e detyroi atëbotë në kohë lufte dhe në Kosovë, ish Akademikun e Matematikës të shprehet me aq smirë, në mënyrë aq mohuese, mbase për këtë libër Universiteti i Prishtinës kishte bërë pjesëmarrje në gjysmën e mjeteve financiare për ta botuar, për studentët e tri fakulteteve në mesin e tyre edhe për FSHMN aty ku punonte ai. Mos vallë kishte parë ëndrra, që në të ardhmen mund t'i rrezikohet 'postit')?!

Akademiku i vjetër emri i të cilit figuronte në gjashtëdhjetë e tre libra (si autor, koautor dhe recensent thoshte): '*Libri është pranuar si Tekst Bazik për FSHMN- Dega e Matematikës* aty ku je edhe ti i punësuar! ***Libër të Matematikës mund të shkruaj unë, ti dhe ti*** (tre veta akademikësh debatonin!) ***por Libër të Metodikës çfarë ishte MMM ('98) nuk do dija ta shkruaja as Unë, as Ti dhe as Ti!*** Përgjigje e çiltër, e sinqertë, objektive, pa hile dhe pa interes. Në gjuhën e Akademikut fizikan, kjo ishte 'përkthyer' kështu: '*Unë, Ti dhe Ti dimë t'i punojmë arat tona sepse si ne veprojnë edhe të tjerët' por 'të punosh arën e cila shtrihet në beton, këtë nuk kisha ditur as Unë, as Ti dhe as Ti'!* Që nga çasti i futjes së titujve shkencorë në xhep, matematikanët tanë lidhur me MMM nuk kishin mbetur as për peng as për dorëzanë.

Rreshtat vijues i përkasin një ngjarjeje të transmetuar nga RTP e kohës, para viteve ('90), ku të pranishëm ishin 'aktorët e ngjarjes'! Para tandemit Akademikësh, 'nga dy trupa të një koke' u shfaq një

‘fenomen i rrallë matematikorë’! I riu shqiptar donte ta regjistronte FSHMN-Degën e Matematikës por pa Shkollim të Mesëm të kryer! Duke qenë Shef Katedre, i riu i talentuar ishte refuzuar. Pas disa ankesave në Rektoratin e UP, regjistrimi kishte ndodhur! Po ky student tregoi rezultate të shkëlqyera në Shkencën e Matematikës duke diplomuar në afatin rekord! Më pas Magjistraturën dhe Doktoratën e ka mbrojtur në Francë dhe para disa vitesh në po atë vend një kohë ka qenë dhe Ambasador i Kosovës! Përgjatë viteve (1960-1970) kishte raste të panumërta tek ne që kandidatët pa e kryer shkollën e mesme (nëpërmjet provimeve pranuese të organizuara me komisione) kualifikoheshin për ta regjistruar fakultetin! Në rast kalueshmërie për çudi te të tjerëve që vështronin për anash, shkollimi superior i tyre ishte i suksesshëm, ata ishin shndërruar në poetë e shkrimtarë; mësuese e gazetarë; piktorë e skulptorë; regjisorë e artistë...

Për botimin e librit MMM ('98) dedikuar tri institucioneve të larta arsimore (SHLP; FSHMN dhe Fakultetit Filozofik), Universiteti I Prishtinës (UP) i *'burgosur'* kishte pjesëmarrje në gjysmën e shpenzimeve, duke dhënë shumë prej njëmijë e gjashtëqind DM të kohës (në dy këste nga tetëqind DM). Për autorin ato para, në kohën (mjerimit e skamjes) kur u dhanë dhe rrethanat (fshehtas) kur u pranuan, ishin të stolisura si një *MIRËNJOHJE HISTORIKE*, e paharruar dhe jashtëzakonisht e vlershme, meqenëse nga ai fond parash nuk përfitoi çdo autor libri universitar! Ishte një mirënjohje madhore e bashkangjitur me një shpërblim për një vepër karriere të autorit!

Libri MMM ('98) doli nga shtypi me 21 shkurt ('98), në rrethana lufte këtu tek ne, ku patrullat policore ishin shumëfishuar në *'Qytetin pa lum'*, aty ku u shtyp libri. Për bartje të pesëqind kopjeve nga shtypshkronja për në shpinë e kunatit, shoferi është dashur të planifikojë nëpër cilat rrugë nuk bën të kalohet dhe të zgjedhë cilat rrugë janë më pak të rrezikshme?! Libri ishte magazinuar në *'Qytetin pa lum'*, në bodrumin e kunatit, të cilit për jetë të jetëve i mbetet borxhli moral për faktin që 'librat ishin mall kaçak me rrezikshmëri të përhershme'! Gjatë çdo udhëtimi për në vendlindje, ai nuk e kishte guximin për të bartë më shumë se dhjetë kopje libri. Post-bloqet policore të instaluara nëpër rrugët e Shqipeve ishin të shpeshta me kontrollime më rigoroze se nëpër dogana! Mundësia për t'u zhdukur si udhëtar ishte e madhe! Autori në parathënie të këtij libri haptas e kishte sfiduar *'Pushtetin e Dhunës'* por vetë nuk i di përse vdekja nuk i erdhi! Me vepra tregojë që pakrahasueshëm me shumicën e mësimeve të tjerë të UP sakrifikojë shumë, të thuash gjithçka për ekzistencën e shkollës shqipe!

Ja çfarë 'trimërie të dokumentuar' si 'person i pa sherr' kishte shfaqur atëbotë! Në faqen nëntë të librit ishte shkruar: *'Në harkun kohor ndërmjet botimit të parë dhe atij të dytë (1987-1997), këtu tek ne në Kosovë u shfaqën dhe u realizuan ecuri dhe rrjedha shkatërrimtare të Arsimit Kombëtar në të gjitha nivelet. Falë ngulmimit dhe durimit të paepur gjithë-popullor, sakrificave mbinjerëzore edhe të vetë personelit arsimor deri në vetëflim, PËR TA RUAJTUR SHKOLLËN SHQIPE me çdo kusht, AJO MBIJETOI'. Ai e mbron mendimin dhe vlerësimin 'kjo ishte një thirrje që i është bërë vdekjes'!* Atëbotë, ata që ikën për në Perëndim, me gjasë shpëtuan edhe kokën, si ai i Parlamentit, që sot 'në shitje' ka nxjerrë edhe shkencën! Por sikur të gjithë mësuesit e asaj kohe, 'me grada' dhe 'pa grada' të iknin, sot do mbetnim pa shkollë pa shkollim dhe pa parlament, sikurse në Çeçeni!!

Ja çfarë kishte shkruar gazetari i vendlindjes Z.H. në "Bujkun" e datës. 14 mars '98, "Në kuadër të përpjekjeve të gjithanshme për t'u bërë ballë sfidave shkatërrimtare të Arsimit kombëtar shqiptar në Kosovë, botimi i çdo libri me vlera të mirëfillta shkencore dhe shoqërore, padyshim se shënon një

kontribut të çmueshëm në vazhden e mbijetesës së shkollës sonë. Në këtë vështrim do të duhej të vlerësohet edhe teksti universitar i Safir Kromit: “Metodika e mësimdhënies së matematikës...”

Vlerën e librit MMM ('98) ai e kuptoi me të arritur në shtetin amë si refugjat, (2.prill. 1999) kur me vete kishte marrë një kopje të tij. Në FSHMN-Dega e Matematikës në Tiranë, *librin e kontrolluan, e vlerësuan dhe e fotokopjuan!* Libri i ndreqi punë, duke ia siguruar vendin në Këshillin e mësuesve shqiptarë, që ligjëronin për mësuesit refugjatë nga Kosova të ndodhur në kryeqytet, për të cilën punë fitoi treqind DM, në kohën kur mësuesit refugjatë ishin shndërruar në ‘kufoma të gjalla’ me fry marrje!

Botimi i këtij libri universitar, me shumë vlerë nuk kishte ardhur në ‘kohën e vet’ dhe koha e tij ishte në ikje! Vlera dhe cilësia e lartë e tij e pa dritën shumë vonë, në fund të shekullit njëzetë, kohë kur Mësimdhënia tradicionale do duhej të jetë në grahmat e fundit të zbatimit. Kjo bëri që libri të bie ndesh me arritjet e mëdha në procesin e Mësimdhënies dhe Mësim-nxënies të cilat i kishte *zbuluar* dhe *artikulluar* Arsimi i përparuar Perëndimor dhe kjo në vitet: ('69); ('78); ('82); ('84); ('85); ('86); ('87); ('90); ('92); ('97) dhe ('98) si *Teknika dhe Strategji të Zhvillimit të Mendimit Kritik!*

Në librin e Gjeografisë në kohën kur Safiri ishte maturant, shkruante: “Do jetë çështje e kohës kur do të zbulohet *telefonja pa tela*”! Nga koha kur u lexua ai rresht, kaluan vetëm katër vite dhe në gusht të vitit ('69) këmba e njeriut shkeli në Hënë! Nga ai çast historik për mbarë njerëzimin, *filloi Evolucionin madhështorë shkencor- teknik-teknologjik edhe në lëmin e Arsimit*, risi me të cilat u njohëm tri dekada më pas, të mbështetura në këto premisa:

I Askush nuk mund të mësojë e të dijë gjithçka që i duhet në jetë!

II Mësuesi nuk mund ta mësojë nxënësin për gjithçka që i duhet në jetë!

III Nxënësi vetë-vlerëson çfarë më mëson mësuesi im nuk mjafton!

IV Lindi domosdoshmëria për vetë-arsimim gjatë tërë jetës, nëpërmjet mësim-nxënies!

V Nxënësi e pranon rolin e mësuesit! Ai që mëson të tjerët, mëson më shumë se ai që mësohet!

VI Ai që shkruan, mëson më shumë se ai që lexon!

VII Nxënësi ndërton kuptimin e tekstit, por nuk i përsëritë fjalët e tekstit!

Sa më herët ta kuptojmë trendin e ri në mësimdhënie së bashku me mësim-nxënie, aq më shpejtë dhe më lartë do gjendemi në ranglistën e vendeve me arsim të përparuar ku aktualisht jemi ndër të fundit në botë! Rezultatet në PISA janë zhgënjyese por edhe të pritshme nga politizimi i shkollës sonë kombëtare! Testet ishin digjitale dhe mjaft të vështira për mënyrën si punohet në shkollat tona!

XIII. BOTIMI I LIBRIT TË KATËRT, METODIKË E MËSIMIT ELEMENTARË TË MATEMATIKËS (2003)

Libri MMM (2003) si dorëshkrim përfundoi në verën e vitit ('98) atëherë kur nga kodra e Çabratit granat-hedhësit bënin kërdi në Rekë të Keqe, luftohej edhe në Glllogjan e Dushkajë dhe për çudi matematikani i vonuar shkruante shkencë, ishte tjetërsuar! Nga kontrolli policor nëpër qytet mundësia për ta fotokopjuar dorëshkrimin nuk ekzistonte! Është për t'u çuditur në guximin e tij për të udhëtuar për në 'Qytetin e Urave' dy ditë në javë, në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm pranë SHLP-së deri pesë ditë para bombardimeve të NATO-s, kur autobusët bartnin tre-katër udhëtarë! Për ta futur trishtimin tek udhëtarët e rastit, Safiri nga autobusi kishte shikuar të masakruarit e fshatit Rugovë e Hasit, të cilët çetat e armatosura serbo-ruse i kishin ekspozuar buzë rrugës kryesore: 'Qyteti i 4 lumenjëve'- 'Qyteti i Urave'.

Dorëshkrimi i librit MMM (2003) u krijua në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme, kohë lufte me granatime fshattrash; dyndje fshatarësh për në qytet; rreshta për ta blerë vetëm një bukë! Shpia ku dorëshkrimi sajohej ishte vetëm një kilometër vijë ajrore nga trualli ku minahedhësit gjuanin predha për në Rekë të keqe, kohë kur nuk dihej kush do ta përjetojë dhe gëzojë lirinë! Dorëshkrimi edhe i krijuar (pa mundësi fotokopjimi) ishte në rrezik të humbas! Gjasat për të humbur autori dhe familjarët e tij, ishin të barabarta me humbje të dorëshkrimit! Autori dhe familjarët e tij ikën për në Shtetin amë ndërsa dorëshkrimi kishte mbetur 'roje shpie' i 'maskuar' në centrifugën e mjaltit në bodrum shpie, në të cilin hajnat nuk kishin mundur të hynin! Pak çaste para ikjes, të futurit e dorëshkrimit në centrifugën e mjaltit ishte ide e papjekur, por fati ishte në anën e autorit dhe ai 'mbijetojë'; po të merrej centrifuga, atë do ta flaknin si diç e pa vlerë!

Më 2. Prill. '99. së bashku me dhjetëra mijë qytetarë tjerë me familje për ta shpëtuar kokën, iku nga vendlindja me dhimbje të madhe, për t'u strehuar në Shqipëri (nëpër *Qafë Prush -Letaj-Krumë-Tiranë*) duke e lënë Dorëshkrimin e librit MEMEM (2003) të vendosur në bodrum, çelësin e të cilit ia humbi, me gjasa reale të pakta që do mbijetojë Dorëshkrimi dhe autori i saj! Ndodhi kështu në momentin e fundit para ikjes, sepse i hamendshëm donte ta merrte me veti! Libri MEMEM (2003) ishte një llotari njerëzore duke mbijetuar dorëshkrimi bashkë me autorin e tij. Dorëshkrimi ishte i rrezikuar skajshëm, kur 'ai mbeti i vetmuar për t'ia ruajtur shpinë' ndërsa i zoti me familje ikën për në shtetin amë.

E përcjell me tronditje të forta shpirtërore ishte nisja për në Shqipëri në cilësinë e refugjatit bashkë me disa dhjetëra mija njerëz, të gjithë në këmbë: pleqë; plaka; të sëmurë; shtatzëna; fëmijë të cilët nuk kishin mbushur ende njëvjetorin e lindjes; të rinj në karroca të maskuar nga ndonjë plagosje me armë zjarri; turma njerëzish me nga një shportë në dorë dy-tri kilogramshe të cilët për ta shpëtuar kokën, kishin lënë prapa tërë pasurinë e tundshme dhe të patundshme, tërë 'luksin e jetës', si ta kishte vlerën e një pako duhani! E dhimbshme, trishtuese dhe pikëlluese për personat e moshës 50-të e më mëçëm ishte kjo dyndje në kohë lufte së cilës nuk i dihej si do të përfundojë! (Nga goja e popullit është thënë: "Mençuria fitohet deri tek të tridhjetat ndërsa pasuria (mirëqenia) deri tek të dyzetat")! Rrugës vajtohej me të madhe me kukatje nga gjinia femërore dhe fëmijët për më të dashurit e tyre, për njerëzit e vrarë natën e fundit; për njerëzit gati të humbur në të gjallë, të cilët ishin larguar në heshtje duke mos lënë asnjë gjurmë, nuk u dihej ku ndodheshin bashkëshorti apo bashkëshortja, të cilët disa ditë para ikjes për në Shqipëri për 'çështje sigurie' ishin ndarë në dy vendqëndrime familjare! Vajtohej edhe për fundin tragjik të gjithsecilit i cili po trokiste në derë! Më parë ishin edhe disa ditë të tjera e ikjeve nga 'Qyteti i katër lumenjëve' për në Shqipëri, me makina dhe autobusë (nëpër 'Qytetin e Urave' drejt Morinës dhe Kukësit) por më 2 prill ndodhi shpërngulja masive e popullësisë drejt shtetit amë.

Pas masakrës që ndodhi në mëhallën e tyre (natën midis 27 dhe 28 marsit '99) kur gjashtë frymë njerëzish, katër të rritur dhe dy fëmijë të ngjuar në bodrumin pa derëdalje (vrasjet dhe djegëjet filluan vonë, pak para orës 24), pritnin vdekjen, por ajo nuk erdhi edhe pse ishte larg vetëm 100 metra. Të nesërmen sapo zbardhi dita, + Safiri dhe mysafirët morën qëndrim vendosjeje në banesën e zbrazët të një kunati (rrugën kryesore të qytetit). Me vete morën pak ushqim dhe tranzistorin, me të cilin dëgjonin lajmet e stisura të Regjimit Racist Antishqiptar të lexuara nga shqipfolës sllavë ku citoreshin 'vrasjet e personave të njohur publik me reputacion', pjesë e madhe e të cilëve asnjë e ligë nuk i ka gjetur! Aty tri familje me gjithsej dhjetë veta qëndruan pesë ditë. Puna e paramilitarëve serbo-rusë bashkë me policinë vendore të dehur dhe të droguar, aksionin e djegëjes së shtëpive dhe vrasjen e njerëzve të pafajshëm (të pa armatosur) e fillonin nga ora 22; e më rrallë paksa më vonë, sipas regjistrit të tyre mbështetur në "Planin Patkoi": Paskanikët; biznesmenët dhe intelektualët më në zë që kishte lokaliteti; argjentarë; mjekë; këmbysesë valutash; biznesmenë të cilët plasonin prodhimet serbe në tregun kosovar dhe kurrështarët të cilët donin të vëzhgonin se çfarë po ndodhë?! Këta të fundit nuk e kuptonin që Çetat e armatosura sllave donin ta bënin 'prodhimin' pa dëshmitarë! Natën, me të rënë muzgu dritat duhej të ishin të fikura për të treguar që aty nuk frymon jetë njeriu. Kur dinin që personi ka pasuri në mjete valutore, fillimisht e plaçkitnin; nëse tregojë 'koprrac' duke u thënë nuk kam çfarë të jap, atë e vrisnin në çast në prani të familjarëve dhe iknin; po qe se ishin të kënaqur me sasinë e të hollave të plaçkitura ia falnin jetën me kusht që viktima të deklarohet (me bindje) që nuk i njeh ata persona! Në të kundërtën u merreshin të gjitha kursimet jetësore dhe po qe se identifikojë nga viktima se kush ishte, atëherë atij i merrej edhe jeta! Të gjitha këto storie ishin të vërteta, të treguara nga familjarët e viktimave menjëherë pas Luftës në 'Qytetin e larë nga gjaku' i cili ishte më i dëmtuari në njerëz në nivel vendi ku serbët vendas u dinin shqiptarëve edhe 'lugët në krojshe'!

Natën midis 1 dhe 2 prillit '99 në afërsi të Stacionit të Autobusëve të qytetit ishin vlarë pastaj edhe djegë trupat e anëtarëve të katër-pesë familjeve, të tubuara në një shtëpi, komshinj me një familje serbe, i cili i kishte këshilluar dhe porosur si të veprojnë, dhe në po atë shtëpi do jetë vendi më i sigurt për ata! Të gjitha viktimat ishin gra, në mesin e tyre dhe mësuese, fëmijë të moshave të vogla nga dy vjeç, vajza të moshave të reja, ku për çudi por fatmirësisht vetëm një djalë ka mbijetuar! Gjatë tërë natës krisma armësh kishte edhe në pjesët tjera të qytetit dhe mendohej që ishin vlarë më shumë se 50 veta, të gjithë persona të pa armatosur. Masakra, ullahtaria dhe gjenocidi i ndodhur atë natë në nivel qyteti, bëri që në tre-katër ditët vijuese të iknin drejt Shqipërisë më shumë 40 mijë qytetarë dhe porosia e ish –Presidentit nga LDK 'për ta ruajtur pragun e shpisë' doli të jetë një lajthitje e madhe!

Pamje të trishtueshme me atmosferë vdekjeje ishte nisja për në Shqipëri e një lumi të paparë njerëzish me disa dhjetëra mija njerëz, të gjithë me ecje në këmbë; pleqë, plaka, të sëmurë (bile edhe të plagosur e të maskuar e me dializë), shtatëzëna, fëmijë të moshave parashkollore, të rinj dhe të reja të cilët ishin të rrezikuar më shumë se të tjerët! Turma njerëzish bartnin nga një shportë në dorë me peshë dy-tre kilogramëshe, shkurt ishte pamje e një funerali njerëzish të cilët nuk dinin a do kthehen të gjallë apo të plagosur apo edhe të vdekur për t'u varrosur jashtë vendlindjes apo do ikin jashtë Europës. Rrugës vajtohej me të madhe për njerëzit e vet të dashur, të cilët i kishin humbur në të gjallë apo në të vdekur, me lidhje ndërfamiljare të humbura, kishte shumë njerëz të humbur, të zhdukur apo edhe të gjallë por të strehuar në vende sekrete për të cilat as familjarët e sofrës nuk kishin informacione ku ndodhën!

Atmosferë varri ishte kur filluan të ecnin rrugës drejt Çarshisë së Madhe, vargu i dyqaneve dhe shpive njëra pas tjetrës të bërë shkrumë e hi; me minahedhës ishte shembur Minarja e Xhamisë Hadum me të cilën nisë themelimi i qytetit; shtyllat telefonike dhe ato të dritave ishin rrëzuar përtokë dhe kalimi nëpër Çarshi të Madhe ishte bërë ‘me pengesa’ dhe pleqë e fëmijë mezi gjenin shtegun për të kaluar.

Pas tre kilometra ecjeje arritëm në pozicionin ku rruga e rrafshët shndërrohej në pjerrësi të madhe dhe befasi turma si të ishte ‘kafshë me dy këmbë’ ndalon! Atje poshtë në tatëpjetë përtej ‘Urës së Tabakut’ mbi lumin Erenik vërehej Togu i Policisë, disa prej të cilëve ishin të uniformuar ndërsa disa të tjerë të veshur me rroba civile. Fillimisht askush nga turma nuk mori guxim për të ecur mëtej në drejtim të Punktit të Policisë serbe! Pas pesë minutash Policia fillojë të jepë shenja me dorë; Ejani po u presim! Dhe njerëzit e turmës filluan ‘ta bluajnë me kokën e tyre’, se çfarë mund t’i ndodhë secilit veç e veç. Safiri me familjarë ishin ndër të parët e turmës duke ecur me ‘hapa të breshkës’, akoma më të vegjël, tamam sikurse ‘Cjapi kur të shkojë tek Kasapi’ duke u dhënë përparësi disa qindësheve njerëzore të kalonin para tyre.

Vendi i ndalesës ishte udhëkryqi (njëra rrugë të shpiente për Ponohec e Molliq ndërsa tjetra për Qafa e Prushit (Kufiri Kosovë-Shqipëri). Ndalua për dy-tri minuta, për t’i dorëzuar Kartat e Identitetit, me Urdhëresën shtesë, kush e ka Pasaportën edhe atë me e dorëzuar! E përkthyer kjo do thoshte: Turma njerëzore si kjo dhe të tjerat që do ikin të ‘përhëndetën me Kosovën’ sepse ky vend është Serbi! Pikë. Ato çaste nuk u vërejtën skena pengese, ndalese a veçimi të ndonjë personi apo grupi njerëzish, tashmë të shndërruara në ‘kufoma të gjalla’. Vijuam udhën për në Qafë-Prush, majtas.

Rruga deri në kufi numëronte nëntë kilometra dhe filluam ecjen për të na dhënë një pushim pas pesë kilometrash. Aty në një lëndinë livadhi shumë të madh kishin mbërritur dymbëdhjetë orë më parë, një turmë e madhe njerëzore, disa mija, me gjasë të fshatërave përreth apo edhe më larg të cilët ishin në pritje të një urdhëri të dytë për ecje dhe largim nga aty! Frika ishte e pranishme, veçmas për familjarët e të rinjëve, me moshë djalërie si ai i Safirit. Ku ndodhej arsyeja, ata të prisnin këtu? (Kohë lufte dhe bombardimet nga NATO-ja tashmë kishin filluar! Ndalese mund të paramendohej si një ugrur i zi për të gjithë njerëzit e ndodhur në atë rrethim në pritje të një urdhëri të ri (tamam siç ndodhi më vonë në Masakrën e Mejës)! Ai tubim aq i madh njerëzor konsiderohej ‘lloj pengu’; në ndërkohë po qe se nga ana e ndonji të çmenduri vritet një serb, atëherë të ekzekutohen njëmijë shqiptarë! Kjo ishte moto e veprimit gjenocidal shtetëror. Turmën e gjetur aty, e kishin ndaluar mos të ecnin drejt kufirit, me qëllimin e caktuar të tyre; me gjasë nga masa e madhe njerëzore mund të krijohet ndonjë reagim, kundërshtim apo edhe ekces dhe më pas të fillojë ploja dhe masakra gjithëpërfshirëse mbi grupimin e madh njerëzor! Një polic i hipur në kalë në cilësinë e kalorësit shëtitej nga një grupacion personash tek tjetri, vështronte dhe vëzhgonte duke mos dëgjuar asnjë zë, heshtje varri; të gjithë trupin dhe kokën e kishin të ulur, me shikim në tokë! Pritja në atë livadh kishte zgjatur më shumë se një orë dhe arriti urdhëri i rinj që mund të ecin, bile kush dëshirojë nga të moshuarit, gratë dhe fëmijët, për pjesën e mbetur të rrugës (tre kilometërshë) u bartën me disa traktorë!

Safiri ‘veten e tij e vlerësonte me faj’ sepse siç thoshin të tjerët, bile edhe nxënësit (të cilët flasin pa hile) i ngjasonte shumë liderit historik kosovar. Flokët e tija kishin katër muaj që nuk ishin qethur, ajo ishte bërë ‘luks’; atë ditë vetëm kollarja i mungonte! Me kohë ishte pajisur me kapele dhe atë e kishte vuar në kokë që nga dalja prej shpie. Përgjatë ecjes, shiqimin fund e krye e kishte në drejtim të tokës!

Pas dridhjeve të para kur dorëzuan Kartat e Identitetit (posaçërisht për djalin) do pasojnë edhe dy dridhje të tjera. Aty afër para se të arrijnë në kufi, buzë rrugës ishte vendosur një batalion ushtarak i armatosur, shtrirë në Tokë të cilët vështronin (dyndjen sikurse nëpër filma) dhe pushonin. Askush nuk shikonte për anash. Safirit me kapele në kokë me shikim drejt këmbëve të veta nuk i ndodhi asgjë, por në gjendjen shëndetësore që gjendej [ditë më parë nga ankthi i mbijetesës familjare bëri mos të dëgjonte gati asgjë për atë se çfarë flitej në rrethin familjarë, kanalet e veshëve të tij ishin mbushur plot e përplot me dyllë si asnjëherë tjetër më parë përgjatë jetës, të cilët i pastrojë ‘mekanikisht’ me grep (kanxhë) mjekësore me të arritur në Shtetin amë], ishte trishtuar me prezencën e numrit të ushtarëve!

Dhe e fundit, njëzetë metra larg nga vija kufitare ndodhej turma e njerëzve, aty ku printe Safiri me familjarët e tij. Filloi ndalesa e cila zgjati më shumë se një orë! Filluan të rrahurat e përsheptuara të zemrës së tij. Ai e ‘lexoi’ situatën kundër të tij. Një Ish- nxënës i tij i përjashtuar nga shkolla para tridhjetë viteve, për një ekces drejtuar kundër personit tij do duhej t’ ishte në detyrën e policit doganier! Ndoshta nga Ura e Tabakut ishte telefonuar prania e Safirit në këtë dyndje të madhe njerëzore. Ndalesa ishte plot me domethënie para se gjithash ishte e frikshme për mos me u harruar kurrë, por pa epilog hakmarrës! Kufiri Kosovë-Shqipëri në Qafa e Prushit, me lot në sy u kalua në buzëmbremje pak minuta para se të errësohej, duke u ngjitur përpjetë nëpër një rrëpirë bregoreje dhjetëmetërshe, atëherë kur filluan të bien edhe rigat e para të shiut, shenja që edhe qielli po qante për këtë largim të dhunshëm në të gjallë nga vatrat stërgjyshore, aty ku ishin dembabadem shumë mote para Erës së Re!

Matanë kufirit dolën në rrafsh duke e shpëtuar kokën familjarët e afërt ku pas dyqindë metrave një nënbashkësi familjare ktheu në të djathtë dhe mori rrugën për në Shkodër ndërsa të tjerët vazhduan rrugën në të majtë edhe për një kilometër për t’i pritur vëllazërit e tyre në një godinë fshati Letaj!

Në ndërkohë pas disa orë pushimi nën strehë, ku shumë veta kërkonin edhe ndihmën e mjekëve, të cilët ishin prezentë aty, e thirra djalin të dilnim jashtë dhe ta zhvillonim një bisedë: Djali im Ideal, fati jetësor i yt por edhe i familjes së ngushtë ndërlihet me qëndrimin personal tënd të cilin duhet me marrë që tani; dy rrugë i ke; a dëshiron të jetosh në Shqipëri dhe këtu ta vazhdosh Semestrin e dytë të Fakultetit të Mjekësisë apo dëshiron të jetosh në një shtet të Europës Perëndimore dhe të mbetesh i pashkolluar?! Kjo për arsye sepse unë duhet ta di; A do të vendosemi në Tiranë apo në Durrës? Vendosi në të dytin ofron shansë ikjeje të përsheptuar për në Perëndim, qoftë dhe në drejtim SHBA apo KANADA ndërsa për Tiranën u kuptua vetiu të presin studimet në Mjekësi, qoftë dhe me humbje të këtij viti akademik! (Dhe lotët rridhnin rreke të cilët i fshinim me duar)! Pa u hamundur për asnjë çast Ideali ma ktheu: ‘Babë unë dëshirojë të shkollohem’! Atëherë faliminderit shumë djali im, ma hoqe një prej shqetësimeve më problemore aktuale.

E bija e vëllait më të madh me familje deri në mesnatë nuk kishte mbërrijë në atë pikë qëndrimi. Vëllai e këshilloi Safirin me familje të nisen për në Krumë në mesnatë bashkë me familjet e dy fqinjëve, të bartur nga një kamionetë ku u vendosën diç më pak se njëzetë veta. Gjatë tërë rrugës binin riga shiu dhe trupat e emigrantëve kosovarë ‘shkundeshin’, herë në të majtë dhe herë në të djathtë, sepse rruga Letaj-Krumë ishte ‘udhë dhish’, me kodra e kodrina dhe askund udhë rrafshi. *Ishin me shumë fat që në atë mesnatë nuk u rrukullisën për ta gjetur vdekjen që natën e parë!* Ky rrugëtim ishte pa pagesë! Me të

zbardhur drita, të nesërmen nga Xhamia e Krumës ku pushuan tre orë nëpërmjet një kombibusi tetë udhëtarësh u nisën për në Tiranë, për të cilën vajtje u paguan treqind marka të kohës.

Përgjatë qëndrimit tre mujor në Tiranë çdo gjësend përreth tij dhe më larg (shtëpia) e kishin përhumur vlerën, rëndësinë dhe funksionin. Ankthi për dorëshkrimin ishte dhe mbeti i madh, por edhe rritej, meqenëse druante që nuk do dijë kurrësi ta (ri)shkruante në të ardhmen nëse mbetet gjallë edhe njëlloj të ngjashëm! Loti i pikon, sa herë që i rilexon këta rreshta!

Në fund të muajit të Qershive të hënën e fundit të tij, në kujtesën e Safirit mbetet dita më e lumturuar në jetë! Ishte koha kur çdo person i rritur ka qarë dhe dënesur si fëmija, me lot dhimbjeje dhe pikëllimi; shprese dhe gëzimi; për të afërmit dhe të njohurit dhe për qenien shqiptare në përgjithësi. Për 'të gjallët' përfundoi 'statusi i refugjatit', për t'ia filluar jetës nga fillimi; me disa fotografi; *një transistor në dorë; me një orë muri dhe një paketë me hurme* si ndihma humanitare emergjente, të dhuruara nga vendet mike të Kosovës! Pasuria tjetër me gjësende, të thuash ishte plaçkitur dhe vjedhur!

Megjithatë, fati shumë i madh ishte në anën e Safirit, familjarët e tij e shpëtuan kokën dhe trupin dhe *Dorëshkrimi MEMEM (2003) kishte mbijetuar (i fshehur në centrifugën e mjalit)!*

Stafi i Recensentëve të Dorëshkrimit pas punës tre mujore, ofruan *Vlerësimin e tyre pozitiv*, në fund të vitit dymijë ku në mes tjerash shkruanin: "Teksti do të plotësojë mungesën tepër të madhe që ndihet sot tek ne, për këtë lloj të literaturës didaktike-metodike në gjuhën shqipe. Do të ndihmojë shumë edhe mësuesit e tashëm të matematikës nga praktika e drejtpërdrejt shkollore, për ngritjen e arsimit metodik të tyre, të cilat nuk ishin trajtuar në kohën e përgatitjes e të kualifikimit të tyre. Për këtë arsye kujtojmë se: ***Dorëshkrimi i paraqitur për botim përmban vlera të larta e rëndësi të veçantë dhe ai meriton të botohet si Tekst Bazë e Metodikës së Mësimin Elementar të Matematikës***".

Është paksa e pazakonshme apo thënë ndryshe e zakonshme në kohëra ndërrim epokash, dorëshkrimin edhe pasi u dha 'drita jeshile' për ta botuar (dhjetor, dymijë) ai '*për të mos u plakur para se të botohej*', me vetiniciativë autoriale iu nënshtrua 'rrymës së dytë të ndryshimeve substanciale të kohës, së shekullit të rinj', nën dritën e Zhvillimit të Mendimit Kritik, lidhur me:

-Sistemin e rinj arsimor dhe Kurrikulën e re të Kosovës;

-Përpunimin e teknikave dhe metodave të mësimdhënies dhe mësim-nxënies dhe

-Orën e mësimin, strukturën e saj dhe të mësuarit me objektiva; ***për ta botuar tre vite më vonë, me ndryshimet dhe plotësimet e sipërpërmendura*** (rast unik autorial)!

Asokohe, çfarë dinin Recensentët lidhur me Mësimdhënien bashkëkohëse e cila kishte ardhur tek 'porta e shpisë' por ende pa hyrë përbrenda. Mëqenëse Recensioni pozitiv ishte dhënë (pas katër muajve) në dhjetorin e Vitit 2000, lirisht mund të themi: "Ata nuk dinin ende asgjë"! Me vetiniciativë për shkaqe rrethanash 'Made in Daxner', Safiri largëpamës hoqi dorë nga botimi i menjëherëshëm i M M M (2003); për t'u ballafaquar me më rejtat e procesit të mësimdhënies

Më pas, Recensentët ishin të befasuar për të mirë, Recensioni i tyre dhënë tre vite më parë doli paksa formal (duke e lënë autorin ndoshta edhe të pakënaqur)! Ai me vetiniciativë përgjatë tri viteve të

ardhshëm (2000-2003), nën dritën e Zhvillimit të Mendimit kritik, e përpunoi Sistemin e rinj arsimor dhe Kurrikulin e rinj të Kosovës; Teknikat dhe Metodatat e mësimdhënies; Orën e mësimi dhe strukturën e saj, Objektivat mësimorë dhe klasifikimin i tyre; Mësimin Tematik; Mësimin Elementar të Matematikës dhe refleksionet e tij me rrezatim moral; Pavarësia e M M M nga Pedagogjia (në Kosovë), si shkencë e mëvetësishme; Zhvillimi i Mendimit Kritik; ofroi një numër të konsiderueshëm përkufizimesh, të sajuara si ‘prodhim autorial’ në origjinale dhe risi të ngjashme.

Përmbajtja e librit M M E M (2003) ka mbetur nën hije, e pa komentuar dhe ndriçuar si duhej, përndryshe ishte një punë vëllimore, hulumtuese, krijuese, autoriale disa vjeçare, tamam si të shkruhej një libër tjetër plotësisht i rinj dhe i ndryshëm nga botimi i parë MMEM(1993) për të cilin nëpër shkollat fillore të Kosovës u shfaqë interesim i madh, gjë që dëshmoi shitja e pesëqind kopjeve në afat rekord, përgjatë tetëmbëdhjetë muajve!

Në fund të librit ishte përfshirë e ashtuquajtura **Shtesë** pesë faqesh lidhur me **Metodologjia e Programit (Step-By-Step; Hap Pas Hapi)**, e cila në Kosovë filloi të zbatohet në vitin shkollor 2001/02 në 25 paralele të klasave të para të shkollës fillore (I-V). Në vitin shkollor 2003/04 kanë funksionuar afro 100 paralele me program H p H. Duhet theksuar që zbatimi i kësaj Metodologjie ishte i kushtueshëm dhe kjo kapte një kosto të madhe financiare.

Në truallin tonë e mbollëm farën e Programit H p H për shkollën fillore (I-V), mirëpo kjo farë nuk doli të jetë e frytshme! Praktika shkollore bashkëkohëse e shekullit 21, tek ne ende ndodhet në fazën eksperimentuese dhe ajo kërkon përkujdesje dhe trajtim të vazhdueshëm. Duhet formuar mekanizmat, për ta modifikuar, kontrolluar dhe vlerësuar një praktikë deri në mospranim, me gjasë të asaj praktike!

Menjëherë pas luftës në Kosovë, ndodhi **‘kthesa kundër-universitare’!** Personeli udhëheqës i UP **dhanë dorëheqje** prej zorit, ishin ata të cilët me guxim e trimëri dolën para tankeve, në mbrojtje shkolle dhe shkollimit shqip të ‘burgosur’! Për kohën dhe rrethanat kur ndodhi ‘kthesa’, poeti shkroi:

U nxi koha, u zu Dielli;

Lot të zjarrtë lëshonte qielli!

Një aforizëm i moçëm vlerësohej shumë: *‘Nuk është mirë të ndërrohen kuajt e karrocës që gjendet në mes të lumit dhe në mes të dimrit’!* Ish udhëheqja kaloi në kujtesën historike të brezave, për faktin se ata edhe në ditët kur luftohej për ekzistencën e UP, *dinin të flisnin, të shkruanin dhe të vepronin* përkundër *‘kamxhikut të përditshëm’ i cili shpesh iu ‘ledhatoi trupin’*, vepra jetësore e të cilëve mbetet një peng nderimi i përjetshëm nga personat e shkolluar a partiak! Partitë politike të të gjitha krahëve synuan kontrollin mbi Universitetin për interesa shumë pragmatike; të regjistronjë studentë ke të duan dhe sa të duan; të ndajnë diploma dhe tituj shkencor pa asnjë kriter; të bëjnë avancime në tituj shkencor e profesional sipas përkatësive politike; të zgjedhin e të zgjidhën dekanë e senatorë, po sipas kësaj përkatësie!

Po qe se analizojmë rrjedhat e UP pas vitit dymijë kur nëpërmjet **kthesës** ishte instaluar ‘mendësi jodemokratike’, rëndësi përcaktuese kishte ‘administratori’ i jashtëm në cilësinë e Pashait, qëndrimet dhe veprimet e të cilit ishin të mirënjohura, si të porositura; antishkencore dhe antikombëtare:

“Humbje e vendeve të punës për një numër të konsiderueshëm të mësimitdhënësve”, ishte një nga pjesët e Reformës (Koha Ditore, 02. 05. 2000)

“Do të largohen nga procesi i mësimitdhënies personat e pakualifikuar” (13.10. 2000).

Ngjashëm kishte vepruar “Pushteti i forcës” në vitet e (’90), ndaj Kuadrit udhëheqës universitarë, të cilëve u mungonte Grada shkencore, si dhe ndaj udhëheqësve tjerë komunal në Kulturë dhe Kulturë fizike pak para pensionimit, të cilëve u mungonte Arsimi superior, me ç’rast fituan trauma vdekjeje!

*Kështu nga të ‘shkruarit e shkencës në libra’ u kalua në ‘pajisje me disertacione’ përndryshe ‘rrezikohej vendi i punës’. Për të qenë situata akoma më e nderë “U nënshkruan 90 vendimet e para për profesorët dhe asistentët që do të shkojnë nga UP (Zëri, 16. 01. 2002)”. Gazeta e vetme e solidarizuar e cila jepte Shpalljen për rrënimin e heshtur të UP, pa asnjë reagim! **Aty në krye të një shtylle faqeje, për largim nga UP figuronte edhe emri i Safir Kromit, i cili përgatiste për botim librin e katërt universitar!** Aty mungonin emrat e pesë profesorëve të tjerë ku punonte, të cilët nuk kishin as grada shkencore, as punime shkencore por as dispensë e lëre më libër të botuar! Drejtoria (**Palaçoja**) e ‘Shkollës së Lartë tek Bunari’ krye pazari, kishte punuar me disa lista emrash! Mësimitdhënës dhe asistentë të cilët kishin punuar me dekada në Universitet (UP) por kishin mbetur pa tituj shkencorë dhe njëkohësisht nuk kishin shkruar së paku një libër universitar (në vigjilje pensionimi ku në mjediset e tyre nuk kishte mbrojtje institucionale) në heshtje ishin larguar nga puna të cilët mëpas i gjeti vdekja e hershme! Saora ia behu **Teknokratizmi** i cili evidentohet e luftohet në Socializëm por atëbotë nuk ekzistonin ‘fabrikat e diplomave’*

Keqpërdoruesi ndiqej edhe penalisht tamam sikurse droga e ditëve tona! Gjithnjë ka pasur persona të cilët kanë jetuar edhe pa diplomë, bile me shumë dinjitet njerëzor! Njerëzit e të gjitha shtresave ishin shumë kureshtarë të dinin diç më tepër për fatin e personave *aksidentalisht të vonuar, të cilët kishin mbetur pa tituj shkencor!* Bile disa haptas e merrnin nëpër gojë Safirin me librat e tija të botuara MMM, përgjatë kohës kur ‘shkolla shqipe ishte e burgosur’; duke shfaqur ‘keqardhje’! Ata nuk dinin që në trevat mbarëshqiptare (Shqipëri dhe Kosovë) nuk kishte kuadro të mirëfillta matematikanësh me kompetencë nga MMM, para të cilëve Safiri mund t’i mbronte dituritë e tija, ndërsa ai dhe disa të tjerë ishin vetë shkenca; për të cilët nuk ekzistonte as interesimi; as interesi kombëtar as dëshira por as vullneti i matematikanëve *më në zë që kishte vendi*, për ta njohur e vlerësuar angazhimin dhe punën e tij, për ta shpërblyer për aq sa e njihnin njerëzit dhe për aq sa e meritonte! Kishte denigrime, insinuata, dyshime, fajësime, shpifje, trillime, qëndrime e sjellje prej ziliqarësh e bajraktarësh, të cilëve u kishte humbur bishtpena qëmoti, për të shkruar vetë ose fëmijët e tyre; jetonin dhe punonin ‘me famën’ dhe ‘për famën’ e dikurshme pa arsye, vetëm për të tanishmen e aspak për të ardhmen e tyre dhe të tjerëve!

“Fenomeni i të shkruarit për llogari të tjetërkujt nga letërsia është përhapur në memoare, madje edhe në Tema Magjistrature dhe Disertacionesh” (Koha Ditore, 16.05.2005).

Plagjiaturat janë të përhapura kudo në botë në vendet demokratike, bile dhe në Perëndimin e përparuar! Atje po ndodhi me të zbuluar qoftë ai edhe Ministër Qeverie, menjëherë jep dorëheqje nga funksioni, dorëzon titullin shkencor dhe karriera e tij merr fund! Në 'rretën e plagjiaturës' ka rënë dhe një ish nxënës i Safirit me 'përzgjedhje' MMM! I zbuluar nga portali i tij në Internet! Punon normal ka 'pjellë edhe doktorë femra' të tjerë dhe intervistohet në TV! Në mbështetje të zhvillimeve të regjistruara përgjatë njëzetë viteve të fundit në Universitetin e Prishtinës, të gjithë asaj çfarë ka ndodhur dhe të gjithë asaj çfarë është shkruar në shtypin periodik dhe atë të përditshëm, pa asnjë reagim prapa-mohues nga ana e bartësve të funksioneve zyrtare ish-qeveritare dhe ish-universitare, mbetet 'dyshimi i bazuar dhe i mbështetur' që librat e Safirit, edhe pse të mbrojtura me ISBN, kanë qenë (me gjasë) 'lëndë e parë' për këto disertacione! Ata që vijnë pas nesh me gjasë do punojnë për t'i 'zbuluar' plagjiatorët por atëherë i vdekuri i merr të fshehtat në varr e bashkë me këtë dhe titullin shkencor!

Për tu mbrojtur nga fshesa e Hamurabit 'produkt Daxneri', filloi mbrojtja e Disertacioneve si të ishin *Tema Mature* të punuara dhe nga bedelët disa edhe me *Tema të dyshimta* por edhe disa herë të përsëritura, meqenëse u konfirmua nëpërmjet shtypit "Universiteti i Prishtinës" nuk i kontrollon (sepse i ka rënë damlla) "Doktoratat e dyshimta"! (Koha ditore, 27.05. 2005)!

"Plagjiatorët nuk janë ndëshkuar dhe mbetur pa tituj por zakonisht kanë avancuar në postet drejtuese dhe përgjegjëse të Fakultetit dhe Universitetit!(Koha Ditore,13.06.2001). "Plagjiatorët janë fenomeni më i përfolur dhe në opinion është krijuar ideja se në UP dhe gjithandej botës akademike nuk bëhet gjë tjetër përveç se vidhet në shkencë dhe abuzohet me procesin mësimor"(K.Ditore,13. 06. 2006).

Është proces i dhimbshëm edhe për ata njerëz të UP që me shumë sakrificë kanë provuar ta ruajnë integritetin moral dhe profesional. Të tillë ka doemos por në degradim të përgjithshëm ata duken specie të rralla, madje pak të besueshme për këtë realitet.

Që nga paslufta UP vazhdon të mbetet në krizë të thellë identifikimi për shkak të qeverisjes së diktuar dhe politizimit të skajshëm për nevojat e Partisë në Pushtet! Kështu filloi *periudha e Rektorëve të kontestuar*. Për Safirin edhe botimi MMEM (2003) ishte problemor megjithatë pas sqarimit nga Shefi i botimeve universitare duke e prezantuar si autor të katër librave, ku libri i tretë i tij ishte dedikuar edhe për FSHMN-Dega e Matematikës, por edhe me participim mjetesh nga UP, u hoqën pengesat e vëna nga ish-Rektori (më vonë dhe ish-Ministër), pa kërkim falje! Të kuptohemi; dhe botimi i MMEM('03) ishte tërësisht privat dhe UP nuk kishte particip ar asnjë centë paraje. Për dallim nga MMEM ('93), kësaj radhe në mbështjellësin e librit nuk mungonte Stema e UP pra ishte nën 'Kurorën e saj' dhe asgjë më tepër! Përveç Recensentëve të librit të cilët ishin në anën e autorit, çdo strukturë tjetër nga UP; Rektorati ('08) dhe Dekanati i Fakultetit të Edukimit ('08) dhe disa Akademikë ishin një çartaqejf.

*Botues libri MMEM (2003) ishte Universiteti i Prishtinës ndërsa financues Safir Kromi. Tirazhi 500 kopje. Doli nga shtypi Ditën e Pranverës së atij viti. Universiteti i Prishtinës tashmë ishte tjetërsuar. Kishte filluar epoka e "Rektorëve të njëpasnjëshëm të kontestuar". Derisa MMM (1998), në kohën kur *shkolla shqipe ishte e burgosur*, në cilësinë e 'mallit kaçak u shpërblye me participim mjetesh financiare dhe "Bujku" lajmëroi botimin e tij, tani në kohë paqeje nuk kishte as participim mjetesh por as mundësi lajmërimi klasik, nëpërmjet një teksti simbolik disa rreshtash, ta zëmë në "Koha Ditore" e cila mbijetoi*

përgjatë viteve (98/99), edhe pse për këtë qëllim një kopje libri ishte falur penës eminente redaktuese të gazetës në fjalë! Dëshira e autorit ishte: Promovimi i librit nuk bënë të ndodhë (mungonte gatishmëria e dysjes së Recensentëve); pa falje librash dhe pa kamera! Tri vite pas çlirimit, tek intelektualët e çliruar fizikisht, kishte mbetur ende i pa çliruar mentaliteti i tyre! Sorollatja e autorit për promovim media I të librit, ishte një ecejake e pa merituar! Megjithatë shitja ecën me ritëm të përshpejtuar!

MEM (2003) me përmbajtjen e saj përfundimtare ishte një *dhuratë shumë e çmuar nga Arsimit i përparuar Perëndimor*, dituri të përmbledhura, të sistemuara e të provuara praktikisht, të përpunuara me përkujdesje nga vetë autori lidhur me mësimdhënien dhe mësim-nxënien bashkëkohëse. + Përgjatë dekadave të fundit të shekullit njëzetë, këto risi mësimdhënieje, fillimisht u shpërndanë në tetë vende të Evropës Qendrore e Lindore, numri i të cilave më pas arriti në tridhjetë.

Dhe lexuesi i nderuar botimin e librit MEM (2003) e priti me shumë respekt dhe ngrohtësi; bile në "Qytetin e Urave", mësueset e vlerësonin më lartë krahasuar me "Metodologji e mësimdhënies", i botuar në shtetin amë. Për ta plasuar librin tek lexuesi, autori krijoi strategji të re shitjeje. Fillimisht 'regjistroi qytetet-qytezat, përkatësisht, shkollat në ato vende të cilat do ta pritnin! Andej pari thotë ai, kisha marshuar edhe më parë ('93-'96), por atëherë ngava makinë tjetër dhe isha dhjetë vite më i ri!

Përgjatë udhëtimeve (pranverë-vjeshtë, 2003) dhe (pranverë-vjeshtë, 2004), (kur Daxner ende ishte gjallë!) 'shkollat e programuara' ishin vizituar nga dy herë; herën e parë për ta promovuar librin (nëpërmjet një kopjeje) para mësuesve të pranishëm! Kishte debat lidhur me librin, i cili kalonte nga 'mësuesi tek mësuesi'; nga 'dora në dorë'. Ata të cilët shfaqnin interesim për ta blerë, me dorën e vet shkruanin emrin dhe mbiemrin. Grupi i mësuesve caktonte datën kur Safiri do duhej t'iu sjellë librat në shkollë dhe me atë rast bëhej pagesa me dhjetë euro të kohës.-Vetëm në 'Qytetin pa lum' ishte ndalur ora. Ish ministri i Arsimit (i përfolur atëbotë disa herë në gazeta, për punë të dyshimta, së bashku me A. V. në botimin e Librit Shkollor) e më vonë dhe për punë të tjera të pista etike e morale, nuk kishte lejuar shitjen e librave nëpër shkolla (të cilat me Recensione pozitive ishin të firmosura nga Akademikë të shquar të shkencës sonë)! Kjo ishte dhe një provë e 'rrënimin të hershëm dhe të heshtur' të shkollës sonë kombëtare te ne, e cila edhe sot e gjithë ditën nuk ka të ndalur! Ishte koha kur punonte "fabrika e diplomave" anembanë vendit, në tëra rangjet!

Pesë muaj pas daljes së librit nga shtypi, në gusht të atij viti, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) botoi Modele të Mësimdhënies sipas strukturës ERR. Ishte refleksion i shpalljes së një gare ndërmjet një matematikani dhe një bashkësie mësimdhënësish të lëndëve mësimore të tjera, për çfarë autori i MEM (2003) (të cilin një vit më parë, planifikonin ta largonin nga puna) e ndjeu vetën të vlerësuar nga KEC! Me kalimin e viteve Safiri kishte krijuar përvojë në vazhdimësi dhe për çdo pesëvjeçarë që do vijë, do shkruaj edhe katër libra të tjerë, duke e ngritur cilësinë e tyre!

Për t'i plasuar vëllimet e librave te lexuesi, Safiri kishte udhëtuar: 1000; 2000; 3000 e më shumë kilometra anembanë Kosovës! Për vëllimet e librave të botuara e më pas të shitura në kohën kur ende ishte në marrëdhënie të rregullt pune, kishte udhëtuar më pak, meqenëse punohej në dy Shkolla të Larta dhe pjesë e konsiderueshme librash, plasoheshin te studentët dhe familjarët e tyre, adhures të mësimdhënies së matematikës! Në 'Qytetin e Urave' ta zëmë, mësimdhënësi i MEM e shfrytëzonte

librin, si të ishte ai autor i tij! Pas çlirimit të vendit, me zvogëlimin e numrit të studentëve dhe heqjen dorë nga angazhimet shtesë me honorar, numri i udhëtimeve drejt shkollave fillore të vendit për ta plasuar librin u shtua dukshëm!

Para se të udhëtohej i vetmuar, për ta promovuar librin, planifikohej dita e vajtjes; shkollat e afërta të atij lokaliteti; largësia e shkollave nga vendlindja; kushtet atmosferike që do mbretëronin atë ditë (pa reshje); përcaktimi për të udhëtuar me makinë personale (në largësi deri 80 kilometra); me taksi (kur dorëzoheshin librat nëpër skajet e vendit); apo me autobus (përgjatë udhëtimit për ta promovuar, atë, në skajet e vendit). Me vete merrej vetëm një kopje libri(jo më shumë, sepse prishej shit-blerja!); blloku i shënimeve së bashku me dy lapsa! Ndalesa e parë do bëhej në shkollën, te e cila do shfrytëzohej pushimi i parë i gjatë, prej 15 minutash (9,25-9,40). Arritja në lokalet e shkollës ishte pas fillimit të orës dytë mësimore aty diku pas orës 9 të mëngjesit!

Vizita e parë eventuale kur promovohet libri ishte i përcjellë me shumë emocione, tak-taku i zemrës tashmë e kishte ndërruar ritmin. Në mendje përfytyrohej vërdallë drejtori me të cilin fillimisht do duhej takuar! Meqenëse vizita nuk ishte e paralajmëruar, athua si mund të reagojë drejtori? Edhe po qe se e refuzon takimin me mësuesit e shkollës ku gjendet duhet vetëpërmbajtje, nuk bën të futesh me atë në polemikë! Nuk është vendi por as objekti (libri) për të cilin ia vlen të polemizohet! Po qe se pritja nga ana e drejtorit do jetë e ngrohtë, ‘alegro’ dhe e hareshme, atëherë ‘gjysma e punës’ do jetë e kryer, sepse cilësia e librave do fliste vetë në gjuhën e tyre, çmimi i të cilëve ishte simbolik!

Ka ndodhur që mësueset herë-herë nuk e dinin dhe nuk ishin njoftuar, që në mesin e tyre kishte ardhur, “Rilindësi” e ditëve tona por drejtori i shkollës e kishte përzënë, për t’iu ofruar të shkruar trendin e ri në mësimdhënie së bashku me mësim-nxënie, me synim për ta orientuar dhe futur Kosovën e vogël dhe të pavarur në ranglistën e vendeve me Arsim të përparuar!

Të realizosh shit-blerjen e librave te mësuesit, është tamam si të futesh në një provim serioz, ‘të cilin me çdo kusht duhet kaluar’; duhen parapërgatitje psikologjike, si të prezantohesh; si të flasësh; me supozim çfarë pyetje të parashtrajnë; si duhesh t’iu përgjigjesh; për çfarë ‘nuk guxon’ t’iu flasësh dhe të ngjashme! Për shit-blerjen finale të ‘prodhim-Kromit’ realizoheshin dy vajtje-kthim; promovim libri para kolektivit të mësueseve dhe pas dy javësh, dorëzim librash të porositura! Kuptohet vetiu, udhëtimi i parë ishte i mundimshëm, shqetësues, i zorshëm dhe përcaktues për sukses shit-blerjeje, kur pas dy javësh dorëzoheshin librat dhe bëhej pagesa për ato! Tre-katër numra telefoni merreshin që në takimin e parë! E rëndësishme dhe përcaktuese ishte pritja e reagimi nga personeli udhëheqës i shkollës; a ishte misionar i dijes dhe arsimimit apo ‘zëdhënës prej bajraktarësh politik’, i emëruar dhe i udhëhequr nga mësimet e ‘Partisë politike’ së cilës i përkiste, me përfitime karrieriste i një të dëshmuari si demagogë!

Fillimisht, nga punëtori tekniko-shërbyes kërkohet informacion, lidhur me praninë e drejtorit në zyrën e tij! Në rast mungese kërkohet zëvendës-drejtori dhe pranimi eventual i menjëhershëm ose në pritje, prej disa minutash! Pas prezantimit, kishte raste kur drejtori vetëvendoste për moslejim shitjesh librash në objektin e shkollës (qasje normale sjelljeje por librat MMM ishin me recensione pozitive dhe të pranuar, për **tekste bazike universitare**), por nuk diferencohet personi i cili tashmë ishte i njohur me disa vëllime librash, në çdo pesë vite! Rastet më të shpeshta të kësaj natyre, u shfaqen në disa shkolla të

kryeqytetit, aty ku ushqejej Ministri i Arsimit i emëruar nga PAN-i. Kishte raste kur drejtori e lejonte me qejf promovimin e librit, por në fund të takimit nuk regjistrohej asnjë mësuese për ta blerë. Evidencohej si rast kur drejtori i shkollës e hetonte që një kopje libri nuk do t'i jepej falas dhe vartësit e tij 'lexonin'! Asnjë drejtor shkolle në asnjë lokalitet nuk kishte përfituar nga posti që mbante, për t'ia dhënë një libër falas! Kishte lexuar nga Kadareja, *'libri i mirë nuk falet, por blihet'* dhe këtë aforizëm në vazhdimësi e kishte zbatuar, sepse lexuesit e pavarur 'me nota në indeks', librat e Safirit i konsideronin cilësore!

Në rastin kur merrej lejehyrje nga drejtori i shkollës për takim me mësueset e ciklit të ulët (I-V) apo të ciklit të lartë (VI-IX) dilej nga drejtorja dhe pritej në sallën e mësimdhënësve derisa të përfundojë ora e dytë mësimore. Pasi të vërehej që aty tash ndodhej pjesa më e madhe e tyre, personeli udhëheqës i shkollës ose mësuesi kujdestar i ditës ia jepte fjalën Safirit, përse ndodhej në mjedisin e tyre? 'Ligjërata' më e gjatë e tij ishte deri në dhjetë minuta! Kopja e vetme e librit merrej dhe shflettohej por edhe vështrohej edhe lexohej duke u futur në 'rëntgen', nga 'dora në dorë'; nga 'mësuesja te mësuesi' dhe tregohej çmimi! Gatishmëria eventuale e mësueseve, për ta blerë librin 'dëftohej' duke shkruar në 'bllokun e shënimeve' emrin dhe mbiemrin me 'dorën e vet'. Nga ana e mësueseve përcaktohej data kur autori obligohej t'i sjell librat e porositura! Mësueseve të cilat ishin të punësuar aty, si misionare diturie, në çast u qeshej fytyra, gëzoheshin për sihariqin e radhës përcjell me plot komplimente për libër shkruasin! Përgjatë shit-blerjes së librave, asnjëherë nuk ishte ndeshur me ankesa, lidhur me çmimin dhe nuk ka ndodhur që libri i porositur, të refuzohej përgjatë blerjes! Çmimi ishte i arsyeshëm dhe i rrumbullakosur të thuash i "pandryshuar"; fillimisht 2 DM (1987); 5 DM (1993); 20 DM (1998); pas luftës së fundit: 10 Euro (2003); 10 Euro (2008); 10 Euro (2013) dhe i fundit 15 Euro (2020), sa për të mbuluar shpenzimet e botimit! Përgjatë botimit të shtatë librave universitarë, përfitimi material prej tyre, nuk ishte qëllimi parësor! E rëndësishme ishte që pa bujë dhe i pa ekspozuar nëpër medime publicistike, të bënte përpjekje 't'i emitojë' Rilindësit shqiptarë të shekullit 19-të, mbase tani jo për gjuhën shqipe, por për 'gjuhën me të cilën flasim të gjitha shkencat tjera'!

Ka rastisur në të dal, ditën e promovimit, ende duke ecur në oborrin e shkollës, dëgjoheshin zëra me thirrje; me të kthyer koke, shiheshin mësuese duke vrapuar, me kërkesën për prurje edhe atyre nga një kopje libri! Kjo dukuri e 'blerjeve me pishman' ishte e rrallë ('03), por shumë domethënëse. Atëherë ka ndodhur që mësuesja kishte bërë porosi për dy kopje; njërin për vete ndërsa tjetrin për mësuesen e cila ndodhej larg saj shtatëdhjetë kilometra! Atëbotë, së paku tri herë e ndjeu veten të vlerësuar, kur për të blerë një libër prishej 100 euro në një rast dhe 50 euro në dy raste të tjera (kuptohet vetiu, duke u kthyer kusuri)! Këto tri raste ndodhën në shkollat e Dukagjinit! Në disa mese shkollore kërkonin t'iu lija 'librin ekzemplar' disa ditë në dispozicion, për ta 'rizbuluar' cilësinë e tij, kërkesë gjithnjë e paplotësuar nga ana e autorit! Po të veprohej ndryshe, do 'pezullohej shit-blerja masive' e librave!

Me librin e katërt MMM(2003) në kthim drejt vendlindjes, përgjatë udhëtimit të mundimshëm me autobus nga një cep i largët i vendit drejt stacionit të autobusëve në kryeqytet, pason një ndalesë e paplanifikuar, afër një shkolle fillore! Befas iu mbush mendja 'ta shfrytëzojë rastin', për të zbritur aty duke u drejtuar për në shkollë! Në atë pasdite të vonshme i lodhur tej mase paksa dhe i uritur, pas prezantimit me të futur në zyrën e drejtorit (aty qëndronin nja katër veta duke pirë çaj), ende pa u ulur në karrige për të marrë frymë, me gjasë drejtori i shkollës kishte qenë kureshtar të mësojë të dhëna nga gjenealogjia e fisit dhe parashtron pyetjen:

- “Çfarë e ke filan-fëstëkun?”

-Ju zotëri, shkoni e pyesni filan-fëstëkun, çfarë lidhje familjare ka me fëstëk-filanin, ai ka për të treguar, ia priti Safiri! Drejtori i ulur ia ktheu, ik jashtë! Vërtetë iku, meqenëse ishin duke pirë çaj rus dhe mund të ndodhte të fluturojë përreth fytyrës së tij ndonjë gotë çaji! Në ikje e sipër Safiri ia ktheu: Ju jeni i pafajshëm, “*fajet i ka çaji rus*”! Pas dy ditëve ai kishte planifikuar promovimin e librit në skajin tjetër të kryeqytetit, atje ku këmba e tij nuk kishte shkel asnjëherë më parë! Në mënyrë analoge, të vrazhdë, udhëheqësi i njëres shkollë, që në hyrje pa asnjë fjalë shfaqti qëndrim të njëjtë. Me gjasë, drejtorët e këtyre dy shkollave ‘ishin marrë vesh’, nëpërmjet telefonit!

Pas pesë viteve, libër shkruasi ndalet në po atë shkollë (2008), për ta plasuar një vëllim tjetër libri! Drejtor shkolle ishte po ai person! Pasi e vërejti në oborr të shkollës, në cilësinë e skifterit ia priti me zhurmë: -“Ik, përndryshe do ta thirri policinë”! Porosia ishte pranuar! Ky rast ndeshjeje i vetëm me një drejtor ‘politik’ të një shkolle fillore të ‘privatizuar’ duhet evidentuar, nuk bën të harrohet!

Ishte viti 1993, kohë kur “Shkolla shqipe në Kosovë ishte burgosur”! Libri i dytë MEM fillimisht kushtonte 5 DM (të kohës), [numri i kopjeve ishte (500+500); shit-blerja kishte zgjatur pesë vite], shumë paraje me të cilën janë blerë 30 vezë! Një drejtor shkolle atje te udhëkryqi i rrugëve Velani - Gërmi, e kishte pranuar një kopje libri, të cilin do ta promovonte para mësuesve të asaj shkolle. Pas dy javësh erdh radha e dërgesës së librave të porositura nëpër shkollat tjera të kryeqytetit. ‘Safiri i motorizuar’ u kthye aty ku drejtori e kishte pranuar një kopje libri! Me të ulur në kolltukun përball tij, e pyeti lidhur me porosinë eventuale të librit dhe mori këtë përgjigje:

- Nuk deshi ta blejë askush! Anash ku ishin ulur ndodhej një tryezë ku kishte objekte dekorues me vlerë! Dhe pa një pa dy, Safiri ia ktheu drejtorit: “Një libër e keni pranuar herën e kaluar, a doni me e blerë apo doni ta ktheni”?!

-“Po atë e kam lënë në shtëpi, si ta kthejë”?!

-Ju me e blerë nuk po doni atëherë unë po vështroja t’iu marrë një objekt dekorues në vlerën e 5 DM!

-Sa çel e mbyll sytë drejtori nga ‘xhepi i vogël i sahatit’ nxjerrë një 5 DM prej letre dhe ia lëshon Safirit në dorë! Vërtetë u tregua burrë dai me xhep të vet!

Atij ‘nuk i kishin treguar’, që për botimin tërësisht privat të librit MEM (’93), (kohë kur shkolla shqipe në Kosovë ishte ‘burgosur’ ndërsa UP gati ishte zhbërë, ndodhej në grahamat e fundit të ekzistencës), autori i tregimit tonë kishte investuar më shumë se 3000 DM, kohë kur shumë profesorë të Universitetit të Prishtinës për ta shpëtuar kokën dhe familjen, kishin ikur në Perëndim dhe jepnin *moral patriotik* nga atje. Safiri këtu në Atdhe ‘arnohej’ për të fituar vetëm dy marka nga puna e tij intelektuale, meqenëse tri markat tjera ishin marrë hua (pa kamatë); me para në dorë! Çdo punë intelektuale bie ndesh me njerëzit e qelepirit sepse ajo kushton shtrenjtë më vonë! O kohëra, o zakone!

Është kënaqësi e posaçme për t’u ‘shitur dije’ njerëzve të ‘një gjaku’! Ata të gjithë ishin të mençur dhe ‘të gjithë dinin të shkruanin libra’! Zakonisht, ‘për të blerë dritë-dije’ e pranonin pak me vështirësi. Është interesant që disa nga mësuesit nëpër shkolla kërkonin ‘autorin e librit’! Pse nuk ka ardhur autori?

(Edhe pse Safiri në veshje dhe qëndrim ishte i rregullt, me kollare; me gjasë, periudhën e parë të prezantimit nuk e kishin dëgjuar, për arsye të ardhjes me vonesë në tubim)! Po unë jam autori, u thosha! Ata mendonin që autori i librit (me treqind e shtatëdhjetë e gjashtë faqe) do duhej të jetë i gjatë së paku njëqind e tetëdhjetë e pesë centimetra dhe i rëndë tetëdhjetë e pesë kilogramë; ndërsa Safiri ishte i gjatë vetëm njëqind e gjashtëdhjetë e pesë centimetra dhe me peshë gjashtëdhjetë e pesë kilogramë! Aktualisht njëzetë vite më vonë, Safiri me numra ishte akoma më i vogël! Ose, pse ti të jesh marrësi i shitjes së librit, kjo nuk është punë për ty! Ajo që e bënte të ndihet mirë në ato *vizita*, ishte kërkesa e disa mësuesve të zellshëm për t’iu dhënë *autografe* edhe pse libri nuk ishte i falur, por i paguar! Ai për shitje të librit **MMM (2003)** kishte udhëtuar më shumë se dymijë kilometra!

Duke qenë i *vetmuar* kur i shiti librat nëpër shkolla, në kërkim të emrit të mësueses e cila kishte nënshkruar vetë për ta blerë librin, ai nuk i shikonte ‘fytyrat e panjohura’ të tyre por vetëm ‘duart’ dhe gjithnjë merrte përgjigjen: “Profesor, nuk po na njuh fare na paske harruar për dy javë!” Ai me dorën e majtë jepte librin ndërsa me të djathtën u merrte paranë, një për një! Në këtë mënyrë nuk kishte libra të firuar! Kjo ishte dhe një provë tregonte Safiri, që matematikanët dinë të llogarisin! Nëpër shkolla qyteti, aty ku ishin porositur më shumë se dy paketa librash (10 kopje), kishte raste të shpeshta që mësuesi i cili nuk e kishte porositur librin të shfaqë ‘interesim’ aty për aty, duke shfletuar një sosh! Me një lutje vëllazërore e falënderim, i njëjti shmangej nga paketa!

‘Ëndrra e dikurshme’ i përkiste të kaluarës së largët dhe tashmë ishte shndërruar në realitet të prekshëm. Ritmi i shitjes së tyre në harkun kohor gjashtëmbëdhjetë mujor, ku blerës ishin mësuesit me diplomë mësuesie, dëshmoi saktësinë e vlerësimeve të Recensentëve: ***“Dorëshkrimi përmban vlera të larta e rëndësi të veçantë dhe ai meriton të botohet si Tekst Bazik i Metodikës së Mësimin Elementar të Matematikës.”***

Në dekadën e parë të shekullit 21-të këtu tek ne, kishte zëra edhe nga shkëlqesia e matematikës kosovare, të cilët flisnin me admirim për ‘botimin e librave në seri’ nga Metodika apo Metodologjia e Matematikës nga një autor i vetmuar! Bile mbronin idenë; nëse dikush do ta zëvendësonte ‘babën’ e metodistëve të matematikës ndër ne, ai duhej të ishte Safiri! Por kjo ide-propozim për ta avancuar atë, me gradë shkencore, ishte kundërshtuar ashpër nga treshja vendore e ***“tramakëve pa kokrra”***! Mjerisht “babëzia”, duke dashur të qëndronin në ‘maje’, aspak nuk e kuptonin që edhe ata vetë në cilësinë e të shpirtplasarve kishin humbur shumë, duke e njoollur punën e mëhershme shkencore dhe mençurinë e njerëzve të ditur, meqenëse kishin dhënë prova të mjaftueshme që dituria dhe zotësia e tyre nga viti dymijë e këndeje ndodhej në rënie të lirë, bota ecën përpara; tani ajo pyet si jeni sot e jo si keni qenë dje!

*Pas botimit të librit MEMEM (2003), pas disa muajve kishte ‘lëvizje pozitive’, të orientuara dhe të kurdisura në disa drejtime:

*Në gazetën “Koha Ditore” ishte shpallur një Konkurs, për librin më të mirë të botuar përgjatë vitit. Kushtet e Konkursit përkonin me MEMEM (2003) [Iniciativë e Recensentëve (pa e lajmëruar autorin) dështoi, meqenëse librin MEMEM (2003) e konsideronin Ribotim (1993), edhe pse plotësimet dhe ndryshimet e shumta përmbajtësore kurrikulare dhjetavjeçare ishin të paevidentuara në botimin e parë.

*Një Organizatë bamirësie italiane në verën e atij viti donte ta botonte Librin MEMM në shumë kopje, por e konsideronin si pengesë që autori i librit nuk kishte titull shkencor!(Safiri me familje ishte për pushime në Velipojë të shtetit amë dhe në valët e Radios shtetërore, përgjatë një jave kishte dëgjuar tekstin e lajmërimit të njëjtë, i cili përkonte bindshëm me librin MEMM- 2003)!

* SHLP- në Gjakovë ‘zyrtarisht’ u kishte dërguar shkresa FSHMN- në Prishtinë por edhe Fakultetit Filozofik- Dega e Pedagogjisë: Si rezultat i katër librave të botuara Universitare, personi Safir Kromi, të propozohet për avancim në Gradë shkencore! (Me arsyetimin prej disa faqesh). Propozimi kishte mbetur pa përgjigje! Këto dhe të tjera të ngjashme ishin ‘lodra’ intelektuale provokuese; ‘nisma dashakeqëse’ nga “Ademik” vendor të Mixhës Ramë, të cilëve u kishte humbur bishtpena për të shkruar vetë, pa asnjë mundësi gjetjeje!

Për autorin e një libri, një prej detyrimeve madhore është bashkëpunimi intelektual me dyshen apo treshen e Recensentëve të propozuar (apo të emëruar) e cila mund të ndodhë: udhëhiqet edhe nga zilia; smira; xhelozia; paragjykimi; nënvlerësimi; provokimi; revanshi; njëmendësia; interesi; kryeneçësia; lakmia; porosia; padituria...e tyre! Edhe pse përgjatë dyzetë viteve të punës për të shkruar e botuar, sorollatjet e autorit karshi Recensentëve ‘egoistë’ e të ‘porositur’ nuk ishin të vogla, ndërrim ekipesh të Recensentëve, me diktatet dhe urdhëresat e ndonjërit prej tyre, me emërime të reja, zhargitje punësh, megjithatë botimi i 7-të librave universitare (Recensionet e së cilave ishin pozitive, të një matematikani të vonuar, pa titullin shkencor!), të jep me kuptuar që puna e autorizuar e tyre në fund të fundit ishte krejt në rregull dhe krejt mirë!

Nga një mori vërejtjesh nga ana e Recensentëve për të cilat Safiri ishte zemëruar por kursesi i pikëlluar për ta prishur qejfin e ditës, të cilat nuk i përfilli dhe për ato ishte në gjendje ta pezullojë edhe botimin e njërit libër apo të disa prej tyre në vazhdim, ishin ato të njërit pedagog! Veçojmë:

Recensenti: *Nuk qëndron as mendimi i autorit për sistemimin e Metodikës së Mësimdhënies të Matematikës në sistemin e disiplinave të shkencave matematike-natyrore. Metodika e Mësimit të Matematikës (MMM) para se gjithash është disiplinë e Pedagogjisë.*

Safiri: *Megjithatë le të mendojmë dhe vlerësojmë edhe paksa ndryshe. Le të heqim këto paralele: **Disiplinat shkencore –teknike** kërkojnë dhe marrin ndihmë nga **Matematika** dhe ajo shërben si udhërrëfyese duke ushtruar edhe kontroll në **disiplinat teknike** si i shfrytëzojnë ato ligjëroritë matematike. Megjithatë, **asnjë disiplinë shkencore teknike** edhe pse **të gërshetuara dhe të udhëhequra** me njohuri të thella të arsimit matematik, **nuk konsiderohet disiplinë matematike!***

*Po ashtu do të thoshim: **MMM** kërkon dhe merr ndihmë nga **Didaktika** dhe ajo shërben si udhërrëfyese duke ushtruar edhe kontroll në **MMM** si i shfrytëzon ajo ligjëroritë e procesit të mësimdhënies. Kështu **MMM**, edhe pse **gërshetohet dhe udhëhiqet me njohuri të ngjeshura didaktike do të ishte logjike, mos të konsiderohet disiplinë pedagogjike!** Didaktika nuk do duhej të mbajë peng metodologji lëndësh mësimore, në veçanti atë të matematikës, së paku tash në shekullin e 21-të.*

Mësuesit tanë matematikanë ‘meqenëse nuk dinin të flisnin’, Metodikën e Mësimdhënies së Matematikës (MMM) u kishin dorëzuar vullnetarisht Pedagogëve dhe tani në dekadën e dytë të shekullit

njëzetë e një, në Fakultetin Filozofik-Dega Pedagogji; Metodikën e Matematikës (MM) e ligjëron vetëm Pedagogu!!! Pedagogët, as Kursin e Matematikës elementare bashkëkohëse nuk e dinë mjaftueshëm, as për vete e lëre më ta ligjërojnë! Vetëdija intelektuale për qëllime të caktuara mund edhe të deformohet! Pra, tek ne nga Pedagogu Ak. shtrembërohet qëllimisht aftësia për të kuptuar, gjykuar vepruar qenësinë e veçantë dhe specifike të mësimdhënies matematike! Për t'u turpëruar kurrë nuk është vonë!

Është e padrejtë, e panjerëzishme, jo dobiprurëse, antishkencore, tanimë kur mësimdhënia bashkëkohëse duhet me qenë përditshmëri reale, edhe mëtej kursin MMM ta udhëheqë Pedagogu! Kjo tani nuk shkon e nuk do duhej të ndodhë dhe ky veprim do jetë i pafalshëm po qe se vazhdohet 'me të vjetrën'! Përndryshe ata që do vijnë pas nesh, do na gjykojnë për (mos)reagim, (mos)ndërhyrje dhe (mos)veprim!

Ishte Analiza e Safirit lidhur me MMM, e para e kësaj natyre nga ana e matematikanëve e cila shënohet si 'fitorja e një beteje kundrejt pedagogëve'. Po këtu ndodhej IN MEDIA RES! Në mesin tonë kishte edhe matematikanë me tituj shkencor të mbrojtur në kohëra të ndryshme; disa tek pedagogu ndërsa disa të tjerë tek psikologu! Athua, kush – kënd e ka vlerësuar?! Ku ndodhej faji dhe cili është fajtori!? Këta tituj shkencorë dhe të tjerë të ngjashëm të pa përcjell me botim librash origjinalë, vështirë mundën me qenë të besueshëm! Dëshmi për këtë është fakti që kërkesat e Studentëve të Huaj për të studiuar këtu tek ne tash e tri dekada nuk ekzistojnë! Para viteve ('90) në studimet post-diplomike ekzistonte një 'hendek' tek titujt shkencorë: mr. sc. dhe dr. sc. Numër i konsiderueshëm magjistrash shkonin në pension me po atë gradë shkencore sepse e dyta nuk jepej për ata të cilët nuk e meritonin, me vepra të dokumentuara!

'Beteja e dytë' ndërmjet pedagogëve dhe Safirit ishte ajo lidhur me Klasifikimin e Metodave mësimore në mësimdhënien tradicionale. Ishin këto ndërhyrje të vazhduara të Recensentit sekondar tek dorëshkrimet e radhës. Autori çuditej për qëndrimin gati imponues (njëherazi të pambështetur për mësimin e matematikës) për ta marrë një model didaktik tjetër klasifikimi të Metodave e Teknikave në mësimdhënien e matematikës i ndryshëm nga ai që tashmë kishte fituar legjitimitet, që nga viti i largët njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër të publikuara (në vazhdime) në Revistën Arsimore 'Shkëndija', ku anëtarë redaksie ishte dyshja e matematikanëve më të mirë të vendit, edhe nëpërmjet Metodikave tashmë të botuara dhe të pranuar! Këto dy vërejtje po të pranoheshin do kishte *lëkundje* dhe *dridhje* të tjera brendapërbrenda kursit dhe si pasojë autori nuk do pranonte që '*librat ta shihnin dritën.*'!

Recensenti:

"Do të jetë më mirë që Metodatat mësimore të matematikës të klasifikohen sipas modelit:

Verbale - tekstuale;

Demonstrative – ilustruese dhe Laboratorike – eksperimentale ose Laboratorike e të punimeve grafike.

Metodat Teknike – punuese (të cilat i pranon autori) nuk mund të veçohen si grup i metodave. Elementet e veprimeve teknike të punës kryhen përmes Metodës së Demonstrimit vlerëson Recensenti. Titulli: Metodat Teknike – Punuese të ndryshohet dhe të jetë Metodat Laboratorike – eksperimentale në mësimin

e matematikës. Të kujtojmë se Puna Laboratorike nuk nënkupton vetëm punën në laborator, por edhe punën në kushte laboratorike të cilat praktikohen në mësimin elementar të matematikës.”

Safiri:

Së pari duhet thënë: *Në mësimdhënien e matematikës vërtetë mungon puna në laboratorë por mungon edhe puna në kushte laboratorike!*

Së dyti, edhe po qe se do të ekzistonte grupi i metodave laboratorike- eksperimentale (kuptohet në mësimdhënien e matematikës) edhe elementet e veprimeve laboratorike-eksperimentale kryhen përmes metodës së demonstrimit.

Së treti, metoda e punimeve laboratorike e ngushton nocionin e punimeve praktike vetëm në punime laboratorike që shfaqën në formë të gjerë në fizikë, biologji kimi, gjuhët e huaja, mineralogji, gjeografi, astronomi etj., ndërkaq në matematikë, gjuhë amtare, gjuhë e huaj, etj., puna laboratorike nuk gjen terren dhe zbatim.

Sa i përket nocionit “*eksperimentale*” ekzistojnë kryesisht këto interpretime. Njëri grup i metodikanëve të matematikës, me fjalën *eksperiment* kuptojnë atë metodë me ndihmën e së cilës i kontrollojnë dhe i vlerësojnë njohuritë, shprehitë dhe shkathtësitë e nxënësve me ndihmën e detyrave të shtëpisë dhe testimit. Grupi tjetër i metodikanëve me fjalën *eksperiment* kupton vërtetimin e pohimeve dhe të teoremave matematike si dhe provën për ta arsyetuar saktësinë e zgjidhjes analitike të detyrave të caktuara problemore.

Me metodën Tekniko-punonjëse kuptojmë përpjekjet e orientuara të mësimdhënësit për: *aftësimin* e nxënësve që t’i përdorin lirisht dhe me shkathtësi veglat e punës (vizoren, kompasin, këndmatësin, dy trekëndëshat) për të vizatuar, modeluar dhe konstruktuar figurat, trajtat e trupat gjeometrikë; *aftësimin* për të matur me përpikëri: gjatësinë, peshën, vëllimin (kubaturën e druve) sipërfaqen dhe për të bërë matje të tjera në terren; *aftësimin* për t’i punuar modelet e figurave dhe të trupave gjeometrikë prej kartoni, druri, teli, e deltine. Punimi i një mjeti mësimor nga ‘dora e nxënësit’ është punë tekniko-kreative. Nxënësi me atë rast (ri)mat, (ri)vizaton, (ri)konstrukton, pret me gërhërë (kartonin..), duke ndërtuar trupin, objektin, modelin...me përpikëri e saktësi, nivelesh të ndryshme; *aftësimin politeknik* të nxënësve (punimi i topit me ndihmën e 12 pesëkëndëshave të rregullt, punimi i fluturakes, treguesit të erës, punimi i lundrës, i shenjave të komunikacionit etj.); *aftësimin* për ta përdorur dhe shfrytëzuar Internetin për qëllime arsimore, kalkulatorëve llogaritës në ekonomi, prodhimtari, teknikë; aftësimin për aplikimin e diturive matematike në përditshmëri.

Në fazën fillestare të ‘*punimeve teknik*’ (duke vizatuar dhe konstruktuar) mungojnë shkathtësitë për përdorimin pa pengesa të kompasit, të vizores, të dy trekëndëshave...Në këtë drejtim është me rëndësi përkrahja dhe ndihma profesionale e mësuesit që do duhej t’u ofrohej nxënësve, atëherë kur përgjatë mësimi të rregullt aplikohet forma individuale e punës .

Padyshim mësuesit tanë matematikanë ‘të një gjaku’ janë të ngarkuar me shumë faj, duke u lënë ‘*kopilin në derë*’ pasardhësve, që **Safiri** me një vonesë gjashtëdhjetëvjeçare, atëherë kur ai tashmë ishte

'vyskur' fare, ta mbrojë i vetmuar statusin e MMM; cilave disiplina shkencore i përket; atyre pedagogjike apo matematike dhe të fillojë pazari i 'shit-blerjes' mall me mall?! Angazhimi i tyre ishte ta kompletojnë një 'fletore njëzetë faqesh' nga MMM dhe 'studimet' e tyre të jenë të shoqëruara vetëm me: nocione e operacione; shenja e relacione; numra e simbole; barazime e pa-barazime; vizatime e konstruksione; trekëndësha e trapeza; ideale e radikale; integrale e diferenciale...

Duhet thënë: Matematika përmban si të mëvetësishme edhe Metodologjinë e mësimdhënies së saj, si disiplinë shkencore të pavarur. Kjo ishte beteja e parë e fituar kundruall Recensentit-Pedagog i cili përgjatë një dekade (1998-2008) nuk bindej; orvatej ta mbronte atë çfarë nuk mbrohej dhe ishte Recensenti tjetër, matematikan me ndikim për t'ia ndërruar mendjen!

'Birësimi i MMM' me atësi 'Pedagogji' ishte kryer që moti por 'pa dokumenta' dhe kjo vetëm në Kosovë, meqenëse e para, matematikanëve tanë u dukej që Metodika e saj nuk përmban matematikë puro dhe e dyta, pjesa elitare e tyre tanimë kishin ikur pa e zotëruar të folmen e Gjuhës së Sotme Shqipe. Metodika e rritur, zhvillohet dhe lind edhe Metodologji dhe në pamundësi për t'u ushqyer vetë e dyta tek Pedagogjia, doemos herët apo vonë është dashur t'i kthehet Matematikës sepse ajo ishte nëna biologjike e saj. Kjo ishte arritur nëpërmjet tri vëllimeve të fundit, në vitet 2003; 2008 dhe 2020.

Jemi komb me potencial të lartë inteligjence! Për ta 'zbehur' sado pak mençurinë e tij ish- pushtuesit nën thundrën e të cilëve mbijetuam shikuj me radhë u duhej 'politizimi i shkollës kombëtare', të cilën e arrijnë shumë kollaj! Politizimi i Arsimit në Kosovë, dukuri e padëgjuar tek popujt tjerë, mund të jetë 'ide e huaj' dhe me siguri 'nuk është e jona' por gjithsesi paraqet primitivizëm, shthurje morale dhe kombëtare, me qëllimin e vetëm për ta 'rënuar në heshtje' shkollën shqipe! 'Ideologët' mund të jenë të financuar dhe nga jashtë për ta politizuar sa më skajshëm Arsimin në Kosovë për të cilin sjellje dhe veprim do t'i mallkojë dhe gjykojë historia!

Fillim-shekulli njëzetën timer për Safirin ishte më e ngarkuara e karrierës së tij dyzetë vjeçare e përcjell me një aktivitet të ngjeshur studimor-botues e shoqëruar me situata dhe rrethana të tjera dhe ankthi. Le t'i numërojmë disa prej tyre:

Dekada e fundit drejt pensionimit; - Dalja e emrit personal Safir Kromi në gazetën 'Zëri' së bashku me nëntëdhjetë mësimdhënës të tjerë universitarë të cilët Administratori Daxner i OKB donte t'i largonte nga puna, sepse konsideroheshin si të pakualifikuar, edhe pse deri në atë çast i kishte botuar katër libra universitarë nga disiplina Metodike e mësimdhënies së matematikës (edhe atë me të cilën diplomonin në FSHMN-Dega e Matematikës) dhe konsiderohej **pionier i këtij lëmi në trevat shqiptare;*

**Dega e Matematikës pranë Shkollës së Lartë ishte ajo e cila ia diktoi dhe ia zbukuroi profesionin e jetës si matematikan profesionist, për të prodhuar dhe plasuar dije në po atë ambient përgjatë tridhjetë viteve të tjera deri në pensionim, ishte në *grahmat e fundit të ekzistencës*, për një mori arsye objektive dhe subjektive; u shua me pensionimin e Safirit pa i kryer ai botimet tjera të radhës! Mbyllja e Degës së Matematikës ishte shumë e dhimbshme për vendasit, por për rrethanat e kultivuara të bajraktarizmit dhe kur njerëzit e saj u shndërruan në 'subjekte gjyqi', s'ka mundur të ndodhë ndryshe më keq!*

**Në gjysmën e kësaj periudhe kohore u pensionua doajeni i Degës së Matematikës, vlerësimi i të cilit për kalueshmëri ishte rigoroz dhe që nga viti dymijë e pesë puna dhe veprimtaria profesionale e Degës u katandis! Stafi i matematikanëve u varfërua tej mase. Vetëm Safiri ishte profesor i rregullt, tre të tjerët ishin bashkëpunëtorë me grada shkencore dhe njëri prej tyre firmoste kalueshmërinë në katër provime dhe kështu punonin nën petkun 'konflikt interesi', duke dhënë nota kaluese për familjarët e tyre dhe të tjerët në*

këmbim të tri vendeve të punës! Ishin personat nga Bregu i Diellit me ndikim të madh në lëmin e Arsimit që siguronin vendet e punës të cilët merrnin si kundërvlerë pajisjen me diplomë të arsimtarit të matematikës për familjarët që karrierën e tyre mos ta vazhdonin në Arsim por në Administratën publike. *Safiri ishte (ende larg pensionimit) por i 'përrjashtuar nga loja'* dhe punën e tij e bënin personeli nga 'Qyteti i Urave'! Shkolla u mbyllë me një turp të madh dhe bartësit e vërtetë të 'shit-blerjes' së diplomave mbetën 'të pastër' dhe të 'paprekshëm'!

Pas vitit 2001 tek ne në Kosovë filloi të përdoret me të madhe nocioni (MM) **Metodologji** e Matematikës, në vend të **Metodikë** e Matematikës duke i kualifikuar ato si të ishin sinonime gjë që ishte e padrejtë, gabim diferencimi material.

Metodologji e mësimdhënies së matematikës është disiplinë shkencore e cila studion teorinë dhe praktikën e mëimit të matematikës. **Karakterizohet me rreptësinë e lartë logjike në të shkruarit e shkencës**, ku *apriori mungojnë komentet personale të autorit*. Po qe se themi, shumë vlerësime dhe përfundime të mësimdhënies janë empirike dhe shpeshherë bazohen në numër të fundmë vrojtimesh, pason që do gjejmë dhe do ndeshemi me pikëpamje, mendime, vlerësime dhe interpretime të autorit të cilat mund të mos pranohen nga autorët tjerë! Nga ky moment kemi **rrëshqitje nga Metodologjia tek Metodika e mësimdhënies**, kur nuk mungojnë komentet e autorit, biseda dhe interpretime të shtruar, kuptohet si të vërteta, të sakta, të cilat mbrohen me anë të disa provave, të argumentuara me fakte. Përfundimisht, fjala *Metodikë* do të thotë: *rrugë, mënyrë, mjet*; ndërsa fjala *Metodologji* do të thotë: *rrugë, mënyrë plus dije, shkencë*.

Lojërat matematike deri tek Edukata muzikore, tek ne janë mbarsur me 'nacionin e vlerës' **Metodologji!** Aktualisht metodikat e lëmenjve të veçantë kurrikularë më shumë trajtohen si të themi 'veprimtari artistike' e më pak si 'punë puro shkencore'. Titulli shkencor, aq shumë i kërkuar dhe për metodikanin ngjashëm si në punën e piktorit, kostum-grafit, trajnerit të top-këmbës, skulptorit, aktorit, moderatorit, dirigjentit, regjisorit, skenaristit, kësaj radhe për fëmijë, nxënës e studentë, 'nuk ndreqi shumë punë', madje 'ka krijuar huti'! Në lëmin e Metodikës së Matematikës krahasuar me të tjerët përreth nesh ne shfaqim prapambetje të theksuar shekullore dhe për shkaqe bajraktarizmi, karriere, xhelozie dhe smire!

Mësimdhënia tradicionale e përfaqësuar nëpërmjet M M M (1998) ishte në grahamat e fundit të jetës saj dhe atë duhej ta zëvendësonte Mësimdhënia bashkëkohëse e 'lindur' në Perëndimin e përparuar! U deshën dy vite punë intensive (2001 dhe 2002) për ta 'modeluar' mësimdhënien si një kalim i lehtë nga Mësimdhënia tradicionale në atë bashkëkohëse. Dorëshkrimi i fituar ishte 'pjekur' për ta botuar pas katër vite pune; ('97); ('98); ('01); (02); në pranverën e vitit 2003.

XIV. BOTIMI I LIBRIT TË PESTË, METODOLOGJI E MËSIMDHËNIES SË MATEMATIKËS (2008)

Libri MMM (2008) ishte krijuar vërtetë si një rastësi! Në faqen gjashtëmbëdhjetë të librit MMM (2003) është shkruar: “Në asnjë mënyrë nuk nxitova të nxjerrë këtë libër nga dora me mendimin se kam kohë të marrë në dorë edhe njëherë në një ribotim të mundshëm. *U përpoqa që libri për mua të jetë nga çdo pikëpamje i përfunduar*”. Ishte miku i moçëm fëmijërie, djali Tezeje punëtor shkencor me emër, i cili e bindi tezaku për ta kapur edhe njëherë lapsin në dorë me porosinë vëllazërore; vazhdoje punën, ti di të shkruash!

Libri MMM (2008) i ka pasur themelet e vëna dekada më parë me kapituj nismëtarë 1; 2; 3; 4; 5; 7; 8 dhe 9. Meqenëse gjysma e punës ishte kryer, Safiri ndezi pasionin për atë, për ta kompletuar këtë botim me kapituj ‘të kohës më të re’ e këtë: 6; 10; 11; 12; 13; 14; 15 dhe 16; studim i kryer në harkun kohor (shtator 2005- dhjetor 2006) duke sendërtuar kështu ëndrrën e ëndrrave krijimin e ‘dorëshkrimit të pamundur’ : ***Metodologji e Mësimdhënies së Matematikës*** .

Për realizim të objektivit në sajimin e Dorëshkrimit të MMM (2008) ndihmesën e vet e ofruan:

Puna e përditshme intensive gjashtëmbëdhjetë mujore;

Përdorimi i Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe, disa mija herë;

Pavarësia nga Pedagogjia si shkencë ‘mëmë’e disiplinave: Metodikë dhe Metodologji e Matematikës;

Materiale dhe dispensa të shkruara e të aplikuara në Arsimin e përparuar Perëndimor.

Për punën gjashtëmbëdhjetë mujore (shtator 2005 – dhjetor 2006) lidhur me krijimin e dorëshkrimit *Metodologji e Mësimdhënies së Matematikës*, MMM (2008), librin e parë me këtë emërtim në trevat mbarë-shqiptare, padashur Safiri e ndiente vetën që kishte prekur ‘zenitin’ e krijimtarisë personale, punë të cilën para tij askush nuk kishte provuar ta bëjë! Për dallim nga periudhat tjera krijimtarie kësaj radhe përkushtimi për ta krijuar dorëshkrimin ishte shumë më i madh, më serioz dhe përgjegjësia për fjalën e shkruar doemos ishte më e madhe meqenëse tani nuk bëhej fjalë për Metodikë të mësimdhënies së matematikës por për Metodologji të asaj mësimdhënieje! Më pas do duhej bërë përpjekje që duke mjeshtëruar me një gamë të gjerë të arsenalit gjuhësor shprehës, përmbajtja e tekstit (krahas plotësimit të kërkesave të saktësisë shkencore) të jetë më praktike, interesante, joshëse dhe ç’ lodhëse për lexuesin, blerësit e të cilit kryesisht do jenë mësuesit e punësuar nëpër shkolla dhe shumë më pak studentët!

*Materiali i shkruar dhe i plasuar në formën e udhëzuesve disa numrash, të cilën e solli Arsimi i përparuar Perëndimorë ishte i përkthyer dhe i shtypur në Tiranë. Me shembuj të ilustruar përfshinte të gjitha lëndët mësimore. Para se gjithash ishte i cekët, i varfër dhe herë-herë konfuz e duhej për pak orë të kthehej, aty ku ishte marrë! (Nuk duhej të qëndronte shumë gjatë në dorën e lexuesit, kishin frikë nga abuzimi me fotokopjimin)! Këtu ndodhej IN MEDIA RES! Po të ofrojë skica instruksionesh teorike por për aplikimin praktik të tyre duhet ndjekur ***Kurset e aftësimin!*** Konsultimi i literaturës vetëm për vetëm nuk*

mjaftonte! Kaq! Po të ishte ndryshe atëbotë do kishte së paku edhe nja dhjetë autorë metodologjie! Fati ishte në anën e Safirit meqenëse përvoja e tij e gjatë dhe e ngjeshur në të shkruarit e librit (por e përvlerësuar si meritore) nuk mund të krahasohej me të tjerët sepse ajo numëronte të thuash tri dekada!

Si zakonisht, dorëshkrimin e vlerësuan doajenët e shkencës sonë gjatë muajve (mars-qershor) 2007 duke i dhënë epitetin **Tekst Bazik Universitar për nevojat mësimore të: Fakultetit të Edukimit, Programi Fillor dhe Matematikë-Informatikë; FSHMN- Dega e Matematikës**, më pas **Fakultetit Filozofik-Dega e Pedagogjisë** si dhe për ngritje profesionale të mësuesve nga puna në shkollat fillore.

Në betejat intelektuale drejt marrjes së *Pëlqimit për botim* (janar2008) u shpalosën kryqëzimi i interesave të ndërthura personale, grupore dhe klanore (në Dekanatin e Fakultetit të Edukimit) e më pas të *Vendimit për botim* (me shfaqje të burokracisë, injorancës dhe formalitetit në Rektoratin e UP).Në Dekanat kërkohet ndërrim i stafit të recensentëve pas një pune të kryer e të firmosur gjashtë muaj më parë me arsyetimin që Recensentët janë të punësuar diku gjetkë! “Ora e Rektoratit të UP ishte ndal!”

Labirinti kundërthënës atëbotë ishte i pashpjegueshëm dhe i padiskutueshëm nga askush; nuk i dihej arsyeja për të arritur tek një përfundim logjik,përse tani veprohej kështu!Nuk dinin as Akademikët!

Në fund të vitit 2007 dhe fillim-vitin 2008 nëpërmjet shtypit ishte bërë lajmërimi i botimit të një serie librash universitare të cilat në shqipe do përktheheshin nga gjuha angleze dhe për të cilat UP do shpenzojë një gjysmë milioni euro.Universiteti i Prishtinës i dorëzojë paratë tek një ndërmarrje botuese, kurse librat e përkthyer nuk erdhën kurrë në Prishtinë! Ishte një aferë korrupsioni e dukshme dhe e prekshme me shumë dëme, bartësit e së cilës (partiakë të thekur) kaluan pa llogaridhënie; për më tepër u avancuan në poste të rëndësishme shtetërore! Kjo ndodhi në agun e Pavarësisë së Kosovës dhe në vitin jubilar të njëqind nga Kongresi i Manastirit (Alfabetit)! Koha, ambienti e rrethanat kur kjo ndodhi dhe dimensionet e saj akademik,“këtë abuzim mjetesh e bëjnë *emblemë turpi*”, të cilin nuk mund ta fshijë dot as “*goma e traktorit*” ndërsa bartësi kryesor i kësaj ‘afere të pakripë e të pacipë’ ende bën lëvizje nga njëri ekran televiziv- tek tjetri ekran duke dhënë këshilla, sugjerime dhe opinione mençurie!

Rektori i radhës i kohës kur do botohej *Metodologji e Mësimdhënies së Matematikës* (2008), kishte ndaluar botimin e teksteve universitare nën ombrellën e UP. Ishte kërcënim dhe frikë e madhe, po qe se dikush do vepronte ndryshe! Për Safirin nuk ndreqi punë as ndikimi i Akademikut, anëtar e rregullt i ASHAK i cili ishte Recensent i MMM (2008). Ndalohej botimi i librave universitarë nën ‘çadrën’ e tij! U çmeritën njerëzit e ‘shkrim-leximit’ së bashku me Botën Akadematike e cila u step! E gjitha me turp të madh përfundoi duke rrënuar një traditë sjelljeje të kulturuar shkencore dyzetvjeçare!

Përgjatë viteve 2006-2007 periudhë e punës intensive hulumtuese drejt kompletimit të dorëshkrimit të ëndërruar *Metodologji e Mësimdhënies së Matematikës* (2008), nga shqetësimet e fituara prej rrethanave përreth botimit të librit MMM (2008) kur UP ishte shndërruar në një filialë partiake dhe pengohej botimi i çdo libri universitar ndërsa autori ndodhej në zenitin e krijimtarisë, filloi të lëngojë për herë të parë nga pezmatimi i *gjëndrës Tiroide* (për shkaqe hidhërimi e pikëllimi lidhur me ‘lirinë e fituar’ për botimin e librit universitar!) kur kishte humbur një të gjashtën e peshës së trupit dhe nuk mund të peshonte as tre kilogram edhe pse ushqohej tërë ditën!

Nga Recensenti Ak. i jepet si këshillë prindërore: “Mos u shqetëso, librin botoje privatisht sa më parë. Tek ne në Akademi kur refuzohet botimi i ndonjë libri, autori i tij e gjen zgjidhjen duke e botuar privatisht”! Vërtetë, me botimin privat të librit, për herë të tretë ('93; '03 dhe '08) dhe me plasmanin e tij tek lexuesi përgjatë një viti kalendarik (mars '08-mars '09) u largua përfundimisht ankthi, bashkë me lëngatën njëvjeçare e shkaktuar nga gjëndra Tiroide, vetëm me pilula pa operacion të cilin e propozonin dhe planifikonin disa mjekë zullumqarë, batakçinj dhe të paditur!

Zgjidhjen edhe kësaj radhe e gjeti Safiri, duke marrë qëndrim që botues dhe financues i librit MMM (2008) të jetë ai me Tirazh 500 kopje i cili doli nga shtypi më 11 mars 2008 me 454 faqe.

Për ta plasuar librin MMM (2008) tek lexuesi ishte ndjekur ecuri e njëjtë sikurse me librin MMM (2003) por kësaj radhe ‘udha e shkronjave’ ndodhi të jetë paksa më e gjatë për të mos i bezdisë blerësit (mësuesit)! Shitja e kopjeve të librit (për rrethanat kosovare) u realizua në afat rekord përgjatë një viti kalendarik (mars 2008- mars 2009)! Libri është shitur në dyzetë vendbanime në shtatëdhjetë e katër shkolla nga dy herë të vizituara, rrugëtim i padëgjuar dhe i paparë ndonjëherë tjetër tek ne nga një autor libri universitar. Shtegu i udhëtimit ishte më shumë se njëmijë e pesëqind kilometra në vajtje dhe njëmijë e pesëqind kilometra të tjera në kthim. Blerësit e moçëm të pesë viteve më parë kësaj radhe ishin dorështrënguar!

Përvoja dyzetë vjeçare në Arsim në të gjitha shkallët e shkollimit formal; të shkruarit dhe botimi i katër librave paraprak (që nuk ishin përfundimtar ende!); përdorimi i literaturës gjermane; ia mundësoi Safirit t’ia vënë bazat **Metodologji e mësimit bashkëkohës të matematikës** në dekadën e parë të shekullit njëzetentë e cila përgjatë një viti kalendarik u plasua tek lexuesi sikurse buka, *për të cilin nuk kishte asnjë reagim profesional*, e çuditshme ndryshe nga sa priste e mendonte! Libri MMM (2008) ishte ‘çudibërës’ sepse, shumë shit-blerje tek shtëpia ‘nëpërmjet duarve të tija’ mbetën anonim. Mendimi i opinionit intelektual gjithandej ‘jashtë sferës së Arsimit’ për atë veçohej dhe vlerësohej si një arritje e madhe personale, arsimore, shkencore por dhe kombëtare, për të cilën *matematikanët shqiptarë të njohur; ish-përkthyes librash, recensentë, gazetarë por dhe libër shkruar, koautorë librash, mentorë, prorektorë, ministër arsimit...së bashku të sistemuar në Google, preferuan të heshtin, mos të thënë asgjë publikisht ‘për të mirë’ ose ‘për të keq’! Ky libër e meritoi vlerësimin publik me shkrim! Botimi i MMM (2008) dhe plasmani i tij tek lexuesi përgjatë një viti kalendarik ishte një arritje e madhe e trefishtë e autorit, për faktin që **mbetet libri i parë Metodologji e mësimit së matematikës në trevat mbarë shqiptare** i cili: **E para**, përkonte me rrjedhat bashkëkohëse të Arsimit të përparuar Perëndimorë; **e dyta**, u botua privatisht, përkundër “prangave kërcënuese të UP” (që libri nuk guxon të botohet) dhe **e treta**, **MMM tanimë është Disiplinë shkencore matematike e mëvetësishme, e pavarur nga Pedagogjia!***

Nga koha kur në treg nuk kishin mbetur kopje të tjera, interesimi i lexuesit për librin rritej në Kosovë, Maqedoni e Veriut dhe Shqipëri. Libër-shkruar ishte ndie i kënaqur me vlerësimet e porositë e vjela të fillimit fare, në faqen e tij të Internetit (nga persona të panjohur për atë);

Mësuesi: Metodika e juaj MMM(2008) po i sjellë frytet e veta. Kjo më së miri shihet tek nxënësit e mi. Me lehtësi të madhe kanë mundur ta kuptojnë lëndën e matematikës në vitin shkollor 2008/2009.

Avidiu: Kur dëshiroj të jem më i afërt me nxënës është e pamundur mos t'i kujtoj metodat e juaja mësimore! Atëbotë, shumë veta nga bota alofone donin të komunikonin me autorin por Safiri i mjerë, nuk e dinte asnjë gjuhë të huaj; i dënuar nga Regjimi antipopullor e antikombëtar që në vitin e 1961!

Kur njeriu dinë ta shpreh veprën e vet atëherë ai është pronar i saj. Por kjo për Safirin nuk ishte e vlefshme! Kolegët e punës dhe të profesionit, së bashku me ish dekanë dhe vartësitë e tyre; mediokër dhe demagogë; ziliqarë dhe matrapazë; hipokritë dhe dallkaukë 'ia grabitën nga duart' librin MMM (2008) për t'u shërbyer vetë me atë, për qëllime përfitimi profesional dhe material. Atë të trajnuar nuk e futën në listën e 'Trajnerëve të dëshmuar' (fals) në Programin e Avancimit dhe kualifikimit të mësimdhënësve AKM ku pjesëmarrësit e saj ishin Ligjërues për Metodologji e mësimdhënies. Edhe pse libri MMM (2008) përdorej për literaturë, ai nuk ishte i angazhuar sepse e dinin që ishte mbështetës i Pushtetit të notës dhe donin të bënin 'punë pa dëshmitarë' por edhe trajnerët tjerë të dëshmuar ishin bile 'tramak pa asnjë kokërr'. *Me punën, veprimin, fitimin e shumë parave dhe sjelljen e tyre prej ultramatrapazësh arsimorë, dallkauk e hipokrit; mediokër e demagogë, bëri që saktësisht pas dekadash të krahasohemi me Arsimin afrikan!!!* 'Esnafi prej titullarësh të Degës së matematikës' së bashku me një biçim pedagogësh dhe gjuhëtarësh të gjithë me 'grada shkencore' (shumë prej të cilave nuk kishin njohje as nga familjarët e tyre) autorin plak të MMM e patën shndërruar në 'qiraxhinj të shtëpisë' ndërtuar me duart e tija, në një lëndinë të djerrinës shkëmbore ku më parë nuk kishte shkel 'këmbë shqiptari'!

XV. BOTIMI I LIBRIT TË GJASHTË, LOJËRAT MATEMATIKE ME METODIKË (2013)

Veterani i 'dehur nga puna' dhjeta vjeçare për shumë intelektualë 'bëhet pengesë në jetën e tyre'! Në memoaret e tija ai shkruan: Një vit pas pensionimit atëherë kur më së paku prisja, një biçim gjuhëtarësh përreth meje me qëllime djallëzore më nxitën mos ta ndalojë të shkruarit! Duke ma kurdisur modelin e 'Kalit të Trojës'- thoshte Safiri, nëpërmjet një 'kontrate false' të nënshkruar në origjinale nga ish 'Rektori matrapaz' (2011) donin ta provonin 'pushtimin edhe të një pylli' i cili ngjasonte një 'xhungle të braktisur'! Puna ishte përpjekja për ta shkruar librin lidhur me nocionet fillestare matematike për më të vegjëlit; parashkollorët dhe ia doli për ta përfunduar në moshën gjashtëdhjetë e shtatë vjeçare, të gjashtin me radhë të cilin e kishte lënë mangët.

Një 'biçim udhëheqësi' ('komisari i dritës') fillimisht e nxiti dhe më pas e motivoi për ta kapur rishtas lapsin në dorë. Motivimi ishte për ta mbajtur në vazhdim një cikël ligjëratash semestrale nga LMM. "Në fund të ditës doli që angazhimi të jetë një mashtrim"! Megjithatë puna për ta hartuar *librin me ngjyra* për para-shkollorët nuk bën të ndërpritet! Rrethanë ca rënduese doli të jetë *pleqëria e hershme* gjashtëdhjetë e shtatë vjeçare! Beteja e parë njëvjeçare, formimi i dorëshkrimit nga variantet e krijuara doli i kënaqshëm (në pamundësi konsultimi me ndonjë 'person me frymëmarrje')! 'Bartësi i mashtrimit' përgjatë gjashtë-shtatë viteve e angazhoi 'doktorin e ekuacioneve' i cili për kursin në fjalë ligjëronte 'zgjidhje ekuacionesh' ndërsa 'studentet nuk bënë zë, ishin shndërruar tamam në dele'!

Safiri kishte etje të madhe për dije, të shpërndajë rreze diturie aktuale lidhur me Mësimdhënien bashkëkohëse parashkollorë të cilën do ta përdornin mësuese kopshtesh dhe fëmijët e grup-moshave (3-4); (4-5); (5-6) vjeç. Përkundër vështirësive të shumta të shfaqura gjatë hartimit të këtij doracaku vërehen përpjekje për shkrime, të cilat buronin nga shpirti krijues i një mësuesi:

*"Duke u fut në qenien e fëmijës" u përpoqa të bëhem fëmijë, për aq kohë derisa po shkruaja këtë dorëshkrim për mësueset e fëmijëve!

*Nga vetja e kërkoja të pamundurën, "të shpjegoja atë që nuk shpjegohet"; "ta shkruaja atë që nuk shkruhet"; "ta vizatoja (skicoja) atë që nuk vizatohet (skicohet)", lidhur me "blloqet logjike"!

*Pas pensionimit mbase i fortë nga goja dhe nga lapsi, pak besoja nga mandati im! Si ka mundësi personi i cili ndodhet në moshën e pleqërisë t'i rikthehet kohës së rinisë; për ta shkruar pengun e madh të fëmijërisë!

*Në cilësinë e krijuesit ndjehem pikërisht si fëmijë 7-të vjeç, i lumtur, i plotësuar dhe i realizuar!

Pas suksesit të arrirë me librin MMM (2008), ish bashkëpunëtorët e mbetur gjallë (gjuhëtarë; matematikanë; pedagogë) për arsye të ndryshme nuk dëshironin të ofronin ndihmesë profesionale për librin LMM (2013). Për çudi asnjëri nuk donte të angazhohej (në këtë mënyrë); ata pjesëmarrjen e donin si koautorë libri! Mungonin: Anëtarin e Këshillit Botues Universitar (UP gati ishte zhbërë!); Recensenti; Redaktori; Lektorin dhe Korrektori. Safiri ndodhej para një dileme të madhe; të heq dorë nga dorëshkrimi apo ta vijojë punën në mënyrë ca të 'egër' në kohën kur 'Rektorët e kontestuar të njëpasnjëshëm' të UP ndërroheshin sikur kollaret (para e pas 2013)! 'I hartuar me shumë nguti' përgjatë një viti, në pleqërinë e

hershme të tij, pa kontribute të matematikanëve (smirëzi e ziliqarë) dhe të pedagogëve (të zënë në të shkruar për llogari të tjetër kujt); nuk kishte si të ndodhë ndryshe, pos që autori të mbetet i pakënaqur me cilësinë dhe vlerën e librit të cilit i mungonin: Parimi i Maturisë në të shkruar dhe ilustruar; vërejtjet e mësueseve të dalluara (të cilat donin ta mbanin dorëshkrimin në shtëpi së paku dhjetë ditë dhe kjo punë e tyre të paguhej);(ekzistonte droja nga kushti i parë që dorëshkrimi të keqpërdorej!); Piktori Ak. për ilustrime të ngjyrosura, me pagesë të pa imagjinueshme dhe Recensentët matematikanë.

I mbështetur për muri atë formalisht e ndihmuan *veteranë arsimit* por çuditërisht asnjëri prej tyre nuk ofroi ndihmesë reale për ta shkruar së paku atë çfarë dinin; ndonjë fjali vërejtjesh të cilat ishin evidente! Çuditërisht i moçmi për nënshkrimin e dhënë pa asnjë kontribut të ofruar kërkoi edhe mori pagesë në lartësinë e një pensioni!

Për ta botuar *librin me ngjyra*, punë komplekse e kushtueshme dhe me përgjegjësi, për herë të tretë, punimet mrekullisht i kreu shtëpia botuese "SIPRINT"- Prizren. Libri LMM (2013) u botua me ngjyra i kushtueshëm dukshëm. Ilustrimet e shumta dhe faqosja po të punoheshin nga piktori akademik do rritnin akoma më shumë çmimin e tij.

Safiri vendosi '*huazimin*' e ilustrimeve prej disa librave në gjuhën gjermane por dhe nga Interneti! Figurat (pamjet) e bollshme, të bukura e të rralla në cilësinë e mjeteve shprehëse ishin ç'lodhëse, tërheqëse, interesante, funksionale dhe me vlera formuese. Figura gjithnjë duhet të thotë diçka. Ajo flet 'gjuhën' e saj dhe 'përktimi' nismëtar i mbetet mësueses! Një foto e përzgjedhur dhe e bukur flet më shumë se 'historia' e përmbajtjes matematike. Figura të mëson që në bazë të intuitës, të (ri)-'zbulojmë' dhe emërtojmë: sende e objekte; pikësime e vijëzime; forma e ngjyra; emra e koncepte; simbole e numra; vizatime e modelime; rregulla e ligjëtori; zgjidhje e rrugëzgjidhje; ndërtime e rindërtime; sasi e madhësi; kohë e hapësirë...

Për librin parashkollor autori bëri shumë kujdes për të mos qenë mall i lëndueshëm. Duke pasur këtë ndjesi i bëri të gjitha përpjekjet për ta hapur një dritare dritëshumë për komunikim me fëmijë, nëpërmjet figurave me ngjyra të cilat flasin gjuhën e tyre me shumë ngrohtësi! Ato tek fëmijët ndezin emocione të fuqishme, të bukura e të gëzuara, kujtime mbresëlënëse plot e përplot me mallëngjim deri në përfaqim!

Leksionet: '*Lojërat matematike me metodikë*', Safiri i kishte ligjëruar edhe në dekadën e nëntë të shekullit të kaluar por paksa më ndryshe! Atëbotë tek ne kishte zënë rrënjë forcërisht Mësimdhënia tradicionale e mësimdhënies pa mësim-nxënie!

Për ndryshimet substanciale të kohës që po vjen duhej të pritnim edhe disa dekada! Nuk kishim asnjë ndër më të voglat njohuri për: ***Teknikat dhe Strategjitë e Zhvillimit të Mendimit Kritik; Objektivat mësimorë; Edukimin e aftësive kompjuterike; Orën e mësimin, strukturën e saj ERR (Evokimi, Realizimi i Kuptimit e Reflektimi)***. Mësuesi nuk mund ta mësojë dhe aftësojë nxënësin për gjithçka që i duhet në jetë; Domosdoshmëria për vet-arsimim gjatë tërë jetës, nëpërmjet vet-nxënies; Nxënësi të pranojë rolin e mësuesit; Vetëvlerësimin;...; të cilat do jenë 'shtylla ndërtimi' për Mësimdhënien bashkëkohëse. Me keqdashje dhe punë qelipiri material në njërën anë dhe dembelosje në anën tjetër, të gjitha Metodikat e

lëndëve mësimore i konsideronin Disiplina Pedagogjike dhe Metodika e Matematikës ligjërohej nga Pedagogët uzurpues edhe pse u mungonin dituritë bazike të Matematikës elementare!

Libri LMM(2013) i gjashti me radhë i paplanifikuar, me ngjyra, i kushtueshëm, i botuar në vetëm 300 kopje meqenëse nuk e ligjëronte; *tri 'betejat'* e të cilit krahasuar me librat tjerë i dolën më të vështira. Radha i erdhi zhvillimit të *'betejës së tretë'* të librit- shitjes! Fare shumë pak libra janë shitur mbi çmimin kushtues! Përreth dyqind prej tyre janë shitur nën çmim kushtues dhe kjo përgjatë vitit të parë dhe të dytë pas botimit në këto vendbanime (çerdhe dhe shkolla): *Prishtinë*: Gëzimi ynë; Bardha 1; Little stars; Yllkat; Butrinti; Loja; Dielli; Xixëllonja; Libraria Artini; Libraria Kada; *Pejë*:Pëllumbat e paqes; Shtëpia e Diellit; ABC; Lidhja e Prizrenit; Vaso Pashë Shkodrani; Dardania; *Prizren*: Nëna Kabrini; *Gjakovë*:Mehmet Akif; Zekeria Rexha; Fehmi Agani; Këlmend Rizvanolli; Yll Morina; Ganimete Tërbeshi; Agu; Dielli; Bleta; Gjilan: INTEGJ; Thimi Mitko; Musa Zajmi; Mitrovicë:Gëzimi ynë; Nina; Folea; Abdullah Shabani; A.Z.Ç. Çajupi; Qyteza: Rahovec; Tulipanët; Ardhmëria; Deçan: Junik;Fshatra: Prejlep; Piskotë; Strellc; Zrze; Novosellë e Ultë; Novosellë e Epërme; Ferizaj: Xhon Sereçi; Ahmet Hoxha; Kopshti i Ri.

Tri ditë para mesit të Nëntorit të vitit 2015, në dhomën e tij të punës i shtrirë në divan dëgjonte Lajmet lidhur me Panairin e Librit në Shtetin Amë, u ballafaqua me vdekjen tinëzare, pa asnjë parashenjë dhimbjeje të çfarëdo lloji! Ishte në pritje dhjetëminutëshe për ta thirrur familjarët për të drekuar.Ndodhi 'vetëdorëzimi' duke mos pasur mundësi të lëshojë çfarëdo klithme sado të vogël e lëre më të telefonojë për ndihmë! I kujtohej që kishte rrëshqitur bythas nga divani për në dysheme, i 'vetmuar', në heshtje, pa dhimbje, ndodhej në ikje e sipër,pa mundësi për ndonjë amanet!

Fati për ta fituar një 'aneks jetësor' ndodhej në anën e Safirit!Me gjasë nga 'momenti i dorëzimit' deri te 'thirrja për të drekuar'nuk duhej të ketë zgjatur shumë. Falë reagimit si 'vetëtima' të Marigos merr lajmin Ideali, Internist në Gjermani dhe poashtu si 'vetëtima' arrinë me ndërhyrje Ekipi mjekësor i emergjencës spitalore dhe falë tyre, jeta e Safirit ngadhënjeu mbi vdekjen e sigurtë! Përgjatë pesë ditëve vijuese mbështetur në teleterapi në gjermane, realizues të së cilës ishin kolegët e djalit, shëndeti i Safirit ngadhënjeu mbi sëmundjen! Ngjarja mund të kishte rrjedhur dhe ndryshe, kur kihet parasysh që pak muaj pas Luftës së fundit, nga diagnoza e njejtë pas tri javësh qëndrimi në spital,iku vëllai i tij më i madh. Këndellja erdhë më ngadalë, fatbardhësisht pa pasoja fizike dhe intelektuale dhe automobilin e tij do ta zëvendësojë 'këmbabili'; në njërën anë batallisi ngasjen e veturës dhe në anën tjetër i shumëfishojë ecejaket e tija të përditshme deri pesë-gjashtë kilometra të përcjella me kontrollë e analiza mjekësore.

Në qytetin e lindjes 'tramaku pa kokrra'dallkaku i cili e kurdisi kalin e Trojës për ta shkruar LMM (2013), smirëziu, shkollë-paku e pengoi shitjen në masë të librave nëpër çerdhe! Në vitin 2015 ai braktisi ngasjen e makinës duke ndërprerë plasmanin e librit LMM (2013)! Tani miqëve, dashamirëve, fëmijëve, shokëve, shoqeve (familjare), personelit mjekësor, teknikëve shëndetësorë, gjysheve të përkushtuara, fqinjëve të cilët kishin nipa apo stërnipa,....nga zemra u dhuroi nga një kopje libri dhe këto afërsisht nja njëqind(me listë emërore)!Aktualisht, në bibliotekën familjare të tij ndodhën edhe tridhjetë kopje që do thotë e dhjeta e tirazhit!

Shkrimtarët, dijetarët por dhe shkencëtarët kur ata tashmë kanë shkruar disa vëllime librash, të cilat e kanë gjetur lexuesin dhe autorët në fjalë përgjatë jetës në vazhdim nuk kanë probleme të theksuara shëndetësore edhe po që se deklarohen '*do jetë libri im i fundit*', lexuesi do duhej pohimin ta vlerësojë 'pak të besueshëm'!Kështu e thotë Safiri sepse ka prova të mjaftueshme vërtetësie tek vetja.

XVI. TURPI I AKADEMIKUT TË RINJ, ANËTAR REDAKSIE ENCIKLOPEDIË!

Në fillim dhjetori të vitit 2018, Safiri fare rastësisht u fut në librarinë “Iliri kum” të qytetit aty ku shërbente një ish student i tij dhe e kërkoi Fjalorin Enciklopedik të Kosovës për ta blerë (kompleti në dy vëllime kushtonte pesëdhjetë euro)! Gjatë punës së tij krijuese e kishte përdorur Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe me dhjetëra mija herë dhe ‘sa çelë e mbyll sytë’ në kërkim të shkronjës K, e gjeti mbiemrin e tij Kromi! Aty ndodheshin disa familjarë të një gjaku por mungonte emri i tij Safir! Nuk kërkoi emra të tjerë, nuk dëshironte të krahasohej me askënd. Nuk kaluan plot tre minuta, mbylli njërin vëllim, nuk e bleu, librarit i kërkoi falje u përshëndet me atë dhe iku!

Mungesa e pranisë së Safirit në ‘Fjalor’ ishte simptomatike, e habitshme për atë por dhe për të tjerët që e njihnin së paku për faktet: Deri atëherë ishte autor i gjashtë librave universitarë dhe për të qenë ‘figurë e pagabuar’ e ‘Fjalorit’, personi akademik i autorizuar që do duhej ta bënte evidencimin (pa inate personale) së paku edhe të matematikanëve (e të tjerëve) thuaja ishte i po asaj lagjeje (i rritur nga fëmijëria e hershme në prehër të xhaxhait tij, mësues matematike)! Akademiku kishte pretenduar që ‘rasti do kalojë në heshtje’ dhe ‘matematikani i vonshëm’ nuk do dijë të reagojë ‘as me gojë dhe as me shkrim’ dhe unë mbetem mësues i tij edhe pse jam katër vite më i rinj se ai! Mjerisht, Ak.-u në fjalë tani në Shekullin e Rinj na doli të jetë me mendjefuçkë duke e harruar që *dituria është kurdoherë pranë të diturit e mbron atë nga njeriu i lig!*

Nuk kaloi asnjë javë dhe mori qëndrim për ta adresuar një Reagim me shkrim nëpërmjet një shkrese Rekomande (meqenëse Reagimi nëpërmjet kompjuterit mund ta humbas rrugën!) drejtuar Kryeredaktorit të Fjalorit Enciklopedik të Kosovës me këtë përmbajtje:

REAGIM

Fillimisht, pranoni urimet e përzemërta për botimin e Fjalorit Enciklopedik të Kosovës (2018), punë madhështore, atdhetare, me përgjegjësi të madhe morale, e gatuar nga ASHAK. Kjo punë intelektuale kërkon vlerësim dhe mirënjohje! Në këtë punë voluminoze edhe po qe se është bërë ndonjë gabim pa qëllim të caktuar, lidhur me mos përfshirjen e personave dhe personaliteteve publike, ato të gjitha janë të falshme më qenë se gabimet janë njerëzore. Mendoj, për “Fjalorin” është dashur të aplikohet version i printuar në formë elektronike në Internet t’i kryheshin dy deri tri korrekture publike, e më pas ta merrte formën përfundimtare edhe si libër fizik!

Me gjithë pritjen e bazuar, unë Safir Kromi nuk pata vend në “Fjalor”?! Nuk dua të besoj që ndonjë anëtar i ASHAK në përzgjedhjen eventuale të personit t’im është udhëhequr nga motive të larta apo të ulëta apo me të dyja sëbashku!

Në analizën t’ime, me punën e fundit tridhjetëvjeçare në Arsimin e Lartë (1980-2010) bëra shumë përpjekje për të shprehë vetën por edhe për t’i bërë vend vetës në këtë “Fjalor” apo në ndonjë ranglistë tjetër! Unë nuk jam dhe nuk desha të isha si shumë të tjerë përreth meje. Karriera ime e gjatë profesionale është e veçantë dhe specifike, “i dehur nga puna shkencore”, por për fat i “pa ekspozuar” nga media! Megjithatë unë nuk jam fajtor që ju nuk më njihni!

I mbështetur në argumente dhe fakte; dëshmi dhe arsye; ja përse personi im do të duhej të kishte hapësirë sa do të vogël identifikimi në “Fjalor”:

*Autor i gjashtë librave universitarë të lëmit *Metodikë e mësimit të matematikës* (MMM) në mesin e tyre dhe autor i *Metodologji e mësimit të matematikës* (MMM, 2008), libër bazik, i pari i këtij lloji në trevat shqiptare. Për çdo pesëvjeçarë u shkrua, u botua dhe u plasua për shitje (tre beteja) nga një libër nëpër shkollat fillore dhe personin t’im mësuesit e Kosovës e njohin me zë dhe me figurë!

(1987) I Metodika e mësimit të matematikës

Për studentët e SHLP-së-Dega e matematikës; Botues dhe Financues ETMM-2000 kopje ;

(1993) II Metodika e mësimit elementar të matematikës

Për studentët e SHLP-së Dega e Mësimit klasor; Botues dhe Financues Autori, (500+500) kopje;

(1998) III Metodika e mësimit të matematikës

Për studentët e SHLP-së –Dega e matematikës, FSHMN- Dega e matematikës, të Fakultetit Filozofik-Dega e Pedagogjisë,

Botues dhe Financues UP, 500 kopje;

(2003) IV Metodika e mësimit elementar të matematikës

Për studentët e Fakultetit të Edukimit- Dega e Mësimit Klasor, të Fakultetit Filozofik- Dega e Pedagogjisë, Botues UP; Financues Autori, 500 kopje;

(2008) V Metodologji e mësimit të matematikës

Botues dhe Financues Autori, 500 kopje;

(2013) VI Lojërat matematike me metodikë

Për studentët e Fakultetit të Edukimit, Programi Parashkollor,

Botues dhe Financues Autori; 300 kopje.

Të gjitha botimet (gjashtë) ndodhën në sirtarët e Bibliotekës Kombëtare, në Tiranë.

Gjithsej 2800 kopje libri janë plasuar për shitje nëpër shkollat fillore të Kosovës nga vet autori, rast paksa i rrallë për mjedisin kosovar; i ngjashëm me rilindësit! Kjo literaturë u krijua nga asgjëja, nga hiçi! Ja se çfarë kishte deklarua në vitin e largët (’87) pranë shkollës ku punoja (autori nuk ishte prezentë) ish-Ministri i arsimit: *“Kemi gabuar që lejuam botimin e librit MMM (’87)! Si do të paraqitemi para opinionit jugosllav me autor anonim, kur mësuesi i parë i matematikës ndër ne (1952) ende nuk ka shkruar Metodikë të matematikës”!*

Dhe para meje është shkruar Metodikë e matematikës por paksa më ndryshe ose është shkruar për Histori të zhvillimit të matematikës (plan-programe, lëvizje reformiste, kongrese, konferenca, projekte

didaktike, tendenca etj); ose *Metodikë matematike* (klasike) *me autorë pedagogë*, të cilët nuk kishin qasje tek njohuritë elementare matematike! Metodika dhe Metodologjia e matematikës u ishte dorëzuar vullnetarisht Pedagogëve! Ato ishin një oazë pak e shkelur nga matematikanët shqiptarë në të dy anët e kufirit, për arsye të ndryshme, thjeshtë ishin një “xhungël e pashkelur”!

Recensentë të librave: (1993); (1998); (2003) dhe (2008) kanë qenë ndër matematikanët dhe pedagogët më të mirë që kishte vendi dhe anëtarë të ASHAK. Botimeve të viteve (1998); (2003) dhe (2008) nga Recensentët u dha statusi *TEKSTE BAZIKE* me përdorim për dy apo më shumë Fakultete dhe Degë të tyre. *Redaktorë gjuhësorë* të librave: (1998); (2003); dhe (2008) ishte njëri ndër gjuhëtarët dhe akademikët më të mirë që kishte vendi!

Botimi MEM (1993) ndodhi në kohën kur shkolla shqipe ishte ‘burgosur’ dhe ETMM ishte nën dry, atëherë kur luftohej në disa ish republika sllave, ndërsa në çdo skutë të Kosovës ndihej ‘erë lufte’. Ikja masive i të rinjve tanë nëpër Evropë ishte shumë i dhimbshëm dhe pikëllues për kohën. Bashkë me ata atëherë u larguan edhe shumë kadro të mirëfilltë të UP-së. Botimi i këtij libri ishte refleksion dhe rrjedhojë e shqetësimit të madh të autorit, për fatin e shkollës shqipe, këtu tek ne në Kosovë. Bën pjesë ndër botimet e para universitare të vetëfinancuara, për të mos thënë i pari! Kjo vërehet me faktin që në faqesjen e librit mungonte Stema e UP-së (mars, ’93), ndërsa në botimet e mëvonshme universitare, Stema e UP për autorin ishte domosdoshmëri! Libri është shitur përgjatë pesë viteve nëpër shkolla dhe jashtë tyre, në tirazh (500+500) kopje, si “mall kaçak”!

Libri MMM (1998) është botuar në kohën kur në Kosovë luftohej nëpër fshatra! Me rastin e botimit të dytë në kryerreshtin e tretë, ja çfarë është shkruar: *“Në harkun kohor ndërmjet botimit të parë dhe atij të dytë (1987-1997), këtu te ne në Kosovë u shfaqen dhe u realizuan ecuri dhe rrjedha shkatërrimtare të Arsimit Kombëtar, në gjitha nivelet. Falë ngulmimit dhe durimit të paepur gjithë popullor, sakrificave mbinjerëzore edhe të vetë personelit arsimor deri në vetëflim, për ta ruajtur shkollën shqipe me çdo kusht, ajo mbijetoi”*. Kjo ishte dhe një thirrje që i bëhej vdekjes. Librat ishin “mall kaçak”, i ndaluar dhe ilegal me rrezikshmëri. Gjatë çdo udhëtimi Bregu i Diellit – vendlindje autori nuk e kishte guximin të bartë më shumë se dhjetë kopje libri! Mundësia për t’u zhdukur si udhëtar pa gjurmë ishte e madhe! Atëbotë kush ka jetuar në Kosovë këtë duhej ta dijë!

Libri MMM (2003) si dorëshkrim përfundoi në verën e vitit ’98 atëherë kur nga kodra e Çabratit, granatahedhëset bënin kërdi në Rekë të Keqe. Luftohej edhe në Glllogjan e Dushkajë, ndërsa autori i këtyre rreshtave shkruante shkencë, ishte tjetërsuar!

Libri i pestë Metodologji e Mësimdhënies së Matematikës (2008) padyshim ishte ajka e librave të botuar. Ishte libri i parë Metodologjie bashkëkohëse për matematikën në Gjuhën Shqipe. Në vigjilje të botimit të këtij libri (2008) ndalohej botimi i librave universitarë nën ombrellën e Rektoratit! U çuditën e u çmeritën të gjithë njerëzit e lidhur me librin, shkollën, shkollimin dhe jo vetëm ata! Autori e hapi edhe njëherë kuletën për ta botuar privatisht, pa stemë të UP dhe ndalimi i botimit ishte kërcënues, edhe pse Recensentët Akademik i jepnin statusin e *Tekstit bazik universitar*! I kërkuar dhe i shitur si buka nëpër shkolla anë e mbanë vendit përgjatë një viti kalendarik (mars 2008- mars 2009)! Në mbrojtje të shkollës

shqipe dhe në Kosovë me pagesë njëqind euro në muaj në periudhën kohore (1989-2003) isha bashkëpunëtorë katërbëdhjetë vjeçar në SHLP në 'Qytetin e Urave' me fond të plotë orësh!

Megjithatë është diçka që nuk shkon logjikisht! Nga akademikët e mesit Tuaj nuk isha i panjohur, disave prej tyre u kisha dhuruar nga një kopje libri (MMM-1998) dhe (MMM-2003). Për të parin isha shumë i njohur, bile deklaroj që ai m'i dinte edhe lugët në krojshën (shportën) t'ime. Botimet e librave të m'i për atë kanë qenë një 'halë në sy' edhe atëherë kur 'shkolla shqipe ishte e burgosur'! Spikasim një debat të zhvilluar ('subjekt diskutimi' i tij ishte Safir Kromi) ndërmjet Recensentit të librit MMM ('98) dhe dy akademikëve të ngritur vonë, të udhëhequr me mentalitete të shekullit nëntëmbëdhjetë:

Ak. i shekullit 19-të: "Në botimin e librit MMEM ('93) keni bërë gabim në dhënien e Recensionit pozitiv ndërsa tani në botimin tjetër Metodika e Mësimdhënies së Matematikës ('98), keni gabuar akoma më shumë në dhënien e Recensionit tjetër pozitiv"!

Recensenti Ak. "*Libri është pranuar si Tekst bazik për FSHMN- Dega e Matematikës dhe libër matematike mund të shkruaj Unë, Ti dhe Ti por libër Metodike çfarë ishte MMM ('98) nuk do dija ta shkruaja as Unë, as Ti dhe as Ti!*

Çfarë motivi e detyroi atëbotë (në kohë lufte) ish- Akademikun e matematikës të shprehet me aq smirë në mënyrë aq mohuese kur për këtë libër Rektorati i UP-së për ta botuar për studentët e tri fakulteteve në mesin e tyre dhe për FSHMN aty ku punonte Akademiku, kishte pjesëmarrje gjysmën e mjeteve financiare! Mos vallë kishte ëndërruar që në ardhmen mund t'i rrezikohej 'Posti i Akademikut'?!

Krejt në fund: Faktet e ofruara janë të mbështetura dhe kokëforta. Për sa i përket (pa)meritës së autorit të (mos)gjëndet në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës, përveç opinionit intelektual para se gjithash flasin *Librat e botuara*, në "*gjuhën e tyre*". Me punën shkencore dhjeta vjeçare ndjehem krenar. Librat e botuara dhe rrethanat e plasmanit tek lexuesi duhet trajtuar si trashëgimi kulturore (shkencore) por dhe kombëtare. Nuk është etike-thotë Safiri megjithatë mbetem *pionier Metodologjie matematike!* Para se të iki nga kjo botë, asgjë nuk më mbetet peng. Dhe pas ikjes sonë, me gjasë të tjerët do të shkruajnë për ne! "Përmendorja e përmendoreve" e çelë shtegun që edhe pas pesëdhjetë apo njëqind vitesh, këta rreshta të shkruar do ta shohin dritën për të jetuar edhe pas vdekjes, pa e pasur emrin në Fjalorin Enciklopedik të Kosovës! Dituria është kurdoherë pranë të diturit, e ruan atë, i jep emër të mirë për kohë të pacaktuar!

Tronditjet e forta shpirtërore të cilat i pësuan njerëzit tanë përgjatë luftës dhe pas luftës së fundit, në cilësinë e 'traumës së mbyllur' mbetën pjesërisht të shëruara ose të pashëruara! Në këtë rrafsh, personi i cili e pa vdekjen me sy; e 'përqafojë' atë me dhjetëra herë; thënë të drejtën ç'fajësohet plotësisht! Gabimi i tij qëndron në pranimin e 'Qyrkut të Nasradinit'! Gabimi madhor mbetet tek 'propozuesi e vitit 2013'! Cilat prova, argumente dhe analiza ishin ofruar për të justifikuar që gjendja psiko-sociale e tij ishte OK! (e tëra në rregull)?!

Megjithatë, Safiri mendon edhe ndryshe: 'Akademiku' vështruar nga afër, mbështetur në sjellje dhe qëndrime, gjithnjë ka mbivlerësuar punën shkencore- personale të arritur katër dekada më parë e cila tanimë ka mbetur e 'vyshkur' duke ra në intelektualizëm. Nga viti ('98) 'qahej për hallin i cili me kalimin e kohës do rritej'! Në anën tjetër gjithnjë ka nënvlerësuar aftësitë krijuese - shkencore të 'personave të pakualifikuar'; 'pa gradë shkencore'; 'made in Daxner'

XVII. TREGIMI PËR LIBRAT DHE BOTIMI I LIBRIT TË SHTATË, MMM (2020)

Matematikani i vonshëm do bëjë përpjekje të spikatë të pathënat lidhur me librat tij fizik, ndër vite (1987-2020), periudhë kohore 33 vjeçare bashkë me 'historinë' e kopër tinave!

'Poligoni i të ushtruarit' për të lexuar; shkruar; e më pas për të botuar punime me përmbajtje matematike ishte krijuar që moti, në vitin e largët 1970, atëherë kur u themelua Universiteti ynë. Ajo ishte Shkëndija, fillimisht dhjetëditëshe arsimore, pedagogjike e shoqërore dhe më vonë e përdyjavëshë! Udhëheqej nga Këshilli Botues me trembëdhjetë veta (në cilësinë e Recensentëve) me kryetarin e tij, të gjithë personalitete me kredibilitet, të mirënjohura dhe të afirmuara publike të kohës; nga lëmi i arsimit; i gazetarisë; shkencës; artit dhe politikbërjes!

Matematikani i vonuar kur fillojë të shkruajë dhe të botojë në faqet e kësaj gazete ishte viti dymbëdhjetë i botimit të saj, moshë minorene! Interesimi për punime nga lëmi Mësimdhënia matematike ishte befasues për fillestarin, më i madh se pritej dhe mendohej, thuaj se nuk kishte shkruar askush para tij nga Metodika e Matematikës, ajo ishte batallis!

Nga 16 punimet profesionale të botuara në Shkëndija përgjatë viteve (1982- 1990), më i vlerësuar mbetet "*Si të zhvillohet dhe përparohet mësimi elementar i matematikës*" (nëntor, 1983). Kjo për faktin që punimi në fjalë ndodhej në faqen 12-të përballë punimit të faqes 13-të "Aktualiteti i pashtershëm i veprës së Migjenit", e shkruar nga penda e shquar e letrave shqipe, përndryshe Akademik! E "përkthyer" kjo do thoshte; punimi nga Matematika (nga fq.12) ishte vlerësuar dhe pëlqyer shumë dhe 'krahasohej' me punimin nga Gjuha shqipe (në fq. 13); por dhe me subjektin Migjeni, që analizohej nga Akademiku! Ishte kjo një 'mirënjohje' dhe 'respekt' për ata 'që dijnë të lexojnë në mes rreshtash'! Sikur Shkëndija mos të funksiononte atëbotë si gazetë arsimore apo të punohej pa Këshill Botues eminent dhe aty Safirit mos t'i botohej asnjë punim profesional, gjasat për ta hartuar M M M ('87) do ishin iluzore! Kjo mbetet një provë dëshmie e prekshme, që edhe Socializmi vetëqeverisës ka ditur të arsimojë!

Botimi i librit të parë MMM ('87) ishte me shumë fat dhe vendimtarë në "botimet seriale" të radhës. Ai u botua falë rrethanave politike, "kohë shtrigash" (aspak të favorshme për UP, i cili vite më parë kishte filluar të emërtohej si Universiteti i Kosovës dhe dembelisë së pashpjeguar të mësuesve të tij, metodikanë)! Nga viti 1981 kishte filluar 'diferencimi ideo-politik' i kuadrit të eminencës universitare dhe largimi i tyre nga procesi mësimor, në mbështetje të bindjeve të tyre politike! Libri u botua edhe falë këmbëngulësisë katërvjeçare autoriale që nuk u nda nga "ëndrra" për ta 'ringjallur dorëshkrimin' i cili katër vite qëndroi në 'Morgun e dorëshkrimeve' të E T M M! Përgjatë katër viteve ('83-'87) në relacionin 'Qyteti i katër lumenjëve'- "Qyteti pa lum" udhëtoi më shumë se gjashtëdhjetë herë; i sorollatur e i bezdisur; i harxhuar e i lodhur! Stimuli moral i kësaj 'pune boshe' thoshte atëherë Safiri; mund të krahasohej me atë të një të 'burgosuri të përjetshëm'! Përgjatë 'vizitave' në ETMM, as dy herë rradhazi nuk kishte marrë përgjigje të njëjtë: "Do botohej"; "nuk do botohej"; "do botohej si dispensë"; "nuk do botohej as si dispensë"! Meqenëse situata politike ishte e 'turbulltë'; okteti i kundërshtarëve donin rrjedhje të pafund kohe.

Recensenti me 'vlerësimin e dykuptimshëm' kishte ofruar 'pazar shit-blerjeje'; këmbimi (malli me mall, i realizuar në kohën kur mungonte paraja)! Malli aktual i çastit ishin 'vërejtjet tona' kundruell shkrimeve të njëri-tjetrit; por nga pesha, roli dhe rëndësia e tyre, ato nuk ishin të

barasvlershme! Pra oferta ishte 'eliminim' vërejtjesh të dyanëshme për të cilat ish-studenti i tij nuk ishte pajtuar! Në dorëshkrim ishin kritikuar librat e tij për disa klasë (IV; V; VII); me përmbajtje të stërholluar, ku nuk përfillej Parimi i Maturisë! S'tundej nga vendi, ideja, sjellja dhe mendimi personal!

Një vit para se të botohej M M M ('87), atij në cilësinë e koautorit (vet i treti) u doli nga shtypi një libër universitar. Po në atë kohë ETMM e 'shpalli të humbur' Recensionin e tij (dhënë me 'dy kuptime')! Kërkoi nga Safiri një kopje të re të atij Recensionit! Në këtë mënyrë 'lindi Dielli i shpresës' për botim të M M M ('87)!

Nga fundi i faqes së parë të Recensionit u hoqën tre rreshta me dykuptimësi dhe ai e mori 'kuptimin e plotfuqishmërisë' si pozitiv. Në vazhdim përgjatë gjashtë muajve të ardhshëm u emëruan edhe dy Recensentë 'të dorës së dytë' të cilët ofruan Recensione pozitive, 'duke shkruar aq sa dinin'. Treshja e kompletuar e Recensentëve (*me mungesë Pedagogu!*) i dha 'vizë dorëshkrimit për ta botuar' larg përmirësimeve të thella e përmbajtësore.

Mungesa e emërimit të një Pedagogu përparimtar në cilësinë e Recensentit për një libër shkollor, mbetet 'gabim i qëllimshëm', 'kurthë e kurdisur nga Okteti', në mënyrë që edhe po të botohej libri, atë ta përcjellnin mangësi të shumta duke e shndërruar atë në 'telenovelë' të një hiçi.

Gjashtë muaj para se të botohej libri, nënëlokja ime Drita Neone ndërroi jetë duke më krijuar një peng të madh amnor! Edhe pse e pashkollë, e kishte peng në zemër ta përjetojë gëzimin e daljes së librit nga shtypi të 'djalit të vogël' me të cilin jetonte! Në shenjë dhimbjeje dhe përmallimi, kostumet e përditshmërisë sime morën ngjyrë kaltër të mbyllur!

Para se të botohej libri, autori i tij bashkëpunoi me Lektorin e emëruar (duke identifikuar 'përmbajtje kallpe' të cilat duhej të hiqeshin) dhe me Pikturin Akademik i cili e punoi ballinën e librit. Duke vërejtur kostumet e mia të errta; ngjyra blu për ballinën e librit (në heshtje) tashmë ishte përcaktuar! Pikturi e mori fjalën: Motivi amnor është i madh, ai dallon nga personi tek personi. Në përgjithësi është dukshëm më i fuqishëm krahasuar me motivin atënor! Unë mendoja që nëna ime nuk do vdes kurrë, nënat tjera mund të vdesin por 'kjo e imja është e pavdekshme'! Ajo gjithnjë u falte moral njerëzve: bujare e shëndoshë; e bukur; e dëlirë, e ëmbël; e dashur; e mençur; mikëpritëse; e hareshme... Mirëpo erdhi dita dhe iku në amshim! Edhe tani në këtë moshë pas shumë viteve nga ndarja, shpeshë përmallohem për nënën t'ime! Deri vonë 'mendoja që ajo do kthehej'! Safiri s'i mbante dot lotët duke falënderuar pikturin për ngushllimin!

Libri u shtyp në 'Qytetin e Urave' i dalë për ta parë 'dritën në Nëntor ('87). Tirazhi 2000 ekzemplarë, të cilin do ta përdornin përveç mësuesve e tjerëve edhe studentët e tri Shkollave të Larta Pedagogjike-Dega e Matematikës.

Zhargitja kohore katërvjeçare deri në botim kishte topitur punën hulumtuese dhe krijuese të autorit për t'i përmirësuar gabimet dhe lëshimet evidente. Mungonin kontributet e Pedagogut dhe të tre Recensentëve 'zyrtarë'! Libri përmbante 175 faqe prej të cilave trembëdhjetë prej tyre kishin mbetur bosh; cilësia e letrës ishte e 'trashë' dhe e 'zezë', tamam e gazetave; kartoni i kopër tines, i 'butë' dhe jo cilësor! Një koleg pune, biolog autor i disa librave nga Biologjia pas një kohe

kishte deklaruar: 'Njëzetë përqind e librit është kallp (pa vlerë)' me vlerësimin e të cilit dakordohej edhe autori!

Disa rreshta të një faqeje (me cilësi mburoje), kishin përmbajtje ideologjike të kohës, mëqenëse dimë: "*Qëllimi justifikon mjetin*" ('Botimi i librit të ëndrruar', justifikonte 'rreshtat e ideologjisë së kohës!'). Padyshim ajo përmbajtje lozi rolin mbrojtës për t'u vlerësuar pozitivisht dorëshkrimi përndryshe aplikohej edhe '*Recension i porositur*'!

Ishte kënaqësi të gjëndeje libri jot në vitrinat e librarive të vendit por kjo nuk do thoshte që libërshkruesin do e kaplonte euforia! Kjo u provua me punën e mëvonshme, në vazhdimsi! Tirazhi prej 2000 kopjesh nuk kishte mbaruar as pas tre vitesh nga botimi i tij dhe në vitin 1990 ETMM u vue 'nën pranga', u mbyll bashkë me 'burgosjen e Shkollës shqipe', në këtë anë kufiri! Librat e mbetur pa u shitur, me gjasë ishin shndërruar në letër gazetash!

Honorari nga libri solli 400 DM të kohës dhe ajo shumë ishte 10% e vlerës së tërësishme të librit, që do thotë botimi i librit nga ETMM kushtoi 4000 DM të kohës dhe një kopje libri kushtoi 2 DM, dhjetë kopje të të cilit u blenë nga autori në një librari për t'u dhuruar miqëve dhe dashamirëve, në shenjë gëzimi, nderimi dhe kujtimi! Po të dihej që libri do botohej pas katër vitesh pritjeje dhe harxhimesh më të mëdha krahasuar me honorarin e fituar, do shkruhej sëpaku dhe një dorëshkrim i rinj, për të qenë më përfaqësues! Përvoja jetësore për të shkruar libër ishte e 'madhe' por ende pa përvojë për ta 'botuar' dhe 'shitur' atë. Koha që do vijë, ka për t'i sjellë ato të dyja bashkë!

Viti akademik 1980/81 mbetet fundi i periudhës së artë zhvillimi dhe përparimi të UP. Ende vinin studentët të huaj për të studiuar në 'Qytetin pa lum'. Rektori vizionar (ëndrrimtar) i përparimit kombëtar e kishte formuluar një 'mesazh lapidarë të rrallë, por motivues: "*Në UP nuk ka vend për asnjë mësimdhënës i cili nuk shkruan një libër ose një dispensë për studentët e tij*"! Kjo porosi punuese-motivuese ruan 'aktualitetin e zbatimit' në çdo kohë dhe hapsirë; "detyron edhe të vdekurit", të ngritën nga varri për të shkruar e shkruar; natën dhe ditën! "Porosia" mbeti "histori e paralelizuar"! Për çdo fillim viti akademik botohej Plani Botues i UP. Po që se Tituj të caktuar tekstesh universitar nuk botoheshin atë vit akademik për arsye ndër më të ndryshëm atëherë ai përsëritej dhe vitin tjetër deri në realizim!

Pas ngjarjeve të përgjakshme të vitit ('81) Universiteti ndodhej në epiqendër sulmesh të vazhduara nga Pushteti hegjemonist, fillimisht nëpërmjet diferencimeve ideopolitike kuadrosh të madhërishtme universitare për të arritur në fund të viteve ('90) ta ndërpresin financimin e tij edhe ta mbyllin 'shkollimin dhe studimin legal kushtetues'! Ishte koha që "të dyndurit donin t'ia zënin vendin autoktonit"! Përgjatë kontrolleve të rastësishme dokumentash personale (patentë shoferi; kartë identiteti e të ngjashme) tek personi të evidentoheshin "iniciali" K.R. e cila "përkthehej" Kosova Republikë; fillimisht maltretohej; paditej dhe dënohej, e pakta gjashtë muaj burg!

Nga viti ('83-'87); me diferencimet e filluara që nga viti ('81); largimet nga puna; linçimet (përrjashtimet me 'dy gishta' 'zëvendësohen' me përjashtimet me 'një gisht'); burgosjet më pas dhe vrasjet, megjithatë Universiteti përkohësisht mbeti i 'pamposhtër'! Në këtë periudhë kohore edhe Shkollat e Larta Pedagogjike (SHLP) ishin në shënjestër drejt mbylljes (funksiononin Degë të njëjta studimi në Qendra universitare në një distancë më të vogël se 40 kilometra)!

Ideja për të shkruar libër apo dispensë për MMEM kohë rrethanash të parehatshme, lindi në vitin 1984 kohë në të cilën një vit më parë u hap Dega e Mësimi Klasor pranë SHLP, në “Qytetin e katër lumenjëve”. Dorëshkrimi i parë i kësaj lënde mësimore ishte sajuar një vit më parë! Pas botimit në Shkëndija të punimit të parë: “Si të zhvillohet dhe përparohet MEM” (Mësimi Elementar i Matematikës), autori i dorëshkrimit MMM ('87) në vlerësim e sipër merrë guxim për të shkruar punime të tjera profesionale nga MEM dhe forma finale e një punimi arrihej pas përpjekjeve të përkushtuara dhjetëditore! Të njëjtat, pas daktilografimit me pagesë dergoheshin nëpërmjet Postës Rekomande në adresën e gazetës Shkëndija! Atëbotë, “*makina e memorjes*”-- *komputeri* nuk figuronte si nocion, as në Fjalorin e Gjuhës së Sotme Shqipe (1980)! Punimet ishin vlerësuar dhe botuar dhe nga kjo kohë, ‘autorin anonim’ e ndoqi fati i mirë! Pas punimit të parë të lartëcekur, botimet tjera ndodhën me këtë radhitje kohore:

*Puna me dhjetëshen e dytë; 1.shkurt. ('84);

*Të shpjeguarit e thyesave në klasat e ulëta të shkollës fillore; 15.mars. ('84);

*Puna me dhjetëshen e parë; 1.shtator. ('84);

*Çfarë metodash të përdorim në mësimin e matematikës; 1.dhe 15.tetor ('84);

*Formimi i nocionit të numrit NJË dhe shkrimi i numrit (1); 15.shtator ('85);

*Madhësitë dhe matja e madhësive; 1.mars. ('86); *për të cilat ishte paguar honorari në lartësinë e disa pagave mujore të një mësuesi!*

Në cilësinë e një rrëfimi të vockël, do veçoja punimin e datës 15.shtator ('85), kohë kur djali i autorit të punimit, vijonte klasën e parë fillore, tek mësuesja *Terri*, e përzgjedhura nga prindërit ndër më të mirat e shkollës më të madhe të ‘Qytetit të katër lumenjëve’! Shkëndija shpërndahej në të gjitha shkollat e vendit në cilësinë e gazetës obligative, për çdo mësues. Në ndërkohë, në bashkëbisedim me djalin, e hetoi që mësuesja nuk kishte përmendur asnjë veçanti (detaj) të punimit i cili kishte mbuluar një faqe gazeteje, të cilin punim u kishte kushtuar shoqërisë së djalit dhe rritës së tij! Dhe përgjatë shkollimit fillor (V-VIII) vijoi në një shkollë tjetër si ‘më e mira e qytetit’ (enkas për matematikë dhe anglisht) dhe ndodhi ‘çudia’! Përgjatë katër viteve shkollore, ‘në shenjë nderimi dhe respekti’ për babain e djalit, mësuesi i matematikës, gjatë tëra orëve mësimore e ‘bombardoi me shikim të vazhduar djalit’ për të cilën sjellje prindi i tij nuk ishte në dijeni, sepse djali nuk ankohej! Në kohën e përcaktimit për profesion jete, fati njerëzor ishte në anën e tij; nuk dha shenja lakmie për Degën e babait, por diplomojë në Mjekësi, në cilësinë e studentit të shkëlqyeshëm me notë mesatare 9.5. Në Fakultetin e Mjekësisë nuk e pranuan për asistent! U largua për në Gjermani dhe atje specializojë për Sëmundjet e brendshme-Internist! Shumë shpejtë planifikon për t’u kthyer në vendlindje me specializime të mirëfillta dhe me disa diploma! Prindi e orientojë për **matematikë** dhe **anglisht**, por ato i zëvendësojë me **mjekësi** dhe **gjermanisht!** Dhe prindërit gabojnë, ndonjëherë shumë!

E dinte për ta shkruar dorëshkrim për MMEM krahasuar me dorëshkrimin e librit të parë MMM ('87), i cili ende i ndodhej në ‘vlerësim dekade’, autori do ballafaqohej me të ‘panjohura të shumta’, të thuash ‘mal të panjohurash’; të paprovuara, të papërjetuara më parë; vështirësi pas vështirësie! Para se gjithash, do duhej të ‘shndërrohet’ në një fëmijë moshe (6-10) vjeç! Lajmi i

angazhimit për të shkruar libër tjetër u përhapë shpejtë, duke marrë dhenë! Kishte zëra të cilët flisnin nën zë duke u nisur nga 'Recensentët potencial' që mund të emëroheshin deri tek 'bashkëpunëtorët potencialë' të cilët e donin dhe e dëshironin koautorësinë! "**Një libër tashmë e ka shkruar, çfarë po don tani ky 'njeri'**"?! Disa të tjerë 'kukurisnin': "Po mirë kishte me qenë për dorëshkrime të ngjashme të bashkëpunonin dy-tre veta"! Ajo 'përkthehej', ja ku jam, me titull shkencor por edhe mësues i juaj, nëse doni mund të bashkëpunojmë megjithëse jam bërë batall, në të shkruar duke vrapuar pas honorareve?!

Ideja për të shkruar një 'çfarëdo varianti' të MMEM u fuqizue akoma më tepër kur fillojë të shtrëngohej 'laku' përreth shkollës shqipe të cilën Pushteti hegjemonist donte ta zhbënte! Ishte ndërmarrje plotësisht private e autorit për të bashkëpunuar me ndërmarrës privatë, për gatitje dhe botim libri me financim tërësisht privat (të kuptohemi, pa biznes)! Poashtu, plasimi për shitje libri do bëhej nëpërmjet autorit në kohëzgjatje pesëvjeçare për 1000 kopje!

Viti 1990 pat nisur me vrasje shqiptarësh. *Numri i të vvarëve* vetëm gjatë muajve: janar dhe shkurt ishte më i madh se 30 veta. Edhe në 'Qytetin e katër lumenjëve' ndodhën dy vrasje. Në mars të atij viti u provua '**helmimi misterioz**' me fëmijë shqiptarë, që në tërë vendin do preken 7000 veta (nga regjimi antipopullor kualifikohesh si '*aktrim fëmijsh*')! Filloi *suspendimi dhe largimi nga puna e Policëve shqiptarë* dhe filluan së zbatuari *Masat e jashtëzakonshme* bashkë me '*Orën policore*', ndërsa punonjësit e pakët aktual, bënë '*roje nate*' për t'i ruajtur objektet ku punonin për t'u likuiduar më kollaj! Filloi migrimi i të rinjëve nëpër Europë, për t'i ikur Shërbimit ushtarak në kohën kur *dhjetëra shqiptarë nga ushtria ktheheshin nëpër arkivole*! Shumçka tjetër ka mbetur pa u thënë dhe pa u shkruar përreth kësaj tabloje jetësore shqiptare në këtë anë kufiri ndërsa matematikani i vonshëm si askush tjetër ishte tjetërsuar dhe planifikonte të shkruaj e më pas të botojë Libër universitarë në kohën kur studentët dhunshëm ishin larguar nga objektet shkollorë. Shpërthimin e luftës serbo-kroate (gusht'91) Safiri e 'mendonte' por edhe e vlerësonte se po zhvillohej në një kontinent tjetër, të largët dhe imagjinar!

Përveç Pedagogut veteran [i 'porositur' për të kryer punë të cilit i "*pjelli mushka QAMO*" ndërduar, e "mbarsur në veri të vendit" për ta dobësuar dhe shembur Arsimin Kombëtar të mesëm (1975)], asnjë matematikan nuk kishte provuar ta shkruaj një libër apo dispensë nga MMEM. Ishte kjo një 'oazë' e pashkelur! Për ta shkruar dhe përgatitur një dorëshkrim kërkohesh punë disa vjeçare! Sekretet e një mjeshtrie në asnjë profesion shumë rrallë tregohen! Ato në rastin e 'tregimit tonë' vetë 'autori i zbuloi'; janë të shkruara në detaje dhe nuk bënë të përsëritën. Pushtetarët e viteve të ('80) të shekullit kaluar kur dilnin nga mbledhjet bashkë me vartësit e tyre, pyetja e parë që u bënin bashkëshoqëruesve ishte: "**Si t'u duk diskutimi im?**"! Kjo m'a rikujtoi: Dorëshkrimi i 'papjekur' mund të realizohesh gjatë një ecejake disa vjeçare të një 'zvarraniku' i cili bënë përpjekje të vazhduara 'për t'a pjekur' nëpërmjet '*variantit provokues*', i cili për dorëshkrimin, bartë me vete edhe 'rreziqe flijimi'!

Recensentët e dorëshkrimit do duhej të jenë personalitete të afirmuara shkencore më të ditur se autori, me njohje të hershme ndërsjelltazi, të pa hile e që nuk pranojnë thashethemnaja, altruistë dhe vlerësues kohe! Detajet tjera të punës së tyre janë t' imta dhe nuk diskutohen!

Për lektorin nuk duhet shfaqur nguti derisa 'të zbulohet' më i dituri ndër personat të cilët shfaqin gatishmëri për t'u angazhuar! Doemosdoshmërisht do duhej të jetë mësimdhënësi Arsimi

të Lartë! Për lektorin e mirë nuk kursehet paraja për ta angazhuar! Atij do duhej ofruar edhe kohën e nevojshme të cilën ai e kërkon dhe dëshiron. Puna cilësore e lektorit e ndryshon dhe e lartëson shumë vlerën e librit e cila reflektohet edhe me shitje dhe plasim të tij!

Korrektor libri MMEM ('93) ishte autori, punë intelektuale e cila bëhet me shumë qejfe!

Radhitjen kompjuterike (1992) e kreu Ndërmarrja private "**Infotrade**" si më e besuara për kohën, në 'Qytetin pa lum'. Atëbotë mungonte profesionalizmi i mirëfilltë dhe personat *shiteshin* si 'njohës të mirë të punës me kompjuter'! Kryesit e punimeve me kompjuter, bënë konsultime të shpeshta nëpërmjet telefonit me 'ata që ishin më të ditur se këta' edhe për punë e operacione më elementare (shumë nga ato punë dhe veprime sot i bën autori në kompjuterin e tij në shpi pa e pyetur askend)!

Për 'ta prekur me dorë' rrezikun e një pune të tillë intelektuale në kohën kur Lufta e dy vëllazërve më të mëdhenj sllavë kishte marrë hov, dy punonjësit e "**Infotrade**"-s; (një femër dhe një mashkull) të cilët e kryen 'Radhitjen kompjuterike' nuk pranuan shkrimin e emrave të tyre në faqen e fundit të librit, por e shënuan emrin e Ndërmarrjes "**Infotrade**"! E pra, "autori sherrak" *planifikon ta botojë këtë libër me vetëfinancim dhe në ballinën e librit do ta shkruaj emrin dhe mbiemrin e plotë!* As atëherë as sot, pas më shumë se 30 viteve, askush nuk e ka përmend fare aktivitetin e një arsime dashësi, të paepur, në kohën kur të gjithë ishin në 'gojën e luanit' por mendonin dhe vlerësonin se ishin duke parë ëndërr!

Dorëshkrimi me *Radhitje kompjuterike* (1992) përcjellej në *Fletë pausi* të cilat ruheshin në *Disketë* bashkë me *Figurat e punuara*. Autori ishte *bashkëpunëtor* disa ditore për ta kryer Radhitjen kompjuterike e cila kushtoi 300 DM (paga mujore e Personelit mësimdhënës në Arsimin e Lartë (punohej nëpër xhami) ishte një e treta e saj. Puna përbri Radhitjes kompjuterike ishte Punimi i tabelave, skicave, figurave në Paus, nga personi specialist, familjar autori. Kalimi i viteve sollti Revolucion në Teknologjinë telekomunikative. Regjistrimi i dorëshkrimit me Radhitje kompjuterike i mbetej për detyrë 'makinës së kujtesës' - kompjuterit dhe prodhimi i Pausit për këtë qëllim mbeti 'histori' zhvillimi dhe përparimi njerëzor.

Para se të përcaktohej për Shtypshkronjën, e cila do ta finalizojë Tekstin në Libër fizik, i shoqëruar nga bashkëpunëtori i 'Radhitjes', në 'Qytetin pa lum' bënë një xhiro hulumtimi, nëpër shtypshkronjat ekzistuese të kohës për ta zgjedhur njerën prej tyre. Kjo ishte "**Timegate**", pronë e një elektroinxhinieri, punëtor administrativë pranë LDK, më i rinj se tridhjetëvjeçarë dhe me atë ishte lidhur Kontratë pune.

Në këto troje në kohën e pushtesve turqë nuk kishte shtypshkronja por ndiqeshin librat bashkë me njerëzit që merreshin me shkollimin dhe leximin e librave. Në vitet e ('90) të shekullit kaluar, po në këto troje kishte Universitet (të ndaluar) bashkë me shumë shtypshkronja me ardhacakë të tjerë të cilët kishin plane mesjetare për ta shkombëtarizuar një popullësi të tërë!

Si fëmijë shpesh kishte dëgjuar në vitet e pesëdhjeta të shekullit të kaluar, duhangririsit ruheshin mos të bien në *kurthin e Policisë* mëqenëse duhani ishte '*mall kaçak*'; me përpunimin dhe shitjen e tij merrej shteti. Por në kapërcyellin e shekullit 20-të; shkolla; shkollimi; Universiteti libri; nga Pushteti shndërrohen në '*mall kaçak*', këtë nuk e kishte imagjinuar kurrë!

Shtypshkronja ku do botohej MEM('93) ndodhej në pjesën e thellë të 'Qytetit pa lum', në verilindje, në një vend thuajse të braktisur për të cilin nuk mund të krijohet asnjë dyshim që po aty do kryhej botimi i një libri në 1000 ekzemplarë!

Kopërtina dhe ngjyra vjollcë e saj të theksuara në Kontratë, ishte brengosja më e vogël e mundshme. Gjysma e dytë e pagesës së tij tashmë ishte siguruar. Firma *Timegate* e cila do shtypi librin dhe njerëzit e saj të cilët do punonin aty ishin tërësisht të panjohur! Mbështetur dhe në ambjentin ku punonin për cilësinë e librit që do prodhohej, autori ishte shumë më i frikësuar se ç'duhej! Përcaktimi për ngjyrën vjollcë të kopër tines së librit MEM ('93) simbolizonte para se gjithash 'lulen e parë pranverore'; bora do shkrihej; pas dimrit të egër dhe shkatërrimtar; një ditë prej ditësh do vjen pranvera përsëri! Kopërtina e M M E M ('93) ishte më e mirë krahasuar me atë të M M M ('87).

Para se të barteshin librat nga Shtypshkronja për në shpinë e kunatit, planifikohej *nëpër cilat rrugë do kalohej*; sigurisht nëpër ato më pak të rrezikshme ku qarkullimi i automjeteve do jetë i pakët dhe i rrallë!

Pranim-dorëzimi librave të botuara nuk ishte bërë tamam ditën për të cilën ishin marrë vesh palët. Atë ditë u muarën 12 libra! Ishte havarisur Makina e Prerjes dhe duhej pritur disa ditë! Në ndërkohë frika ishte rritur akoma më shumë, çfarë mund të ndodhë me botimin e librit?! Me pranimin e 12 librave u vërejtën disa gabime në tekstin e librit por dhe në figura! Havarisja e Makinës për prerje Formatit (16.3 X 24) cm. u 'përkthye' për 'kohën e nevojshme të paketimit të librave' i cili përveç tjerash vuante nga mungesa e Formatit standard (17 X 24) cm. Dimensioni ekzistues i letres B5 (17.6 X 25) cm. si shënohej në Kontratë ka pasur mundësi të sigurojë një prerje standarde (17 X 24) cm. Kjo ndodhi në mungesë përvoja profesionale të inxhinierëve të rinj.

Librat (1000 kopje) ishin bartur dyherësh nga 500 kopje që në rast 'rënie në kurthë' të konfiskohen 500 kopjet e para (në faqen e fundit të librit shkruante: Tirazhi 500 kopje), ndërsa për të tjerat 'të shpëtuarat' do gjëndeje zgjidhje tjetër! Por, kjo nuk ndodhi!

Safiri padyshim ishte bërë pishman për numrin e madh të kopjeve në kohën kur luftohej në disa ish Republika sllave. Në çdo skutë vendi, ndihej 'erë lufte'! Ishte koha kur këndohej kënga 'Ojë Kosovë, ojë nëna ime', e shndërruar në hit, por e përcjellur me lot! Libri shitej dorë në dorë. Me një rast autori u ankuar kunatit: 'Padyshim, do jetë libri im i fundit'! Kunat e priti ai, mos u ngut, është vetëm libri i dytë. Ti nuk ke të ndalur. Shpejt ke me e nisur së shkruari librin e tretë, e më pas, besa edhe të katërtin!

Botimi i librit zvogëlon numrin e miqëve, shokëve dhe dashamirëve, të të gjitha rangjeve ata të shkolluar apo të pashkolluar! Botimi i disa librave bën që ata mos të gjënden 'as për farë'! Ata të gjithë do ikin edhe nga 'hija e jote'! 'Urimi i sinqertë' që merret me rastin e botimit të librit, është 'specie' e rrallë urimi! Por, *nuk mund ta detyrosh asnjë njeri që për gëzimin tënd të qejfeniset edhe ai njësoj si ti!*

Titulli i botimit Metodika e Mësimit të Matematikës, MMM ('87) me sugjerimin e autorit por e mbështetur dhe nga Recensentët do transformohet me shqiptim fjalësh; në Metodikë e

Mësimdhënies së Matematikës MMM ('98) një kalim evolutiv e fjalës *mësim* n'atë *mësimdhënie*, për të cilën i dedikohet (kushtohet) libri.

Botimi i librit MMM ('87) me vete kishte sjellë ndjenja të përziera *gëzimi* dhe *hidhërimi*! Në njëren anë, 'u thye akulli' për t'u shkruar një tekst universitar: Metodika e matematikës, në vend të një fletoreje njëzetë fletëshe, por në anën tjetër, i 'fjetur katër vite' pa e shtuar dhe pa e munguar asnjë shkronjë; botimi ekzistues kishte mbetur me vlera të vogla e të papërfillshme; atë e përcjellnin një mori vërejtjesh serioze dhe të nduarduarta. Para se gjithash ato ishin lëshime të bëra nga ana e Recensentëve dhe të tjerëve të cilat qëndronin mbi 'kokën e autorit'! Ai gjatë katër viteve kërkonte ndihmë profesionale duke udhëtuar më shumë se gjashtëdhjetë herë për në 'Qytetin pa lum' por ajo nuk i ofrohej! Ishte pakujdesi e pafalshme mungesa e Pedagogut të çiltër bashkëkohës, konstruktiv e përparimtar i cili ka pasur mundësi të aktivizohet!

Puna intensive inspiruese, motivuese afro dyvjeçare ('95-'97) për ta shkruar një libër për të qenë, ishte rezultative. Përvoja e fituar nga Recensionin provokues MEM ('93) ishte e madhe! Fillimisht, filloi të lirohej nga përmbajtjet kallpe (pa ndonjë vlerë); heqje e skemave të caktuara, si të panevojshme bile dhe të dëmshme; depolitizim i përgjithshëm përmbajtjeje; përzgjedhje e re literaturë e vjelur nga Panairët e përvitshme të librit; përdorim i ngjeshur fjalorësh gjuhësorë dhe shkencorë; përmirësime drejtëshkrimore; heqje dhe flakje e disa figurave por zëvendësim dhe rritje e disa të tjerave më të qëlluara; përdorimi i shënimit të shkronjave 'me të zeza' për *dekor* dhe 'ushqim truri dhe syri' (zëvendësim i nënvizimit me ngjyra të rreshtave) lidhur me ide; nocione; përkufizime; rregulla; ligjëtori dhe përmbajtje thelbësore. Përveç heqjeje teksti kallp, pasonin riformulime; ripërkufizime (ka ndodhur për një sosh janë harxhuar deri pesë orë); reduktime faqesh bosh; krijime shtesash përmbajtësore; aplikime përvojash shkollore. Asnjë faqe libri MMM ('87) nuk ka qenë *immune* ndaj ndryshimeve rrënjësore të planifikuara për realizim.

Përmbajtja e librit u karakterizua si një kalim nga Metodika në Metodologji, e cila me gjasë do të fuqizohej në botimet e ardhshme eventuale! Shërbimet private të cilat e përgatitën librin për botim (të gjitha me pagesë) ishin më cilësore krahasuar me ish shërbimet përkatëse shoqërore para viteve ('90). Libri MMM ('98) kishte fituar **MIRËNJOHJE** nga UP (në kohë lufte) me participim mjetesh financiare për botim deri 50%. Mbi të gjitha *u pranua si Tekst Universitar valid edhe për FSHMN-Dega e Matematikës* dhe për Fakultetin Filozofik-Dega e Pedagogjisë!

I tërë ekipi i bashkëpunëtorëve në përgatitjen e librit për botim MMM ('98) ishte një fat i madh njerëzor për autorin; secili sish ishte i përzgjedhur si me 'konkurs'; **Lektor**, njëri ndër gjuhëtarët më të mirë që kishte pasur vendi ndonjëherë nga i cili mësojë shumë të panjohura e të paditura gjuhësore deri atëherë; **Redaktori teknik**, (bashkë me Realizim kompjuterik dhe Punim figurash) ndër elektro-inxhinjerët më të ditur të gjeneratës së tij; **Redaktori profesional**, mësimdhënës i dalluar gjeometrie universitare dhe njohës i thellë përmbajtjeje studimi. Përgatitja teknike e dorëshkrimit deri në shtyp ishte më e ndëlikuara dhe më e vështira por njëkohësisht më e mira në mesin e shtatë librave të botuara!

Që moti në 'Qytetin pa lum' punonin shumë shtypshkronja private. Cila mund të jetë më e mira, 'pa e njohur asnjë person aty pari'!? Para se të përcaktohej shtypshkronja për ta finalizuar tekstin e kompjuterizuar në libër fizik duke qenë jashtëzakonisht i kënaqur me punën cilësore të

Redaktorit teknik me sugjerimin e tij, Safiri u drejtua tek Shtypshkronja “Galeria Lumi ‘91” me të cilën u nënshkrua Kontrata.

Kontratat lidhur me shtypjen e librit ishin të hartuara nga vet autori në mbështetje të një përvoje personale, e cila arrihej përgjatë viteve nga njëri pesëvjeçar në tjetrin; nga botimi i librit të dytë tek i treti, i katërti e kështu me radhë. Kontratat edhe pse nuk kishin fuqi prapavepruese mëqenëse punohej në ‘vendin e shpellës’ pa shtet dhe pa pushtet, megjithatë për kryerësin e punimeve dhe vartësit e tij nuk ishte krejt njëllor të punohej me kontratë cilësie apo pa atë! Për më tepër libri ‘qëndisej’ nën petkun e UP. Atëbotë, Shtypshkronjat kishin bi sikurse kërpurdhat pas shiut dhe pronarët e tyre edhe poqese donin të punonin më mirë ata nuk dinin! Kushtet e Kontratës nuk përfilleshin deri në fund. Kontraktuesi librat e shtypura i ‘paketonte’ një orë e më parë, pa u bërë inspektimi i cilësisë së botimit!

Librin MMM(’98) në 500 kopje e shtypi “Galeria Lumi ‘91” në ‘Qytetin pa lum’, në afat rekord përgjatë një muaji, kohë kur pritej shpërthim i Luftës Frontale në vend. Autorit të librit i kishte mbetur për detyrë Përgatitja e ‘filmit’ për Stemën e UP-së të cilën e punoi fotografi por paksa më të madhe se ç’duhej! Kapakët e librit nga kartoni ishin ndër më të mirët prej librave të botuara deri atëherë! Ngjyra e ballinës së librit dhe kontrasti lidhur me shkronja ishte e pëlqyera!

Megjithatë shkronjat e titullit të librit ishin më të mëdha se ç’duhej! Librin MMM (’98) e kishte përcjell një gabim madhor! Kishte ‘prerje libri’ përgjatë dimensionit të tretë (trashësi libri) nëpër disa fletë të veçuara. Për autorin kjo ishte një përvojë e fituar. Në botimin e librave të tjerë Kontrata u zgjërë edhe me këtë pikë: **“Nuk bën të ketë prerje, përgjatë trashësisë së librit”** dhe tek librat tjerë të botuar gabimi nuk u përsërit asnjëherë!

Ishte kohë frike, tmerrri e varri. Çdo person i rritur e vërente dhe e ‘prekte me dorë’ lakun përreth qafës së tij e pastaj shiqohej se çfarë po ndodhë me atë që ishte përbri tij: majtas; djathtas; para; prapa. Në ‘Qytetin e katër lumenjëve’, rreshtat për të blerë vetëm një bukë ishin rrëngqethës! Njerëzit dilnin në orët e hershme të mëngjesit dhe pritnin deri tri orë për t’u futur në rresht e për ta blerë një bukë! Aty ku kërkesat për bukë ishin më të mëdha atëherë dilej e tërë familja! Atëherë me gjasë krijohej ‘prita’ për personat e evidencuar në listat e tyre! Të tjerët ‘fotografoheshin’ për kërkesa të mëvonshme! -Në pyetjen e bërë një djali dajë: ‘Nuk po të shoh kurrë ku po furnizoheni ju me bukë’!? Ai u përgjegi: ‘A po e përdorni ende bukën a’!! Atëbotë punoja edhe në ‘Qytetin e Urave’ me popullësi heterogjene dukshëm, atje kishte bukë me ‘bollyk’, kuptohet vetiu dy herë në javë nuk kthehesha duarthatë!

Në vendlindje përgjatë vitit 1998 jeta ishte bërë skëterre, me e lakmuar të vdekurin aty ku ai gjënde! Njerëzit (shqiptarët) vriteshin si pulat! Prej fillimvitit në vend ishin vlarë 2300 veta ndërsa ishin rrëmbyer apo zhdukur më shumë se 1600 veta (Koha Ditore, 20. 12. ’98. fq. 5)

Safiri do përpiqet ta përshkruaj një rast rrëmbimi, n’afërsi të drejtpërdrejt (2-3) metra larg tij, rast i cili e vret në shpirt në pamundësi që dikush nga turma ta ndihmojë të mjerin!

E hënë ditë pazari, lëvizje më e madhe dhe më e dendur njerëzish të panjohurish. Atje në ‘Çarshi të Vogël’ (3-4) metra para tij u zhvillua një dramë e vërtetë njerëzore! Dy policë me rroba civile (në mbështetje të rastit u identifikuan që ishin policë) dolën nga makina e tyre (civile) dhe

drejt në personin i cili ecte me kahe të kundërt të tij (në trotoar). Pa një pa dy e rrethojnë të 'kërkuarin' për ata, ndërsa person i panjohur për ne, më i ri se dyzetëvjeçar, me flokë të gjata si 'femër', flokëverdhe si një kalim në ngjyrë ari. Nuk i kërkuan Kartë Identiteti. I mjeri me duar e kishte shtrënguar fort një trung të trashë druri dhe nuk e lëshonte ndërsa policët shtrëngonin trupin e tij. Fillojë britma dhe kukama e personit: 'Nuk kam bërë asgjë, nuk jam ai që po kërkoni!' Më pas për ndihmë vjen dhe polici i tretë poashtu në rroba civile dhe me atë britmën e madhe për ta ndihmuar dikush, e futën zvarrë në makinën e tyre dhe ikën. Në bazë të sjelljes së policëve, vështirë ishte të besohet që ai ka mbetur gjallë. Kush mund ta dijë nga cili vend kishte ardhur në qytet, me mendimin që është Ditë Pazari dhe nuk e heton njeri!

Këto ishin rrethanat ku jetohej e punohej por edhe botohej 'sot për nesër', pa e ditur se çfarë e priste e nesërmja apo e pasnesërmja: mësuesin; punëtorin; mjekun; minatorin; nxënësin këngëtarin; shkencëtarin; aktoren; studentin; pensionistin; shtatëzënë;+ zejtarin; nëpunësin, foshnjën; sakatin; avokatin;... pa dallim moshe, gjinie, feje, profesioni apo mirëqenie, të gjithë e kishin një 'adresë' dhe po qe se likuidohej ndonjëri prej tyre, një shqiptar do jetë më pak!

Ngjyra teget (e kaltër e mbyllët) e kopër-tinës i përgjigjej situatës shoqërore-politike në vend në kohën e botimit. Simbolizonte mundimin shpirtëror vuajtje për çdo gjë, për luftën që po troket në derë shpie, për brengën e pasardhësve, kur prindi do sakrifkohet me jetë për fëmijën e tij, kjo do ishte dhurata më fatlume për atë prind! (Asnjë prind nuk e dëshiron mbijetesën pa fëmijën e tij)! Po ndodhi ajo do ishte tragjedia më e madhe njerëzore për atë prind fatzi, (i cili së shpejti do futej 'i gjallë në dhë')! Ai është në gjëndje të bëjë çdo gjë, që fëmija i tij të shpëtojë!

Mëqenëse ishte ngjyrim ndjenjash, punëkryerësi kishte ofruar edhe nyancën gati krejtë të errët por ishte refuzuar nga ai sepse dhe në atë gjëndje pasigurie për të mbijetuar, ekzistonte shpresa për ditë më të bardha që do vinin edhe për librin si 'mision' (dhe jo si objekt), nuk bën të përzgjedhej ngjyra ekstreme e fatalitetit njerëzor, gjithëkombëtarë. Dikush do mbetej gjallë!

(Pas lufte një ish student nga rrethina e 'Qytetit të Urave' kërkon autorit t'ia blejë një libër!- Po ti para disa muajve e ke blerë një kopje!- E vërtetë ia ktheu, por i ikur nga shpia e gjeta librin të ngjyrosur me gjak, 'në trajtë flamuri'! Me lot në sy, studenti e mori një libër falas)! Në fund të fundit edhe pse botimin MMM ('98) e përcjellën disa gabime profesionale, tek "Galeria Lumi '91" për atë se çfarë e priste komunitetin kosovar pas disa muajsh, ishte një atdhedashuri e sinqertë, intelektuale e të gjithë atyre që u morën me botimin e librit, mëqenëse për kryerje detyrash madhore siç ishte Arsimi në kohë lufte, njëherë i ofrohet shansa gjithësecilit pa humbur kohë ta tregojë vetën për të mirë apo për të keq!

Fundvitet e shekullit të kaluar Safiri ishte i zënë me punë dhe shkrime intensive në dy libra; MMM ('98) dhe MMEM ('03). Këtë të dytin si dorëshkrim filloi ta shkruajë nga janari ('97), pas pritjes së Vitit të RI, për ta përfunduar në verën e vitit ('98), punë pak më shumë se një vit e gjysmë, por kohëzgjatja për botim të MMEM (2003) do jetë gjashtë vite!

Pranvera e vitit ('97) ishte e ligë për shqiptarët dhe Shqipërinë! Përgjatë muajve shkurt - mars u ndoqën me shkatërrim fatal Organet e Rendit dhe i tërë armatimi i lehtë kaloi në duar të popullit. Përgatitej një luftë e çmendur qytetare dhe ndarje faktike e vendit amë. Megjithatë falë ca vendeve mike të saj ndërkombëtarë ajo nuk u copëtua!

Përgjatë vitit ('98), në 'Qytetin e katër lumenjëve' filloi migrimi masiv i popullsisë nga rrethina për në brendësi të qytetit. Popullsia qytetare organizoi mikëpritje bujare për vëllazërit e tyre nga fshati. Kjo ndodhi sepse nga Kodra e Çabratit granatohej Reka e Keqe. Luftohej me armë në dorë edhe në Glllogjan e Dushkajë. Donin zbrazje fshatrash për t'i sulmuar më pas ('99) qytetet shkallë-shkallë.

Vendi në kodrën e Çabratit prej nga minahedhësit sulmonin fshatrat ndodhej vetëm një kilometër vijë ajrore nga shpia e matematikanit. Ai i tjetërsuar 'mendonte që rreziku është diku larg tij' ndërsa ushtima nga krisma e minahedhësve lënte një përshtypje si t'ishin lodra fëmijësh! *'Dora e tij nuk donte pauza në të shkruar'* sepse *'druante nga fakti se mund t'i harronte shkronjat'*. Ai ende nuk e kishte tejkaluar normën e të shkruarit. Mendonte si shumë të tjerë që 'është më i shpejtë se plumbi'! Kjo u dëshmuar përgjatë ditëve të fundmarsit ('99), para se të iknin për në shtetin amë. Tre-katër netët e para pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, 'njerëzit si pa kokë tuboheshin natën deri në njëqind veta në shtëpi oborresh të mëdha e të gjata dhe bënin roje'! Po të vinte Policia, mendonin që mund të iknin për të qenë 'më të shpejtë se plumbi'. Presidenti u kishte thënë: *"Mos u largo nga pragu i shpisë sate"*! Porosinë doemosdo duhej çuar në vend!

Pas Luftës shkolla e jonë ishte e shkatërruar në çdo pikëpamje. Ajo do të mbetej edhe shumë kohë jashtë rrjedhave, sikur të mos na ofrohej mbështetje financiare dhe logjistike nga shumë agjensione, shoqata dhe asociacione ndërkombëtare si KEDP; SAVE THE CHILDREN; ANDRA; CIDA të cilave populli i Kosovës u shprehë përjetësisht falenderim dhe mirënjohje duke u mbetur borxhlinj përgjithnjë. U derdhen shumë mjete financiare për trajnim dhe kualifikim mësuesish, para dhe përgjatë shërbimit nëpërmjet seminareve dhe konferencave; u trajnuan shumë kuadro universitare; u përkthye literaturë e mjaftueshme e procesit të mësimdhënies.

Çlirimi i vendit në Qershor ('99) me vete solli panumër shumë të mira. Në mes tjerash nxënësit dhe studentët pas dhjetë viteve u rikthyen në objektet e tyre shkollore dhe universitare të uzurpuara! Arsimi i përparuar Perëndimorë ishte bërë gati për të ndihmuar në ringritjen e tij i cili gati ishte zhbërë!

Fillimisht në lëmin e Arsimit ishin bërë disa gabime 'në hapa'. Arsimi i Lartë deri në vitet ('90) kishte krijuar një traditë pune dhe krijimtarie botimesh tekstesh universitarë dhe pushtet vlerësimesh diturie të krahasueshme me vendet e Arsimit të përparuar. Dëshmi për këtë mbetet fakti; në Fakultetet tona studjonin një numër i konsiderueshëm studentësh të huaj dhe nëse hetohej një keqpërdorues vlerësimi, atë e priste suspendimi; burgosja dhe pensionimi!

Emërimi i Administratorit të Huaj edhe në lëmin e Arsimit me gjasë ka qenë normale, në suazat e shtetndërtimit. Mirëpo për situatën e pasluftës përplot trauma nga vrasjet, përdhunimet, kidnapimet, humbje pasurie, varreve masive, pengjesh të gjallë nëpër burgje, të plagosorish, kur banorët ende nuk e kishin siguruar racionin e ditës së nesërme; emërimi i Daxner-it nuk ishte i duhuri! Ai në mendjen dhe mendësinë e intelektualëve vëzhgohej si personalitet i cili kishte ardhur nga një Planet tjetër dhe nuk di asgjë nga realiteti e mentaliteti tokësor-Balkanik i cili donte ta zhbënte dhe ta rrëronte punën 20-të vjeçare të UP-së me pretendimin që mund t'ia dalë duke aplikuar 'Rregullore dhe Ligje të Hamurabit' si t'ishite i 'porosituri nga dikush'! Fillimisht 'personi që nuk ka titull (gradë) shkencor është i pakualifikuar dhe ai nuk bën të vazhdojë punën në UP'

(edhe po qe se i ka katër libra universitarë të botuara, në mesin e tyre dhe libra bazik).I bëri me dije 'njerëzit' mos të qëndrojnë 'duarkryq' por të pajisen përgjatë muajve dhe vitit me *doktoratë* së cilës singërisht nuk i besohej as nga 'njeriu i sofrës'.Në anën tjetër inspiroi por edhe frymëzoi duke legalizuar themelimin e Universiteteve Private (Politike) ku 'integrohej mentaliteti ballkanas' kundërvënie Universitetit Publik! Më pas Universitetet Private (Politike) morën dhenë u themeluan në të gjitha Qendrat e mëdha të vendit! Universitetet private në Ballkan nuk mund të krahasohen me Universitetet private në Perëndimin e përparuar për një mori arsye të cilat nuk bënë të elaborohën! Puna dhe veprimi i ligë asnjëherë nuk vijën vetëm!

Reforma në Arsim e ndryshimet pozitive drejt arritjes së rezultateve optimale e kërkon kohën e duhur e cila para se gjithash varet edhe nga e shkuara e lënë prapa,'redimentet' e së cilës vilen në vitet e mëvonshme.Ambjenti arsimor në Kosovë është i ndërthurur nga një mori të ligash të trashëguara nga e kaluara e hidhur nënshtruese por dhe asosh ndërshqiptare në krye të së cilës ndodhet '*bajraktarizmi mesjetar*' i stilit: '*Mëqenëse unë nuk arrita suksesin e dëshirës në udhëheqje atëherë do bëja të pamundurën për të penguar edhe ty për të qenë i 'dështuar', në mënyrë që të rikthehem në udhëheqje aty ku isha para teje!*

Njëzetëvjeçari i shkuar (2000-2020) lidhur me Reformën në Arsim na iku në pakthim, 'pa ngulë asnjë gozhdë' në Sistemin Arsimor edhe pse ishim të privilegjuar,të përkrahur, të ndihmuar dhe të udhëzuar nga Arsimi i Përparuar Perëndimor! Pikëlluese mbetet shfaqja e trendit: *Arsimi në Kosovë ka shënuar Regres* (ecje prapa në një drejtim të kundërt me përparimin) me damkën e pashoqe dhe të turpshme poshtëruese të *politizimit skajshmërisht*, si të ishte pronë e ndonjë 'oligarku', *dukuri e padëgjuar më parë diku gjatë!* *Arsimi; Shëndetsia; Policia; Ushtria në asnjë 'vend normal' nuk bënë të politizohën.* Pushteti vendor s' bënë të jetë kundërshtar politik i Pushtetit Qëndror.Politika arsimore vendore (lokale) nuk bënë të bie ndesh me trende aktualiteti arsimor të udhëhequra nga Pushteti Qëndror! 'Peshku i vogël' asnjëherë nuk ka mundur ta hajë 'peshkun e madh'! Pushtetarëve komunal duhet rikujtuar këto vargje të verbit Nolian para 100 viteve: "Ku e lam e ku na mbeti; Vaj-vatani e mjer-mileti; Anës detit i palarë; Anës dritës i paparë; Pranë sofrës i pangrënë; Pranë dijes i panxënë; Lakuriq dhe i dregosur; Trup e shpirt i sakatosur"?

Pushteti i notës në Arsimin parauniversitar është liberalizuar tej mase.Nota kaluese gjatë dekadave të fundit të shekullit të kaluar është trajtuar si blerje (prerje) e një bilete autobusi! Dhe të mësohej Matematika pa pushtet note është njësoj si mbushje uji me shoshë! Pushteti i notës për matje dhe vlerësim diturie varet edhe nga numri i tyre në sistemin e shkallëzimit.Sa më i madh të jetë numri i notave Pushteti i vlerësimit ecën me kahe dobësimi.Dyshi (2) si nota e parë kaluese ('nuk di si duhet por bënë përpjekje për të ditur') është futur me djallëzi në sistemin e vlerësimit të diturive.Dyshi(2) sidokudo ishte vëlla i njëshit(1),duke e lënë nxënësin në humnerë, nuk e shpiente askund vetëm sa për ta kaluar disi 'lloçin e paditurisë'! Tani është koha pas 60-të viteve ekzistence (1963-2023) pa e diskutuar më shumë të vendosim unanimisht për Dyshin (2) duke e 'shndërruar' në notën e cila dëfton pakalueshmëri për t'iu lënë vendin tri notave të tjera kaluese: treshit (3); katërshit (4) dhe pesëshit (5).Kjo ç'vendosje notash në sistemin e vlerësimit do ta këndëllte sadopak Pushtetin e nëpërkëmbur të notës!

Shkolla jonë para viteve ('90-ta) të shekullit kaluar e ka pasur Obligative Organizimin e Mësimeve Plotësuese (edhe për një nxënësi!) ndihmesë për nxënësit të cilët kishin prapambetje

nxënieje në lëndet e caktuara mësimore. Shumë shpejtë kishte lindur lajthitja përveç mësuesit të matematikës të tjerët deklarorin: 'Në mësimdhënien t'ime nuk ka nxënës të prapambetur në nxënie, prandaj unë jam i liruar për ta organizuar Mësimin Plotësues'.! .Sot pas 30-të viteve këtë lloj mësimi nuk e zën në gojë askush edhe pse cilësia e Arsimit ka rënë në 'fund të pusit'!

Puna e jonë 20-të vjeçare 'frenuese' në lëmin e Arsimit (kur asgjë nuk mungonte), mund të krahasohej me frenimin e automjetit që ngjitet përpjetë një shpatmali! Po ndodhi makina të jetë paksa 'defekt' dhe pas ndalesës përpjetë ajo fiket dhe nuk ndez!

Arsimi në Kosovë aktualisht ndodhet në qorrsoak! Aplikimi I Reformës shkollore mbetet domosdoshmëri kohe! Që nga Gjysmëvjetori i parë i vitit shkollor 2023/24 (pas dekadash kohe të humbura) duhet filluar të ecim me hapat e një foshnje ndryshe kollaj e kemi të shndërrohemi në një hiç të Arsimit çëçen!

Dorëshkrimi i librit MMEM (2003) i cili i shpëtoi fatmirësisht Luftës bashkë me autorin u dorëzua Recensentëve të mirënjohur të cilët dekadë më parë me admirim përcjellnin punën e ngjeshur të matematikanit! Pas shqyrtimit disamujor të materialit, në fund të vitit 2000 dhanë 'dritën jeshile' edhe për ta botuar! Ata në Referatin e tyre Recensues kishin dhënë shumë pak vërejtje. Ky dorëshkrim merrej si kalim i avancuar, nga SHLP-Dega e Mësimit klasor në Fakultet të Edukimit-Dega e Mësimit klasor por edhe për studentët e Fakultetit Filozofik- Dega e Pedagogjisë. Vlerësimi qëndror ishte: ***"Dorëshkrimi i MMEM (2003) përmbanë vlera të larta dhe rëndësi të veçantë dhe ai e meriton të botohet si tekst bazik për MMEM"***.

Pas vitit 2000 u vërejtë shpejt Evolucionin në Arsim i cili do fillojë edhe në vendin tonë! Nën zë filloi të dëgjohej që Mësimdhënia tradicionale në Perëndimin e përparuar ka filluar të zëvendësohet me Mësimdhënie bashkëkohëse ku nxënësi do jetë në epiqendër dhe ai më ngadalë do pranojë 'rolin e mësuesit'! Duke shpallur dhe dëgjuar për të rejtat që po 'trokitnin' dhe shpalljen e emrit Safir Kromi në gazetën flamurtare të vetme 'Zëri' (16. 01. 2002) ku lexohej: 'U nënshkruan nëntëdhjetë (90) vendimet e para për profesorët dhe asistentët që do shkojnë nga UP'. E 'përkthyer' kuptohej për mungesë Titulli shkencor 'këta persona do largohen nga puna e mësimdhënies, si të pakualifikuar'! Matematikani i vonshëm me vetiniciativë pa e pyetur 'njëri të gjallë' e *prolongoi botimin e MMEM (2003)* edhe për dy vite të tjera në vazhdim, edhe pse Dorëshkrimi ishte pranuar për Tekst bazik për dy fakultete!

Dhe fidani i rinj i një peme mbjellët, rritet, zhvillohet dhe jep frytet e saja, në mbështetje të 'gjuhës së bioritmit'. Fillimisht mbjellët në gropën e plehëruar mirë, i ujitur rregullisht; i orientuar në ç'drejtim dëshirojmë t'i rrisim degët e tij; përkujdesja e veçantë përgjatë ngricave të dimrit në mënyrë që bora mos t'ia dëmtojë degët dhe degëzat e njoma (duke shkundur borën për të mos u mërdhirë); në pranverën e hershme, krasitja e disa degëve; fillimi i spërkatjes së rregulltë për çdo pranverë dhe vazhdimësi mbikëqyrjeje zhvillimi të saj derisa t'i jep frytet e para por edhe në vazhdimësi përkujdesje; prashitje përreth trungut; plehërim; ujitje e spërkatje. Po që se mungon përkujdesja pema do shndërrohet në një të egër dhe fryti i saj do jetë i paktë, i vocërr dhe përplot me krimba!

Personi ka mundësi ta kufizojë dhe urdhërojë vetën, të shkruaj lidhur me atë që di dhe për atë çfarë ka mësuar. Duke larguar nga vetja pritesën, duke shtuar durimin për motiv pune,

sistematike e të vazhdueshme, ajo heret apo vonë ka për t'i dhënë rezultatet e saja, kuptohet vetiu, duhet ta sakrifikosh parandë dhe fitimin!

Për prolongimin e botimit të librit MEM (2000) me Recensione pozitive, afirmative, i pranuar për Libër Bazik të cilin do ta përdornin studentët e disa fakulteteve nuk kishte bërë llafe me asnjë person, as me Recensentët e nderuar. Ishte një gjest intuitive e rrallë, e matur dhe e mençur! Ai e 'urdhëroi' vetën, tani për tani nuk bën të botohet pa e ditur se çfarë do 'pjellë' e nesërmja! Ndryshe 'libri do plakej para se të botohej', plus planifikohej ta largonin nga puna sepse ka mbetur i 'pakualifikuar' si autor katër vëllimesh librash universitare!

Pritja ishte rezultative. Ishte ndërrim epokash të cilën nuk e kishin hetuar Recensentët! Ndodhi kthesa historike, epokale në mësimdhënie. Mësimdhënia tradicionale u plak në çast dhe ajo do të duhej të zëvendësohet me Mësimdhënie bashkohëse, ku mësuesi dhe nxënësit bëhen partnerë në mësimdhënie; nxënësi me 'vetëdëshirë' pranon rolin mësues! Lindi mësimnxënia si pasojë e 'nxënësit-mësues'. Në raportet e reja të krijuara doli që M M M të pavarësohej nga Pedagogjia dhe nëna biologjike e saj mbetet të jetë Matematika, fakt që një pjesë e konsideruar mësuesish e pranojnë me vështërsi. Saora MMM ('98) 'vëtëm dyvjeçare u bë e moçme' dhe veterane e procesit të mësimdhënies, për botimin e së cilës kishte participuar edhe UP!

Materialet e shkruara filluan ta preknin 'pulsin e mësuesve' të vendit, duke filluar nga shkurti i vitit 2002, të cilat ishin përkthyer në shtetin amë:

Strukturë për zhvillimin e Mendimit kritik gjatë Kurrikulumit; Udhëzues 1

Zhvillimi i Mendimit kritik; Udhëzues 2

Leximi, Shkrimi dhe Diskutimi në çdo lëndë; Udhëzues 3

Teknika të tjera për Zhvillimin e të Menduarit kritik; Udhëzues 4

Të nxënit në bashkëpunim; Udhëzues 5

Seminari për të shkruarit. Të vetëshprehurit tek argumentet e shkruara; Udhëzues 7

Krijimi i lexuesve mendimtar. Udhëzues 8

Materialet e shkruara në trajtë broshurash (libra të vegjel e të thjeshtë, me pak fletë të qepura deri në 120 faqe) dorëzoheshin nëpër shkolla; ta zëmë tri sosh brenda muajit, me afat njëditor: leximi dhe vëzhgimi; krahasimi dhe përshkrimi; hulumtimi dhe aplikimi. Këto materiale për autorin e Dorëshkrimit të prolonguar MMM (2000) ishin të vlerëshme si 'buka'. Duhej t'ishte personi më i interesuar në tërë vendin! Ndryshe ishin të porositur që përgjatë një dite broshura pas leximit dhe përshkrimit eventual të kthehej në bazë (shkollë)! Frikësohej nga fotokopjimi dhe keqpërdorimi i mëtejme i tyre. Për qasje urgjente njëherit e të sigurtë në këto broshura zgjidhja ishte gjetur nëpërmjet një familjari – mësues!

Mësimdhënie apo mësimnxënie 'puro' matematike kishte pak ose aspak. Më tepër kishte skema sqarimesh lëndësh mësimore ndër më të ndryshme. Materialet ishin paksa dhe me hile, të ngurta, të shtangëta të cilat duhej 'përpunuar' dhe 'përkthyer' për mësimdhënie matematike. Koha

punonte për Safirin. Ai kishte punuar gjithandej ku vjelet praktikë mësimdhënieje por edhe mësimnxënieje dhe përvoja e tij jetësore nuk mund të krahasohej me asnjë tjetër. Shumë sish përkundër aspiratës nismëtare që kishin me asnjë libërth nuk u dëshmuar aftësia e tyre. Për përdorim Metodash bashkëkohëse të mësimdhënies duhet ndjekur Kurset e aftësimi. Konsultimi i vetëm për vetëm i literaturës nuk mjaftonte!

Këto broshura diturie mësimnxënieje dhuratë e Arsimit të Përparuar Perëndimorë tek ne nuk u hulumtuan, shqyrtuan dhe vlerësuan si duhej! Edhe pas 20-të viteve vendi ndodhet në një humnerë qorrësokaku lidhur me Mësimdhënien bashkëkohëse! Aktualisht kundërshtimet lidhur me Reformën shkollore janë të mëdha, ato vijnë nga Opozita aktuale por edhe përgjatë kohës që ishte në Udhëheqje vendi, nuk përfilli Reformën! Ka 20-të vite që punon 'fabrika e diplomave'!

Dy-tre vitet e parë pas çlirimit të vendit vërehej një rrëmujë në orientim dhe veprim. Ishte koha kur autori nuk dinte të punonte me kompjuter ndërsa ish pushtetarët e socializmit njëzetë vite më parë (1979) ia kishin dhuruar postin e 'ministrit komunal' për Shërbime shoqërore (arsim, shëndetësi e mbrojtje sociale) me mbështetje. "Mëqenëse 'Epoka e Informatikës' po troket në derë shpie, matematikani do duhej të ketë qasje te Kompjuterët dhe ai neve na nevojitet!"

Atij tashmë kompjuteri i duhej si 'buka' për përgatitje të MEM (2003) për botim! Por atë as që e kishte blerë apo do t'i shkonte mendja për ta blerë! Mendonte që 'nuk ishte koha e moshës së tij' për t'u aftësuar të punohet me kompjuter! Paragjykimi i tij ishte përjashtues me bindje të thellë që ishte i 'harxhuar' për të mbajtur në mendje risitë teknologjike të kohës!

Radhitjen kompjuterike të MEM (2003) në disa 'runde' e bëri një punonjës i një gazete të përditshme ndërsa Realizimin kompjuterik, një veteran botimesh Tekstesh shkollore, i cili kishte 'harruar' si shënohej 'kllapa e vogël e një fusnote'! Fillimisht e kishte ditur, ndërsa sot ditën kur e kërkon një autor libri e kishte harruar! Kur nuk mbajmë në mendje një 'veprim' që e kemi ditur dikur është proces normal. E keqja ishte që ai nuk pranonte të pyes asnjë njeri përreth tij apo më larg dhe që e dinte këtë 'punë' si bëhet! Në tërë librin në fund të faqeve të caktuara, aty ku figuron literatura e përdorur mungon 'kllapa e fusnotës'! (Libri ndodhet edhe në rrjetin e Internetit dhe mund të shikohet)! Të dy shërbimet ishin të paguara por për këtë të dytin 'veterani' nuk mësoi dot ta vë këtë shenjë, në respekt të pagesës së majme që ishte bërë!

Nga ajo kohë pas katër vitesh, autori i katër librave e bleu kompjuterin (2007) dhe u aftësua për ta realizuar Radhitjen kompjuterike të MEM (2008) në shpinë e tij, pa pagesë!

Në mbështetje sugjerimesh shokësh të SHLP e 'Qytetit të Urave', botimin e librit 'shumë të përfolur' MEM (2003) e bëri shtypshkronja 'Siprint' e këtij qyteti e cila në seri pesëvjeçare, do botojë edhe tri vëllime të tjera; në vitet (2008); (2013); dhe (2020).

Ballina e librit MEM (2003) në shikim të parë nuk përmbanë vërejtje, ngjyrë vishnje (ngjyrë e kuqe errët) mbulon dy të tretat e saj (një e treta e saj i përket pjesës së pangjyrosur, bardhësisë); madhësia e shkronjave dhe harmonia e tyre, nuk përmbajnë dot vërejtje. Poashtu edhe madhësia e Stemës së UP, të gjitha së bashku qëndrojnë në harmoni të plotë në hapësirën ballore të librit. Vërejtje mund t'i bëhen KARTONIT nga i cili janë punuar 'kapakët e librit' sepse

'nuk ishte i fortësisë së duhur' çfarë e meriton mësimi i matematikës i cili rrallë largohet nga dora e frekuentuesit!

Ngjyra e kopërtines së librit MEM (2003) ishte e kërkuara, kuptohet e duhura, ngjyrë jete, festimi dhe çlirimi e fituar me gjakun e derdhur për liri! Derisa, kopër tina e librit MMM ('98) ishte 'ngjyrë e gjakut venoz';kopër tina e librit MEM (2003) do simbolizonte 'gjakun festiv arterial', ashtu që dy llojet e gjakut të të njejtit autor sajojnë një tërësi; mësimdhënia tradicionale dhe ajo bashkëkohëse janë të puçura, tamam si gjaku venoz me atë arterial të cilët sajojnë qarkullim gjaku të njësuar!

Me botimin e librit MEM (2003) nuk kompletohet përfundimisht Mësimdhënia bashkë me Mësimnxënie bashkëkohëse.Asaj i duhen më shumë se një dekadë për arritje ëndërrash të dëshiruara nëpërmjet botimeve të ardhshme; MMM (2008) dhe MMM (2020)!

Është për të ardhur keq nga moria e 'fateve njerëzore' asnjëri sish nuk u kërkua nga vetja e tij! Të gjitha ato të shndërruara në 'aksione punuese' ishin vetëm mendime, nxitje, ide dhe këshilla dashamirësie të personave jashtë vetes së tij; çfarë do bëjë tani dhe me çfarë do merrej! Kjo ishte e vërteta,nuk mund të jetonte pa shtysa! Padyshim kjo mbeti brenga më e madhe e punës së tij krijuese! Po qe se këta persona do të heshtnin ku do plasohet ai në jetë? Gjasa,diku ndërmjet mësuesit të fshatit dhe atij të qytetit në një shkollë fillore!

Me botimin e MEM (2003) ishte mbyllur cikli i librave të shkruara e të botuara, gjithsej katër vëllime librash universitare; 'Çka është boll; boll është!' Duhet ngopje për gjithçka! Po t'i shkruante edhe dhjetë libra (si në ëndërr!), njerëzit e njohur do të pyesnin:'Përse nuk fillojë t'a shkruajë të njëmbëdhjetin'?! Athua nuk ka ditur apo nuk ka dashur apo udhëheqja komunale e politizuar skajshmërisht do e pengonte shitjen e tij nëpër shkolla dhe librari?!

Tezaku i ditur 'me një fjalë goje' e kishte bindur tezакun më të moçëm që punën e tij krijuese nuk e kishte përfunduar akoma(2005)! '*Ti di të shkruash, vazhdoje punën përderisa nuk është bërë vonë*'. Ishte një udhëzim e vlerësim i drejtë cilësie dhe mundësie por dhe dëlirësie pa hile që kishte dhënë një person i ditur jashtë vetës së tij! Sikur 'tezaku i zemrës' mos të bënte zë,gjashtëdhjetë vjeçari nuk do ta ndiente asnjë shqetësim apo detyrim ndaj askujt, 'kishte shkruar;aq sa kishte ditur'! Po të mungonte kjo qasje e rastit,me siguri nuk do shkruhej Metodologji e Mësimdhënies Bashkëkohëse për Matematikë (2008)! Nuk do evidentohet dhe shkruhej dallimi mes nocioneve Metodikë dhe Metodologji matematike; do mungonte Pavarësia e Metodikës nga Pedagogjia dhe të tjera risi të studiuara.Vetiu do mungonte edhe Botimi dytë i plotësuar dhe i përmirësuar (2020); 'ajka' e të gjitha librave të botuara,për të cilat flet ISBN!

Për dallim nga poeti zëmadh i vendit i cili një përmbledhje poezish e kishte titulluar "Fatin t'im nuk e nënshkruaj"; matematikani do e thoshte të kundërtën e saj: '*Fatin t'im e nënshkruaj*' meqë atë 'me një fjalë goje' e gatuan miqët dhe dashamirët e zhvillimit dhe përparimit njerëzor.

Me pranim shtytjesh serioze për ta plotësuar me mbarështim MEM (2003),Safiri i druajtur ndodhej në dilemë, a mund t'ia dalë mbanë! Fillimisht shkroi planin e punës krijuese, në fillim të stinës së verës! Shkroi për çdo ditë përgjatë gjashtëmbëdhjetë muajve për ta mbyllur së shkruari në fundvitin 2006.Përshtypjet e para lidhur me Dorëshkrimin e MMM (2008) ishin shumë

premtuese bile befasuese për autorin! Pasqyra e lëndës do kishte 50% përmbajtje të re mësimore-shkencore ndërsa 50% tjetër i përkiste 'pjesëve embrionale' plotësime e përmirësime, të librave tjerë të botuar MMM ('98) dhe MMEM (2003).

E veçanta e dorëshkrimit: Pas autokorrekurës së dorëshkrimit u bënë orvatje të heqen dhe të shmangën të gjitha pikëpamjet, mendimet, vlerësimet dhe interpretimet e autorit dhe të tjerëve, të cilat mund të mospranohen nga autorët tjerë. Këtu ishte arritur qëllimi nismëtarë dhe i fundit duke emruar dorëshkrimin: **Metodologji e Mësimdhënies së Matematikës**, arritje në zenitin e krijimtarisë personale, botimi i të cilit do t'i lënë 'pa frymë' esnafin e matematikanëve!

Viti (2008) ishte vit jubilar i 100-të vjetorit të Kongresit të Alfabetit (Drejteshkrimit) dhe viti që do shpallej Pavarësia e Kosovës, të dyja data të shënuara kombëtare. Të botohej një libër, i pari i këtij lloji (në vendin ku para një dekade ishte afër shpopullimit dhe zhbërjes si lokalitet, pas një lufte gjenocidale), nuk mund të kishte vetëkënaqësi më të madhe autoriale! A mund të ketë ndjenjë gëzimi e lumturie kur autorit i plotësohen dëshirat dhe pengjet më të mëdha jetësore, njëra pas tjetrës; kur autori nuk do asgjë më shumë, sesa ajo që ishte arritur!?

Ishte koha e Rektorëve të kontestuar e përcjellë me shumë të bëma, të cilat do mbetën 'emblemë turpi' kombëtar kurdo që përmenden! Në vitin historik (2008) ndalohej (pengohej por dhe ndiqej) botimi i Librit universitarë nën 'ombrellën' e UP! Kush vepron ndryshe le ta provojë! Ishte koha kur edhe Akademiku (Recensent) i frikësohej Rektorit (politik)! Nga Rektori dhe stafi i tij u përbishtë Intelegjencia kosovare! Elita intelektuale e vendit (edhe ASHAK bashkë me Mjetet e Informimit Publik; Televizionet dhe Gazetat) ishin shndërruar në 'dele', të cilat hanin barë me therra' ditën dhe natën!

Përgjatë gjysmës së dytë të vitit 2007 Safiri filloi të lëngohej. Fillimisht nuk dihej se çfarë e gjeti! Pas tri Analizave mjekësore të njëpasnjëshme u konstatue: Tajitje e tepruar e hormoneve të gjëndrës Tiroida. Me gjasë 'sëmundje femërore'; ajo ishte arsyeja përse nuk u zbulua porsa filloi lëngimi! Pretendohej sëmundje e pashërueshme. Shkaktari dihej: Dorëshkrimi MMM (2008) me Recensione pozitive, i pranuar për Tekst Bazik Universitarë, nuk guxon të botohej nën 'çati' të Universitetit kur dhjetëvite më parë (1998-2008) në gjendje lufte e lejonin dhe jepnin para në marka gjermane e studiohej jashtë objekteve universitare! A mund të gjendej absurd më i madh?

Për një vit e gjysmë kishte humbur tetë kilogramë. Gjendja e tij ishte e rëndë por ai nuk kishte kohë ta shikonte vetën në pasqyrë! Duke ecur kishte filluar ta merr 'era e lehtë' me vete! Nuk ngopej me ushqim si të ishte 'vetë i treti'. Nuk kishte forcë fizike për të udhëtuar, por as të bartë tre kilogramë peshë! Dukej që i ka hyrë një pune që nuk mund të bëhej! Shëndeti i tij në sytë e bashkëshoqëruesve mbanë erë lëngate e cila shpejtë do përfundojë fatalisht. Tre-katër mjekë specialistë (në mesin e tyre edhe një ish nxënës-gjinekolog) patën përcjellë sëmundjen dhe patën thënë: Kjo të shpie buzë vdekjes por mbijetohet me përdorim të PROPILTIDURACIL, kur personi bëhet 'mjek i vetëvetës' si të jetohej në një 'peshojë'; duke rritur apo zvogëluar sasinë e përdorimit të pilulave. Kur eliminohet faktori që ta ka sjellë lëngatën, atëherë ajo ikën dhe shërimi ndodhë! Prognoza doli e saktë plotësisht; libri u botua; lëngata u largua, e cila e çoi matematikanin në breg varri!

UP 'nuk qante kokën' për participim mjetesh financiare për botim tekstesh universitare, sikurse në vitin 2003. Edhe atëherë mungoi participimi, por formalisht shënohej që botues ishte UP, ndërsa financues mbetej autori dhe lejohej të përdoret stema e UP në Kopërtinë, shenjë e një vlere identifikuese për autorin! Tani pas pesë viteve të tjera 'në liri dhe demokraci' edhe mëtej botues dhe financues mbetej autori por tani nuk lejohej përdorimi i Stemës universitare (UP ishte shndërruar në një 'filialë partiake')!

Për kronistin që do vjen pas nesh, ajo çfarë ka vepruar ish Rektori i UP (2008) do mbetet 'emblemë turpi' e një intelektualit të rrejshëm dhe të një 'kuazi shkencëtar'. Nuk mund të gjëndet 'një sjellje dhe veprim analog më i turpshëm' e kjo në vigjilie të Pavarësisë së vendit dhe të Njëqindvjetorit të Kongresit Drejtëshkrimor. Për të qenë person i mbrojtur ligjërisht, ai u avancua në poste akoma më të larta ekzekutive! Ai sot ende shetitë nga njëra studio televizive në tjetrën, i ndihmuar nga opozita aktuale 'për të na dhënë këshilla politike, juridike dhe asosh kushtetuese'! Çfarë i ka punuar ai vendit, nuk e meriton t'i jepej hapsirë publicitare dhe të shikohet nëpër studio televizive në cilësinë e Gogolit! Politizimi i Arsimit, 'tragjedia më e madhe intelektuale' tek ne, ndodhi menjëherë pas Luftës së fundit, kur u shkarkua dhunshëm Stafi Rektorial pa bërë zë, në emër të dorëheqjes. Rektori ('08) ishte i dyti me radhë me të cilin 'mori vulë politizimi i Arsimit' në vend i cili nuk ka të ndalur, bile skajshmërisht i ndihmuar edhe nga 'Televizionet Private Partiake' të dala si kërpuardhat!

Për kopërtinë libri MMM (2008) autori u frymëzua nga cikli i vargjeve 'Lulet e verës' e në mesin e tyre 'Bagëti e Bujqësi' të poetit tonë më të madh kombëtar, rilindasin Naim Frashëri, vargjet e të cilit tek autori ngjallin emocione të fuqishme e të pafundme, saherë që këndohen! Kopërtina e librit (toka, livadhi, ara) mbeti të jetë e mbuluar me blertësi (ngjyrë e blertë bimësie), ndërsa titulli i librit; emri i autorit; vendi i botimit bashkë me vitin 'kur e pa dritën' stolisen me ari, ngjyrë luleje e verdhë. Në faqen e pasme të saj, mbetet tërësia 'sa e gjatë po aq e gjërë' me shifrat flakëruese ISBN 978-9951-00-070-3; e pëlqyera, ngjyrë ari.

Shumësia përmbajtjesh shkencore-mësimore; metodash mësimore; teknikash; ecurish; strategjish; ligjërorish; objektivash; funksionesh edukative-arsimore; formash pune; vlerësimesh; algoritmesh; konceptesh; aplikacione mësimdhëniesh; abstraksionesh; operacionesh; leksionesh funksionesh; ekuacionesh; zgjidhjesh; kompetencash; përkthimesh; enigmash; numrash; tipesh shembujsh; përkufizimesh; relacionesh..., të cilat do shtrihen në livadhin e blertë me 454 faqe, i formatit (17 X 24) cm, të përdorshëm për çdo 'bimësi' që rritet aty në 'livadhin drejtëkëndësh' të MATEMATIKËS, "O malet e Shqipërisë! E ju o lisat e gjatë; Fushat e gjëra me lule, u kam ndërmend ditë e natë; Ju bregore bukuroshe e ju lumenjtë e kulluar; Çuka, kodra, brinja, gërxhe dhe pyje të gjelbëruar"! (Naim Frashëri)

I shitur tërë Tirazhi MMM (2008) nëpër shkollat në 500 kopje përgjatë një viti kalendarik, i plasuar edhe në ato mese shkollore tek të cilat pesë vite më parë kishte shit-blerje për MEMM (2003), në po aq kopje, ishte treguesi më i mirë që "**libri MMM (2008) përmbanë vlera të larta dhe rëndësi të veçantë, për ta shpallur tekst bazik universitar**"! (Recensentët)

Safiri nuk i përkiste asnjë Partie politike. Përpikëria matematike, specifike kjo e saj dhe Politika kanë orientime me kahe diametralisht të kundërta dhe ato askund nuk puçen. Realisht, ai do duhej t'i përkiste Shoqatës së Matematikanëve shqiptarë por me gjasë ai vlerësohej si i

'pakualifikuar'.U botuan MMM (2008) dhe MMM (2020) me ç'rast Shoqata hoqi 'maskën!' 'Çele gur gojën!' Por 'guri nuk flet!' Kjo nuk ndodhë në Arkeologji; Arkitekturë; Arte të tjera pamore si Pikturë; Skulpturë; Grafikë; Muzikë, zhanresh të ndryshme; Gjuhësi; Sporte ..Ndoshta presin për botim MMM (2025)! Të presim dhe të shohim, nuk dihet!

Dhe librin e fundit **MMM (2020)** i botuar dhjetë vite pas pensionimit ('fëmija i plakut; vaji i sokakut') e ndoqi fat i ngjashëm edhe në rrethana lirie e pavarësie por tani nën sundimin e: Pleqërisë; Virusit 'Corona-19' i cili bënte përzgjedhjen e të moshuarve u jepte moka e koka dhe i merrte me vete për të mos i kthyer më; duke mos harruar dhe 'aktivizim zemërligësie dijetarësh me grada shkencore', të cilëve aksidentalisht u kishte humbur bishtpena për të shkruar!

Po qe se vështrohën ecejaket e librave MEM (2003) dhe MMM (2020) edhe ishishin të pranuar për Tekste bazike veç e veç megjithatë rrugëtimi i tyre doli të jetë ters (të përcjell me prapësi). Botimi i MMM (2008) ishte i përcjell me disa gabime të cilat nuk ishishin të autorit. Ai donte që libri mos të përmbante asnjë gabim të evidentuar! Në Realizimin kompjuterik **u hoqën** dhjetë gabime të evidentuara dhe u shtuan tridhjetë të tjera (si t'ishite i porositur)! Plasimi i tij ishte i sigurtë por për vitet që do vinin, mbetej peng Ribotimi i plotësuar dhe i përmirësuar!

Libri i fundit doli të jetë 'kampion cilësie', dëshmitar i të cilit do mbetet ISBN flakëruese, por 'libër i pafat sezonal', mëqenëse kalem i intelektualit betër (nuk di të lexojë as ISBN) e kapi librin për ters duke 'nënshkruar fatin e tij' por e fitoi mallkimin e nxënësit, studentit e mësueses!

E njerëzit e dinë që fëmijët i ka dërguar për shkollim në Perëndimin e përparuar! I përndjekuri u aftësua për t'i përndjekur të tjerët por Matematika nuk bënë të përndiqet sëpaku nga ai sepse ajo e bëri 'këmbë e dorë' dhe i dha emër!

Për dallim nga librat tjerë të cilët dilnin për ta parë dritën në 'syrin e pranverës' i fundit MMM (2020) ishte bërë 'halë në sy' nga 'Corona-19', në kohën kur 'virusi nuk shkonte te njerëzit' por 'njerëzit shkonin te virusi'! Ishte fillimi i sundimit të tij, për të cilin 'askush nuk dinte me tamam të vërtetën e sekretit të tij'. Një gjë dihej po të shkohej në spital moshë e autorit, gjasa për të dalë gjallë nga ai ishishin të pakta! Shumë i dhimbshëm ishte 'akti lamtumirës' kur edhe 'qeni varrosej më me dinjitet'! Kjo ishte tabloja jetësore kur do botohej **MMM (2020)**, 'pazar me vdekjen'!

Pas gjashtë muajve të parë nga sundimi i 'Corona'-s, i frikësuar nga më e keqja që mund t'i ndodhi, vendosi ta ribotojë MMM (2020), financimi i të cilit ishte siguruar nga shitblerja e makinës personale 'Golf-2', të cilin nga moshë shtatëdhjetëvjeçare nuk ishte i aftë të ngas më atë; i blerë nga shitja e librit MEM (2003).

Me plotësimet që i kishte bërë dorëshkrimit ishte shumë i kënaqur! Ribotimi do kishte risi të shumta. Emblemë e rrallë ishishin 'tekstet' e fundit të çdo kapitulli mësimor, të cilat përcjellnin pjesët më të rëndësishme përmbajtësore, pjesët më qenësore ku kapet thelbi i kapitullit titulluar: *Në vend të përfundimit, shtojcë e cila ndeshet rrallë në librat tanë.* Më pas risi do ishte: Funkcioni edukativ pasurohet dhe me Edukimin kompjuterik; Mësimi i Integruar s' është sinonim i Mësimi Tematik dhe 'Temat Tabu' të shpërndara të cilat i kishte pagëzuar 'recensenti aktual-politik'!

Me shtëpinë botuese 'Siprint' në 'Qytetin e Urave' ekzistonte bashkëpunimi dhjetëra vjeçarë shumë i suksesshëm i botimit, edhe të tri librave të tjerë në vitet (2003); (2008) dhe (2013)

së cilës u besua edhe botimi i librit MMM (2020) pa Kontratë të shkruar! Autori u mbetet falënderues për cilësi botimi akoma më të lartë dhe lehtësira financiare. I kënaqur shumë me shifrën flakëruese të ISBN, autori e lehtësoi punën e botuesit lidhur me punimin e ballinës së librit të cilën e kreu desenjatori grafik me hijeshi. Ngjyra teget e mbyllur i përshtatej situatës së përgjithshme: shoqërore-arsimore; shëndetësore-sociale; ekonomike-politike, por edhe moshës së katërt të autorit.

Para viteve ('90) nga shumë veta hapur ishte thënë: Safiri një libër tashmë e ka shkrua! Çfarë po dëshiron tani ky njeri. Intelektualët me 'letra' nuk e dinin apo nuk donin ta dinin që M M M përfaqësonte 'minierë' lokacioni i së cilës dihej se ku gjëndej, por nuk donin për të 'investuar' në të, ajo ndodhej jashtë funksionit, e braktisur. Me gjasë, 'pritej' për vitët që do vinin për shfrytëzim nga familjarët e afërm të tyre!

Personi i cili përgjatë karrierës së tij profesionale nuk ka shkruar kurrë libër, nuk mund ta kuptojë që: Poqese (me kokën tënde) e shkruan një libër atëherë shumë shpejtë ke për t'ia nisur ta shkruash librin e dytë; besa edhe të tretin...

Botimi i MMM (2008), tekst bazik universitarë, para se gjithash ishte një 'trofe e çmuar' e një vlere personale; arsimore por edhe kombëtare e fituar nëpërmjet një pune sistematike të pa lodhshme dyzetë vjeçare, botim i parë Metodologjie, i këtij lloji në trevat mbarëkombëtare! Askush nga të evidentuarit me 'frymarrje' nga Shoqata e matematikanëve shqiptarë 'nuk e mori guximin' për t'i thënë disa fjalë; 'të mira' apo 'të liga', lidhur me botimin! Koha e leximit të librit dhe Reagimit të rastësishëm ishin të pa limituara! Injorimi në këtë mënyrë i botimit të librit MMM (2008) nuk i bënte nder Shkollës shqipe. Sjellja tyre e bëri me dije autorin për 'cilësinë e lartë të librit', tek i cili do duhej kontribuar akoma deri në 'përsosmëri' sepse tani për tani (2008) për atë nuk mund të gjënden 'fjalë të liga'!

Është për t'u theksuar, dy muaj para se të botohej libri (përkundër ndalesës që bëri UP) përgjatë sorollatjeve të autorit nëpër Zyrat e Dekanatit dhe Rektoratit, eksponentë të cilët pengonin botimin qartas fërkonin duar për ta përvetësuar dorëshkrimin (pasi siç shihej autori shpejt ka për të ikur nga kjo botë!) I matur tek mishitësi familjar, ndodhej në peshën 57 kilogramëshe, me veshje dhe mbathje dimri e gjatësi 165 cm (Lëngata ishte pasojë taitjeje e tepruar e gjandres Tiroida, e shkaktuar nga ndalim botim libri)!

Ishte viti 2018 kur doli nga shtypi Fjalori Enciklopedik i Kosovës. Mungesa e qëllimshme e autorit të gjashtë librave universitare e vuri në aktivitet intelektual dyvjeçar Safirin për ta hartuar M M M (2020); botim i dytë i plotësuar dhe i përmirësuar, me ISBN 978- 9951-607230 Të rejat e këtij botimi ishin:

1. Përmbajtje të reja studimore, plotësime e përshtatje të tjera në më shumë se 222 faqe libri;
2. Pas çdo kapitulli studimor ishte krijuar 'Porta dalëse'; Në vend të përfundimit;
3. **Objektivat strategjikë** të shkollës së shek. 21-të nëpërmjet **shtatë kompetencave**: E të mësuarit; E komunikimit në gjuhën amtare; E njohjes së një gjuhe të huaj; E aplikimit të diturive matematike; Qytetare-shoqërore; Për ta kultivuar oratorinë dhe Kompetenca e komunikimit digjital.
4. Edukimi Kompjuterik;
5. Inteligjenca dhe koeficienti i saj;
6. Mësimi i Integruar : Trupi gjeometrik i Piramidës së rregullt me korrelacion Matematikë- Biologji;
7. Mësimi Tematik : Bleta dhe bletaria; 8. Shtesë për ëndërrimtarë
9. Zgjerim njohurish i shumëzimit me duar; 10. Analizë plus lidhur me Thyesat
11. Madhësitë dhe matja e madhësive, detajisht;
12. Aksiomat e vizes dhe kompasit;
13. Gjeometria në rrugë; 14. Të futurit në matematikë ; 15. Biografi matematikanësh të mëdhenj.

XVIII. KOPERTINAT E LIBRAVE

Për secilin libër të botuar në kujtesën e Safirit ruhet tregimi me një 'histori' të veçantë. Titujt e librave të tij edhe pse në shikim të parë mund të duken të ngjashëm, shkurt të emërtuar si MMM ose si MEM megjithatë përmbajtja e studimit të tyre veçohet nga njëri tek tjetri, jo vetëm nga vëllimi; tirazhi; dedikimi (kushtimi); botimi i parë; botimi i dytë (i plotësuar dhe i përmirësuar); titulli Metodikë apo Metodologji por dhe nga rrethanat shoqërore-politike e sociale që e karakterizonin kohën e botimit të tyre; me participim botimi nga UP; vetëfinancim nga autori apo financues dhe botues ETMM të cilit iu vu dryni në vitin 1990 bashkë me 'burgosje shkollash shqipe' këtu në Kosovë! Për të gjitha këto, përgjatë katër harqeve kohore (1980-1990); (1990-1999); (2000-2010) dhe (2010-2020) plotësisht të ndryshëm nga njëri-tjetri KOPERTINAT E LIBRAVE do jenë dëshmitare e kohës, të cilat dinë të flasin në gjuhën e tyre!

Kopër tinës së librit i mbathën disa attribute si: VITRINA E LIBRIT, tamam si ADN e personit apo ISBN e 'cilësisë së mallit material apo intelektual' të cilën si 'shifër e koduar' pak veta 'dinë ta lexojnë' dhe 'ta përkthejnë'!

Ekziston pohimi i përgjithshëm: Në shikim të parë, personi X nuk do jetë ai që po na duket! Veshmbathja e tij nuk e sajton atë njeri; tek ai person 'vlon' edhe bota e brendshme e tij! Me analogji mund të themi që: 'Kopër-tina nuk e sajton librin', megjithatë duhet pranuar që, duke filluar nga arti, shkenca, gjuha, ekonomia, tregu deri tek politikë-bërja, jetohet dhe punohet në botën e dizajnëve flakëruese të cilët në çdo hap 'të hutojnë'; ia marrin mendtë edhe atij që ka përvojë në atë aktivitet!

Ideja për kopër-tinë e dhënë nga autori i librit është fotografi reale, shprehje e botës së tij të brendshme, lidhjeve emocionale, në kohë dhe hapësirë në të cilën ai jeton dhe krijon, i rritur, i pajisur dhe i formuar nga një edukim i caktuar (intelektual; moral; estetik; kompjuterik; për punë).

Dizajn imi i kopër tinës është art në kuptimin e mirëfilltë të fjalës (aty ku 'syri i lexuesit do duhej të pushojë') tamam si korniza e mirë dhe e pashme e syzave, çanta, vathët, këpucët me take, kostum i bukur grash dhe frezuara tek gratë! Në punimin dhe dizajn imin e kopër tinës mund të ofrojë kontribute dhe ndihmesë të caktuar edhe piktori apo artisti! Megjithatë, *askush më shumë se autori i librit nuk di çfarë dizajni i përshtatet përmbajtjes së tekstit!* Po që se jeni autor me disa vëllime librash, me kopër tinë të vlerësuar deri atëherë, e mira e së mirës është mos të ndërrohet dizajni i shkronjave nga librat e mëparshëm. Meqenëse libri paragjykohet, atëherë titulli i kopër tinës duhet të dominojë kundrejt emrit të autorit, disa fish! Lloji i shkronjave, madhësia e ndërsjellë e tyre; përmbajtja e fjalëve (autori; titulli i librit; dedikimi; vendi dhe viti i botimit), duhet të qëndrojnë në harmoni të plotë bashkë me dimensionin e faqes, kontrastin e ngjyrave, ilustrimet dhe figurat. Mbingarkesa eventuale e saj fillon të tregojë, se çfarë ndodhet në të vërtetë brendapërbrenda kopër tines, si 'parfumi i femrave' i cili mund t'i nxitë të vjellët!

Përpjekjet për të hulumtuar, përzgjedhur dhe përcaktuar dizajnimin e kopër tines nuk janë ditore por as javore; me gjasë duhet me qenë mujore! Dhe për blerje veshmbathjeje, një pjesë e madhe personash kanë telashe me blerje! Numri i veshjes dhe i mbathjes janë tamam, por dizajni; cilësia; modeli; ngjyra; kontrasti i tyre; 'moda e fundit' nuk pëlqehen! Ndodhë që 'malli i kërkuar'

nuk gjëndet as në një qytet të madh dhe problemin e blerjes nuk e zgjidh paraja! Numri jot është me vetëvendosje: merre ose lëre!

Dizajn imi i caktuar i kopër tinës po qe se pëlqehet nga shumica dashamirëse e librit në njërën anë ndërsa autori i saj 'nuk ngopet' me shikimin e saj, atëherë në botimet eventuale të radhës, elementet përcaktuese të kopertinës së modifikuar nuk bën të ndërrohen!

Kopërtina në cilësinë e reklamës është ajo e cila duhet ta shet librin! Kopërtina e librit është **urë** e cila mund të bashkojë tekstin e librit me lexuesin për të ofruar mesazhin e duhur me elemente të pakta. Një kopërtinë e gabuar, bën që libri mos të shitet ashtu si e meritonte! Kopërtina e librit të caktuar mund të quhet **katalizator** i një shit-bletjeje solide!

Po qe se përmbajtja e lëndës së një libri është e përzgjedhur shprehimisht e përkryer dhe shumë e pëlqyer nga lexuesi korrekt, mirëpo autori i saj i 'lodhur nga shkrimet e tija' me nguti e ka pranuar një kopër tinë të gabuar, bën që libri mos të shitet ashtu si e meritonte!

Meqenëse libri gjykohet dhe vlerësohet edhe nga kopertina e tij, atëherë 'gjuha' me të cilën flet ajo do duhej të jetë e lexueshme, estetike me më pak elemente duke mos e tepruar!

Dizajnimi i kopërtinës është art. Ajo gjithnjë qëndron ndërmjet blerësit potencial dhe përmbajtjes së librit. Autori duhet bërë përpjekje që kopërtina e librit të tij me qenë ndër më të 'vëzhguarat'. Si objekt i cili i nënshtrohet dizajnimit, kopër tina e librit është vështrimi dhe paraqitja e parë pamore për të cilën teksti bën fjalë. Megjithatë **libri do duhej ta shes veten!** Asnjë njeri nuk është dashamir i marketingut të rrejshëm (me hile)!

Kopër tina e ka funksionin e thirrjes së lexuesit potencial për të mësuar të paditurat e të panjohurat universale, qofshin ato fiktive; historike; autobiografike; artistike; politike; shkencore apo të një zhanri tjetër! Kopërtina do duhej të jetë nga kartoni (letër e trashë, njëherit e fortë, e cila përdoret për kapak librash e cila gjithnjë ndodhet në dorën e lexuesit deri në vdekje!

Po qe se kopër tina parapëlqehet, blerësi potencial i librit shfleton faqet e fundit, vështron cilësinë e letrës; thyerjen teknike të librit; Recensentët; numrin e kopjeve; formatin e faqes; tipin e shkronjave; dendësinë e rreshtave; shkrimin e fjalive dhe ideve të veçanta me nyancë ngjyre paksa më të zezë apo me shkronja të trajtës pjerrtë. Pas veshtrimit me shikim dhe prekje libri, me lexim rreshtash të shpërndarë në faqet e fundit; lexohet dhe Përmbajtja e librit; bëhet me dije për çmimin e tij dhe merr qëndrim për blerje ose lënie! Për shitje të kënaqëshme të librit, përmbajtja e rreshtave të fundit duhet të jetë: ngacmuese; motivuese; inspiruese; mallëngjyese!

Me të përfunduar së lexuari libri, kopër tina e tij mbetet souvenir, i cili ruan kujtimin, e një kohe të shkuar, lidhur me përvojën jetësore të fituar, kënaqësi e cila pas disa vitësh, mund të përsëritet edhe me rilexim të dytë duke ngjallur përmallimin e kërkuar! Kopërtina e librit është shumë më tepër se një kornizë; një vlerë; një trofe; një mirënjohje; një admirim; dhuratë... Ajo udhëheqë shumë funksione; mund të vështrohet si medium trashigimnie, emancipimi dhe shkollimi, platformat e saja janë të shumfishta; nga lidhja e fletëve të shkruara, të mbështjellë nga dy kapakët e saj të fortë, deri te paraqitja digjitale, të gjitha së bashku formësojnë shfaqjen vizuale të librit, i cili tashmë i është prezentuar botës! Bota digjitale e librit as që mund të krahasohet me Botën grafike të tij, si për nga vëllimi poashtu edhe nga llojllojshmëria. Koha nuk ndalet dhe nuk

ngrihet si uji, koha të ngrinë, po qe se nuk bën hyzmetin asaj pune, si ndodhi me disa 'shkollëpak' por edhe 'akademikë', të cilët e bën 'lojën e strucit'! Donin ta pengonin shit-blerjen e librit grafik MMM (2020) në kohën kur libri digjital tashmë udhëtonte dhe lexohej nëpër botë! Si shpjegohet: Mjeranët ushqeheshin në shekullin 21-të dhe jetonin në fillimshkullin 20-të?!

Shit-blerja e librit pas viteve ('90), me 'burgosjen e shkollës shqipe' në Kosovë, ka humbur aktualitetin! Nuk është trendi e tyre! Prirja e rinisë është argëtimi; zbavitja; shetitja; telefoni celularë; blerja, pajisja dhe harxhimi më i vogël për material shkollor; vajtja në shkollë me një fletore në xhep! Dikur për të blerë libra shkollor nëpër librari, krijoheshin turma njerëzish moshash të ndryshme dhe pritjet për tu shërbyer ishin të gjata e të bezdishme, paraja harrohej! Pesha e librave dhe materialit tjetër shkollor bartej nga të rriturit! Gjeneratat e moshës së dytë dhe të tretë me mallëngjim i kujtojnë 'vitet e arta' të zhvillimit dhe përparimit kombëtarë. Ish libraritë e dikurshme janë shndërruar në markete ushqimore; shitore veshmbathjeje; ëmbëltore; mishtore; argjentari; shitore telefonash apo servis i tyre dhe ngjashëm; mall i përzierë me vaje që të prek thellë në shpirt dhe në çdo qelizë trupi, vaj medet se çfarë na gjeti, arsyet e shumta të së cilës gjëndje mjerane tashmë dihen!

Aktualisht prirja e rinisë nuk është më blerja e librave të asnjë zhanri por qëndrimi 'ditor' në lokale gastronomie dhe rregullimi i dokumentacionit për të vajtur në Perëndimin e përparuar! Asnjë e keqe nuk ka fund! Ajo mund të jetë akoma më e keqe! Viteve të fundit në librari qyteti të vendlindjes lidhur me shit-blerjen e librit shkollor i 'ka futur hundët politika ditore, komunale', duke penguar dhe ndaluar shitjen dhe shpërndarjen e librit universitar, me Recensione pozitive (botim dytë i plotësuar dhe i përmirësuar; *Abetare e matematikës*) lëshuar nga Bota Akademike e vendit me pretendimin që libri përmbanë **tema tabu** lidhur me Reformën shkollore ende të pafilluar tash e 20 vite! Ajo ka filluar t'u diktojë librarëve cila literaturë ka mundësi të shitet dhe cila nuk bën; as që guxon të gjëndet në vitrinë apo në sirtarët e librarive të qytetit arsimdashës! Përndryshe librarët i pret gjëma e tatimit dhe zullume të tjera deri te thyerja e vitrinës së librarisë (2013), për t'ia nxjerrë librarit nga xhepi së paku (500) euro dhe për t'u mbushur mend! Me udhëzime të ngjashme porositjeje ishin edhe drejtorët e shkollave fillore e të mesme të qytetit, të cilat nuk lejuan ballafaqimin sqarues; autori – mësueset i cili nuk ishte penguar dhe ndaluar nga '**tellalli**' as në kohën kur shkolla shqipe ishte 'burgosur'! Kjo është tabloja rrëqethëse aktuale e politizimit të skajshëm të shkollës shqipe në Kosovë e reflektuar direkt në vendlindje.

Në 'Qytetin e librit' por njëherit në 'Qytetin pa lum', tregimi lidhur me shit-blerjen e librit, mund të vijojë në këtë mënyrë: Libri jot mund t'i ketë të veçantat e tija; Tematikën e studimit dhe të mësimit; numrin e faqeve; llojin e lidhjes; figura dhe foto ilustruese dhe shtesa tjera origjinale dhe atraktive! Për blerësin tënd të gjitha këto karakteristika nuk do thënë asgjë! Është shumë me rëndësi që ai të dijë: **Si dhe për çfarë mund të ndihmojë libri im, për t'iu nënshtruar blerjes së tij?** Ta fillojmë sqarimin, për atë që dimë dhe mundem për t'iu bindur!

Matematika është lëndë mësimore e frikshme, tamam si nata në det! *Në matematikë duhet të futesh, me punë të pavarur pasi të pranosh sqarime te të tjerëve!* (Kurset me pagesë, në vendet e Ballkanit Perëndimorë janë ilegale, të dëmshme dhe kontraproduktive). Libri të bën me dije: *Tek mësimi problematik i matematikës kush është dhe ku qëndron Gogoli i vërtetë?* (Mësuesi i Shkollës Mesme të Ulët dhe mungesa e punës së pavarur 'zbuluese-hulumtuese')!

Blerësi i rastësishëm me këto karakteristika të ofruara a mund të bindet për ta blerë librin tënd apo atë me një tematikë të ngjashme, të një autori tjetër? Për momentin, me gjasë është i pabindur, nuk i është mbushur mendja ende. Do duhej zbulim arsyeje, përse? Arsyet do t'i shpalosim n'atë mënyrë, karakteristikat e shumta në mësim-nxënien matematike që e bëjnë të dallohet nga të tjerat, t'i shndërronim në **përfitime (benefite)**. Për çdo veçori të thënë, do duhej vetit t'ia parashtrojmë pyetjen: **Blerësi i librit t'im çfarë përfiton?** Bëhet fjalë për një libër matematike! Do t'iu shfaqë një 'konstrukcion': Matematika (nga greq. **Mathema-shkenca e madhësive**) është nocion i moçëm sa edhe vetë civilizimi njerëzor! Ilirët dhe Grekët, fqinjë nga lashtësia ishin pasardhës të Pellazgëve! Nocioni Matematika përbëhet nga tri rrokje: mat-e-mat-ika. A mund të interpretohet edhe si fjalë tejet e moçme pellazge me të cilën do kuptonim: **Mat e mat madhësinë dhe ik (ose ika)?!** Kjo shprehje sipas **temperamentit ilirjan** i përshtatet racës së të parëve tanë!

Çfarë përfitime (benefite) tjera të pritura libri do t'iu ofrojë. Në libër medoemos do të gjeni:

*Cilindo shkollë që ta regjistroni; cilindo shkencë që ta studioni; cilindo punë që do ta kryeni; nëse doni që atje të lëni gjurmë e domosdoshme është ta dini matematikën!

*Matematika dallon nga kimia; fizika; biologjia; ajo *nuk lexohet por ushtrohet!*

*Matematika nuk mësohet pa libra; mësimesh teorike dhe zgjidhje praktike detyrash!

*Matematika nuk mësohet për një ditë, por edhe nuk harrohet për një ditë!

Po qe se pala është ende e pabindur! Viojmë me paraqitje argumentash tjerë të njohur:

*Mësimi i matematikës kërkon punë sistematike, të palodhshme dhe të pallogaritshme!

*Matematika është si një lloj treningu në sport tamam si atletika në sport, nuk e duron mësimin në mënyrë fushate! Lojtari që nuk ka kondicion nuk mund të luaj! Matematikën po qe se nuk e dini mjaftueshëm nuk mund ta aplikoni! Matematika paraqet një 'gjimnastikë truri'!

*Libri përmbanë (34) Teknika dhe Strategji për Mësimdhënie dhe Mësim-nxënie bashkëkohëse me Strukturë E R R nëpërmjet Zhvillimit të Mendimit Kritik të interpretuar me shembuj origjinal!

*Libri shpjegon detajisht Mësimin Tematik nëpërmjet disa Temave të rëndësishme jetësore ta zëmë: **Duhani** dhe **duhanpirja**. Si të flaket duhanpirja? **Bleta** dhe **bletaria!**

Me këtë bashkësi të dhënash në vazhdim sypozojmë që blerësi i rastësishëm ende nuk ofron shenja bindjeje për ta blerë librin; viojmë me sekretet tjera të cilat i përmbanë libri:

*Që në vogli kalamajtë mund ta mësojnë gjuhën e tyre të nënës, me gjasë edhe një apo më shumë gjuhë të huaja pa ndonjë përpjekje madhore, në kohën kur ata nuk dinë të shkruajnë dhe lexojnë! Atëherë, përse një çun apo një çupë e ka të vështirë të mësojë 'gjuhën matematike dhe shkrimin e saj' (shkallë-shkallë) përgjatë shkollimit dymbëdhjetë vjeçarë. Zbulojë fajin e ndodhur tek faktori 'mësues matematike' apo në lëndën mësimore 'matematikë'?!

*'Gjuha matematike' nuk dallon prej 'gjuhëve' nëpërmjet së cilave njerëzit flasin dhe shprehin mendimet e tyre! Dallimi qëndron në të shkruar; në shenja dhe simbole! Dhe shurdhëmecët e kanë gjuhën e tyre të nderuar; me shenja dhe lëvizje gishtash e duarësh!

*Matematika e ka 'gjuhën e vet'; shkrimin simbolik ndërkombëtar, të njoftimit, të komunikimit, dhe kumtimit me të cilën merren vesh ndërmjet veti matematikanët e tëra meridianeve të Botës!

*Libri M M M (2020) ta rikujton: *Inteligjenca e fëmijëve* nuk varet nga numri i neuroneve por nga lidhja ndërmjet tyre në të ashtuquajturat **sinapsa!** Koha deri në vitin e 7-të të lindjes është më e çmuara [Dërgimi i fëmijëve me pagesë në Kopshte katër vite radhazi është 'investim' madhor tejet i rëndësishëm në rritjen dhe zhvillimin e intelektit të tyre].Përgjatë moshës shtatëvjeçare truri krijon 75% të të gjitha lidhjeve të neuroneve.Përgjatë shkollimit fillor dhe atij të mesëm për shfrytëzim truri në kapacitetin e plotë punojmë për 25% -in e mundësive të mbetura!

Mund të ndodhë që blerësi potencial tashmë është përcaktuar për t'u shpenzuar,me blerje të një kopje libri por megjithatë donë të dijë çfarë të dhëna të tjera mund t'i ofrohen lidhur me 'librin në shitje'! Për ta bërë me dije 'koprracin' që libri të udhëzon për të ecur në hap me kohën lidhur me mësimdhënien bashkëkohëse; e njohtojmë se **Ajo 'mbeti me barrë' dhe së voni 'pjelli' mësim-nxënien fatlume!** 'Mbarësimi' ndodhi shumë larg nga vendi ku po shkruhen këta rreshta, atje në vendet e Perëndimit të përparuar! Atje lindi e ushqyer me këto premisa:

*Askush nuk mund të mësojë e të dijë për gjithçka, që i duhet në jetë!

*Mësuesi nuk mund ta mësojë nxënësin për gjithçka që i duhet në jetë!

*Nxënësi vetëvlerëson: Çfarë më mëson mësuesi im nuk mjafton!

*Lindi Domosdoshmëria për arsimim gjatë tërë jetës,nëpërmjet mësim-nxënies!

*Nxënësi e pranon 'rolin e mësuesit' në cilësinë e partnerit (edhe në rast greve të mësuesve)! *Ai që mëson të tjerët,mëson shumë më shumë krahasuar me ata që mësohen!

*Nxënësi ndërton kuptimin e tekstit, por nuk i përsëritë fjalët e tekstit!

Për aq kohë e më heret ta kuptojmë trendin e rinj në mësimdhënie bashkë me mësim-nxënie aq më shpejtë dhe më lartë do gjëndemi në ranglistën e vendeve me Arsim të përparuar!

-Po qe se edhe pas kësaj 'ligjerate' blerësi potencial deklarohet i pabindur atëherë krejt në fund i themi: Kush mund ta mësojë shkrim – leximin pa Abetare? – Askush u përgjigj!

-Njohësit e mësimdhënies së matematikës haptazi kanë pranuar që **MMM (2020)** lirisht mund të quhet **Abetare e matematikës!** *Këtë e përdëfton dhe ISBN.Blerësi anoni m nxori nga xhepi portofolion dhe pagoi tre libra; për tre gjenerata pasardhësish!Faliminderës për shëbimin!*

**[sipas PISA (2015 dhe 2018); Arsimi Kosovar, për shkaqe politizimi të skajshëm, bajraktarësh anakronik (që u ka kaluar koha); bëri të ndodhemi në "bishtin" e Ranglistës Botërore, ndërsa njerëzit e saj aspirojnë për t'u futur në Europë!]

XIX. MATEMATIKA NUK MUND TË JETË GOGOL I VETVETËS

Dimë që Matematika është e pranishme kudo përreth nesh! Të thuash gjithçka në natyrë është e përcaktuar me formulë matematike! Për çudi as trupi i njeriut nuk bën përjashtim! Matematika lexohet e provohet edhe në Anatominë e trupit të tij, duke filluar nga qelizat; indet; eshtrat; muskujt; langjet, 'mënyra si lëvizim' deri te 'si marrim frymë'?! Pra njeriu me trupin e tij fizikisht dhe psikikisht jeton në botë numrash të shkencës së matematikës'!

Edhe pse njerëzit dallojnë sipas pamjes së jashtme: gjatësisë; peshës dhe formës së trupit: 'Çdo njeri është gjeometrikisht i caktuar'! Proporcionet njerëzore ideale i ka tregua Gjeniu Italian **Leonardo Da Vinci** (1452-1519), ku trupi i njeriut me duar të zgjatura shtrihet në brendësinë e një katrori ndërsa ky i fundit është i brendashkruar në një rreth qendra e të cilit ndodhet në pikëprerjen e diagonaleve të tij.

Disa proporcione të cilat Da Vinci i ka përshkruar në vizatimet e tija me tekst përcjellës flasin:

1. Shuplaka është e gjërë 4 gishta;
2. Largësia nga maja e gishtit të mesëm deri te baza e gishtit vogël është baras me gjërsinë e shuplakës;
3. Gjatësia e shputës është baras me gjërsinë e 4 shuplakave;
4. Gjërësia e njeriut me duar të shtrira është e barabartë me gjatësinë e tij;
5. Gjatësia nga bryli deri te majat e gishtave është sa $\frac{1}{4}$ e gjatësisë së tij;
6. Personi mesatar është i një gjatësie 4 bryla ose 24 pëllambë, e të

Për shumicën e nxënësve të ne zgjedhja dhe përcaktimi i profesionit jetësor kualifikohet si punë llotarie mëqenëse shkolla e cila jep 'diplomën' nuk i kryen 'detyrët e besuara të shpisë'! Në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare atëherë kur caktohen shtigjet e jetës shumë pak të rinj dhe të reja me tamam orientohën në Degët dhe Drejtimet përkatëse të studimeve, aty ku vërtetë ata kanë prirje! Devijimet janë të shumta dhe të shpeshta. Korigjimi eventual i orientimit profesional, për të ikur nga 'adresa e gabuar', do duhej ndodhë më së largu përgjatë një viti, tamam si divorci i martesave të dështuara, në kohën kur ende nuk kanë lindje fëmijësh! Një 'betejë e humbur' nuk është fundi i botës! Për çudi, ndonjë humbje është më e vlefshme se fitorja e një beteje! Është për t'u vlerësuar inteligjenca e personit pas dështimit në përcaktimin e parë, kur ai gjen 'adresën e saktë', aty dhe atje ku personi ka prirje në profesionin e (ri)gjetur jetësor i cili e shpien për të qenë i plotësuar dhe i realizuar!

Matematika nuk bën të paragjykohet! Megjithatë është lëndë mësimore e vështirë për t'u aftësuar dhe shkencë poashtu e vështirë për ta studiuar. Duhet ditur, të mësosh matematikën e më pas ta studiosh, personi ndikohet nga shumë faktorë subjektivë dhe më pak asish objektivë! 'Alfabeti' i mësimin të matematikës nuk mësohet përgjatë 'një dite' por as nuk harrohet gjatë 'ditës' dhe kohëzgjatja e të mësuarit të tij numëron tetë deri në dymbëdhjetë vite shkollore. Ai shtrihet në dimensionin e tij linearë dhe koncentrikë, përgjatë tërë shkollimit parauniversitarë.

Fillimisht duhet thënë por dhe duhet pranuar: 'Çdo mësues matematike nuk e meriton të jetë mësues matematike'! Fëmija nuk bën t'i dorëzohet mësuesit të pa ditur, por dhe të diturit i cili është egoist, duke ruajtur për vehte sekretin e mësimin të saj! Në matematikë duhet të futesh! Hyrja në të nuk ndodhë me sqarime te të tjerëve; që do thotë: 'Nuk ndodhë aftësimi në mësimin e matematikës nëpërmjet kurseve'! 'Alfabeti' i matematikës mësohet vetëm me punë individuale dhe sistematike, 'me laps në dorë', mbështetur dhe ndihmuar në Literaturë e cila ka në sfondin e

saj Leksione teorike dhe Përmbledhje detyrash, të cilat do duhej zgjidhur me radhë por 'pa e kapërcyer asnjë sosh', rezultatet e përpikëta të së cilave janë të kontrollueshme.

Euklidi (330-275 p. e r.) mësues i mbarë matematikanëve antikë dhe modern që erdhën pas tij, e kishte lënë këtë aforizëm: "*Matematika ia shpërblen mundin vetëm atij që interesohet për atë!*" Një e vërtetë e padiskutueshme aksiomë metodologjike, e përjetësuar. Megjithatë e para do mbetet shterpë po qe se nuk përfillet e dyta: "*Kush e ka lëvruar matematikën i udhëhequr vetëm nga dobia materiale dhe levërdia e çastit, ose ka dështuar ose s'ka arritur diçka për të qenë!*" (Aleko Minga, *matematikan i madh shqiptar*). Në teorinë e të mësuarit Problemi i Motivimit është i njohur dhe i studiuar mirë. Motiviti i jepet roli i forcës lëvizëse në të mësuar. Motiviti material për të mësuar e pastaj dhe për ta studiuar matematikën gëzon plotfuqishmëri!

Duhet pranuar studimi i saj përmbanë 'dozë' pasigurie ankthi dhe frike mëqenëse nuk është i sigurtë gjithnjë suksesi përfundimtarë. Në këtë drejtim aktualisht studimi i matematikës mbetet 'privilegj' e pak njerëzve duke pranuar që matematikanët janë kuadro shumë deficitarë. Statusi shoqëror i tyre mbetet i parregulluar! Me gjasë përgjatë dekadave të ardhshme ata mund të dukën specie të rralla! Tani parashtrohet një pyetje plus: Përse kandidatët potencial të cilët shpaleshin për matematikë, vetëdijshëm ikin nga studimi i shkencës së matematikës?! Duke mos u pajtuar me realitetin; çfarë duhet bërë në nivel global? Bakllavaja krahasuar me byrekun është disafish më e kushtueshme dhe të parën çdo amvisë nuk di ta gatujë!

Mësimi i matematikës nëpërmjet studimit të shkencës së saj tashmë ishte kryer por personi ende nuk ndjehej i realizuar! Nuk e lënte rehat vlerësimi emblematik: "Bindja e personit se e ka kryer mësimin e matematikës duke mos gjykuar të vetarsimohet, bën që ai përgjithmonë të mbetet në gjysmë të rrugës!" Dhe vërtetë, ai i cili kërkon punë nuk mbetet pa punë!

Pas punësimit në Arsimin e Lartë në Degën e Matematikës, Safiri ishte zhgënjyer me gjendjen faktike që ndodhej MMM, me të cilën edhe diplomohesh në Degë. Teoria e saj ishte shkruar në një 'paçavure' njëzetë fletëshe; edhe pas 13-të vitesh akademike ('67-'80) 'literatura' nuk kishte ndryshuar fare! Nuk vonoi shumë dhe nga preokupimet ditore filloi të dertojë dhe në gjum! Kishte parë një ëndërr të rrallë lidhur me botimin e disa vëllimeve nga MMM. Pas gjumit ende i shtrirë në krevat, për të qenë neveria shumë e madhe, ndodhi që *numri i librave të ëndërrës t'ishte më i madh se gishtat e një dore!*

Ëndërra është lloji veçantë i imagjinatës, kur personi krijon në mendje një tablo idesh; figurash; udhëtimesh; personash; pasurish; arritjesh, ..., një dëshirë e zjarrtë për diçka që dëshiron dhe që orvatesh për ta plotësuar! Zakonisht ëndërrat me arritje marramendëse, iluzore janë të porealizuara por ama çdo rregullë apo ligjëtori në brendësinë e saj mund të përmbajë diç të pashembullt!

Në kohën kur ishte parë ëndërra (1980) për Shqiptarët e Kosovës ka qenë 'ëndërr me sy çelur' të ndodhi 'Kosova Republikë!' 'Kosova shtet'! Për më tepër atëbotë me kontrollime rutinore dokumentesh nga ana e Policisë, po qe se ndeshej akronimi **K. R.** personin e ndaluar e priste maltretimi dhe ndëshkimi me burg disamujorë! Ndodhi një kthesë e madhe historike, diçka që nuk pritej kurrë në asnjë variant dhe as që mendohej realisht dekada më parë; diçka që nuk shihej në horizont bile as në ëndërr!

Dhe botimi i librave serikë MMM për çdo pesëvjeçarë si t'ishin "Referate" (problemore apo shkencore) i përkisnin një 'ëndërre të porealizuar', asnjë; asnjëherë; kurrë; kursesi! Por 'për ironi të fatmirit' ndodhi çudia mrekulluese, libri i pestë universitarë nga autori 'pa gradë', me emërtimin e ëndërruar dhe çudibërës **Metodologji**, i pari me këtë titull në trevat shqiptare, i botuar privatisht 'nën kërcnime universitare', në vitin e madhërishtëm të Shpalljes së Kosovës Shtet i Pavarur dhe Sovran (2008), kohë në të cilën Arsimi në Kosovë tashmë ishte politizuar!

Për një autor paksa anonim siç përfaqësohej 'Safiri plak', nuk ekziston diku kënaqësi më e madhe jetësore! Këto raste 'ëndërrash të porealizuara' bëjnë me dije që edhe atyre do duhej t'u besojmë! Lexuesi porositet, 'për çdo gjë' kurrën e kurrës, kurrë mos thuaj: "Kurrë...!"

Këtyre dy ëndërrave u bashkohet dhe ëndërra e tretë e pakonfirmuar nga matematikanët shqiptarë! Bëhet fjalë për **Pavarësinë e MMM nga Pedagogjia**, të cilën e shpurdh për herë të parë Safiri, në librat e tij të botuar ku Recensenti-Pedagog, me firmosjen e tij në Recensione ka shfaqur dakordimin e tij të plotë për çështjen! Kjo do ishte **Teza** të cilën do ta mbronin gjenerata matematikanësh shqiptarë që do vinin pas nesh! Atëherë do bëhej fjalë për ish-'Pedagogët uzurpues' dhe ish- 'Matematikanët e fjetur' të cilët nuk patën kurajo (guxim) ta pranonin MMM si 'bijë të tyre' por e 'falën' tek 'Pedagogët-uzurpues-demagog', të cilët nuk donin ta dinin ku e ku e ka kokën, trupin dhe bishtin Matematika?! Përgjatë shekullit 20-të vlerësonin që ende aplikohet 'matematika e shpellës' me katër operacione aritmetike ndërsa matematikanët 'belbër' me tërë atë kokë të madhe, 'luanin rolin e personit debil'! MMM tash së voni i është kthyer Matematikës, sepse ajo mbetet 'nëna biologjike' e saj!

Lidhur me mësimin e matematikës ka pak të ngjarë në jetën e një shkollari urrejtja dhe dashuria ndaj saj ta zëvendësonin njëra-tjetrën përgjatë dy muajve në moshën e rinisë kur kërkoheshin dituri bazike nga Trigonometria; Gjeometria Analitike; Planimetria dhe Stereometria. Ndodhi atëherë kur ekzistonte *Pushteti i notës*. Faji nismëtar u mbetej mësuesve të matematikës përgjatë 11-të viteve të shkollimit, thënë ndryshe një vit para se të merrej Matura! Pa mësues të mirë diturie, mësimet mund të bëhen të çoroditura. Pushteti i notës përmbysi situatën në nxënien matematike duke shndërruar urrejtjen e papërmbajtur fillimisht në një 'dashuri të fjetur' e më pas në një dashuri të pafund, të zjarrtë ndaj saj!

Pas sukseseve fillestare në nxënie matematike, për fat të keq në ndërdije të tij ndërfutet e mallkuara, Fobia matematike, (tamam si Fobia karshi lartësive; Fobia kundrejt detit -notit; Fobia ndaj vetmisë; sëmundjes; sigurisë; pasurisë; vdekjes; ngasjes së automjetit), së cilës ia ka parë 'sherrin' me orientim të vonshëm profesional!

Matematika i ofroi kënaqësi jetësore shumë dimensionale, duke i shkruar tetë (8) libra të Degës! Ajo i dha emër të mirë për të cilin ishte i lindur por mësuesit shkollëpak dhe të shpifur si matematikanë nuk dinin ta mësonin, udhëzonin dhe orientonin drejt 'shkencës së madhësive'! Matematika nuk mund të jetë Gogoli i vetëvetës kur ajo i shërben mbarë njerëzimit! Aftësia për të jetuar, vepruar e lulëzuar; për t'u zhvilluar e përparuar njerëzimi pa ndërprerje si forcë jetësore, mbështetjen e ka tek Matematika! Gogoli i vërtetë dhe i padiskutueshëm mbetet mosangazhimi i mësuesit për mësimdhënien cilësore dhe pa hile të saj i përcjell nga egoizmi dinak i tij!

XX. NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Safiri nuk ishte punësua në Arsimin e Lartë me pretendimin që do të dijë të shkruaj libra! Nuk e kishte studiuar Gjuhën shqipe por as Gazetarinë! Botërisht e kishte pranuar; deri në moshën tridhjetë e pesëvjeçare (koha kur u punësua në SHLP) ishte në padijeni të plotë për të shkruar!

Botim librash universitare në ‘*seri pesë vjeçare*’ ku e kanë shkakun? Pse u bë gjithë kjo punë? Cilat ishin shtysat për një veprim të tillë? Në mënyrë fragmentare ai vetë dëshiron t’i paraqet shkaqet të cilat e nxitën së jashtmi dhe e motivuan së brendshmi për t’ia nisur nga hiçi.

MMM('87) Rektori i UP i viteve të ('80) të shekullit të kaluar ishte personi i cili bëri histori. ‘Në Universitetin e Prishtinës nuk ka vend asnjë mësimdhënës i cili nuk shkruan një libër apo një dispensë për studentët e tij!’ Për Safirin apeli mjaftoi!

MMEM('93) Botimi i parë i këtij libri ishte refleksion dhe rrjedhojë e shqetësimit të madh të autorit lidhur me fatin e Shkollës shqipe, këtu në Kosovë. ‘Shkolla shqipe ishte e burgosur’ dhe ‘Sistemi librarë së bashku me ETMM ishin nën dry’. Rektorati i UP gati ishte zhbërë. Shpërngulja masive e të rinjve tanë nëpër Evropë ishte e dhimbshme, vajtuese dhe pikëlluese Bashkë me ata u larguan edhe shumë kuadro të mirëfillta universitare. Ishte mbyllë Televizioni i Prishtinës dhe u ndalua botimi i gazetës së përditshme Rilindja. Ende luftohej nëpër disa ish Republika sllave dhe në Kosovë ndihej ‘erë lufte’!

MMM('98) Ishte nxitja e hershme dhjetëvjeçare nga ish-Ministri i Arsimit dhe deklarata e tij e panjerëzishme për MMM('87): “Kemi gabuar që lejuam botimin e tij nga një autor anonim”, bëri që Safiri të angazhohet maksimalisht për ta shkruar e më pas për ta botuar (me participim mjjetesh nga UP) dhe për nevojat mësimore të FSHMN- Dega e matematikës, duke vjel edhe kontributet e Pedagogut në cilësinë e Recensentit, të cilat i mungonin në botimin e parë, por edhe t’i tregonte ish-Rektorit ('87) që çdo ‘emër’ krijohet nga ‘anonimi’! Kjo ishte ‘historia’ e vërtetë e MMM ('98) përndryshe ishte kohë lufte!

Me rastin e botimit të dytë, në faqen nëntë të librit ishte shkruar: “Në harkun kohor në mes botimit të parë dhe atij të dytë (1987-1997) këtu te ne në Kosovë u shfaqen dhe u realizuan ecuri dhe rrjedha shkatërrimtare të Arsimit Kombëtar në të gjitha nivelet. Falë ngulmimit dhe durimit të paepur gjithë popullor, sakrificave mbinjerëzore edhe të vetë personelit arsimor deri në vetëflijim për ta ruajtur shkollën shqipe, me çdo kusht, ajo mbijetoi”.

MMEM (2003). Në kohën kur luftohej nëpër fshatra përgjatë viteve 97/98, Safiri i tjetërsuar në plotësinë e tij, ishte më afër vdekjes si asnjëherë më parë. Në qytetin e lindjes, rreshtat për ta blerë një bukë ishin krijuar që në mëngjesin e hershëm, dilej familjarisht, për të blerë bukë më shumë! Në atë periudhë ai ndodhej në ‘zenitin e krijimtarisë’ së tij dhe burimet e ideve për ta krijuar dorëshkrimin rriteshin në mënyrë mahnitëse, e pabesueshme por e vërtetë, në kohën kur jeta e njeriut mund të fikej në çast! Dorëshkrimi po shkruhej pa e ditur fare a do të mbijetojë ai dhe shkruesi i tij! Si çdo prind që e veçon njërin prej fëmijëve paksa më të dashur edhe për Safirin libri MMEM (2003) ishte ai i veçanti i cili krahasohej me mbijetesën personale të tij, hiç më pak, më qenë se vlerësonte po humbi dorëshkrimi (ishte i pa fotokopjuar) edhe po qe se mbetej gjallë, nuk do dijë ta shkruaj edhe një tjetër të ngjashëm me atë! Për ta shpëtuar kokën vetë iku në shtetin Amë dhe dorëshkrimin e kamufloi në centrifugën e mjalitit! Fatbardhësisht dorëshkrimi kishte mbijetuar! Gjithnjë ‘loti e tradhton’ kur rilexon katër rreshtat e fundit!

Është paksa e pazakonshme dorëshkrimi edhe pasi e mori ‘dritën jeshile’ për t’u botuar (dhjetor, 2000) ai ‘për të mos u plakur, para se të botohej’, iu nënshtrua ‘rrymës së ndryshimeve substanciale’ të kohës, nën dritën e Zhvillimit të Mendimit Kritik, lidhur me:

Sistemin e ri Arsimor dhe Kurrikulin e ri të Kosovës;

Përpunimin e Teknikave dhe Metodave të Mësimdhënies;

Orën e mësimi dhe strukturën e saj ERR.

dituri teorike e praktike, të vjela përgjatë tri dekadave, nëpërmjet së cilave aplikohet Mësimdhënie bashkëkohëse e sjell nga Perëndimi i përparuar.

MMM (2008) do ishte i përbërë nga 16 kapituj, themelet e të cilit ishin vënë dekada më parë, me kapitujt nismëtarë I ; II ; III ; IV ; V ; VII ; VIII ; dhe IX. Më qenë se gjysma e punës ishte kryer, duke u nxitur nga 'shoku' i tij fëmijërisë, sot punëtor shkencor me emër: 'Vazhdoje punën, ti di të shkruash', ai atëherë i ndezi shpresat për atë, duke e kompletuar botimin me kapitujt: VI; X; XI; XII; XIII; XIV; XV dhe XVI. Motivi për ta shkruar librin *Metodologji e mësimdhënies së matematikës* dihej, i cili ishte shumëfish më i madh krahasuar me librat tjerë të *Metodika e mësimdhënies së matematikës*, para se gjithash ishte motivi kombëtar, meqenëse u punua shumë për të qenë libri i parë bashkëkohës i shekullit 21-të, me këtë titull në trevat mbarë shqiptare! Dorëshkrimi 'Metodologji e mësimdhënies së matematikës' nga Recensentët vlerësohej si Tekst bazik universitarë duke e pranuar për botim! Përkundër pengesave mesjetare+ të Rektoratit të UP (2008) dhe Dekanatit të Fakultetit të Edukimit, duke qenë i lirë në mendim dhe veprim për herë të tretë deri tani, vendosi që MMM (2008) ta botojë privatisht!

LMMM(2013) Një vit pas pensionimit atëherë kur më së paku priste një biçim gjuhëtarësh përreth tij, belbër për të shkruar dhe për të punuar e kurdisën një model 'Kali Troje' nëpërmjet një 'Kontrate false', në 'origjinale', të nënshkruar nga dyshja Dekani por edhe Rektori (2011) e nxitën autorin për ta provuar 'pushtimin dhe të një pylli', i cili ngjasonte një 'xhungle' të braktisur. Puna e tij ishte ta shkruaj dhe një libër me konceptet themelore matematike për Parashkollorët por me shumë mundim ia doli për ta përfunduar në moshën gjashtëdhjetë e shtatëvjeçare, të gjashtin të cilin e kishte lënë mangët!

MMM (2020) 'Botimi i librave të Safirit i ngjason një filmi serik dokumentar'! Pas reagimit drejtuar ASHAK lidhur me mos përfshirjen e tij në 'Enciklopedi' edhe pse ishte autor i gjashtë librave universitarë, një ditë me diell i shkrepri një mendim! Tani është viti 2018, thoshte me vete! Kishin kaluar dhjetë vite qëkur në treg nuk kishte ngelur asnjë kopje nga MMM (2008). Ritmi i shitjes së tij tregonte që lexuesi e kishte pritur shumë mirë! Disa faqe dhe gjysmë faqe të tij kishin mbetur bosh. Kishte edhe gabime të tjera teknike, gramatikore. Çdo kapitull shkencor ishte pajisur me *Portën hyrëse* prej disa rreshtash (f.13-f.16) Vetiu kuptohej që mungonte *Porta dalëse* (Në vend të përfundimit). Funksonit edukativ të mësimi të matematikës do duhej t'i shtohej leksioni lidhur me Edukimin Kompjuterik, më pas Mësimi Tematik do duhej t' i ketë disa shtesa e përmirësime, por edhe ndreqje, plotësime e përshtatje të tjera, të cilat puna dhe jeta ditore i kishte zbuluar!

Ideja për ta krijuar librin e shtatë u fuqizua akoma më shumë me faktin, po qe se do botohej më 2020, atëherë në atë vit do shënoheshin:

Dhjetëvjetori i botimit librit *Metodologji e mësimdhënies së matematikës* (2008-2018);

Dyzetë vjetori i punës shkencore të autorit (1980-2020) dhe

Shtatëdhjetë e pesë vjetori i lindjes së autorit (1945-2020).

Të gjitha këto ishin arsye të mjaftueshme që ai të nxitet dhe motivohet, për të punuar në vazhdim dhe dy vite të tjera për ta parë dritën *Metodologji e mësimdhënies së matematikës* si Botim i dytë i plotësuar dhe i përmirësuar.

Dorëshkrimi i librit MMM (2020) kishte përfunduar në fund të shkurtit 2020. Pritja e botimit të librit ishte çështje ditësh, kuptohet përgjatë pranverës, në vigjilje të shtatëdhjetë e pesë vjetorit të lindjes së autorit. Që nga fillim viti, ai kishte parandjenjë të një frike të pashpjegueshme nga shifrat e njëjta 20/20, të cilat përsëriten njëherë përgjatë mijëvjeçarit (mileniumit)!

Vërtetë ndodhi frika reale nga 'fabrika e vdekjeve të porositura', ku prurës i tyre ishte Pandemia Covid-19, e cila mori jetën e mbi katër milion e gjysmë njerëzve në mbarë botën, ndërsa në Kosovë ikën për të mos u kthyer më, mbi tremijë veta (24. Janar. 2022), si t'ishin insekte! Në historinë e njerëzimit do shënohej me vijë ndarëse; periudha kohore para dhe pas Korona virusit, për mënyrë tjetër sjelljeje, përsëritjeje, qëndrimi, arsimimi, largësie, kualifikimi, izolimi, punësimi, shoqërimi, vendosjeje, mbrojtjeje, shërimi, komunikimi, pushimi, argëtimi, udhëtimi, shit-blerjeje, vlerësimi, mbledhjeje, intervistash, solidariteti, përcjellje funeralesh...

Populli shqiptar e përdorë thënien: Dhe ja "**ra ky mort e u pamë**"! U ribotua libri "*Metodologji e Mësimdhënies së Matematikës*" (i plotësuar dhe i përmirësuar) i vetmi i këtij lloji në truallin mbarë shqiptar, në vitin e 'lulëzimit' të Pandemisë Covid-19, kur vdekjet e personave të moshës 75-të vjeçare, si kjo e libër shkruar ishin të 'porositura'! Intelektualët zemërplasur komunal, 'zbuluan' skenarin e marrëzisë së tyre; tani është momenti që autorin e (7) shtatë librave universitarë, **pionierin** e kësaj disipline shkencore ta shndërrojmë në një hiç!

Libri i shtatë MMM (2020) doli nga shtypi më 1 Shtator 2020 atëherë kur viti shkollor '20/21' po fillonte relativisht mbarë, pa kufizime të mëdha! Por, 'njerëzit e politikës të veshur me pushtet' të sistemuar në vende 'qeveritare' dhe 'joqeveritare' vendore (komunale) ishin futur në istikame duke propaganduar në drejtoritë e shkollave e librari të qytetit dhe jo vetëm, që 'autori i këtij libri nuk bën të komunikojë me mësueset', lidhur me promovimin dhe plasimin e librit tek lexuesit! Këta tanimë e kishin marrë 'rolin e inspektorëve arsimorë' me një ekip 'Recensentësh politik' me 'direktivë partie', të pa shkolluar e të paarsimuar, nën hije, pa pagesë! Ndërhyrja ishte e egër, jo civilizuese, anarkike dhe anakronike për ta politizuar sa më shumë Arsimin tonë të nëpërkëmbur por si dukuri shumë e rrallë sjelljeje dhe veprimi e protagonistëve mbetet 'rast emblemë' e kësaj natyre!

Libër shkruar kishte vizituar një "**Asociacion joqeveritar**"; Drejtorinë komunale të Arsimit duke u dhurua kopje libri (të dyja në lidhje vertikale me Pushtetin vendor); një **Shkollë të mesme pa zanat**, ku mungon Orientimi profesional dhe një **Shkollë filllore**, e cila në vitet e 70-ta të shekullit kaluar ishte *model i javës pesëditore të punës* në Kosovë, aty ku para gjysmë shekulli kishte punuar vetë! Për ta promovuar librin nëpër shkolla me pengesa të kësaj natyre, autori nuk ishte ndeshur as në kohën kur shkolla shqipe ishte e 'burgosur'!

Paksa më vonë u 'zbulua arsyeja', përse u krijua situatë e 'ndalimit' të librit, edhe pse në libraritë e kryeqytetit shitej nga fillimi, pa pengesa! Këta 'bajraktarë vendorë' me kompetencë Partie, kishin marrë rol rrugaçerie mbi Recensentët Akademikë! Këta në cilësinë e 'Shpëtimtarëve të Arsimit' synonin ta vazhdonin situatën 'gjendjeje të mëparshme' në Arsim, mëqenëse ish- Pushtetet e tyre Qendrore përgjatë dy dekadave të pasluftës nuk ia kishin dalë ta rikthejnë shkollimin cilësor të viteve të 80-ta, i cili na iku dhe e shkallëzuan me Arsimin afrikan!

Ndalimi i plasmanit të librit MMM (2020) nëpër shkolla dhe librari të vendlindjes ishte ide mesjetare, me efekte negative afatshkurtëra në ambalazhin e një naiviteti të paparë intelektual, në kohën kur sa po 'fjala del nga goja' atë e 'lexon e tërë bota' (nëpërmjet Internetit)! Kjo mbetet një 'damkë e regjistruar' për 'njerëzit e gjakut t'im' që e bën edhe autorin e librit të turpërohet para të huajve me veprimin e tyre të shëmtuar, i cili lexohet dhe futet në analet e historisë së Arsimit të prapambetur!

“Shpëtimtarët e Arsimit” vlerësonin që libër shkruesi nuk ishte kompetent të merrej me Objektiva të caktuar të Reformës shkollore, me pretendimin që autori është ‘cullak’. Sipas tyre libri MMM (2020) shpërfaq *Tema tabu*, të cilat askush asnjëherë ‘nuk ka guxuar t’i për mend’. Me gjasë, për këtë u thirrën ndaras për të dhënë gjykimin dhe vlerësimin njëri ndër mësimdhënësit më të njohur të kësaj fushe që ka Shteti amë dhe Ministri aktual i Arsimit (2021), të cilët i dolën krah autorit dhe Reformave të mirëfillta, duke i bërë me dije të pranishmit që Reforma shkollore zgjatë (20-25) vite. Shqipëria dhe Kosova janë dy vende të vogla demokracia e të cilave është e brishtë; me ndërrimin e Qeverive, nuk bën të kemi futje politizimi dhe ndërhyrje në Arsim. Kësaj radhe për fat të mirë, u ‘zbulua’ dhe një vend i rinj pune, zëdhënës në Ministrinë e Arsimit! Çfarë përmbanin ‘*Temat tabu*’, të cilat ‘*do ta prishnin Arsimin*’, për të cilat kishin kundërshtuar SBASHK-u, drejtorët e shkollave, por edhe shumë ish-qeveritarë të lëmit të Arsimit!?!- Ta zëmë:

- *Përdorimi i librave shkollore alternative dhe në gjuhë botërore (anglisht ose gjermanisht);
- *Konsolidimi i Pushtetit të notës, nëpërmjet tre vetave;
- *Eliminimi i dyshit famëkeq (nuk di si duhet por bën përpjekje) i aplikuar që nga viti 1963!
- *Testimi i nxënësve pa e treguar identitetin?!
- *Shuarja e Qendrave Didaktike;
- *Themelimi i Inspektoratit arsimor, Vendor dhe Qendror lidhur me Mësimdhënie, me kompetenca këshilluese-ekzekutive e të ngjashme me llogaridhënie;
- *Organizimi i Mësimi Plotësues, obligues;
- *Organizimi i Mësimi Ekipor, në mbështetje kapacitetesh kuadrosh;
- *Arsimi Kompjuterik obligues;
- *Aplikimi i Mësimdhënies dhe i Mësim-nxënies në distancë;
- *Aplikimi i vlerësimit në Dosje;
- *Zhvillimi i Mësimdhënies sipas strukturës ERR; me Teknika e Strategji të Zhvillimit të Mendimit Kritik (34);
- *Zbritja e mësimdhënies tek nxënësi. Nxënësit një nga një, të pranojnë rolin e mësuesit;
- *Aplikimi i Objektivave të shkollës së shekullit 21-të dhe të tjera të aplikuar në Perëndim!

Objektivat mësimorë në mësimdhënie; *Në fund të orës mësimore nxënësi të jetë i aftë: Të dallojë...; Të identifikojë...; Të klasifikojë...; Të vizatojë...; Të formulojë...; Të gjykojë...; Të veçojë...; Të “zbulojë”...; Të tregojë...; Të provojë...; Të demonstrojë...; Të copëtojë...; Të përcaktojë...; Të llogaritë...; Të ilustrtojë...; Të mbrojë...; Të argumentojë...; etj.*

Si plotësohen Objektivat mësimorë për klasat: E pesta Filllore dhe E nënta e Shkollës së Mesme të Ulët? Cilët janë këta objektiva!?

Çfarë objektiva mësimorë shpërfaq shkolla e Mesme e Gjinnazit? (Kishte me qenë Temë e përzgjedhur hartimi, përgjatë klasës së IV gjinnazit!)

Gjumnazi është Shkollë e Mesme “pa zanat”! Si orientohen, ndihmohen, kontrollohen dhe udhëzohen nxënësit për ta zgjedhur tamam profesionin e jetës?!

A pranohen botërisht dështimet e shumë personave në shkollën e mesme të Gjumnazit? Çfarë flet praktika jetësore e këtij libër shkruesi? Çfarë mund të kopjojmë nga funksionimi i Gjumnazeve në Perëndimin e përparuar!?

Çfarë duhet të ishte udhëheqja e Gjumnazeve nëse mësuesi i “gjumnastikës së trupit” e pranon detyrën e mësuesit të “gjumnastikës së trurit”?

A fillon nga këtu “**Arsimi i Politizuar**”, kur “në fund të ditës” *juristi* emërohet **Ministër i Shëndetësisë** ndërsa *ekonomisti* emërohet **Ministër i Arsimit** (Kosovë, 2020) e postet i pranojnë me padurim dhe me shumë qejfe!

Le të marrim për shqyrtim vetëm **Temën** e parë **Tabu** lidhur me librat shkollorë. Vërejtjet e thëna lidhur me librat kishin hatër mbetje, ku pezmi shprehej ‘në libër nuk bën të kritikohet libri!’ Por MMM është ‘dora e fundit’ nëpërmjet së cilës analizohet cilësia e librit! Librat tanë shkollorë përmbajnë gabime të natyrave të ndryshme, të përsëritura, nga viti shkollor në tjetrin:

a) Ekzistenca e paradoksit, numri i faqeve të librit (V-VIII) nga viti në vitin tjetër shkollor zvogëlohet:(f.242; f.183; f.157). Nuk ka bashkërendim kurikularë, mes autorësh librash;

b) Ekzistenca e paradoksit, numër më i madh rregullash dhe përkufizimesh mësohen në klasat e VI-ta në krahasim me klasat e VII-ta dhe ato të VIII-ta (125; 64; 68);

c) Paraqitje e përsëritur e përkufizimeve në klasa të ndryshme;

d) Kompozim rregullash dhe përkufizimesh me shumë fjalë dhe duke i përsëritur fjalët;

e) Në vitin 2007 ndodhi që për klasën V-të fillore të kemi në qarkullim 4 libra, të cilat së bashku numëronin 352 faqe dhe kushtonin 7,5 Euro! E të tjera.

Matematikanët më në zë që kishte vendi, që shkruanin dhe ishin autorë librash ciklesh shkollash të ndryshme, nuk e pëlqenin Safirin për Recensent të tyre. Nuk donin ta dinin që ishte ‘gjallë’ dhe po merrej me botimin e librave nga Metodika dhe Metodologjia e mësimdhënies së Matematikës, aty ku ekzistonte mundësia reale që ‘në libër mund të kritikohet libri!’ Në heshtje vlerësonin: Është me shkollë-pak dhe i pazoti të merrej më këso lloj pune, edhe pse faktikisht ai ishte pionier i MMM në trevat shqiptare! Recensenti i cili e ‘zbuloi’ dhuntinë e tij për të shkruar i thoshte: ‘la kam thënë të parit dhe të fundit, merrni Safirin për Recensent, se u del më mirë!’ Nuk donin që shkrimet e tyre të kishin vërejtje, e aq më pak ato të jepeshin nga një ish student i tyre! Bile ‘autorët pa llogaridhënie’ vlerësonin si ish- Administratori Daxner: ‘Kush nuk ka titull shkencor është i pakualifikuar dhe nuk u duhet!’ Ata shkruanin ‘me porosi’ që librave të tyre brenda ditës t’u jepej Recensioni pozitiv për botim!

Për çudi Safiri nuk kishte pasur asnjë ofertë të vetme për të qenë Recensent i ndonjë libri, kur dihej që kishte ndërruar tetë vende pune; mësues fshati, mësues matematike në shkollë fillore; gjumnaz; në të gjitha shkollat e mesme profesionale (aty ku mësohet matematikë), Këshilltar Pedagogjik; ish- ‘ministër komunal’ Arsimi dhe mësimdhënës në dy SHLP (Shkolla të Larta Pedagogjike)!

Mësimdhënësit universitarë ‘nuk ishin kompetent në plotësinë e tyre’ për të qenë autorë librash të matematikës për Shkollën Fillore! Me gjasë, ata nuk kishin punuar asnjëherë në shkollën fillore! Në aftësimin profesional janë të njohura shkallët e kalimit nëpër faza: shegert, kallfë dhe mjeshtëri. Kur dikush i kapërcen këto, vështirë e ka të gjendet si mjeshtëri!

I Në librat ekzistues të Shkollës së Mesme të Ulët (VI-IX) nga nxënësit kërkohet që mësimit t'i qasën nëpërmjet shkathtësive intelektuale të ulëta, siç janë mbajtje mend dhe riprodhim informacionesh të mbajtura mend.

II Nuk vërehen askund gjurmë për të pasur Mendim Kritik ndaj informacioneve;

III Po këtu mungon Të mësuarit me objektiva;

IV Nuk vërehen as gjurmë të Zhvillimit të mësimit sipas Strukturës E R R , as gjurmë teknikash dhe strategjish bashkëkohëse në mësime dhënie. Nëpërmjet këtyre të fundit ndryshohet fokusi i të nxënës (ndërtimi i kuptimit të tekstit dhe jo përsëritje e fjalëve të tekstit);

V Përmbajtjet e librave janë të sofistikuara, me peshë të rëndë dhe familjari bëhet 'hamall'

VI Edhe pas njëzetë vitesh, mësuesit të cilët aplikojnë mësime të bashkëkohëse, aktualisht janë 'specie' të rralla. Përgjatë këtyre viteve nuk u botua asnjë libër matematike i cili kishte për të ofruar shkëputje fillestare nga mësime tradicionale. **Librat shkollor bien ndesh me aktualitetin arsimor** (por dhe me këtë Metodologji)!

Tani për shqyrtim le të marrim dhe **Temën** e dytë **Tabu**:

Konsolidimi i **Pushtetit të notës** nëpërmjet tri vetave.

Suksesi i Reformës shkollore (kuptohet vetiu dhe i Mësimit të matematikës) përcaktohet nga "trekëndëshi magjik": *Kurrikuli*; *Transmetimi* (përcjellja) *i njohurive* (diturive) dhe *Vlerësimi me notë*. Nëse ekziston 'pushteti i notës' edhe pa transmetim cilësor të diturive, nxënësi me vetë- arsimim bëhet i lumtur! Së këndejmi, ekzistenca e **Pushtetit të notës** së bashku me **Kurrikulin** cilësor e përcaktojnë suksesin e **Reformës shkollore**.

Për mësimin e Matematikës, po qe se 'Pushteti i notës' mungon, atëherë vlerësimi i diturive nuk ka kuptim! Është njësoj si '*mbush ujë me shoshë*'! Vlerësimi i diturive (nëpërmjet testimit) para një ekipi mësuesish është shumë më objektiv, tamam si sistem referimi në një ndeshje top-këmbe!

Rezultatet në PISA/2016 dhe PISA/2018 dëshmuar që dijet e nxënësve tanë nuk janë funksionale për jetën reale. Krahasuar me moshatarët e vendeve tjera, ata nuk mund të kuptojnë, ta përpunojnë, ta përdorin, ta vlerësojnë, të reflektojnë dhe ta integrojnë informacionin! Nuk janë në gjendje ta përfaqësojnë matematikisht një situatë fare të thjeshtë, nga jeta e përditshme, ta identifikojnë e të shpjegojnë saktë një dukuri tregtare, ekonomike, komerciale, juridike, ndërtimore, matematike apo fizike.

Në këtë drejtim, Arsimi Kombëtar nuk bën të jetë i politizuar e kjo do thotë që pavarësisht cili grupim qeverisës udhëheqë vendin, vlerësimi i diturive të nxënësve (studentëve në fakultete por dhe ata në provimet e magjistraturës dhe të doktorant-urës) dhe kategorizimi i suksesëve të tyre duhet të jetë objektiv, duke nënkuptuar ekzistencën edhe të nxënësve përsëritës dhe ata të vonuar apo të dështuar, shkollimi i të cilëve ka shtegdalje të tjera, me ndërrim shkollash, nivelesh dhe vlerash më të ulëta!

Ta zëmë, në fakultetet e Gjermanisë aplikohen këto nota kaluese: shtatë(7); tetë(8); nëntë(9) dhe dhjetë(10). Po qe se studenti nuk është i suksesshëm në provim, as pas herës së tretë të nënshtrimit (kalueshmëria e provimeve vlerësohet para komisioneve), kandidatit në fjalë i ndërpritet e drejta për të studiuar në Fakultetin e asaj Dege (e atij lloji) në nivel vendi! Aftësitë intelektuale të frekuentuesve gjithnjë janë të ndryshme. Nuk është e thënë që çdo personi do duhej t'i ofrohej kalueshmëri!

Përfundimisht,

Faktet e përmendura janë reale dhe të prekshme! Pas një pune sistematike 40-të vjeçare u botua një libër Metodologjie lidhur me mësimdhënien bashkëkohëse të matematikës të cilin njohësit e fushës e pagëzuan **Abetare e matematikës!** Edhe pse aty nuk vërehej asnjë shenjë ideologjie, Politika lokale së bashku me njerëzit e saj, të shpërfaqur, u ulën këmbëkryq në këtë libër, "**duke e shpikur bishtin**" **Tema tabu!** Intelektuali me mentalitet të shek.19-të e mori rolin e Tellallit **të përhapë fjalë poshtë e përprjetë, për librin por edhe për libër-shkruesin (si matematikan i vonshëm dhe** pa titull shkencor), nëpër shkolla, librari të qytetit dhe në Radio-televizionin lokal, aty ku prej kohësh është kryetar bordi. Të gjitha këto zhurma me bujë, *në interes të një tjetri*, i cili para dyzetë vitesh donte ta prekte 'qjellin me dorë'! Dy shokët e pandarë sinqerisht më dhimbsen, sepse dikur kishin koeficient inteligjence më të lartë se njëqindetridhjetë ndërsa sot në të shtatë dhjetat, te ata sheshazi vërehej mungesa e freskisë intelektuale për ndryshe veprimi i tyre nuk ishte i logjikshëm! Më dhimbsen diplomat e tyre të cilat flasin krejtësisht ndryshe!

Për ta testuar '*frymëmarrjen*' e Bordit të **Televizionit në fjalë**, me rastin e *Ditës së Mësuesit /'22* autori me shtatë vëllime librash universitare, kishte plus edhe arsyen e **pionierit** të kërkojë sigurimin e një kohe e hapësire foljore disa minutash me veteranin shtatëdhjetë e shtatëvjeçar të Arsimit. **Kjo nuk iu mundësua.** Për motive të ulëta (të një mentaliteti mesjetar) apo dhe të larta+ (të një shpirtplasuri), aktualisht përgjatë viteve shkollore 2020/21 dhe 2021/22 penguan deri në zhvatje promovimin deri në plasman të librit MMM/2020, nëpër shkollat e vendlindjes, edhe pse libër shkruesi nuk i përkiste asnjë partie politike! Intelektuali po qe se, nuk orientohet dhe udhëhiqet me qëllimin e mirë nuk sjellë asnjë dobi, për më tepër ai mund të shkaktojë dhe shumë dëme. Sikur këta persona të ishin veshur me Pushtet Qendror me gjasë do ta tërhiqnin librin nga shitja për të cilin kemi pritur 70-të vite, ta shkruaj si disiplinë të pavarur shkencore një matematikan i vonshëm shqiptar!

Aktualisht, *Arsimi në Kosovë është i politizuar* në të gjitha shkallët e shkollimit, herë-herë edhe skajshmërisht, i përcjell me banalitet! Rasti ynë përfaqëson një primitivizëm intelektual! Kundërshtarët e plasmanit të librit MMM/2020, fëmijët e tyre i kanë dërguar për shkollim në vendet e Perëndimit të përparuar!!! Si e gjykoni ju këtë!? A mund të gjendet ndonjë paradoks i ngjashëm ose identik më i madh i kësaj natyre, ndërsa në sirtarët e bibliotekës familjare edhe pas dy vitesh blerësin e presin më shumë se gjysma e kopjeve! Shkrimi i librave, botimi dhe plasmani i tyre tek lexuesi, për autorin asnjëherë nuk kanë qenë të udhëhequra nga dobia materiale dhe lëvërdia e çastit. E rëndësishme ishte 'mos të vjetrohët, para se të shitej'! Libri MMM (2020) edhe pas shumë vitesh nga botimi, kurdoherë që shfletohet do ta ruan freskinë e tij bashkëkohëse! Cilësia e përmbajtjes aktuale gjithëpërfshirëse e tij pasqyrohet nga kodi konvencional shifrash flakëruese ISBN e që e kuptojnë vetëm ata që dinë të lexojnë në këtë gjuhë!

Prania eventuale kaheër e munguar në një emision rasti në Radion dhe Televizionin lokal, me rastin e *Ditës së Mësuesit (7 marsit)*, nuk planifikohej të kishte premisa reklame të personit në moshën 77 vjeçare! 'Do ishte mirënjohje publike' për aktivitetin e tij botues, pa ndërprerje, më pas për ta reklamuar e shpërndarë librin universitarë aq shumë të rrallë, si në kohë lufte po ashtu dhe në kohë paqeje, për ta rrëfyer jetën dhe veprën e tij përgjatë 42 viteve të fundit e cila nga shumë veta vlerësohej si specifike dhe paksa e rrallë, e padëgjuar më parë!

Studimi i shkencës së Matematikës, fillimisht nuk ishte as në Planin A, as në B por as në Zh, bile as në ëndërr! Ndodhi fati njerëzor në disa episode jetësore, të sinkronizuara, si të ishin kaheër të porositura, për të rilind një matematikan, krahasuar me të tjerët paksa i vonshëm, i cili gjuhën me të cilën flet matematika e mësoi nga zori, në moshën e pjekurisë! Faji i kësaj 'situatë përrallore' nuk mbetet 'jetim'! Ajo ka një adresë; *mësuesit dhe mësuesit e matematikës mbeten 'personat pa llogaridhënie'*.

Fillimisht, kreator i aftësisë dhe paaftësisë së nxënësit në mësimin e matematikës është mësuesja (I-V) dhe familja, porse ndikimin e vet e ushtron edhe rrethi i gjerë shoqëror. Realisht, mësuesja e lëndës së matematikës (VI-IX) mbetet faktori kryesor dhe rrethanë përcaktuese nga e cila varet aftësimi i nxënësit në mësimin e saj. Nxënësi i moshës së re ka besim të plotë në aftësinë e mësueses. Ajo për nxënësin është gjeniale dhe çdo veprim të saj e mbron me kryeneçësi. Nxënësi e mbron tezën 'Ashtu mësuesja ka thënë, prandaj ashtu duhet të mbetet!

Mësimi i matematikës në shkollë aty ku zënë fill mësimi i organizuar mund të krahasohet me një 'lotari jetësore'! Të gjithë mësuesit e matematikës nuk e meritojnë me qenë mësues matematike! Çdo fëmijë si qenie e padjallëzuar, nuk e ka fatin e mirë ta mësojë mësuesi i pajisur me dituri cilësore, i udhëhequr me mendime të çiltra, pa paragjykime dhe me gjenetikë bamirësie. Pa dilema mund të themi lirisht, *Matematika dhe mësimi i saj nuk është Gogoli, por gogol mbetet mësuesi i saj!*

Në Perëndimin e përparuar (ta zëmë në Gjermani..) mësimdhënien e matematikës, mund ta ushtronte personi i diplomuar me sukses të shkëlqyeshëm në matematikë! Arsyja e formuluar ishte: 'Për ta vlerësuar objektivist nxënësin e shkëlqyeshëm, edhe vetë do duhej të ishte e tillë'! Të diplomuarit me suksese të tjera, më të ulëta punësohen aty dhe atje ku matematika gjen aplikim, por jashtë veprimtarisë së mësimdhënies. Vlera e mësuesit të shkëlqyeshëm në matematikë nuk mund të matet, me kushtin që ai të jetë i padjallëzuar dhe i pajisur me shprehi punuese!

Kishte edhe shumëçka për të thënë në atë emision eventual televiziv, i cili mbeti i perealizuar duke u penguar nga disa shpirtplasur përreth tij dhe të tjerët për xhelozitë e inate personale të udhëhequra nga një mentalitet mesjetar! 'Ziliqari i humb gjërat që i duhen'!

Lexuesit e librave të tij të shpërndarë anembanë vendit, të cilët e njohin me zë dhe me figurë, kësaj radhe do t'i gëzojë me një shtetë tjetër të rinj! Më qenë se ishte **fëmija i tetë** në familje; klasën e parë fillore fillojë ta ndjekë në moshën **tetë vjeçare**; karriera e tij jetësore ka regjistruar **tetë vende pune** dhe vërtetë jetës asnjëherë nuk i dihet dhe 'mbyllja e derës së një Radio-televizioni', për Safirin veteran arsimit, i moshës 77 vjeçare, deri tani libër-shkrues i shtatë librave universitare bëri të motivohet në atë masë për t'ia filluar **shkrimin e libërthit të tetë** me titull: "**Rastësia, si u bëra matematikan**"! Tani lexuesit i paraqitet paksa ndryshe, në detyrën e gazetarit, jeta dhe veprimtaria e të cilit ishte përplot të papritura, me ngjarje të vërteta por dhe pak të besueshme, nëpërmjet së cilave mund të ndërtohet edhe skenar të një filmi dokumentar, gjithsesi interesant!

Ky jetëshkrim intelektual i autorit të tetë vëllimeve me përmbajtje matematike u ekspozua me rastin e 78-të vjetorit të lindjes së tij dhe 43-të vjetorit të punës shkencore.

Gjakovë, 30. 04. 2023.